# Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komunitetit të Lezhës, 2013 – 2030

## BASHKIA LEZHË

**Titulli:** Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2030, Bashkia Lezhë

© Bashkia Lezhë, 2013

**Mbështetja metodologjike**

Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje, FLAG

Tiranë, Shqipëri.

**Mbështetja financiare për hartimin e planit strategjik**

LGI/SOROS, Budapest

**Mbështetja për aspektet gjinore të planit strategjik**

Programi i Kombeve të Bashkuara, PNUD, Tiranë

**Mbështetja financiare për botimin**

Programi i Kombeve të Bashkuara, PNUD, Tiranë

**Shtëpia Botuese:** Expo Vision Albania

**Paraqitja grafike:** Expo Vision Albania

# Fjala e Kryetarit të Bashkisë

Të Dashur Qytetarë dhe Bashkëpunëtorë,

Jam i lumtur të prezantoj para jush Vizionin "Lezha 2030" dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Lezhë.

Vizionin 2030 dhe Planin Strategjik janë tashmë kushtetuta e politikave të zhvillimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm të Bashkisë Lezhë në avancimin evropian të komunitetit, në rritjen sociale të ekonomisë dhe në modernizimin e qytetit tonë. Perspektiva integruese e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, politikat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë dhe objektivat e mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara kanë qenë orientimi ynë përgjatë gjithë proçesit të hartimit të Vizionit dhe qëllimeve dhe objektivave të zhvllimit të Lezhës.

Plani Strategjik, përmes qëllimeve dhe objektivave afatgjatë, na udhëzon qartë për përpjekjet që do të bëjmë të gjithë ne, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë, për të arritur Vizionin "Lezha 2030". Ne do të mirëpërdorim të gjithë partnerët dhe do të mirëpresim të gjithë bashkëpunëtorët në zbatimin me sukses të programeve dhe projekteve të Planit.

Shumë nga ju kanë kontribuar në hartimin e Vizionit dhe Planit, dhe gjej rastin të shpreh falenderimet dhe mironjohjen time të sinqertë për kontributin dhe bashkëpunimin përgjatë një periudhe dy vjeçare të hartimit të këtij Plani. Ky është Vizioni juaj dhe unë dhe Këshilli i Bashkisë Lezhë do të jemi me ju në realizimin hap pas hapi të tij.

Realizimi i Vizionit dhe arritja e objektivave të Planit tonë do ta pozicionojë edhe më fuqishëm Lezhën si qendrën ekonomike, arsimore, administrative, turistike dhe e transportit në rajonin e veriut të Shqipërisë e më gjerë në Ballkan, dhe do bëjë komunitetin shumë më besues dhe optimist, dhe qytetin shumë më miqësor me bizneset dhe vizitorët.

Për Këshillin Bashkiak, Plani do të jetë udhërrëfyesi i vetëm për të gjithë vendimmarrjen e rëndësishme në përcaktimin e prioriteteve, marrjen e vendimeve, alokimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore, njerëzore, financiare, kulturore e teknologjike për vitet në vazhdim.

Unë jam i bindur se përfitues të rezultateve të Planit do të jenë të gjithë qytetarët dhe grupmoshat, sipërmarrësit dhe njerëzit në nevojë, rinia, gratë dhe vajzat, dhe ndikimi i tij do të shtrihet përtej mureve bashkiake, duke mbërritur tek çdo banorë dhe biznes në Lezhë.

Bashkëpunimi midis të gjthë aktorëve dhe faktorëve është jetik për realizimin me sukses të Planit, dhe Bashkia Lezhë do të krijojë të gjithë mjedisin e nevojshëm për ta mundësuar angazhimin dhe kontributet e të gjithë aktorëve në zhvillimin e qëndrueshëm të Lezhës.

Pasioni juaj për Lezhën është garancia më e madhe për suksesin e këtij Plani dhe unë kam bindjen se sëbashku do ta bëjmë Lezhën qytetin ku duam të jetojme dhe jo thesht qytetin ku duhet të jetojmë.

**Përzemërsisht,**

**Viktor Tushaj**
**Kryetar i Bashkisë Lezhë**

# Mirënjohje

Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunitetit të Lezhës, 2013-2030, është produkt i hartuar nga Bashkia e Lezhës, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e FLAG, në kuadër të projektit "Drejtimi i Ekonomisë Lokale përmes Teknikave dhe Aleancave" (DELTA faza 2), të finacuar nga LGI-Budapest, si dhe me mbështjen e PNUD, përsa i përket aspektit gjinor, dhe përbën një përpjekje shumëpalëshe për të udhëzuar, bashkërenduar dhe balancuar zhvillimin e Bashkisë Lezhë me zhvllimin në Qarkun Lezhë dhe atë në nivel kombëtar.

Hartimi i Planit është fryt i punës së shumë aktorëve në Lezhë, anëtarëve të Këshillit dhe stafit të Bashkisë Lezhë, përfaqësuesve të biznesit, shoqërisë civile, të agjencive qeveritare rajonale, përfaqësuesve të Këshillit të Qarkut Lezhë, të udhëhequr nga Kryetari i Bashkisë Lezhë.

Koordinimi me projektin DELTA 2 dhe PNUD dhe organizimi i punës për hartimin e Planit Strategjik është ndërmarrë nga Drejtoria e Programim Zhvillimit.

Ekipi i FLAG, Artan Rroji, Dr. Iain Wilson, Alba Dakoli Wilson, kanë prezantuar dhe udhëhequr nga ana metodologjike vlerësimin e zbatimit të strategjisë (2005), hartimin e Planit 2013-2030, si dhe kanë ofruar trajimet për vlerësimin dhe rishikimin e Planit Strategjik, kanë drejtuar procesin e anketimit të biznesit, si dhe lehtësimin e takimeve të Këshillit të Partneritetit dhe stafit të Bashkisë, kanë mundësuar analizën e të dhënave dhe redaktimin e dokumentit të Planit. Gjithashtu ndihmesë në hartimin e dokumentit kanë dhënë ekspertë të tjere të FLAG, Erind Kraja, Ledina Gjiknuri, Arben Kashahu dhe Kreshnik Loka.

Ndihmesa teknike për çështjet e perspektivës gjinore në matricën e strategjisë si dhe mbështetja finaciare për botimin e dokumentit të Planit Strategjik, është ofruar nga PNUD, me mbështetjen financiare të Ambasadës Suedeze. Një falenderim të veçantë për Zj. Emira Shkurti, menaxhere e programit të UNDP "Barazia Gjinore dhe Dhuna me Bazë Gjinore", si dhe Zj. Monika Kocaqi, eksperte gjinore dhe lehtësuese e takimeve për përfshirjen e perspektivës gjinore në Planin Strategjik.

Mbështetja e dhënë nga Këshilli Bashkiak dhe kryetari i tij Agustin Marku, nga anëtarët e Këshillit të Patneritetit dhe koordinatorët e këtij këshilli Arjan Barbullushi, Pashko Smaçi, Llesh Doku, Arben Dodaj, Nikolin Prendi, si dhe Pjetër Kola ish drejtori i progamim zhvillimit pranë Bashkisë.

Mbështetje të veçantë nga administrata e Bashkisë kanë dhënë Dile Nikolla, Ornela Sokoli dhe Hekuran Koka (Drejtoria e Programim Zhvillimit); Nikolin Prendi, Jak Gjin dhe Ernest Marku (Drejtoria e Shërbimeve Publike); Arben Dodaj, Eris Bejo, Entela Ndoj (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit); Bardh Dedgjonaj, Emirjana Gega dhe Ema Osmani (stafi i arsimit, kulturës,turizmit dhe sportit; Prek Miraj (drejtuesi i financës); Anita Jaku, Kastriot Kodheli, Llesh Doku, Edison Kipti, Marije Frroku (Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë); Liljana Dushku, Blerim Brahimi, Sead Reci dhe Shkurt Leka (stafi i tatim taksave); Marjola Gjoni, Halit Kavaja dhe Ded Margjoni (stafin drejtues dhe specialistët e Memorialit të Skëndërbeut, Kalasë dhe Muzeut); Gjergj Shyti, Florinda Bruka dhe Lula Lleshi (stafin drejtues dhe specialistët e Biblotekës). Gjithashtu falenderojmë të gjitha drejtoritë rajonale që na kanë asistuar dhe ndihmuar me statistikat dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme.

# Tabela e Përmbajtjes

**1. RËNDËSIA E PLANIT STRATEGJIK PËR KOMUNITETIN TONË ............................ 6**

**2. KORNIZA E POLITIKAVE ........................................................................ 8**

FILOZOFIA E PLANIT ........................................................................ 8

KËNDVËSHTRIMI GJINOR I PLANIT ........................................................ 9

**3. ZHVILLIMI I PLANIT ........................................................................ 11**

FILOZOFIA E PLANIT NË KUADËR TË INTEGRIMI EVROPIAN .................................. 11

PARIMET E PLANIT ........................................................................ 12

METODOLOGJIA ........................................................................ 13

*Faza 1. Organizimi dhe Instalimi i Strukturave për vlerësimin, planifikimin dhe monitorimin ....................13*

*Faza 2. Vlerësimi i ekonomisë vendore ........................................ 14*

*Faza 3. Proçesi i përpilimit të Planit ........................................ 14*

*Faza 4. Organizimi dhe Rrjetëzimi për Zbatimin e Planit ........................ 14*

*Faza 5. Planifikimi i Monitorimit dhe Vlerësimit ................................ 15*

**4. KOMUNITETI DHE BASHKIA E LEZHËS ........................................ 16**

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KOMUNITETIN E LEZHËS .................................. 16

SHTRIRJA GJEOGRAFIKE DHE KLIMA ................................................ 17

SFONDI HISTORIK DHE ANTIKITETI ................................................ 18

DEMOGRAFIA ........................................................................ 19

ZHVILLIMI HAPSINOR ........................................................................ 21

PROFILI EKONOMIK ........................................................................ 26

*Bizneset private në Lezhë ................................................ 26*

*Bujqësia ........................................................................ 28*

*Blegtoria ........................................................................ 28*

*Peshkimi ........................................................................ 29*

*Punësimi dhe forca e punës ................................................ 29*

*Burimet natyrore ................................................................ 31*

*Turizmi ........................................................................ 32*

*Shërbimet Financiare ................................................................ 35*

ZHVILLIMI NJERËZOR ..................................................... 35

*Kohezioni social* ..................................................... *35*

*Shëndetësia* ..................................................... *36*

*Arsimimi* ..................................................... *37*

*Strehimi* ..................................................... *39*

MJEDISI, AKSESI NË INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME ..................................................... 39

*Mjedisi* ..................................................... *39*

*Mbetjet* ..................................................... *40*

*Largimi i ujrave të përdorura* ..................................................... *41*

*Furnizimi me ujë të pijshëm* ..................................................... *41*

*Furnizimi me energji elektrike* ..................................................... *42*

*Infrastruktura* ..................................................... *43*

*Aksesi në shërbime* ..................................................... *43*

KULTURA DHE TRASHËGIMIA ..................................................... 44

QEVERIA VENDORE ..................................................... 46

**5. PLANI STRATEGJIK ..................................................... 53**

SWOT, ANALIZA E KONSOLIDUAR ..................................................... 53

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE ..................................................... 59

MATRICA E PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM ..................................................... 63

MATRICA E TREGUESVE TË PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM ..................................................... 73

FISHAT E PROJEKTEVE ..................................................... 82

**6. SHTOJCAT ..................................................... 138**

SHTOJCA 1: *Lista e shkurtimeve* ..................................................... *139*

SHTOJCA 2: *Raporti mbi vrojtimin e mjedisit të favorshëm për biznesin vendor* ..................................................... *140*

SHTOJCA 3: *Lista e anëtarëve të Këshillit të Partneritetit për Zhvillimin Strategjik të Lezhës* ..................................................... *160*

SHTOJCA 4: *Urdhër i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm për Bashkinë Lezhë* ..................................................... *163*

SHTOJCA 5: *Vendimi i Këshillit Bashkiak Lezhë për miratimin e Këshillit të Partneritetit për hartimin e Planit Strategjik të Bashkisë* ..................................................... *164*

SHTOJCA 6: *Vendimi i Këshillit Bashkiak Lezhë për miratimin e Matricës dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë, 2013-2030* ..................................................... *165*

# 1 Rëndësia e planit strategjik për komunitetin tonë



Iniciativa që mori Bashkia jonë për hartimin e Planit Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm është në kuadër të përpjekjeve për ushtrimin e funksionit të saj ligjor si nxitëse, përkrahëse dhe mbështetëse e zhvillimit dhe avancimit ekonomik e njerëzor të Lezhës dhe komunitetit të saj.

Plani prezanton ambicien për përparim, shtjellon aspiratat zhvillimore dhe vlerat që ndan komuniteti, qeveria dhe bizinesi i Lezhës në funksion të rritjes së ekonomisë dhe mirëqenies. Vizioni 2030 e prezanton komunitetin tonë të bashkuar dhe të dakortësuar në atë se çfarë është e ardhmja e tij e dëshiruar dhe cilat janë objektivat që synojmë të arrijmë, si dhe orienton rrugën që duhet ndjekur për të zhvilluar Lezhën në 17 vitet e ardhshme.

Plani ofron një kornizë të konsoliduar politikash multi sektoriale që i mundësojnë qytetit, komunitetit dhe partnerëve koordinimin e përpjekjeve dhe burimeve për të siguruar rritje të qëndrueshme sociale, konkurrueshmëri rajonale, integrim të shpejtë në hapësirën kombëtare e evropiane, zhvillimin e një qyteti kulturalisht të integruar, ekologjikisht të qëndrueshëm dhe një komuniteti shoqërisht gjithëpërfshirës. Ai përbën përpjekjen madhore për të bërë transparente

politikat e zhvillimit strategjik dhe ndërhyrjet prioritare që synojnë ndërtimin e një komuniteti të sigurt, të shëndetshëm dhe optimist që vlerëson antikitetin dhe traditën e tij.

Plani ofron një qasje të integruar të zhvillimit afatgjatë të komunitetit, dhe shërben si udhëheqës i zhvillimit strategjik të Bashkisë në harmoni me strategjitë rajonale, kombëtare dhe evropiane dhe në bashkëpunimin mes aktorëve publik e privatë. Ai synon të korrigjojë faktorët që kanë pasur deri tani një ndikim negativ në zhvillimin ekonomik, social e mjedisor të Bashkisë dhe të maksimalizojë vlerat, avantazhet dhe potencialet vendore. Si i tillë Plani është një dokument që sanksionon përpjekjet sistematike që angazhohemi të ndërmarrim për të përballuar sfidat, menaxhuar ndryshimet e planifikuara dhe rritur mirëqenien e komunitetit.

Plani që kemi hartuar bazohet në katër shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm, atë ekonomik, social, mjedisor e kulturor. Ai bashkon komunitetin dhe qeverinë bashkiake në një Vizion për avancimin e cilësisë së jetës dhe përcaktimin dhe zbatimin e politikave që udhëheqin zhvillimin në këto katër përbërës zhvillimor.

Plani i jep formë zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të Lezhë dhe orienton strategjitë, planet sektorialë të Bashkisë, duke i kontribuar njëkohësisht rritjes së efektivitetit të menaxhimit të punëve dhe shërbimeve bashkiake. Ai do të disiplinojë përpjekjet dhe burimet për çështjet e zhvillimit strategjik ekonomik e social, veprimtarinë vendimarrëse, alokimin e fondeve, dhe do të udhëzojë procesin e buxhetimit vjetor dhe afat mesëm.

Plani ynë përfaqëson një përpjekje madhore për të sjellë një ndryshim të madh edhe në mënyrën dhe cilësinë e qeverisjes, në procesin e vendimmarrjes dhe bashkëpunimit mes aktorëve publik dhe privatë. Ai ka hedhur tashmë themelet për partneritete funksionale dhe ka ngjallur një krenari civile të banorëve. Mjaft njohuri e kontribute nga komuniteti, Bashkia dhe agjencitë qeveritare dhe joqeveritare janë dëgjuar dhe konsideruar në procesin e hartimit të Planit, gjë e cila ka siguruar pronësinë e nevojshme të komunitetit dhe vendimarrësve vendorë dhe angazhimin e tyre për zbatimin, monitorimin dhe rifreskimin e institucionalizuar dhe transparent të Planit.

Ai afron dhe udhëzon Bashkinë dhe komunitetin në konsolidimin e një platforme komunikimi, debatimi e bashkëpunimi mes aktorëve zhvillues në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse, shton efektivitetin e përpjekjeve zhvilluese shumëpalëshe, dhe nderkohë e pajis Bashkinë me një dokument për të lobuar në mënyrë profesionale tek qeveria qendrore dhe donatorët.

Plani ynë demostron se qeveria bashkiake, si autoriteti ku kulmojnë interesat publike të grupeve të ndryshme të komuniteti tonë, do të luajë rol kyç në promovimin, buxhetimit, dhe koordinimin e Planit. Objektivi që ka Plani për një qeverisje bashkiake të mirë, moderne, të hapur, të zgjuar dhe të orientuar drejt partneriteteve publiko-private është një garanci për të udhëhequr dhe mbështetur realizimin e vizionit dhe objektivave të Planit me vendimmarrje të përgjegjshme dhe efektive.

Ky nuk është një Plan i ngurtë, por një dokument i gjallë që do të trupëzojë një proces konsultimesh të vazhdueshme dhe do të reflektojë sfidat, nevojat dhe pritshmërite e komunitetit dhe avancimet në nivel kombëtar dhe rajonal. Ne jemi optimistë se Vizioni ynë do të inspirojë banorët dhe qeverinë bashkiake të jenë aktivë, dinamikë dhe ambiciozë në rritjen e mirëqenies dhe dinjitetit njerëzor të komunitetit.

# 2 Korniza e politikave

## Filozofia e planit

Komuniteti ynë beson në integrimin e shpejtë të shoqërisë dhe ekonomisë së Lezhës në rajonin e veriut të Shqiperisë, dhe në anëtarësimin e Shqipërisë në BE brenda afatit 2030 të vizionit tonë. Kjo ka qënë shtysa kryesore që Këshilli i Partneritetit për Zhvillim Strategjik të Qëndrueshëm (KPZhSQ), në formulimin e Planit, ndoqi përqasjen e orientimit dhe harmonizimit të Planit me strategjinë e Qarkut Lezhë, me strategjitë kombëtare dhe Evropiane.

Në prespektivën Evropiane të zhvillimit të Shqipërisë, Plani Strategjik adreson sfidat e kohezionit ekonomik, social dhe territorial dhe vështirësitë e përfshirjes së produkteve të komunitetit tonë në përparimin shoqëror, ekonomik, kulturor e teknologjik, dhe ndërkohë thekson përpjekjet për demokraci vendore funksionale, barazi gjinore dhe akses të grupeve të disavantazhuara.

Përsa i përket strategjive në nivel kombëtar, KPZhSQ dhe ekipi që e mbështeti morën në konsideratë disa strategji kyçe kombëtare, si:

Zhvillimin dhe Integrimn 2007-2013 dhe draftin 2014-2020,
Bujqësinë 2007-2013,
Zhvillimin e Sektorit të Trashëgimisë Kulturore 2005-2013,
Arsimin Parauniversitar 2009-2013,
Mbrojtjen Sociale 2007-2013,
Zhvillimin e Turizmit 2007-2013,
Ujësjellës Kanalizimeve 2011-2017,
Ndërsektoriale të Mjedisit 2013-2020,
Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Mbetjeve 2011-2025,
Barazinë Gjinore 2011-2015,
Rininë 2007-2013,
Zhvillimin e Inovacionit dhe Teknologjisë së SME-ve 2011-2016,
Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013,
Planin Kombëtar të Eficenës së Energjisë 2010- 2018.

Plani Strategjik është në harmoni edhe me strategjitë dhe planet në nivel qarku, si:

Plani i Zhvillimit Rajonal Shkodër-Lezhë, 2005-2020,
Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (2005),

Strategjia Rajonale e Zhvillimit të Qarkut Lezhë, 2005-2015,

Koncepti i Zhvillimit Rajonal për Qarkun Lezhë (2010),

Strategjia për Turizmin dhe Agro-turizmin në Qarkun Lezhë, 2010-2013,

Plani i Veprimit Rajonal për Mjedisin, Lumi Drin, Shkodër-Lezhë (2006),

Plani i Menaxhimit të Zonës Kënetore Kune-Vain-Tale, 2010-2019, (2010),

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për Qarkun Lezhë (2013).

Plani është koordinuar edhe me planet vendore të Bashkisë, si:

Plani Lokal i Veprimit për Mjedisin (2001),

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2015, (2011),

Plani Strategjik për Trajtimin dhe Parandalimin e Korrupsionit në Bashkinë Lezhë, 2014-2016,

Plani për Qendrën e Riciklimit të Mbetjeve (2011),

Planin Vendor i Veprimit për Integrimin e Romëve (2013-2015),

Paketa fiskale e Bashkisë, 2014-2016.

Harmonizimi i Planit më strategjitë e mësipërme, si dhe me Objektivat e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara dhe Strategjinë Evropa 2020, do t'i mundësojnë Bashkisë dhe komunitetit tonë ndjekjen e vizionit dhe arritjen e objektivave të Planit, konsolidimin e bashkëpunimit me agjencitë qeveritare dhe ato të asistencës ndërkombëtare, dhe njëkohësisht zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave dhe shënjestrave në nivel kombëtar, evropian dhe botëror.

## Këndvështrimi gjinor i planit

Si pjesë të përpjekjeve të saj për një qeverisje të mirë, Bashkia e Lezhës, ka synuar dy vitet e fundit të adresojë më mirë problemet e pabarazisë gjinore, si dhe të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Në vijim të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje (2011-2015), si dhe në zbatim të kuadrit përkates ligjor dhe nënligjor, Bashkia ka konbinuar dy rrugët e njohura për integrimin gjinor në politikat vendore të zhvillimit: miratimin e programeve dhe ndërhyrjeve specifike për fuqizimin e grave dhe ndryshimin e statusit të tyre në qytet dhe zonat përreth tij, si dhe përfshirjen e analizës dhe konsideratave gjinore në çdo aspekt të planifikimit vendor.

Kështu, Strategjia e Zhvillimit të Qendrueshëm të Lezhës përbën në të njëjtën kohë një plan veprimi të Strategjisë Kombëtare në nivelin vendor, por edhe një plan zhvillimi të ndjeshëm nga pikëpamja gjinore dhe që adreson me kujdes sfidat e zhvillimit të grave dhe burrave në këtë zonë. Për realizimin e integrimit gjinor në Strategjinë e Zhvillimit të Lezhës, por edhe për të shtruar rrugën drejt një qeverisjeje më të përgjegjshme nga pikëpamja gjinore, ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm teknik Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP) në Shqipëri, me mbështetjen financiare të Qeverisë së Suedisë. Ky kontribut vjen në zbatim të Programit të Bashkëpunimit Kombe të Bashkuara-Qeveri Shqiptare (2012-2016).



3

# ZHVILLIMI I PLANIT

## Filozofia e planit në kuadër të integrimit Evropian



Plani nxjerr në pah vizionin dhe qëllimet strategjike që ka komuniteti ynë për zhvillimin e tij, dhe udhëzon e konsolidon përpjekjet e Bashkisë dhe komunitetit për të zhvilluar një mjedis mbështetës dhe favorizues për integrimin në BE, zhvillimin e komunitetit, zhvillimin rajonal dhe atë të biznesit.

Bashkia dhe aktorët në proces, kanë synuar që nëpërmjet planit dhe përqasjes së përpilimit të tij, të mund të:

- sigurojnë një dokument orientues në përcaktimin e drejtimeve të ardhshme të rritjes ekonomike për komunitetin dhe qeverinë vendore
- krijojnë një shembull të një procesi strategjik vendimmarrës që përfshin bashkëpunimin mes politikanëve vendorë dhe komunitetit të biznesit
- lehtësojnë përpjekjet për bashkëpunim mes partnerëve publikë dhe privat për një zhvillim të koordinuar të Bashkisë

- krijojnë një kornizë vendimmarrëse për çështje të rëndësishme si mjedisi e shërbimet publike, infrastruktura e planifikimi urban dhe bashkëpunimi me biznesin
- krijojnë një eksperiencë të re dhe vendosë një kulturë të planifikimit të zhvillimit ekonomik
- krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese, sepse ne besojmë se vetëm në një komunitet ku bizneset ekzistuese janë të kënaqura, ka shanse për krijimin e bizneseve të reja
- ndikojnë në politikat e financimit dhe mbështetjes teknike të qeverisë qendrore dhe agjencive donatore
- ofrojnë Bashkisë sonë autoritetin e duhur drejtues që kërkohet në planifikimin e zhvillimit ekonomik
- mundësojnë një qeverisje vendore transparente, efektive dhe që i përgjigjet me profesionalizëm nevojave dhe kërkesave të pritshmërive të banorëve dhe vizitorëve.

Plani ynë strategjik është sinkronizuar më së miri me qëllimet e zhvillimit rajonal dhe objektivat e Dibrës dhe i kontribuon zhvillimit të Dibrës me burime dhe projekte që ndikojnë përtej komunitetit tonë.

Bashkimi Evropian i sheh tregjet rajonale si shumë më të mëdha sesa zonat lokale. Zona e Lezhës është e lidhur ngushtësisht me tregjet më të largëta, duke filluar me kryeqytetin shqiptar Tiranën, gjeografikisht më të largët, si dhe me tregjet përtej kufirit në Itali, Kosovë, Mal të Zi e Maqedoni.

Katër kapitujt e parë nga të 35 përbërëse të acquis communautaire të BE-së, trajtojnë politikën e saj mbi lëvizjen e lirë të mallrave, lirinë e lëvizjes për punëtorët, të drejtën e organizimit dhe lirisë për të ofruar shërbime dhe lëvizjen e lirë të kapitalit. Për politikën e parë të sipërpërmendur, kapaciteti administrativ është thelbësor për të adresuar për zbatimin e masave horizontale dhe procedurale në fusha të tilla si standartizimi, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

Ky plan strategjik për zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit përfshin këtë kuadër më të gjerë, veçanërisht në rastet kur asetet e Bashkisë kërkohen veçanërisht në rajonin e Dibrës dhe në tregun më të gjerë.

# Parimet e planit

Plani ynë strategjik synon të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit tonë, në përputhje me politikën e BE-së:

Zhvillimi i Qëndrueshëm përbën plotësimin e nevojave të gjeneratave të tanishme pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre. Ky është një vizion i progresit që integron objektivat imediate me ato afatgjatë, veprimin lokal me atë global, dhe i trajton çështjet sociale, ekonomike dhe mjedisore si komponente të pandashme dhe të ndërvarura të progresit njerëzor.

Parimet orientuese të Bashkisë dhe Këshillit të Partneritetit[1] në formulimin e Planit Strategjik përfshijnë si më poshtë:

1. Këshilli i Partneritetit, ngritur në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak, mbart përfaqësimin e aktorëve, faktorëve dhe partnerëve zhvillues në Bashki në mënyrë të institucionalizuar për të dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në vendimmarrje, politikëbërje dhe zhvillim afatgjatë të komunitetit

- suksesi ekonomik balancohet me cilësinë e jetës;
- rritja ekonomike balancohet me kërkesat sociale dhe mjedisore;
- qeveria bashkiake është një faktor kyç në përmirësimin e klimës vendore për investime;
- bashkëpunimi midis qeverisë bashkiake, bizneseve dhe shoqërisë civile është një element kyç në progresin e qëndrueshëm ekonomik;
- planifikimi strategjik është një proces gjithëpërfshirës, i integruar dhe i institucionalizuar në Bashki;
- plani strategjik i zhvillimit të qëndrueshëm përcakton drejtimet kryesore për zhvillimin ekonomik, por nuk e kontrollon atë;
- synohet përmirësimi i mjedisit të biznesit në tërësi dhe jo mbështetje e bizneseve individuale;
- ruajtja dhe mbështetja e bizneseve ekzistuese është po aq e rëndësishme sa tërheqja e bizneseve të reja, sepse përbën mjet shumë të mirë marketimi për të përkrahur klimën e biznesit;
- zhvillimi i punësimit duke përdorur burimet e brendshme është më i rëndësishëm se krijimi i punësimit duke përdorur faktorët e jashtëm;
- krijimi i partneriteteve publiko-private në vendimmarrje dhe në përmirësimin e ekonomisë vendore është i rëndësishëm sektorit privat, pasi është gjeneruesi kryesor i zhvillimit ekonomik;

# Metodologjia

Procesi është udhëzuar përmes hapave metodologjike të përpiluara nga FLAG bazuar në përqasjen dhe drejtimin e Grupit të Bankës Botërore. Kjo metodologji ofron hapësirë për përthithjen e risive si nga grupe të ndryshme komunitare apo biznesi, ashtu dhe për menaxhimin dhe udhëheqjen nga qeveria.

Procesi i planifikimit strategjik u shoqërua me aktivitete të forcimit të kapaciteteve dhe lehtësimit profesional të forumeve të diskutimit. Procesi kërkoi veprim të bashkërenduar të një sërë individësh dhe grupesh të ndryshme, si dhe krijimin e një kuadri të përshtatshëm organizativ për planifikim. Fazat e mëposhtme strukturuan procesin e planifikimit:

### *Faza 1. Organizimi dhe Instalimi i Strukturave për vlerësimin, planifikimin dhe monitorimin*

Kjo fazë përfshin:

- ngritjen e Këshillit të Partneritetit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, me vendim të Këshillit Bashkiak për t'i ndihmuar komunitetit dhe qeverisjes bashkiake në çështjet e politikave dhe prioriteteve të zhvillimit strategjik, në hartimin, zbatimin, vlerësimin dhe rishikimin e Planit Strategjik për Zhvillimin të Qëndrueshëm të Bashkisë dhe dokumenteve të tjerë strategjikë. Këshilli mbart përfaqësimin e aktorëve, faktorëve dhe partnerëve zhvillues në Bashki në mënyrë të institucionalizuar për të dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në

vendimmarrje, politikëbërje dhe zhvillim afatgjatë të komunitetit; Këshilli i Partneritetit përbëhet nga pesë komisione tematike: Biznesi, Inovacioni, Punësimi, Burimet; Mjedisi i Ndërtuar, Zhvillimi i Territorit Infrastruktura e Shërbimet Publike; Mjedisi Natyror, Klima dhe Biodiversiteti, Energjia e pastër; Shoqëria, Zhvillimi Njerëzor, Shëndeti e Mirëqënja, Jeta në Komunitet; Kultura, Trashëgimia dhe Arti, Qeverisja.

- ngritjen e bordit të menaxhimit që koordinon përpjekjet e përgjithshme për vlerësimin dhe planifikimit, me urdhër të kryetarit të Bashkisë
- ngritjen dhe organizimin e zyrës së zhvillimit brenda strukturës bashkiake, parakushti kryesor për hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të planit.

## *Faza 2. Vlerësimi i ekonomisë vendore*

Ky stad kërkoi një përpjekje të konsiderueshme në:

- ndërmarrjen e një anketimi me biznesin mbi mjedisin lehtësues për të kryer biznes, me 8% të bizneseve në Bashki
- mbledhjen e një grupi të përcaktuar të statistikave dhe analizën e trendit të zhvillimit. Kjo analizë, së bashku me vlerësimin e planit të mëparshëm siguron bazën për zhvillimin e strategjisë. Fushat e vlerësimit janë përcaktuar në koordinim me analizën e kryer në nivel rajonal, Qarkun e Dibrës, dhe kanë ndjekur demografinë dhe mjedisin hapësinor, kohezionin social, shëndetësinë dhe arsimin, mjedisin, qasjen në infrastrukturë dhe shërbime dhe trashëgiminë kulturore dhe historike.

## *Faza 3. Proçesi i përpilimit të Planit*

Përmes dymbëdhjetë takimeve plenare dhe të komisioneve të Këshillit të Partneritetit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, ku morën pjesë 87 pjesëmarrës, të mbështetura dhe lehtësuara nga FLAG, u zhvillua:

- analiza SWOT
- vizioni
- qëllimet strategjike
- objektivat
- treguesit matës të objektivave
- programet e zhvillimit
- nderhyrjet me projekte

Rruga nga vizioni për tek qëllimet, objektivat, programet dhe projekteve është paraqitur nëpërmjet matricës strategjike.

## *Faza 4. Organizimi dhe Rrjetëzimi për Zbatimin e Planit*

Bashkia ka filluar tashmë komunikimin me bizneset, OJF-të, agjencitë qeveritare dhe donatorët për të çuar përpara zbatimin e planit. Një sërë projektesh kanë filluar zbatimin dhe një pjesë janë në proces negocimi me donatorë dhe qeverinë.

## *Faza 5. Planifikimi i Monitorimit dhe Vlerësimit*

Strukturat për monitorimin e planit janë ngritur përmes vendimit të Këshillit Bashkiak për krijimin e Këshillit të Partneritetit për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Bashkia kreu një analizë të plotë të zbatimit të strategjisë së mëparshme të zhvillimit në drejtim të arritjeve të saj për çdo projekt dhe çdo objektiv (Figura 1). Vlerësimi përfshin analizën e financimit në nivel projekti, nivel objektivi dhe qëllimi duke përfshirë këtu edhe specifikimin e burimeve të financimit për strategjinë në tërësi dhe çdo qëllim.




**Figura 1a. Pema e vlerësimit të Planit Strategjit të Bashkisë Lezhë, 2005. (2010)**




**Figura 1b. Statusi i Zbatimit të Qëllimeve të Strategjisë së Bashkisë Lezhë**

# 4

# KOMUNITETI DHE BASHKIA E LEZHËS

## Vështrim i përgjithshëm mbi komunitetin e Bashkisë Lezhë



# Shtrirja Gjeografike dhe Klima

Qyteti i Lezhës ndodhet në pjesën veriore të Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë, në koordinatat gjeografike 41o e 57’ dhe 41o e 39’ gjerësi veriore dhe 19o e 32’ dhe 19o e 53’ gjatësi lindore. Qyteti i Lezhës është i vendosur në një reliev në përgjithësi të ulët, në lartësi 5 metra mbi nivelin e detit dhe gjendet mjaft pranë një diversiteti të larmishëm të relievit (mal, kodër, lumë dhe mal), klimave e mikroklimave dhe për pasojë të florës, faunës dhe biodiversitetit në përgjithësi. I rrethuar nga laguanat Kunë e Vain, plazhi i bukur i Shëngjinit dhe bukuritë malore të Velës, qyteti është i shtrirë në të dy anët e lumit Drin.

Kufijtë administrativë të kësaj Bashkie janë në veri komuna Balldren (6.7 km nga qendra e komunës), në lindje Komuna Kallmet (10.2 km nga qendra e komunës), në jug Komuna Kolsh (4.2 km nga qendra e komunës), në perëndim Komuna Shëngjin (7 km nga qendra e komunës). Qyteti i Lezhës është njëkohësisht dhe qendra administrative e Qarkut Lezhë dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 505 ha ose 5.05 km$^2$.

Për vetë pozitën gjeografike, 7 km larg detit Adriatik dhe të relievit në përgjithsi të ulët, qyteti i Lezhës karakterizohet nga një klimë e butë mbizotëruese e tipit mesdhetar, verë e nxehtë dhe e thatë, me dimër të butë dhe të lagësht. Temperaturat në qytetin e Lezhës luhaten nga minimumi 7$^{o}$C deri në 24$^{o}$C, me një vlerë mesatare të temperaturës vjetore 14-16 $^{o}$C. Sasitë e reshjeve vjetore luhaten nga 1,400-1,600 mm reshje.



# Sfondi Historik dhe Antikiteti

Lisi (Lezha antike), është një ndër vendbanimet më të hershme shqiptare, i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe të veçantë në historinë iliro-shqiptare. Vetë pozicioni gjeografik ku shtrihet qyteti, ka bërë që Lezha qysh në lashtësi e duke vazhduar në ditët tona të jetë një ndër qendrat ekonomike, politike dhe ushtarake më të rëndësishme në vend.

Mendohet që rajoni të jetë banuar që në periudhën parahistorike, duke vazhduar dhe në epokën e bronzit dhe të hekurit. Zbulimet arkeologjike të këtyre periudhave tregojnë për jetëzim të këtyre trevave që në shekullin e X para erës sonë.

Urbanizimi i qytetit të Lezhës nis dhe dokumentohet nga autorët e lashtë dhe përmendet me emrat Lis, Lissos, Lisso, Lissum. Gërmimet arkeologjike në këtë qytet kanë treguar se muret rrethuese të qytetit të vjetër datojnë në fundin e shekullit të IV para erës sonë. Sipas historianëve të lashtë, Lezha ka qënë një nga qytetet më të mëdha dhe më të fortifikuara të krejt Ilirisë. Në këtë periudhë njihet si një qytet bregdetar dhe si liman lumor, dhe është një ndër pikat strategjike në luftrat iliro-romake. Këtu në shekullin III para erës sonë, shënohen pikënisjet e sulmeve të flotës ushtarake të mbretëreshës ilire Teuta kundër perandorisë romake.

Pavarësisht faktit që Lisi ka qënë qytet vazhdimisht i populluar që në antikitet, studimet e deritanishme lënë ende të hapur diskutimin nëse qyteti është themeluar me të vërtetë që në vitin 385/84 para Krishtit nga Dionisi I i Sirakuzës si një nga kolonitë e tij të Adriatikut, apo nëse bëhet fjalë për një themelim të mirëfilltë ilir të shekullit të III para erës sonë.

Mbas pushtimit romak të Ilirisë së Jugut, më 168 para erës sonë, Lezha përmendet si "Municip". Qyteti antik i Lezhës cilësohet me emrin Lissitan dhe e ruan rëndësinë si qendër ushtarako-administrative dhe si bazë detare për Adriatikun verior. Gjatë viteve të antikitetit të vonë dhe periudhës bizantine, vërehet një rimëkëmbje e Lezhës. Në fillimin e shekullit të VI, Kështjella e Lezhës është në listën e rindërtimeve të mëdha të Perandorit ilir Justiniani i Madh. Rindërtimet e kësaj kohe janë të dukshme dhe qyteti bizantin i Lezhës hyn në qendrat më të mëdha të kohës. Qyteti kthehet në një qendër episkopale dhe përmendet me emrin e Peshkopit Gjon në vitin 592.

Në shekujt VII-VIII, Lezha vazhdon të njihet si një qytet bregdetar ilir. Në fund të shekullit të VIII, qyteti rifortifikohet, duke ndërtuar kulla të reja dhe përdorur teknika të reja duke bërë që kështjella e Lezhës, të përbëjë një simbiozë të ndërtimeve ilire, romake dhe bizantine. Autorët bizantinë, ndër ta dhe Ana Komnena flasin për rëndësinë e madhe të qytetit të fortifikuar të Lezhës.

Në shekujt në vijim, me shpërbërjen e perandorisë bizantine, Lezha do të jetë pjesë e Principatës së Arbërisë, pranë Dukatit të Durrësit të krijuar nga Republika Veneciane. Ajo është një pikë kyç në shkëmbimet tregtare dhe transportin e mallrave, si në rrugët tokësore ashtu dhe në ato detare. Në vitin 1281, Lezha do të njihej si kryeqendër e familjes së Dukagjinëve, por në vitin 1393, do t'i dorëzohet Republikës së Venedikut nga Progon Dukagjini. Lezha do të jetë pjesë e shtetit të Venedikut, megjithë disa ndërprerje deri në vdekjen e Gjergj Kastriotit, ka vazhduar

deri në shekullin e XV. Në 2 mars 1444 Gjergj Kastrioti Skënderbeu organizoi në Lezhë kuvendin e princërve shqiptarë, që njihet me emrin “Besëlidhja e Lezhës”, i cili do të bashkonte princat shqiptarë në luftën e përbashkët antiosmane. Pas vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, në 17 janar 1468, i cili u varros në kishën e Shënkollit (sot memoriali i tij), Lezha bie nën sundimin venetikas dhe me pas në 1478 nën sundimin ottoman.

Lezha shpalli pavarësinë e saj nga osmanët më 4 dhjetor të vitit 1912. Midis Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, Lezha si gjithë Shqipëria është qeverisur nga qeveri të përkohëshme, deri në dhjetor të vitit 1924 kur në fuqi vjen Ahmet Zogu. Në periudhen e qeverisjes se Ahmet Zogut (1924-1939) Lezha ka qënë nënprefekturë e Shkodrës. Nga viti 1945 deri në vitin 1992 Lezha, do të jetë në sundimin e diktaturës komuniste. Me shndërrimet demokratike, në vitin 1992 Qyteti i Lezhës u organizua në Bashki.

# Demografia

Popullsia në Bashkinë Lezhë është 29,214 banorë dhe përbën 13% të popullsisë totale të Qarkut Lezhë në vitin 2013. Sipas të dhënave të Bashkisë Lezhë, trendi i rritjes të popullsisë së Qytetit të Lezhës në periudhën 2005-2013 është 15%, ndërkohë që popullsia në Shqipëri dhe në Qarkun e Lezhës ka pësuar rënie sipas censusit të vitit 2011, 19% në nivel qarku, dhe 8% në nivel kombëtar. Në vitin 2013, popullsia është rritur prej 130% krahasur me numrin e popullsisë 12,677 banorë në vitin 1990.

**Figura 2. Ndryshimi i popullsisë 1990-2013**




***Burimi:** Bashkia Lezhë*

Rritja e vërejtur në popullsinë e Lezhës ka ardhur pasi qyteti vazhdon të jetë preferencë e lëvizjeve migruese të banorëve të zonave, kryesisht rurale veriore e veriperëndimore. Lëvizjet e

brendshme të popullsisë kanë vazhduar dhe gjatë periudhës 2005-2012. Gjithsesi të dhënat flasin për ulje të ndjeshme të popullsisë banuese e cila ka imigruar në qytetin e Lezhës, nga 6% në vitin 2005 në 1% në vitin 2012. Krahasuar me vitin 2005, emigrimi i banorëve jashtë vendit është ulur 57% në vitin 2012. Lëvizjet e popullsisë banuese e cila ka ndryshuar vendbanimin e zakonshëm gjatë viteve 2005-2012 janë paraqitur si në vijim:

**Figura 3. Lëvizjet e popullsisë banuese në vitet 2005-2012**




***Burimi:** Bashkia Lezhë*

Bashkia ka nivelin më të lartë të urbanizimit në Qarkun Lezhë me 5,311 banorë për km$^2$, dendësi shumë më e lartë se mesatarja rajonale 140 banorë për km$^2$ . Në vitin 2013, numri i familjeve të regjistruara zyrtarisht në Bashki është 8,397 rreth 25% më i lartë krahasuar me vitin 2005, dhe përbën 15% të familjeve në qarkun Lezhë.

**Tabela 1. Struktura e popullsisë sipas grupmoshës për vitin 2014 (prill)**

| Grupmosha | 0-14 vjeç | 15–64 vjeç [1] | 65+ | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Numri** | 5,308 | 21,151 | 2,757 | 29,216 |
| **Përqindja** | 18% | 72% | 9% | 100 |

***Burimi:** Bashkia Lezhë*

1. Popullsia aktive përllogaritur me moshën e grave dhe vajzave deri në 60 vjeç dhe moshën e burrave dhe djemve deri në 64 vjeç

Popullsia aktive për punë në Bashki përbën vetëm 21% të forcës aktive të punës në nivel qarku, Raporti i varësisë totale ndaj grupmoshës që përbën forcën aktive të punës është 38%. Të dhënat tregojnë që në tri persona dy përbëjnë forcën aktive të punës, asaj ndërmjet moshës 15 deri në 64 vjeç. Gjatë viteve 2011-2014 popullsia në grupmoshën 0-14 vjeç është ulur me 1%, ajo 15-60 vjeç është rritur 6% dhe mosha e tretë me 19%. Struktura gjinore e popullsisë është pothuaj e njëjtë, 49% gra dhe vajza dhe 51% burra dhe djem.

Popullsia e Bashkisë Lezhë i përket besimit kryesisht katolik dhe atij mysliman. Numri i popullsisë së komunitetit rom dhe egjiptian në Bashkinë Lezhë është 1,330 persona dhe përbën 5% të popullsisë totale të Bashkisë. 90% e këtij komuniteti jeton në lagjen "Skënderbeg", ndërsa 10% prej tyre janë shpërndarë në lagje të tjera.[2]

Sipas Planit Rajonal Shkodër - Lezhë, 2005-2020, popullsia e Bashkisë Lezhë në vitin 2020 pritet të jetë 42,684 persona.

## Zhvillimi hapsinor

Përpjekjet e para për hartimin e një plani rregullues për Qytetin e Lezhës janë bërë në vitet '60. Ky plan rregullues i bërë në kushtet e kohës, përfshinte një zonë relativisht të vogël. Në vitin 1974, plani rregullues u ripunua, duke vendosur si kufij administrativë të Bashkisë Rrugën Shtraus në jug, lagjen Gurra në lindje, bregun lindor të lumit Drin në perëndim dhe në veri urën e vjetër të qytetit. Në fillim të viteve 1990, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 289, datë 25.06.1992, qyteti i Lezhës zgjerohet me 11.2 ha duke përfshirë dhe lagjen në Kodër-Marlekaj, zonën industriale.

Aktualisht, Lezha është e organizuar në **i).** Zonën A që përfshin nga lumi Drin në Kala e nga ish-ushqimorja në rrugën Shtraus, me shtrirje veri-jug 1400m dhe lindje-perëndim 500m dhe **ii).** Zonën B që përfshin nga ish-Ndërmarrja e Ndërtimit dhe kodrën e Marlekajve, shtrirje veri-jug 600m dhe lindje-perëndim 800m.

Bashkia ka një sipërfaqe totale prej 5.05 $km^2$. Zonimi i funksioneve brenda territorit administrativ të Bashkisë e ndan atë në 11 kategori, sipas figurës 4.

2. Plani Vendor i Veprimit i Bashkisë Lezhë për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2013-2015 (2013), fq. 14

**Tabela 2. Zonimi i funksioneve brenda territorit administrativ të Bashkisë**

| Funksioni | m² | ha | % |
|---|---|---|---|
| Zona sipërfaqja e gjelbër e qytetit | 1,959,679 | 195.9 | 35.7% |
| Zona natyrore (Lumi Drin etj) | 1,559,893 | 155.9 | 28.4% |
| Zonë banimi (sipërfaqe e zënë më ndërtesa banimi) | 1,458,960 | 145.8 | 26.5% |
| Sipërfaqe rrugë, trotuare, sheshe[3] | 242,820 | 242.8 | 4.4% |
| Zona monument kulture (zona arkeologjike etj) | 106,226 | 106.2 | 1.9% |
| Argëtim (hapësirat sportive dhe rekreacion) | 58,033 | 5.8 | 1.1% |
| Zona industriale | 26,314 | 263.1 | 0.5% |
| Zonë shërbimesh | 24,421 | 2.4 | 0.4% |
| Shëndetësi | 10,353 | 1.0 | 0.2% |
| Zonë bujqësore | 7,970 | 0.8 | 0.1% |
| Administrative | 5,655 | 0.6 | 0.1% |
| **Sipërfaqe totale** | **5,496,530** | **549.3** | **100.0%** |

***Burimi:** Bashkia Lezhë*

Sipërfaqja e banuar zë pjesën më të madhe të territorit të Bashkisë rreth 62% dhe qyteti ka një sipërfaqe totale ndërtimore prej 4,291,702m². Megjithatë vetëm 22% e sipërfaqes së banimit të Bashkisë është e studiuar dhe rilevuar. Kjo zonë i përket zonave të banimit ku bëjnë pjesë lagjet Skënderbeg, Besëlidhja, Gurra, Varosh e Kodër-Marlekaj. Ndërkohë, sipërfaqja e zënë nga zona ish industriale, së bashku me lagjen Caraj përbën zonën suburbane të Bashkisë dhe është e pastudiuar, duke e bërë lidhjen e këtyre zgjerimeve me qyteti fillestar shumë kaotik dhe me ndikim negativ në zhvillimin e qytetit.

Zona historike e qytetit përbëhet nga Parku Arkeologjik, që përfshin muret rrethuese të Qytetit të Vjetër dhe Keshtjellës Mesjetare, Akropolisit, Mureve Ilire dhe Varrezës Mesjetare në hyrje të kalasë, Keshtjella e Lezhës dhe Memoriali i Skëndërbeut, të cilat zënë një hapësirë prej 22 ha. Në jug të territorit të Bashkisë gjenden dhe hapësirat sportive, stadiumi "Besëlidhja" dhe aneksi i stërvitjes që zënë rreth 3 ha ose rreth 0.55% të sipërfaqes totale të Bashkisë.

Gjatë viteve 2002-2011, numri total i lejeve të dhëna është 377 leje ndërtimi, nga të cilat 73% për qëllime private 27% e lejeve të ndërtimit për qëllime publike. Megjithatë, qyteti ka njohur një bum të ndërtimeve informale dhe të pa studiuara. Gjatë viteve 2012-2013 nuk është dhënë asnjë leje ndërtimi.

3. Plani për Menaxhimin e Mbetjeve (2011)

## Bashkia Lezhë
## Plani i Përdorimit të Tokës Sh. 1:5000






LEGJENDA

- A. Banim
- I. Industri
- B. Bujqësi
- S. Shërbime
- M. Mon. kulture dhe artistike
- ADM. Administrativ
- R. Argëtim Rekreacion
- ARS. Arsim
- H. Shëndetësi
- N. Natyrore

Bashkia Lezhë
Plani i Nënnjësive Strukturore Sh. 1:5000



Në territorin e Bashkisë është planifikuar të ndërtohet Parku i Biznesit me një sipërfaqe totale prej 548,035 $m^2$, nga të cilat truall pronë shtetërore 347,699 $m^2$ dhe truall pronë private 200,336 $m^2$. Në funksion të parkut është parashikuar të ndërtohet dhe infrastruktura e nevojshme si **i).** ndërtimi i tunelit lidhës me Portin e Shëngjinit, **ii).** rruga për në zonën e Parkut, **iii).** stacioni hekurudhor i mallrave dhe **iv).** ura lidhëse me rrugën kombëtare Lezhë-Shkodër.



# Profili Ekonomik

Lezha është një nga Bashkitë që gjendet në rajonin perëndimor të Shqipërisë, i cili ka qënë dhe mbetet rajoni më i zhvilluar në Shqipëri. Në periudhën para viteve ’90, degët kryesore të industrisë në rajonin e Lezhës ishin industria e drurit dhe letrës, e materialeve të ndërtimit (tulla, tjegulla etj.) si dhe industria ushqimore (përpunimi i peshkut). Numri i të punësuarve në këto ndërmarrje industriale ishte rreth 2,000 persona. Aktualisht, zona industriale është jashtë funksioni dhe në të nuk ushtrohet asnjë aktivitet biznesi.

Një nga industritë zhvillimi i së cilës vazhdoi edhe pas vitit 1990, është industria ushqimore e përfaqësuar nga industria e përpunimit të peshkut. Kjo industri e ka zanafillën në vitet ’80 kur u ndërtua dhe Fabrika e Konservimit në Lezhë. Në vitet e fundit, industria e përpunimit të peshkut në rajonin e Lezhës ka njohur investimet më të mëdha në rang vendi përsa i përket ngritjes së stabilimenteve të peshkut. Në vitin 2006, në këtë zonë janë ngritur katër pika përpunimi të peshkut dhe 90% e peshkut që zihet shkon drejt këtyre pikave.[4]

Aktualisht ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve. Ndërtimi i Parkut të Biznesit në pjesën veriore të qytetit do të nxisë përqëndrimin e bizneseve vendore e rajonale të huaja. Në park planifikohen të përqendrohen kryesisht aktivitetet e biznesit të mesëm dhe të madh si: prodhime konfeksionesh, prodhime këpucësh, ndërtim, prodhime agro-ushqimore, përpunim alumini, përpunim druri, transport, tregti e shërbime të ndryshme. Ndërtimi i Parkut të Biznesit parashikon të krijojë rreth 3,000 vende pune.

## *Bizneset private në Lezhë*

Në territorin e Bashkisë Lezhë ushtrojnë aktivitetin ekonomik 860 subjekte private, nga të cilat 629, ose 74%, janë të regjistruar si biznese të vogla, të cilët ofrojnë kryesisht shërbime tregtare. Në nivel qarku, numri i bizneseve të vogla në Bashki është 29.8% Në territorin e Bashkisë ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm 231 biznese të mëdha ose 25.4% e numrit total të bizneseve të mëdha për Qarkun e Lezhës.

Gjatë periudhës 2005-2013, numri i bizneseve aktivë është rritur me 47%, rreth 137 biznese të rinj për 10,000 banorë.

**Tabela 3. Numri i kompanive aktivë të biznesit, në periudhën 2005-2013**

| **Bizneset sipas aktivitetit** | **2005** | **2006** | **2007** | **2008** | **2009** | **2010** | **2011** | **2012** | **2013** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ndërtim | 5 | 10 | 8 | 10 | 11 | 15 | 12 | 12 | 22 |
| Industri | 211 | 268 | 312 | 356 | 418 | 325 | 240 | 285 | 209 |
| Tregti | 56 | 71 | 125 | 226 | 335 | 448 | 435 | 462 | 440 |
| Shërbimi | 185 | 208 | 211 | 218 | 227 | 186 | 172 | 156 | 187 |
| Transport | 1 | 1 | 1 | 1 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| **Total numri i bizneseve** | **457** | **557** | **656** | **810** | **991** | **974** | **859** | **915** | **860** |

***Burimi:** Bashkia Lezhë*

4. MMPAU, Draft Strategjia e Zhvillimit të Peshkimit dhe Akuakulturës 2007-2015 (2006), fq. 17-18

**Tabela 4. Vendndodhja e bizneseve sipas sektorit**

| Nr | Lloji i aktivitetit sipas lagjeve | Besëlidhja | Skënderbeg | Gurra | Nënë Tereza | Varosh | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ushqimore, bylmet, mish, peshk, fruta perime | 75 | 22 | 3 | 2 | 5 | 107 |
| 2 | Industriale, veshmbathje, kancelari, mobilieri, elektrike | 189 | 17 | 0 | 1 | 2 | 209 |
| 3 | Magazinë, tregti me shumicë | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| 4 | Bar-Restorant, piceri, mëngjezore etj | 19 | 0 | 0 | 1 | 2 | 22 |
| 5 | Bar- bufe, Kafe etj | 69 | 19 | 0 | 3 | 4 | 95 |
| 6 | Prodhime druri, duralumini | 4 | 1 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| 7 | Prodhime ushqimore, bukë, ëmbëlsirë, byrektore | 22 | 3 | 0 | 2 | 3 | 30 |
| 8 | Prodhime material ndërtimi | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| 9 | Profesione të lira, avokat, noter, ekonomist, jurist | 25 | 12 | 2 | 0 | 3 | 42 |
| 10 | Autoshkollë, servis, floktore, bilardo, internet, riparime | 168 | 6 | 2 | 0 | 2 | 178 |
| 11 | Shkollë, kopshte, çerdhe | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| 12 | Farmaci, laborator, klinikë dentare etj | 10 | 5 | 2 | 0 | 9 | 26 |
| 13 | Hotele, motele etj | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| 14 | Banka, shoqëri sigurimesh | 57 | 2 | 0 | 0 | 0 | 59 |
| 15 | Subjekte juridike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 16 | Subjekte në sektorin e ndërtimit | 32 | 1 | 1 | 0 | 0 | 34 |
| 17 | Ambulant | 9 | 3 | 2 | 0 | 1 | 15 |
| 18 | Subjekte në sektorin e transportit | 26 | 1 | 2 | 1 | 0 | 30 |
| | Totali | 712 | 93 | 14 | 10 | 31 | 860 |

***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

Sektori i shërbimeve dhe i tregtisë zënë peshën kryesore të bizneseve aktivë në Bashkinë e Lezhës rreth 73%. Aktivitetet kryesore që ofrojnë bizneset në grupin e shërbimeve janë bare, restorante, floktore, servis, riparime, internet, prodhime ushqimore (bukë, byrek, ëmbëlsira), bilardo, etj. Në Bashki ofrojnë shërbimin e tyre dhe profesionet e lira të avokatëve, noterëve dhe ekonomistëve (5%) si dhe ato të profilizuara si farmacitë, laboratorë analizash dhe klinika dentare (3%). Rreth 39.3% e bizneseve të regjistruara drejtohen nga sipërmarrëse gra dhe vajza.

Bizneset e mëdha në qytet veprojnë kryesisht në fushën e industrisë dhe më konkretisht Eurofish (për punimin e peshkut) me 400 punonjës, Junik Shpk (në ndërtim) me 130 punonjës, Molino me 40 punonjës, Iridiani & Kadeli (menaxhimi i mbetjeve urbane) me 35 punonjës.

## Bujqësia

Megjithë sipërfaqen e kufizuar të Bashkisë Lezhë, pozicioni i saj strategjik mundëson akses në të mirat bujqësore, të agrikulturës, blegtorisë dhe peshkimit të cilat ndikojnë gjithashtu në potencialin ekonomik dhe punësimin në Bashki. Në qarkun Lëzhë numërohen 25,954 ferma të vendosura në 170 fshatrat e këtij qarku. Sipërfaqja e tokës bujqësore përbën 22% të sipërfaqes totale të qarkut Lezhë.

**Tabela 5. Struktura e tokës bujqësore (2010)**

| Lloji | Ara (ha) | Pemishte (ha) | Vreshta (ha) | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Sipërfaqe qarku | 35,152 | 383 | 396 | 35,931 |

***Burimi:*** *Strategjia e Turizmit të Qarkut Lezhë*

Në vitin 2010 numërohen në nivel qarku rreth 4,134 fermerë që merren me kultivimin e pemëve frutore, ku mbi 70 fermerë kanë në pronësi pemishte të mëdha me sipërfaqe mbi 5 dynym deri në10 ha. Numri i serave është 43 dhe zënë një sipërfaqe 3.51 ha.

Produktet bujqësore më të prodhuara në rrethin Lezhë janë drithërat, patatet, fasulet, frutat dhe vreshtat. Prodhimi i tyre sipas tokës bujqësore jepet në figurën 7.

**Tabela 6. Prodhimi sipas strukturës së tokës bujqësore (2010)**

| Lloji | Arë, Grurë (t) | Pemishte (t) | Vreshta (t) | Ullinj (t) |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi | 19,444 | 1,491 | 3,705 | 2,850 |

***Burimi:*** *Strategjia e Turizmit të Qarkut Lezhë*

## Blegtoria

Përsa i përket sektorit të blektorisë veçanërisht e zhvilluar është blektoria familjare në rritjen e bagëtive të iméta dhe të gjedhit, por ndodhen rreth 63 subjekte private (stalla) për rritjen e bagëtive të iméta dhe të gjedhit me mbi 10 kokë gjedhë.

**Tabela 7. Struktura e blegtorisë (2013)**

| Krerë | Të imta | | Gjedhë | Derra | Njëthu-ndrak | Shpendë | Bletë (koshere) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Dele | Dhi | | | | | |
| Rrethi | 18,670 | 16,410 | 17,755 | 23,585 | 634 | 120,730 | 3,680 |
| Qarku | 35,255 | 55,344 | 36,825 | 45,659 | 2,164 | 253,580 | 8,871 |

***Burimi:*** *Vjetari statistikor Qarku Lezhë*

Prodhimi kryesor blegtoral në vitin 2010 në nivel qarku është në formën e qumështit 57,775 ton, mishit 7,414 ton, vezë 19,457,000 kokrra vezë dhe 78 ton mjaltë.

## Peshkimi

Peshkimi është një mundësi punësimi për shumë banorë të zonës përreth Bashkisë. Sipas të dhënave gjatë vitit 2012 numri i varkave të liçensuara për peshkim ishte rreth 33, kurse numri i subjekteve të akuakulturës 65.

**Tabela 8. Vëllimi i produkteve të detit të tregtuara (2010)**

| **Lloji** | Peshk i gjuajtur në det | Peshk i gjuajtur në laguna | Peshk i gjuajtur në lumenj | Molusqe të kultivuara |
|---|---|---|---|---|
| **Sasia (ton)** | 2,659 | 624 | 20 | 5 |

***Burimi:*** *Strategjia e Turizmit të Qarkut Lezhë*

Për të rritur jetëgjatësinë, freskinë dhe përmirësimin e tregtimit të produkteve detare jo vetëm për tregun vendas, por edhe për qytetet e tjera, punojnë tri biznese të mëdha “Eurofish”, “Poseidon” dhe “Rozafa” që punësojnë rreth 500 punonjës.

## Punësimi dhe forca e punës

Popullsia në moshë pune përbën 72% të popullsisë totale të Bashkisë dhe 21% të popullsisë aktive për punë në nivel qarku. Popullsia ekonomisht aktive (fuqia punëtore) përbën vetëm 21% të popullsisë së përgjithshme në moshë pune në nivel Bashkie.

Në periudhën 2002-2013, niveli i punësimit në Bashkinë Lezhë është rritur në mënyrë të konisderueshme me 48%. Po për të njëjtën periudhë, rritja e punësimit në nivel rrethi është 24% dhe nivel qarku 7%. Struktura e punësimit gjatë vitit 2013 tregon se sektori privat është punëdhënësi kryesor 68%, i cili ka shënuar rritje gjatë viteve 2002-2013 me 121%. Punësimi në sektorin publik zë 23% të numrit të punësuarve në nivel Bashkie, dhe është ulur 13% në periudhën 2002-2013.

**Figura 4. Punësimi në Bashki në periudhën 2005-2013**




***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

Krahasuar me të dhënat në nivel rrethi dhe qarku, gjatë vitit 2013, niveli i të punësuarve në Bashkinë Lezhë përbën 60% të të punësuarve total në nivel rrethi dhe 30% të numrit total të punësuarve në nivel qarku.

Sipas të dhënave të Zyrës së Punësimit, shkalla e papunësisë në rrethin Lezhë gjatë vitit 2012 është 13.5%. Struktura gjinore e papunësisë është 48% burra dhe djem dhe 52% gra dhe vajza. Numri i punëkërkuesve të papunë të regjistruar në zyrën e punës, për Bashkinë, është rritur me 19% në periudhën 2002-2013, ndryshimi në strukturën gjinore të të papunëve në këto vite është 18% dhe 21% më i lartë për gratë dhe vajzat dhe burrat e djemt respektivisht. Numri punëkërkuesve të papunë të regjistruar për Bashkinë Lezhë për vitin 2013, përbën 21% të numrit të të papunëve të regjistruar në nivel qarku dhe rreth 82% të numrit të të papunëve të regjistruar në nivel rrethi, e treguar dhe në figurën 11.

**Figura 5. Punëkërkues të papunë të regjistruar (2013)**




***Burimi:** Bashkia Lezhë dhe Zyra e Punës Lezhë*

Në ndihmë të grave dhe vajzave të papuna, funksionon dhe Kryqi i Kuq Lezhë. Kjo qendër ofron kurse trajnimi me temë **i).** Shëndeti “Nëna dhe Fëmija”, **ii).** Sida, **iii).** Ndihma e Parë, **iv).** parukeri, **v).** rrobaqepësi. Gjatë periudhës 2004-2012 rreth 780 gra dhe vajza kanë ndjekur dhe kanë përfituar nga këto programe trajnimi.

Gjatë vitit 2013 vetëm 4% e popullsisë rome dhe egjiptiane (54 banorë) është e punësuar në sektorin privat dhe përbën 2% të numrit total të të punësuarve. 2% e kësaj popullsie (27 romë e egjyptianë) janë të vetëpunësuar joformal në mbledhjen e mbetjeve, kryeisht të aluminit dhe hekurishteve.

## Burimet natyrore

Bashkia e Lezhës, mbështetet dhe shfrytëzon burime natyrore që gjenden në afërsi të saj.

**Rezervat minerare** - Nga pikëpamja gjeologjike, Lezha përfshin tre zona tektonike të formuara nga shkëmbinjtë e Triasikut, Xhurasikut dhe Kuartenarit dhe në territorin e saj gjenden rreth 40% e rezervave të mineraleve jo metalikë të vendit. Kërkimet minerare kanë zbuluar rezerva bakri (tip kuartz/sulfuri) që arrin masën 0.5 milion ton në pjesën verilindore të krahinës si dhe burime të shumta bakri në Vele Vendi, Zef Sul dhe Qafë Kangjel. Në kufijtë e Lezhës gjenden dy burime të nikelit-sulfurit me një masë edhe floriri, si dy burime të platinumit. Mineralet e zinkut, kromit, gur gëlqeror, granitit dhe kallajit gjenden në zonat bregdetare të Rilës dhe Talës. Rezerva mermeri, graniti dhe kaolinit (porcelan, argjilë), të cilat përdoren gjerësisht gjenden në Kashnjeti. Burime të tjera përreth Lezhës përfshijnë rezerva të mermerit të kuq dekorativ në fshatin Tresh, afër qytetit, materiale të ndryshme inerte në lumin Mat si dhe gur gëlqeror, në Kokorriq dhe Shëngjin, përdorur për ndërtim.

**Rezervat ujore** - Qyteti i Lezhës është vendosur në luginën e Lumit Drin dhe përshkohet nga ujërat e tij në një gjatësi 3 km. Për më tepër rezervat ujore të rrethit janë të shumta duke përfshirë këtu jo vetëm ujërat e lumit Drin, por edhe afërsinë me detin Adriatik gjë që ka mundësuar zhvillimin e peshkimit dhe industrisë së përpunimit të tij në territorin e Bashkisë. Peshkimi mundësohet gjithashtu dhe në kompleksin ligatinor të Kunë dhe Vainit. Gjithashtu, ujërat e lumit Drin si dhe rezervat ujore të liqeneve artificialë (liqeni i Knallës) përdoren për vaditjen e tokave.

**Prodhimtaria** e rajonit të Lezhës përfshin kryesisht perimet dhe frutat e shijshme, si patatet, shalqirin si dhe për një sërë produktesh mishi dhe bulmetrash. Ajo është e njohur për verën Kallmet, rakinë e Lezhës dhe gjelin e detit të Zadrimës. Prodhimi i lartë i produkteve bujqësore i dedikohet faktit të tokave pjellore, klimës së favorshme dhe shtrijes së tyre përgjatë brigjeve të lumit Mat. Shfrytëzimi i rreth 16,781 ha tokë nga banorët e Rrethit të Lezhës siguron prodhim të mjaftueshëm bujqësor për mbulimin e nevojave të vetë Qytetit të Lezhës, por edhe të nevojave të vizitorëve kryesisht gjatë peridhës së verës.

## *Turizmi*

Qarku i Lezhës ka një potencial shumë të madh të zhvillimit të turizmit bregdetar, kulturor, fetar, rural dhe natyror. Lezha është një ndër ato qytete në Shqipëri, të cilat të ofrojnë atraksione të këndshme dhe të shumëllojshme turistike jo vetëm brenda territorit të saj, por edhe në distancë të afërt. Trashëgimia e saj historike e kulturore e bën këtë qytet një destinacion shumë tërheqës për turizmin kulturor.

Monumentet e kulturës të vizitueshme dhe që mbrohen nga shteti, në Rrethin e Lezhës, janë 15. Pesë prej tyre **i).** rrënojat e Akrolisit (Mali i Shelbumit), **ii).** rrënojat e qytetit të Lissit, **iii).** Kalaja e Lezhës, **iv).** vendvarrimi i Skënderbeut dhe **v).** banesa e Esat Mlikës ndodhen në qytetin e Lezhës. Objektet e tjera kulturore dhe historike që përbëjnë interes për t'u vizituar janë Ura e Plakut Gjon (Rraboshtë - 6 km larg), Ura e Shkinës (Piraj - 10.6 km), Banesa e Sali Bajramit (Varosh - 1.3 km), Banesa e Geg Prendit (Patalej - 3.7 km), Banesa e Ndue Frrokut (Ishull-Lezhë - 2.5 km). Me interes për vizitorët janë dhe objektet e kultit si Kisha e Shën Barbullës (Pllanë -10.2 km), Kisha e Shën Aleksandrit (Boikon Spiten - 7.1 km), Kisha e Shën Venerandës (Shën Premtes) (Balldren - 6.7 km), Kisha e Shën Stefanit (Blinisht - 13.3 km), Kisha e Shën Mhillit (Nenshat - 22 km), Kisha e Shën Ndout (Laç - 20 km). Kjo e fundit është një nga vendet më të rëndësishme të pelegrinazhit fetar jo vetëm në Qarkun e Lezhës, por edhe për të gjitha trojet shqiptare. Rreth 2 milionë pelegrinë të besimeve të ndryshme vijnë në këtë kishë çdo vit.

Parku Arkeologjik i Lezhës, i cili ka një sipërfaqe prej 22 ha, ofron mundësi për të vizituar Akrolissin, Kështjellën e Lezhës, memorialin e Skënderbeut dhe Kishën Françeskane. Kështjella e Lezhës konsiderohet më e madhja në Shqipërinë Qendrore, si dhe simbol i arkitekturës ushtarake të vonë romake, bizantine e osmane. Ajo ndodhet mbi një kodër rreth 305 metra të lartë dhe rreth 80 metra prapa Kishës Françeskane. Në brendësi të kështjellës, vërehen rrënojat e ndërtesave osmane, një xhami garnizoni, si dhe një masiv gëlqeror në qendër. Muret


MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRY OF ENVIRONMENT
Rrjeti i Zonave të Mbrojtura
Protected Areas Network
Janar/January
2014
Emeri/Name
01. Lumi i Gashit
02. Kardhiqi
03. Bredhi i Drenovës
04. Bredhi i Hotovës-Dangëlli
05. Butrinti
06. Divjakë-Karavasta
07. Llogara
08. Lugina e Valbonës
09. Lura
10. Mali i Dajtit
11. Mali i Tomorrit
12. Prespa
13. Qafë Shtama
14. Shebenik-Jabllanicë
15. Thethi
16. Zall-Gjoçaj
17. Bredhi i Sotirës
18. Kurora
19. Maliqi
20. Syri i Kaltër
21. Uji i Ftohtë
22. Vlashaj
23. Zhej
24. Ballolli
25. Berzane
26. Bogovë
27. Cangonji
28. Dardhë-Xhyrë
29. Karaburuni
30. Krastafillak
31. Kune-Vain-Tale
32. Kuturman
33. Levan
34. Liqeni i Shkodrës
35. Patok-Fushë Kuqe
36. Pishë Poro
37. Polis
38. Qafë Bushi
39. Rrëzoma
40. Rrushkulli
41. Shelegur-Gërmenj
42. Sopot
43. Stravaj
44. Tej Drini Bardhë
45. Mali Gropa-Bizë-Martanesh
46. Liqeni i Pogradecit
47. Lumi Bunës-Velipoja
48. Nikolice
49. Vjose-Narte
50. Bjeshka e Oroshit
51. Guri i Nikes
52. Luzni-Bulaç
53. Piskal-Shqeri
54. Karaburun-Sazan
55. Korab-Koritnik
56. Liqeni i Ulzes
Monument Natyre
RAMSAR SITE
Emeri/Name
R1. Pisha e Divjakës-Laguna e Karavastasë
R2. Liqeni i Shkodres-Lumi i Bunes dhe rrethinat
R3. Liqeni i Butrintit-Kepi Stillos-Çuke
R4. Liqenet e Prespave
SHKODER
KUKES
LEZHE
DIBER
DURRES
TIRANE
ELBASAN
FIER
BERAT
KORÇE
GJIROKASTER
VLORE
MALI I ZI
KOSOVA
MAQEDONIA
GREQIA
DETI ADRIATIK
DETI JON
Sektori i Biodiversitetit dhe Zonave te Mbrojtura
Biodiversity and Protected Areas Sector
20 0 20 Kilometers
4350000
4400000
4450000
4500000
4700000
4650000
4600000
4550000

rrethuese që i përkasin periudhës bizantine janë dëmtuar nga osmanët, të cilët i përdorën gurët për ndërtime të tjera.

Memoriali i Skënderbeut është ndërtuar mbi kishën e Shën Kollit, ku është varrosur Skënderbeu në vitin 1468. Ky memorial u ndërtua në vitin 1981 për të rikthyer atmosferën e Kuvendit të Lezhës, si dhe për vendvarrimin e Skënderbeut. Për këtë qëllim në brendësi të mureve gjenden një varg mburojash me stemat e fiseve, që morën pjesë në Kuvendin e Lezhës, të cilët bënë besëlidhjen me Skënderbeun. Kisha e Françeskanëve është ndërtuar në vitin 1240, përballë qytetit, në bregun tjetër të Drinit. Ka marrë këtë emër, pasi këtu është zhvilluar kuvendi i parë françeskan në nderim të Shën Françeskut të Asizit. Gjurmët më të hershme të qytetërimit në Lezhë mund të vizitohen në Akroliss (shekulli XI para erës sonë).

Qarku ka një sipërfaqë turistike bregdetare prej 11,000 ha, me vijë bregdetare 38 km (duke filluar nga Kepi i Rodonit dhe deri në Velipojë) dhe gjerësi të brezit bregdetar 3 km. Ndërkohë jo larg nga Qyteti i Lezhës gjenden disa nga destinacionet turistike të shumë pushuesve vendas dhe të huaj sic janë plazhet e mrekullueshme të Shëngjinit, Tales, Patokut, Godullit etj..Vetëm 7 km larg Lezhës gjendet plazhi i Shëngjinit, i cili vazhdon për kilometra të tërë drejt jugut dhe njihet si plazhi i Kunes, i fshehur pas pishave të buta. Në veri të Shëngjinit, ndodhet plazhi i Ranës së Hedhun, ku erërat që fryjnë pa pushim nga deti, e kanë veshur me rërë të trashë disa metra, krejt shpatin e malit që ngrihet mbi një gji të vogël.

Kompleksi ligatinor i Kune-Vain dhe Patok, që gjendet në deltat e lumenjve Drin dhe Mat ofrojnë një pasuri të rrallë natyrore dhe habitate të shumëllojshme dhe mundësi të mëdha për zhvillimin e ekoturizmit. Ky kompleks me lagunat e Zajes, Cekës, Merxhanit ofrojnë vlera të papërsëritshme të trashëguara natyrore si dhe është strehë, ushqim dhe mundësi riprodhimi për shumë lloje të ndryshme speciesh. Ndër to, zogjtë konsiderohen si shumë të rëndësishëm për nga vlerat e rralla dhe statuset ekologjike që ato kanë. Ishulli i Kunës, me ndërthurjet e variacionet e lagunave, pyjet, çeltirat e dunat, përbën pjesën më atraktive të DLDM. Për larminë e veçoritë e habitateve e shumëllojshmërinë biologjike, Ishulli i Kunes është e shpallur zonë strikt e mbrojtur dhe është e njohur ndërkombëtarisht si zonë e rëndësishme për shpendët (203 lloje). Në mesin e saj, ndodhet trupi ujor me emrin Këneta e Kashtës, i shpallur monument natyror, i cili ndërlidhet me trupa të tjerë më të vegjël ujore në brendësi të Ishullit si dhe me Lagunën e Merxhanit.

Aktualisht, kapacitetet e pritjes së turistëve në Bashkinë Lezhë mbulohen nga dy hotele secili prej tyre me një kapcitet prejt 48 shtetërish. Numri i vizitorëve është kryesisht ditor dhe shumë prej tyre preferojnë të qëndrojnë në mjediset e pushimit përgjatë vijës bregdetare. Vetëm në Komunën Shëngjin gjenden 423 hotele me kapacitet pritës 1,958 shtretër.

Të dhënat tregojnë se Lezha vazhdon të mbetet një pikë turistike kryesisht për vizitorët vendas. Kështu, nga 106,186 vizitorë që kanë vizituar memorialin e Skënderbeut në vitet 2002-2013, 85% janë vizitorë vendas dhe 15% të huaj. Numri i vizitorëve të huaj është rritur ndjeshëm në vitet e fundit.

## Shërbimet Financiare

Shërbimet financiare në Qytetin e Lezhës ofrohen kryesisht nga bankat e nivelit të dytë dhe agjencitë financiare. Në Bashki zhvillojnë aktivitetin e tyre degë të bankave Tirana Bank, BKT, Raiffeisen Bank, Alpha Bank, NBG Bank, Credins, Procredit Bank, Union Bank, Credit Agricole. Këto banka mbulojnë të gjitha shërbimet financiare, si ofrimin e kredive për individë, subjekte private dhe bujqësore, kryerjen e transaksioneve bankare për individë dhe biznese, ofrimin e shërbimeve për individë dhe biznese si llogari rrjedhëse, depozita, karta, kalimin automatik të pagave për nëpunësit e administratës publike ashtu dhe të punësuarit në biznese private, etj.

Niveli i lartë i transaksioneve dhe nevoja për sigurimin e pronës dhe automjeteve ka mundësuar dhe prezencën e pesë agjencive të sigurimit "INSIG", "Sigma", "Sigal", "Intersig" dhe "Dukagjini". Këto agjenci mbulojnë sigurimet si për individë ashtu dhe për biznese.

# Zhvillimi njerëzor

## Kohezioni social

Gjatë vitit 2013 numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike në Bashkinë Lezhë është 549 ose 7% e numrit total të familjeve, prej të cilëve 430 familje trajtohen me ndihmë të plotë dhe 119 me ndihmë të pjesshme me një fond total prej 2,229,992 Lekë në vit rreth 2.4% e fondit për shpenzime sociale të Bashkisë.

Gjatë periudhës 2005-2013, ndërkohë që numri i familjeve është rritur me 25%, numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike është ulur me 18% familjet me ndhmë të plotë dhe 27% familjet me ndihmë të pjesshme.

Për çdo 1,000 banorë numri i familjeve që përfitojnë ndihmë të plotë ekonomike është 15, dhe i atyre që përfitojnë ndihmë të pjesshme është 4. Në total numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike është 19 familje për 1,000 banorë, shifër më e ulët se mesatarja rajonale prej 32 familjesh në çdo 1,000 banorë.

**Figura 6. Numri i familjeve me ndihmë ekonomike në vitet 2005-2013**




***Burimi:** Bashkia Lezhë*

Numri i individëve në vështirësi (me aftësi të kufizuara, sëmundje etj) përbën rreth 3% të popullsisë së Bashkisë, ku 2% e zënë invalidët e punës dhe 1% personat të paaftë mendorë dhe fizikë. Numri i personave me aftësi të kufizuara është rritur gjatë periudhës 2005-2013 me rreth 75%, ku ndryshimi më i lartë vërehet në personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Fondi për të mbuluar ndihmën sociale për individët në vështirësi është 88,997,500 lek në vitin 2013, rreth 77% e fondit për shpenzime sociale të Bashkisë.

Për t'i ardhur në ndihmë personave me aftësi të kufizuara (PAK), që prej vitit 1996 është ngritur Qendra e Zhvillimit Ditor Lezhë. Kjo qendër e përkujdesit shoqëror për PAK, vepron si institucion me fond të deleguar dhe në varësi nga Kryetari i Bashkisë. Qendra ka karakter social-edukativ dhe ofron shërbim për fëmijë dhe të rinj me AK nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme ortofoni, pavarësi praktike, shërbim ushqimor, fizioterapi, transport, aktivitet shtëpiak, pedagogji, kënd muzike, pikturë, shërbim lavanderie, aktivitete të ndryshme argëtuese etj. Gjatë vitit 2013 kjo qendër është frekuentuar nga 29 persona. Përsa i përket mjediseve publike, vetëm 7% e tyre ofrojnë standartet e duhura për personat me aftësi të kufizuara.

Në Bashki funksionon dhe Qendra e Moshës së Tretë e cila është hapur për herë të parë në vitin 2008. Gjatë vitit 2013 numri i të moshuarve që marrin pjesë në aktivitet e qendrës është 70 persona.

## *Shëndetësia*

Shërbimi shëndetësor në Bashkinë e Lezhës afrohet nëpërmjet shërbimit shëndetësor parësor dhe atij spitalor.

Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet përmes një qendre shëndetësore dhe katër ambulanca. Shërbimi shëndetësor parësor ofron shërbim mjekësor të specializuar që mbulon **i).** shërbim mjeku të familjes, **ii).** shërbim pediatrik, **iii).** konsultor të nënës dhe fëmijës, **iv).** kardiologji, **v).** mikrokirurgji, **vi).** shërbim mini laboratorik (dy laboratorë) si dhe **vii).** shërbim urgjence mjekësore.

Numri i strukturave të shërbimit bazë mjekësore në vitin 2013 është 2 për çdo 10,000 banorë. Shërbimi parësor mbulohet nga 54 mjekë dhe personel ndihmës ose ndryshe, 18,5 personel mjekësor për 10,000 banorë. Numri i strukturave dhe punonjësve të punësuar ka qënë i njëjtë në periudhën 2011-2013. Numri i vizitave në vitin 2013 është 61,303 ku vëllimin më të lartë e zënë vizitat në ambulanca rreth 45%, vizitat në familje zënë një më pak se 1% në total. Në vitet 2011-2013 numri i vizitave në institucionet shtetërore është rritur me 38% ndërkohë që numri i personelit mjekësor ka mbëtur i njëjtë.

**Tabela 9. Numri i vizitave në institucionet shëndetësore në periudhën 2011-2013**

| Nr i vizitave | Qendra shëndetësore | Ambulanca | Në banesë | Konsultori i fëmijës | Konsultori i gruas | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2011** | 18,145 | 17,626 | 371 | 3,686 | 4,702 | **44,530** |
| **2012** | 23,670 | 19,596 | 187 | 3,359 | 3,989 | **50,798** |
| **2013** | 24,260 | 27,765 | 174 | 4,072 | 5,032 | **61,303** |

***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

Spitali rajonal, i ndodhur në Qytetin e Lezhës, ofron shërbime të kujdesit shëndetësor në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri, reaminacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Numri i punonjësve në shërbimin shëndetësor është 35 mjekë specialistë, 104 infermierë, 17 staf mjekësor (laborantë, farmacistë) dhe 100 veta personel ndihmës dhe administratë. [5] Aktualisht ky spital ka një kapacitet prej 162 shtretërish. Numri i shtretërve për 10,000 banorë është 55. Numri i pacientëve të shtruar gjatë vitit 2013 ishte 7,031 prej të cilëve 27% ishin prej rretheve të tjera të qarkut Lezhë. Rreth 74% e lindjeve në Bashki për vitin 2013 janë regjistruar në spitalin rajonal të Lezhës. Gjatë vitit 2013 janë regjistruar dhe 2 raste të vdekshmërisë foshnjore dhe 57 raste aborti spontan.

Shërbimi farmaceutik dhe stomatologjik mbulohet nga 10 farmaci private dhe 7 klinika stomatologjike shtetërore dhe 7 private.

## Arsimimi

Në Bashkinë Lezhë gjenden 18 objekte arsimore, 12 publike dhe 6 private. Arsimi parashkollor mbulohet nga 7 kopshte. Shërbimi bazë arsimor mbulohet nga 6 shkolla 9-vjeçare dhe 4 shkolla të mesme, dhe një gjimnaz profesional "Kolin Gjoka".

**Tabela 10. Numri i objekteve arsimore dhe frekuentimi i tyre gjatë vitit arsimor 2013-2014**

| Objekti | Kopshte | Shkolla 9-vjeçare | Shkolla të mesme | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Numri** | 7 | 6 | 4 | 18 |
| **Numri i edukatorëve/mësuesve** | 43 | 171 | 123 | 337 |
| **Numri i fëmijëve** | 819 | 3,339 | 2,449 | 6,607 |

***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

Numri i fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor është rritur me 30% gjatë viteve akademikë 2006-2013. Kjo rritje është shoqëruar dhe me shtimin e numrit të edukatorëve rreth 26%. Në vitin akademik 2013-2014 raporti fëmijë/edukatore është 19 fëmijë për një edukatore dhe ka shënuar një rritje të lehtë (3%) krahasuar me vitin 2006-2007. Të dhënat tregojnë se 21% e fëmijëve romë dhe 65% e fëmijëve egjiptianë, të moshës 3 deri 6 vjeç, shkojnë në kopësht. Ndërkohë vërehet mosfrekuentimi i fëmijëve të grupmoshës 5-6 vjeç të klasave parashkollore, në të cilat nuk mundësohet ushqimi.[6] Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin parashkollor përbën 7% të numrit total të fëmijëve.

Po në të njëjtën periudhë 2006-2013, raporti nxënës/mësues në arsimin 9-vjeçar ka shënuar rënie (11%) ku një mësues ëshë përgjegjës për 20 nxënës, raport i ngjashëm me mesataren rajonale prej 21nxënës/mësues. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së numrit të mësuesve (22%) ndërkohë që një rritje e lehtë (8%) vërehet dhe në nivelin e frekuentimit. Arsimi 9-vjeçar ka 111 klasa, dhe madhësia mesatare e një klase është 30 nxënës. Përsa i përket strukturës

5. Spitali Rajonal Lezhë, www.srl.gov.al
6. Plani Vendor i Veprimit i Bashkisë Lezhë për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2013-2015 (2013), fq. 15

gjinore, 45% e nxënësve që frekuentojnë arsimin bazë janë gra dhe vajza. Në vitet 2006-2013 vihet re një rritje më e lartë e frekuentimit të burrave e djemve (14%) krahasuar me frekuentimin nga gratë dhe vajzat (2%). Gjatë vitit 2013, vetëm 5% e fëmijëve që frekuentojnë arsimin fillor i përket komunitetit rom dhe egjiptian. Gjatë vitit 2013, 40.3% e popullsisë rome dhe 12.7% e popullsisë egjiptiane, 8 vjeç e sipër, janë analfabetë.[7]

Përsa i përket frekuentimit total të shkollave të mesme të përgjithshme, në vitet 2006-2013 numri i nxënësve është ulur me 19%, ndërkohë numri i mësuesve është rritur me 38%, dhe numri i klasave është 53. Kjo ka çuar në uljen (41%) e numrit të nxënësve për një mësues nga 38 gjatë vitit akademik 2006-2007 në 22 në vitin akademik 2013, shifër relativisht e lartë krahasuar me mesataren rajonale 14 nxënës/mësues.

Niveli i frekuentimit nga burrat dhe djemt është ulur shumë më tepër (28%) sesa ai i grave dhe vajzave (11%) në këtë periudhë. Aktualisht, niveli i frekuentimit të arsimit të mesëm të përgjithshëm është 54% gra dhe vajza. Po kështu, niveli i frekuentimit të arsimit të mesëm nga fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian është 16%, dhe përbën vetëm 1% të numrit total të nxënësve që ndjekin këtë nivel arsimi. 61% e familjeve rome dhe 57% e atyre egjiptiane shprehen se ndeshin vështirësi në arsimimin e fëmijëve, duke renditur si arsye kryesore varfërinë.

Në të kundërt frekuentimi i arsimit të mesëm profesional ka shënuar rritje (38%) në këto vite. Ndryshimin më të lartë në nivelin e frekuentimit në vitet 2006-2013 e kanë burrat dhe djemt, me një rritje 75% krahasuar me gra dhe vajza 15%. Arsimi profesional mbulon katër degë, ekonomi-bankë, administrim zyre, gjuhësi dhe teknologji e informacionit dhe komunikimit. Gjithsesi struktura gjinore e frekuentimit dominohet nga gra dhe vajza me 51% ne vitin 2013. Gjithashtu dhe numri mësuesve është rritur në 73% duke bërë që numri i nxënësve për një mësues të bjerë ndjeshëm (20%) nga 21 në vitin 2006 në 17 në vitin 2013. Rreth 91% e nxënësve të regjistruar në vitin e katërt kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm në vitin 2013.

**Figura 7. Raporti nxënës/mësues në vitet 2006-2013**




***Burimi:** Bashkia Lezhë*

7. Po aty

Shkollat e qytetit të Lezhës janë të pajisura me terrene sportive si dhe me palestra, të cilat shërbejnë për zhvillimin e orëve mësimore. Ambjentet sportive të 3 palestrave, 2 fusha volejbolli, 2 fusha basketbolli dhe si 1 fushë futbolli mundësojnë që nxënësit e arsimit bazë dhe atij të mesëm të ushtrojnë aktivitete fizike të ndryshme, përveç atyre te planifikuara.

Në ndihmë të të rinjve të komunitetit rom dhe egjiptian është Qendra “Shenjta Mari”. Kjo qendër përkujdesi shoqëror është hapur dhe funksionon që prej vitit 2004. Falë kësaj qendre vazhdojnë shkollën 171 fëmijë kryesisht të këtyre komuniteteve. Është e vetmja e këtij lloji në qytetin e Lezhës.

## *Strehimi*

Sipas Censusit të vitin 2011, numri i ndërtesave në Bashki është 1,877 ndërtesa dhe përbën vetëm 6% të numrit të ndërtesave të regjistruara në qarkun Lezhë.

**Tabela 11. Lloji i banesave (2011)**

| Objekti | Bashkia | Qarku |
|---|---|---|
| Banesa të zakonshme të banuara | 4,031 | 31,314 |
| Banesa të zakonshme jo të banuara | 1,906 | 13,830 |
| Banesa jo të zakonshme | 31 | 275 |
| **Totali** | 5,968 | 45,419 |

***Burimi:*** *Instati Lezhë*

Numri i të pastrehëve të regjistruar në Bashki është 65 familje, nga të cilët 37 i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Strehimi është mbuluar nga numri i lartë i ndërtimeve private në vitet e fundit. Vetëm gjatë vitit 2013, numri i kërkesave për legalizime të pronave është 131.

# Mjedisi, aksesi në infrastrukturë dhe shërbime

## *Mjedisi*

Qyteti i Lezhës numëron 28 njësi të gjelbëra, që përbëhen kryesisht nga hapësirat e gjelbëra në lagje, oborre shkollash dhe kopshtesh. Në total në vitin 2013 sipërfaqja e gjelbër në Bashki, së cilës i ofrohet shërbimi i mirëmbajtjeje është 10 ha dhe zë rreth 1.8% të gjithë sipërfaqes së Bashkisë. Në 65% të saj sipërfaqja e gjelbër përbëhet nga bari natyral, 33% bar i kultivuar dhe 2% lule. Në këto hapësira janë mbjellë 2,026 rrënjë drurë dhe 1,729 rrënjë shkurre. Krahasuar me vitin 2038, sipërfaqja e gjelbër për banorë, së cilës i ofrohen shërbimi i mirëmbajtjejes, është ulur nga 4.1m$^2$ (2003) në 3.4 m$^2$ (2013).

Faktor kryesor në ndotjen e ajrit në Bashki mbetet numri i lartë i makinave (14.5 makina për

8. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, Bashkia Lezhë (2003), fq. 13

100 banorë) të cilat në masën më të madhe të tyre përdorin si karburant naftën. Në vitet e kaluara ndërtimet e shumta në qytet kanë ndikuar dhe në cilësinë e ajrit.

## Mbetjet

Gjatë vitit 2013, janë gjeneruar rreth 11,200 ton mbetje, nga të cilat 9,125 ton mbetje urbane apo mesatarisht 25 ton në ditë, kurse pjesa tjetër mbetje inerte, komerciale, spitalore, etj. Sasia e mbetjeve urbane për banorë/ditë është 0.86 kg. Qyteti ka rreth 100 pika grumbullimi të mbetjeve, me një numër prej 220 kontenierësh, dhe ky shërbim i ofrohet aktualisht 90% të familjeve, 100% e bizneseve dhe 100% institucione shtetërore. Vërehet një rritje prej 7% të mbetjeve urbane të gjeneruara në raport me 2010.

**Tabela 12. Vëllimi i mbetjeve urbane në vit (2009-2013)**

| Viti | 2009 | 2010 | 2013 |
|---|---|---|---|
| Mbetjet urbane në vit | 8,760 | 8,528 | 9,125 |
| Sasia kg/banorë/vit | 414 | 302 | 312 |
| Sasia kg/banorë/ditë | 1.1 | 0.82 | 0.85 |
| Vëllimi ton/ditë | 24 | 23.3 | 25 |

***Burimi:** Bashkia Lezhë*

Vëllimi i mbetjeve spitalore është 1 $m^3$/ditë (bruto, përfshirë edhe mbetje të tjera që dalin në pikën e spitalit), ndërkohë 0.2$m^3$ e mbetjeve spitalore të rrezikshme administrohen nga një kompani e liçensuar dhe e kontraktuar nga Bashkia, që bën trajtimin e tyre jashtë qytetit të Lezhës, ndërsa pjesa tjetër trajtohet me mbetjet urbane.

Në Bashki po zbatohet dhe projekti pilot për mbledhjen në mënyrë të diferencuar të mbeturinave në qytet. Ky projekt po zbatohet në lagjen Besëlidhja dhe një pjesë të lagjes Gurra dhe Skënderbeg të qytetit, dhe është i përqëndruar në 27 pika grumbullimi me sistem mbitokësor dhe 3 pika grumbullimi me sistem nëntokësor. 39 % e familjeve të Bashkisë aktualisht i ndajnë mbetjet në burim dhe përfitojnë largimin e diferencuar të mbetjeve. Është ndërtuar qendra e rindarjes së mbetjeve të riciklueshme ku bëhet presimi i tyre për t'ju shitur kompanive ricikluese.

Në 2010 mbetje të riciklueshme të gjeneruara përbënin 3,238 ton ose 37% të totalit të mbetjeve prej 8,528, nga të cilat letër/karton 1,225 ton, plastike 1,341 ton, qelq 562 ton, metal ferroz 58 ton dhe metal joferroz 52 ton. Rreth 64% e mbetjeve bashkiake përbehet nga material i biodegradueshëm (lëndë organike, drusore, letër dhe karton). Rryma e materialeve të riciklueshme (letër, karton, qelq, tekstil, plastikë, dru, inerte, metal) përbën 48% të totalit të mbetjeve.

Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve ofrohet nga kompani private e kontraktuar nga Bashkia. Për të mundësuar këtë shërbim drejt pikës së grumbullimit apo depozitimit të tyre, përdoren dy kamionë teknologjik me kompaktim dhe një kamion vetëshkarkues. Aktualisht, mbetjet urbane të Bashkisë depozitohen në landfillin e Bushatit, i cili ndodhet 25 km larg qytetit.

Në zonat ku nuk ofrohet ky shërbim për shkak të mungesës së infrastrukturës cilësore, aty ku ka vatra me mbetje, përdoren forma të ndryshme si kompostime, ndërsa për mbetjet që nuk dekompozohen bëhet transporti i tyre me fuqi punëtore. Aktualisht janë 3-4 vatra ku mbetjet hidhen në mënyrë të pakontrolluar.

Sipërfaqja totale rrugë, trotuare dhe sheshe në territorin e Bashkisë është 372,371 $m^2$, prej të cilave 184,133 $m^2$ ose 49.4 % janë të asfaltuara, nga të cilat 104,223 $m^2$ fshihen e pastrohen me fshesë dhe 67,728 $m^2$ lahen çdo ditë për 6 muaj në vit. Aktualisht 50% e territorit (rrugë, trotuare, sheshe publike) të Bashkisë fshihet me fshesë dore, 50% me autofshesë dhe 70 % e totalit të rrugeve të përfshira në kontratën e pastrimit, lahen. Shtrirja e shërbimit për vitin 2010 ishte 77%, ndërsa për vitin 2013 është 85% të territorit të Bashkisë.

Kostoja e plotë e operative e shërbimit të pastrimi llogaritet në 29 milion lekë në vit sipas kontratës për periudhen 2010 - 2016. Të ardhurat nga tarifa e pastrimit, të arkëtuara në 2013, ishin 8,822,400 Lekë, nga të cilat 74% e totalit mblidhen nga zona A e shërbimit të pastrimit. Në vitin 2013 tarifa e pastrimit për familje ishte 780 Lekë në vit, tarifa mesatare vjetore për biznesin e madh është 16,916 Lekë në vit, tarifa mesatare vjetore për biznesin vogël është 3,469 Lekë në vit.

## *Largimi i ujrave të përdorura*

Sistemi i kanalizimit të ujrave të përdorura është 28 km dhe 50% e familjeve janë të lidhura me rrjetin. Ndërhyrje të rëndësishme janë bërë dhe në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të përdorura. Me fonde të BE-së (3.7 milion Euro grant) ka përfunduar në vitin 2013 **i).** ndërtimi i kolektorit kryesor nga Stacioni ekzistues i pompave në drejtim të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Përdorura Lezhë-Shëngjin dhe **ii).** ndërtimi i 3 stacioneve të pompimit. Nëpërmjet projektit të Menaxhimit të Integruar të Ujit dhe Ekosistemit (2013) financuar nga GEF, BEI me fond në Bashkinë Lezhë është mundësuar ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Përdorura dhe ka përfunduar gjithashtu në vitin 2013 dhe lidhja me rrjetin. Aktualisht, pritet zgjidhja e problemit të furnizimi me energji elektrike të stacioneve të pompimit. Me buxhet të shtetit janë realizuar ndërtimi i dekantuesve, pusetave të kontrollit dhe rrjetit për largimin e ujërave të ndotura në lagjen Kodër-Marlekaj që do të jetë në funksion të 7,500 banorëve të kësaj zone. Vënia në funksion të plotë të të gjithë investimeve të mësipërme do të bëjë të mundur eliminim e shkarkimeve të patrajtuara të ujërave të përdorura në Lumin Drin.

## *Furnizimi me ujë të pijshëm*

Bashkia Lezhë furnizohet me ujë të pijshëm nga stacioni i pompave Barbulloja ku gjenden katër pompa kryesore. Në Bashki gjenden dy rezervuarë me një kapacitet depozitues prej 4,000$m^3$ dhe kapacitet prodhues 400 litra/sek. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm menaxhohet plotësisht nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Lezhë. Furnizimi me ujë të pijshëm ka qenë objekt i shumë projekteve të donatorëve të huaj në Bashkinë Lezhë. Me fonde grant (10.5 milion Euro) të Sekretariatit Zviceran Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) po punohet për **i).** rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes me gjatësi 63 km në qytetin e Lezhës, në zonën e

SMT-së si dhe në zonën frutore, **ii).** rehabilitimin e pusit numër 1, **iii).** ndërtimi i dy depove të reja të ujit me kapaciet 4000 $m^3$ secila, **iv).** integrimin e sistemit të furnizimit me ujë në sistemin ekzistues, si dhe **v).** sigurimin e pajisjeve të mirëmbajtjes, zbulimit të rrjedhjeve dhe kalibrimit. Këto ndërhyrje do të sigurojnë rritjen e numrit të orëve të furnizimit me ujë të popullsisë, nga 12-16 orë në ditë aktualisht, në 24 orë në ditë brenda vitit 2018.

**Figura 8. Furnizimi me ujë të pijshëm në vitet 2005-2013**




***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

## *Furnizimi me energji elektrike*

Bashkia Lezhë furnizohet me energji elektrike nga linja 110 KW e transmetimit (Vau Dejes, Fierze, Shkopet). Konsumi vjetor i energjisë elektrike për qytetin në vitin 2013 ishte 33.4 GW. Shërbimi i furnizimit është i vazhdueshëm gjatë 24 orëve për qytetarët dhe bizneset. Ndërkohë ndriçimi i rrugëve dhe lagjeve të qytetin mbeten një sfidë për Bashkinë. Ndërkohë që energjia diellore, nëpërmjet paneleve diellore, ka një potencial të madh për t'u shfrytëzuar. Bashkia vlerësohet të ketë 226 ditë diell në vit, ndërkohë që ngrohja e ujit nga panelet diellore ndodh në raste shumë të ralla. Në vitin 2011 (INSTAT census) 34 familje, apo 0.4% e totalit të familjeve dhe 1.2% e 2,846 familjeve që kanë boiler elektrik, kishin të instaluar panel diellor për ngrohjen e ujit. Aktualisht, me mbështetjen e PNUD është pilotuar ngrohja termike diellore për konviktin e shkollës "Kolin Gjoka" dhe çerdhen "Besëlidhja".

Një burim alternativ i energjisë mbetet dhe energjia e erës e favorizuar nga kushtet e relievit me kodra të buta, afër zonave me popullim të madh si: Suka e Mjedës, kodrat e Plezhës, kodrat e Paçramit, kodrat e Mabes, kodrat e Dajçit, kurrizorja e Pentarit etj., dhe ekzistenca e erërave lokale të bollshme, deri në 120 ditë në vit.[9] Aktualisht në kodrat e Dajçit po punohet për ngritjen e një parku eolik që do të mundësojë prodhimin e kësaj forme energjie.

9. Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis për Deltën e Lumit Drin, Shkodër – Lezhë (2006), fq. 15

## Infrastruktura

Qyteti i Lezhës gjendet një pozicion gjeografik strategjik, në një nyjë rajonale të transportit rrugor, hekurudhor dhe detar që i ofron një akses të shpejtë rajonal dhe një bazë të qëndrueshme për zhvillimin perspektiv të qytetit dhe mundësi të mëdha për shkëmbim njerëzish, mallrash dhe shërbimesh. Lezha lidhet drejtpërdrejtë me autostradën kombëtare Tiranë-Shkodër, ka një distancë prej 15 km nga autostrada kombëtare Durrës-Kukës-Morinë si dhe lidhet drejtpërdrejtë me hekurudhën veri-jug.

Përsa i përket distancës të Bashkisë Lezhë nga pikat doganore, ajo gjendet në largësi prej 123 km nga pika doganore e Morinës në kufirin me Kosovën, 48 km dhe 70 km nga pikat doganore të Murriqanit dhe Hanit të Hotit respektivisht, në kufirin me Malin e Zi. Bashkia gjendet në distancë 7 km nga Porti i Shëngjinit (me një kapacite prej 92,000 ton), 64 km nga Porti i Durrësit, dhe 45 km nga aeroporti i Rinasit. Lezha gjendet vetëm 56 km larg kryeqytetit të vendit, Tiranës dhe kohëzgjatja e udhëtimit është më pak se një orë.

Territorin e Bashkisë e përshkojnë 4.1 km rrugë nacionale dhe 10.3 km rrugë urbane.

**Tabela 13. Rrjeti rrugor në Bashkinë Lezhë (2013)**

| Sektori | Rrugë kombëtare | Rrugë urbane | Totali |
|---|---|---|---|
| **Km** | 4.1 | 10.3 | 14.4 |
| **Përqindja** | 28% | 72% | 100% |

***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

## Aksesi në shërbime

Shërbimi i telefonisë fikse mbulohet kryesisht nga "Albtelecom". Numri i familjeve të cilat e përdorin këtë shërbim është rritur me 21% në vitet 2005-2013. Përdorimi i internetit ka shënuar rritje si në konsumatorët familjarë ashtu dhe në biznese. Numri i familjeve me akses në internet është rritur nga 250 në vitin 2007, në 1,800 në vitin 2013. Ndërkohë 1,483 ose 18% e familjeve kishin kompjuter (INSTAT census, 2011). Shërbimi i telefonisë celulare ofrohet nga të gjithë operatorët e telefonisë celulare në vend dhe mbulon të gjithë territorin e Bashkisë.

**Tabela 14. Niveli i komunikimit elektronik në Bashkinë Lezhë (2013)**

| | Numri | % |
|---|---|---|
| Biznese me akses në internet me shpejtësi mbi 30 mbps | 300 | 35 |
| Familje me akses në internet me shpejtësi mbi 4 mbps | 1,800 | 22 |
| Familje me lidhje fikse telefonie | 3,150 | 38 |

***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

# Kultura dhe trashëgimia

Lezha, si një qytet antik pasqyron gjithë fazat e zhvillimit, ngritjes dhe rënies së perandorive që kanë sunduar këtë rajon, me kalanë mesjetare që dominon gjithë hapësirën deri në detin Adriatik. Trashëgimia e saj kulturore dhe historike përbëhet nga objekte të shumta arkeologjike, monumente të kultit dhe dëshmi historike.

Emri i qytetit përmendet nga historianët Grek e Latin më shumë se dy mijë vjet më parë, përmendet në kronikat Venecian kur ishte dominim i Republikës se Shën Markut, duke marrë rëndësi të veçantë në shekullin e XV-të, kur Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti, "Skënderbeu", mblodhi këtu të parin Kuvend të Princave Shqiptar, dhe themeloi shtetin e parë mbi bazën e principatave. Gjatë gjithë periudhës së lavdishme të tij, Lezha ka shërbyer si "Kryeqytet Diplomatik" i Arbërisë.

Prezenca e Urdhrit Françeskan në Lezhë, e themeluar nga vetë San Françesku i Asizit në vitin 1220 i shtohet njohurive, historisë, arsimit dhe kulturës së një qyteti që rrethohet nga një natyrë e bukur. Pikërisht, në qendër të qytetit, fare pranë zonës arkeologjike, vite me parë ndodhej porti lumor, duke shërbyer për transportin e mallrave për në vende të ndryshme të përtej detit.

Provinca e Lezhës është njohur në kohërat e lashta për fermerët e saj. Sipas shënimeve të Fran Bardhit, drithërat kultivoheshin në Zadrimë që në vitin 1641. Pikërisht ky kultivim, i ushtruar tradicionalisht në shekuj çoi në krijimin e shumë racave unike të kafshëve dhe shumëllojshmëri të bimëve të kultivuara në rajon si për shembull, fasulet, rrushi dhe ulliri, mishi i gjelit te detit të Zadrimës, mishi i pulës i Malësisë së Lezhës e të tjera. Prodhimet e Lezhës si për shembull, mjalti, dylli, lëkura, produktet e drurit, peshku, pambuku, pëlhurat e të tjera u tregtuan në shekujt 12 dhe 15 në Raguza, Venecia, Ankona e të tjera dhe anijet ngarkoheshin në portin lumor të Lezhës dhe gjurmët e këtij aktiviteti mund të gjenden edhe sot përballë Memorialit.

Lezha është qyteti që bashkon tri treva me rëndësi të veçantë etno-kulturore për Shqipërinë e Veriut, Zadrimën, Mirditën dhe Malësinë e Madhe. Këto krahinat nuk e njohën asnjëherë pushtimin osman, por u vetëqeverisën sipas ligjeve të princit të tyre të fundit, Lekë Dukagjinit dhe jetuan me kujtimin e bëmave të Skënderbeut. Kanuni me emrin e tij është monumenti më i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar (publikimi me i fundit nga At Shtëfjen Gjeçofi, Shkodër 1933). Ndër dëshmitë më të forta kulturore të kësaj krahine është dhe vepra e Gjergj Fishtës me Lahutën e Malësisë, Mrizi i Zanave, Vallja e Parrizit, Anzat e Parnasit, Gomari i Babatasit, Juda Makabe, Jerina, Sh'Francesku i Asizit, Sh'Luigj Gonzaga etj.

Në ditët e sotme, kultura në Bashkinë e Lezhës përfaqësohen nga aktivitete kulturore si shfaqje teatrale, festivale, kinema apo dhe qendra kulturore. Aktivitete alternative kulturore mundësohen nga Biblioteka e qytetit, Galeria e Arteve Pamore (Pallati i Kulturës me 350 vende), Qendrën Kulturore për Fëmijë (me 29 kurse), Muzeu Historik dhe Galeria private "Studio Art Përvathi".

Muzeu Historik ka 808 objekte etnografike të dixhitalizuara dhe mbi 250 objekte arkelogjike të ekspozuara. Ndërkohë biblioteka e qytetit disponon një fond prej rreth 100,000 libra me mbi 25,000 titujsh, nga të cilët 1,100 i përkasin kryesisht literaturës fetare në gjuhët latinisht, italisht,







turqisht etj., 74 prej të cilave inkunabula, që u përkasin botimeve të periudhës para vitit 1830. Biblioteka përfundoi rehabilitimin në vitit 2001 dhe ofron 5 salla leximi me 250 vende dhe 7 punonjës. Aktualisht, është në proçes informatizimi i titujve të librave për t'i hapur rrugë ofrimit të shërbimeve në internet.

Një aktivitet i përhapur në Bashki është dhe sporti, i cili ka një histori 84-vjeçare, që nga viti kur u themelua Klubi Sportiv "Besëlidhja" në vitin 1930. Në vitet e fundit është vënë re një rritje e pjesëmarrjes së të rinjve në praktikimin e shumë sporteve si mundja, karateja, judo, boks, futboll dhe volejboll. Aktualisht klubi sportiv Besëlidhja, përbëhet nga 17 ekipe të drejtuara nga 10 trajnerë. Shumë prej këtyre të rinjve kanë përfaqësuar jo vetëm qytetin e Lezhës, dhe klubin e saj "Besëlidhja" në aktivitete kombëtare, por kanë përfaqësuar dhe Shqipërinë në shumë aktivitete në Ballkan, Evropë dhe lojra Olimpike duke u vlerësuar dhe me çmime të rëndësishme. Stadiumi Besëlidhja, me një kapacitet 3,500 spektatorë, aneksi i tij, palestrat dhe terrenet sportive nëpër shkolla mundësojnë kalimin e kohës së lirë.

Në Bashki organizohen disa aktivitetet kulturore, kryesisht rite në festa të motmotit, si ditët e kthimit të diellit drejt verës (22 - 24 Dhjetor) të cilat kulmojnë me Natën e Buzmit (24 Dhjetor), Dita e Verës, Dita e Shën Gjergjit (6 Maj), Dita e Shën Gjinit (24 Qershor), Kulti i Maleve, Dita e Shegës, dhe që nga viti 2007, Bashkia organizon festimin e "Ditës së Shtegtarit" (15 Gusht), dedikuar emigrantëve nga qyteti.

## Qeveria vendore

Bashkia Lezhë ka një administratë prej 154 punonjësish, prej të cilëve 63 të punësuar në Bashki dhe 91 të tjerë në strukturat e tjera të varësisë. Struktura gjinore e stafit të punësuar në Bashki është 47% gra dhe vajza dhe 53% burra e djem. Stafi i administratës së Bashkisë në 68% të tij është me arsim të lartë (funksionet e drejtorëve, përgjegjësve si dhe të specialistëve), dhe 32% me arsim të mesëm (kryesisht punonjësit që ushtrojnë detyrat e mirëmbajtjes, shoferit, pastruesve), nga të cilat 42% janë gra dhe vajza. Në vitet 2005-2013 numri i grave dhe vajzave në pozicione drejtuese është rritur nga 0 në 11, duke përbërë 55% të stafit në pozicione drejtuese. Bashkia është e organizuar në 7 drejtori kryesore sipas figurës së mëposhtme.

Shërbimet kryesore që mbulohen nga Bashkia janë ai i pastrimit, i mirëmbajtjes së rrugëve, gjelbërimit, shërbimet të përkudesit shoqëror, shërbimet kulturore dhe komunitare, çerdheve etj, ku janë të punësuar 91 punonjës dhe më konkretisht në çerdhe janë të punësuar 12 punonjës, në Qendrën Kulturore 7 punonjës, në Klubin Sportiv "Besëlidhja", që mbulon sportet e futbollit, volejbollit dhe mundjes 11 punonjës, në Muzeum 6 punonjës, në Qendrën e Zhvillimit Ditor 12 punonjës, në ndërmarrjen e shërbimeve 17 punonjës.

Organi vendimmarrës i Bashkisë është Këshilli Bashkiak i përbërë nga 25 anëtarë (ndër të cilët 1 është femër). Këshilli ka 8 komisione të përhershme.

# ORGANIGRAMA E ADMINISTRATËS BASHKISË LEZHË PËR VITIN 2014



**Tabela 15. Të Ardhurat sipas llojit, Bashkia Lezhë, në 000 Lekë**

| Nr | Emërtimi | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| A | Të ardhurat nga taksat | 89,143 | 95,858 | 115,580 | 53,045 | 57,645 |
| 1 | Taksa mbi pasurinë | 5,782 | 5,542 | 5,167 | 6,844 | 5,974 |
| a | Taksa mbi ndertesat | 5,782 | 5,442 | 5,167 | 6,834 | 5,974 |
| b | Taksa mbi tokën bujqësore | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Taksa për biznesin e vogël | 21,217 | 24,166 | 28,628 | 18,199 | 17,174 |
| 3 | Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë | 8,787 | 1,885 | 4,444 | 7,605 | 9,530 |
| 4 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja | 49,710 | 58,055 | 70,578 | 18,505 | 23,489 |
| 5 | Taksa e zëniess së hapsirave publike | 145 | 200 | 504 | 298 | 108 |
| 6 | Taksa e tabelës | 492 | 209 | 539 | 1,594 | 1,370 |
| 7 | Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve | 4,911 | 5,850 | 5,720 | 0 | |
| 8 | Taksa të përkohshme (gjelbërim + ndriçim) | 95 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 9 | Taksa e fjetjes në hotel | 0 | 75 | 0 | 0 | 0 |
| B | Të ardhurat jotatimore | 30,291 | 32,982 | 25,980 | 50,826 | 41,406 |
| 1 | Nga tarifat për shërbimet publike | 18,368 | 11,345 | 10,524 | 12,187 | 12,238 |
| a | Pastrimi dhe largimi i mbetjeve të ngurta urbave | 14,493 | 7,252 | 7,389 | 10,503 | 10,423 |
| b | Përdorimi i pronave publike | 1,961 | 3,345 | 2,522 | 1,262 | 1,049 |
| c | Dhenia e liçencave, leje, atorizime etj. | 1,914 | 748 | 613 | 422 | 766 |
| 2 | Të ardhura të tjera | 7,309 | 16,565 | 10,372 | 32,710 | 23,578 |
| a | Veprimtaritë ekonomike | 279 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| b | Shitja e pasurive kapitale | 0 | 0 | 1,063 | 0 | 0 |
| c | Qeratë mbi trojet, ndërtesat etj. | 505 | 1,524 | 500 | 2,250 | 3,084 |
| d | Kontributet, sponsorizimet etj. | 0 | 250 | 1,350 | 13,557 | 2,824 |
| e | Gjobat | 974 | 981 | 544 | 609 | 719 |
| f | Të tjera | 5,550 | 13,065 | 6,915 | 16,294 | 16,951 |
| 3 | Të Ardhurat e tjera nga institucionet në vartësi të Bashkisë | 4,613 | 5,072 | 5,084 | 5,929 | 5,590 |
| a | Pagesat për çerdhet | 795 | 993 | 1,153 | 1,272 | 1,287 |
| b | Pagesat për kopeshtet | 3,337 | 3,857 | 3,845 | 4,366 | 4,212 |
| c | Pagesat e nxenëse të shkollave të mesme | 336 | 222 | 86 | 291 | 91 |
| d | Të tjera | 143 | 0 | | 0 | 0 |
| | **Totali ( A + B )** | **119,435** | **128,840** | **141,560** | **103,871** | **99,051** |

***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

**Figura 9. Të Ardhurat sipas llojit, Bashkia Lezhë**




***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

**Tabela 16. Të Ardhurat e Bashkisë Lezhë, në 000 Lekë**

| Vitet | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|---|---|
| Të Ardhurat | 119,435 | 128,840 | 141,560 | 103,871 | 99,051 |

**Figura 10. Të Ardhurat e Bashkisë Lezhë**




***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

**Tabela 17. Shpenzimet faktike të buxhetit të Bashkisë Lezhë, në 000 Lekë**

| Emërtesa | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|---|---|
| Administrata e Bashkisë | 52,728 | 50,973 | 56,977 | 55,245 | 54,485 |
| Kultura | 13,929 | 14,655 | 15,339 | 14,804 | 14,760 |
| Çerdhe | 6,047 | 6,688 | 7,712 | 6,756 | 7,367 |
| Ndërmarrja e Shërbimeve Publike | 14,189 | 14,508 | 12,860 | 9,597 | 9,415 |
| Klubi Sportiv Besëlidhja | 16,364 | 17,110 | 28,371 | 13,560 | 13,946 |
| Arsimi (shkolla dhe kopshte) | 15,574 | 15,448 | 17,745 | 11,901 | 12,646 |
| Sipërmarrjet | 33,154 | 33,068 | 32,303 | 23,361 | 24,501 |
| Investime | 41,500 | 0 | 36,353 | 30,125 | 30,125 |
| Shpenzime për borxhin | 0 | 23,905 | 546 | 3,176 | 3,175 |
| Fondi rezervë | 500 | 965 | 600 | 810 | 810 |
| Fondi i emergjencës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kuotë për Këshillin e Qarkut | 2,400 | 2,249 | 5,227 | 2,000 | 2,000 |
| **Totali** | **196,385** | **179,569** | **214,033** | **171,335** | **173,230** |

***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

**Figura 11. Shpenzimet faktike të buxhetit të Bashkisë Lezhë, 000/ Lekë**




***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

**Tabela 18. Të Ardhurave të veta në raport me Shpenzimet faktike, Bashkia Lezhë, në 000 Lekë**

| Emërtesa | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 |
|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet faktike | 196,385 | 179,569 | 214,033 | 171,335 | 173,230 |
| Të Ardhurat e veta | 119,435 | 128,840 | 141,560 | 103,871 | 99,051 |
| **% e të Ardhurave të veta** | **61%** | **72%** | **66%** | **61%** | **57%** |

***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*

**Figura 12. Të Ardhurave të veta në raport me Shpenzimet faktike, Bashkia Lezhë**




***Burimi:*** *Bashkia Lezhë*





# 5

# PLANI STRATEGJIK

## SWOT, Analiza e konsoliduar

Hartimi i Planit Strategjik u shoqërua me zhvillimin e Analizës SWOT, elementët e të cilës u diskutuan në takimet e Këshillit të Parneritetit për Zhvillim të Qëndrueshëm si dhe me stafin e Bashkisë. Analiza SWOT e konsoliduar përfshin edhe perceptimin dhe pritshmëritë që bizneset në Lezhë kanë për mjedisin në të cilin ato veprojnë, si dhe njohuritë për Planin Strategjik dhe gjykimet për ndikimin e tij në zhvillimin e biznesit në Lezhë. Këto vlerësime u bazuan në anketën e ndërmarrë në muajt Prill dhe Maj 2010 me disa biznese në Lezhë. Ky anketim kishte si qëllim edhe krahasimin mes perceptimit të biznesit në vitin 2005 dhe atij në vitin 2010 për cilësinë e mjedisit të biznesit në Lezhë.



<table>
<tr><th>Pikat e Forta</th><th>Pikat e Dobëta</th></tr>
<tr><td colspan="2">Demografia dhe Zhvillimi Urban</td></tr>
<tr><td>
<ul>
<li>Rritje e vazhdueshme e popullsisë, me 40% nga 1990 dhe me 15% nga viti 2005</li>
<li>Dendësi e lartë e popullsisë, 5.311 banorë për $km^2$</li>
<li>Qyteti është qendër e Qarkut Lezhë</li>
<li>Qyteti i shtrirë në të dy anët e Lumit Drin, një potencial për ndërtimin e mjediseve pushuese dhe argëtuese</li>
<li>Pozicionimi i qytetit mes një larmishmërie relievi (mal, kodër, lumë)</li>
</ul>
</td><td>
<ul>
<li>Rritje me 19% e popullsisë së moshë së tretë (2011-2013)</li>
<li>Mungesa e planit të përgjithshëm rregullues urban</li>
<li>Hapsira të pakta për zhvillimin e zonave të reja urbane</li>
<li>Mungesa e planeve të përbashkëta të zhvillimit urban me komunat përreth</li>
<li>Vonesa dhe pasaktësi në regjistrimin e pronave private e publike</li>
<li>Ekzistenca e ndërtimeve të paligjshme</li>
<li>Mosrespektimi i standarteve të ndërtimit</li>
<li>Blloqet e banimit të pasistemuara me standarte</li>
</ul>
</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rritja Ekonomike, Konkurrueshmëria dhe Kohezioni Ekonomik</td></tr>
<tr><td>
<ul>
<li>Klimë e stabilizuar për zhvillimin e sektorit privat</li>
<li>Rritje në vazhdimësi e punësimit</li>
<li>Kultura tradicionale familjare e mikpritëse e banorëve të Lezhës</li>
<li>Ekzistenca e institucioneve shkencore me shtrirje rajonale për bujqësinë dhe blegtorinë</li>
<li>Ekzistenca e hapësirave në ish-zonën industriale që mund të ristrukturohen, si dhe e mjediseve të stacionit të trenit, të ish-ndërmarrjes ushqimore</li>
<li>Qyteti qendër e shërbimeve bankare dhe financiare në qark</li>
<li>Kultivimi i prodhime bio përreth qytetit</li>
<li>Klima e përshtatshme mesdhetare që favorizon turizmin dhe prodhimin bujqësor</li>
<li>Interes në rritje i bizneseve të vogla dhe të mesme për turizmin, peshkimin, bujqësinë, fasonerinë dhe artizanatin</li>
<li>Sektori privat është punëdhënësi kryesor me 68%</li>
<li>Bizneset e vogla dhe të mesme përbëjnë 74% të totalit të biznese në qytet</li>
</ul>
</td><td>
<ul>
<li>Kreditim i ulët i bizneseve të reja</li>
<li>Bashkëpunim i pakonsoliduar midis institucioneve publike vendore dhe sektorit privat</li>
<li>Mungeseë marketimi profesional të bizneseve vendore</li>
<li>Zona industriale e qytetit e parehabilituar dhe pa biznese aktive</li>
<li>Numër i vogël i SME-ve</li>
<li>Biznese të artizanatit jo të mirë zhvilluara</li>
<li>Shkëmbime të dobëta periodike të të dhënave dhe informacioneve midis biznesit, bankave dhe qeverisë vendore</li>
<li>Rrjete biznesi të pakonsoliduara</li>
<li>Mungesa e një studimi të tregut të punës në Bashki</li>
<li>Arsimim i ulët i krahut të punës kryesisht në profesione si: hotelieri, hidraulik, elektriçist etj.</li>
<li>Informaliteti dhe konkurenca e pandershme në ekonomi</li>
<li>Prezencë e ulët e sipërmarrjeve inovatore dhe TIK</li>
<li>Pjesëmarrje e dobët e sipërmarrjes në organizata vendore, rajonale dhe kombëtare</li>
<li>Iniciativa sipërmarrëse tek të rinjë, e ulët</li>
</ul>
</td></tr>
</table>

| Pikat e Forta | Pikat e Dobëta |
|---|---|
| **Kohezioni Social, Shëndeti dhe Arsimimi** | |
| • Rritja e numrit të fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor, me 30% gjatë 2006-2013<br>• Raporti nxënës/mësues në arsimin 9-vjeçar ka shënuar rënie<br>• Frekuentimi i arsimit të mesëm profesional ka shënuar rritje (38%)<br>• Rritje e fëmijëve rom dhe egjiptjanë që shkojnë në kopësht<br>• Shkollat e qytetit të Lezhës janë të pajisura me terrene sportive si dhe me palestra<br>• Ulja e përqindjes së familjeve në ndihmë ekonomike<br>• Qyteti qendër e shërbimeve shëndetesore në qark<br>• Harmonia fetare në komunitet | • Infrastruktura arsimore parauniversitare e paplotësuar për të ofruar shërbime arsimore me standarte<br>• Mungesa e arsimit universitar<br>• Ulje e frekuentimit në shkollat e mesme të përgjithshme<br>• Përqindje e ulët e frekuentimit të vajzave në arsimin profesional krahasuar me djemtë<br>• Mungesa e arsimit profesional të konsoliduar<br>• Mjedise të gjelbëra të pamjaftueshme<br>• Mjedise sportive të pamjaftueshme<br>• Mjedise çlodhëse të pamjaftueshe për banorët (kryesisht rininë, moshën e tretë)<br>• Kënde lojrash për fëmijë, të pamjaftueshme dhe jo me standarte<br>• Shërbimet shoqërore nuk arrijnë të gjithë njerëzit në nevojë<br>• Shërbimet elektronike të shkollave mungojnë<br>• Biblioteka bashkiake e padixhitalizuar |
| **Mjedisi, Aksesi në Infrastrukturë dhe Shërbime** | |
| • Klimë mesdhetare dhe 226 ditë diell në vit<br>• Pozita gjeografike e favorshme, afërsia me Kryeqytetin, Kosovën, Malin e Zi<br>• Afërsia me plazhet e Shëngjinit, Kunes, Vainin, Tales<br>• Ekzistenca e Lumit Drin që përshkon qytetin<br>• Infrastruktura hekurudhore dhe rrugore e përqëndruar dhe afër qytetit<br>• Teknologji të suksesshme për grumbullimin dhe ndarjen e mbetjeve në qytet<br>• Funksionimi i impjantit të ndarjes së mbetjeve urbane<br>• Rritja e përqindjes së mbetjeve urbane të riciklueshme<br>• Amgazhim i investimeve të donatorëve për rritjen e cilësisë së shërbimeve publike<br>• 35% e bizneseve dhe 22% e familjeve kanë qasje në internet | • Furnizimi me ujë të popullsisë, nga 12-16 orë<br>• Infrastruktura e dobët e kanalizimeve të ujërave të zeza<br>• Infrastrukturë e dobët rrugore në disa zona periferike të qytetit<br>• Mungesa e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve Kultura e pamjaftueshme për mbrojtje kolektive të mjedisit<br>• Përmbytjet nga Lumi Drin<br>• Përmbytja nga sistemimi i dobët i ujërave të larta<br>• Jo të gjitha rrugët e qytetit janë të rehabilituara cilësisht<br>• Sinjalistika rrugore e paplotësuar<br>• Mungesa e unazës së qytetit<br>• Ndërgjegjesim i ulët e komuniteti dhe biznesit për përdorimin e energjisë diellore<br>• Nuk ka sistem qendror të furnizimit me gaz |

| Pikat e Forta | Pikat e Dobëta |
|---|---|
| **Kultura dhe Trashëgimia, Demokracia dhe Qeverisja Vendore** | |
| • Qyteti i Ilirisë i themeluar që në shekullin IV para Krishtit<br>• Kalaja dhe parku arkeologjik<br>• Trashëgimia e pasur historike me ngjarje dhe objekte të rëndësisë kombëtare<br>• Memoriali i Skënderbeut<br>• Lidhjet apo binjakëzimet me partnerë ndërkombëtarë në të mirë të qeverisjes vendore<br>• Pozicionimi i qytetit si qendër shërbimesh administrative për qarkun<br>• Bashkia ka kompetenca për ushtrimin e shërbimeve kryesore publike<br>• Bashkia ka disa qendra të shërbimeve sociale<br>• Shoqëria civile është aktive | • Indiferenca e komunitetit për t'u përfshirë në vendimmarrjen bashkiake<br>• Mungesa e disa planeve dhe strategjive vendore që mbulojnë funksionet e Bashkisë<br>• Ndërtimet pa leje në zonën arkeologjike, përreth kalasë<br>• Kapacitete të pamjaftueshme në Bashki për të shkruar projekte sipas standarteve të BE-së për të tërhequr fondet nga programet IPA, SEE apo të tjera.<br>• Kulturë e ulët e komunitetit në pagesën e detyrimeve bashkiake<br>• Transfertat financiare të dërguara nga qeveria qendrore të pamjaftueshme për sfidat me të cilat ndeshet bashkia<br>• Shoqëria civile është pak e organizuar<br>• Financime të ulta për rritje cilësore në shërbimet sociale |

| Mundësitë | Kërcënimet |
|---|---|
| **Demografia dhe Zhvillimi Urban** | |
| • Vazhdim i ardhjeve, kryesisht të grupmoshës së re, nga zonat përreth<br>• Fuqizimi i kërkesave ligjore për koordinimin e zhvillimit të territorit<br>• Rehabilitimi i rrugëve që lidhin komunat përreth me Bashkinë lehtëson shumë aksesin ndaj shërbimeve dhe produkteve<br>• Legjslacion dhe mundësia për publikimin elektronik, në portalin e AKPT, i kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi | • Ulja e përqindjes së popullsisë migruese për në qytet<br>• Zhvillimet urbane përreth qytetit të pakoordinuara me Bashkinë<br>• Shtim i presionit urban nga zonat përreth Bashkisë<br>• Mungesa e planeve pjesore të përbashkëta të zhvillimit të territorit me NJQV-ve përreth Bashkisë |
| **Rritja Ekonomike, Konkurrueshmëria dhe Kohezioni Ekonomik** | |
| • Prodhime bujqësore dhe blegtorale cilësore përreth Bashkisë potencial për bizneset përpunuese<br>• Kultivimi i prodhime bio përreth qytetit<br>• Ekzistenca e një numër të madh hotelesh dhe restoranteve cilësore në zonën e Shëngjinit (7 km larg qytetit)<br>• Rezerva minerare në afërsi të qytetit<br>• Potenciale të mëdha për përpunimin e produkteve të detit, në afërsi të qytetit<br>• Afërsi me Portin e Shëngjinit, tregun e Kosovës<br>• Afërsia me kompleksin ligatinor i Kune-Vain dhe Patok, që gjendet në deltat e lumenjve Drin dhe Mat<br>• Ekzistenca e planeve të menaxhimit të zonave turistike Shëngjinit, Drinit, Lagunës Kune dhe Vain lehtëson koordinimin e zhvillimit të turizmit me qytetin<br>• Lehtësira administrative në hapjen e bizneseve të reja | • Afërsia me qytetet e mëdha në Shqipëri dhe tregjet e tyre konkurruese, si Tirana, Shkodra dhe Durrësi<br>• Turizëm rajonal jo i integruar<br>• Mungesa e masterplanit rajonal të zhvillimit të turizmit<br>• Përqindje e lartë e kredive për biznesin<br>• Kostot e shërbimit bankar për bizneset, janë të larta<br>• Gjykata administrative në eficenë të ulët në raport me nevojat e biznesit<br>• Investime direkte në nivel të ulët në Rrethin e Lezhës<br>• Kapacitetet grumbulluese të produkteve bujqësore dhe blegtorale të ulta |
| **Kohezioni Social, Shëndeti dhe Arsimimi** | |
| • Shërbim shëndetësor në qytet me akses rajonal<br>• Programe nga donatorë dhe qeveria e qendrore për uljen e varfërisë<br>• Standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror të përcaktuara me legjislacion<br>• Interes i shtuar i qeverisë qendrore dhe aktorëve privatë për ngritjen e arsimit universitar në Lezhë<br>• Interes i shtuar i donatorëve për mbështetjen me programe të shërbimit të përkujdesit shoqëror | • Fonde të pamjaftueshme për rehabilitimin me cilësi dhe standarte të mjediseve të arsimit shkollor dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror në komunat përreth<br>• Mungesa e standarteve të plota për arsimin parauniversitar<br>• Zona përreth Bashkisë më të varfëra dhe më zhvillim më të dobët eknomik dhe social sesa Bashkia<br>• Shtim i personave, nga zonat përreth Bashkisë, që kërkojnë shërbime të përkujdesit shoqëror |

| Mjedisi, Aksesi në Infrastrukturë dhe Shërbime | |
|---|---|
| • Zona e lagunës Kune-Vain me status të zonës së mbrojtur<br>• Zona përreth qytetin pa vende me ndotje të lartë<br>• Infrasrukturë rrugore e përmirësuar që lidh qytetin me Tiranën dhe Durrësin<br>• Porti detar i Shëngjinit 7km nga qyteti<br>• Tre ofrues të shërbimeve celulare 3G<br>• Ulja e tarifave të shërbimit të telefonisë celulare<br>• Shërbim me fibër optike për qytetin dhe shtim të ofruesve të shërbimeve TIK | • Mungesa e nxitësve kombëtar për përdorimin e energjisë diellore nga komuniteti dhe biznesi<br>• Trasport hekurudhor me teknologji shumë të vjetëruar dhe jo konkurrues<br>• Kapacitete të vogla të Portit të Shëngjinit<br>• Mungesa e standarte të plota kombëtare për shërbimet publike vendore<br>• Dëmtim i mjedisit në zonën bregdetare |
| **Kultura dhe Trashëgimia, Demokracia dhe Qeverisja** | |
| • Interes në rritje për gërmime arkeologjike nga agjenci të specializura kombëtare dhe ndërkombëtare<br>• Lezha është pjesë e programit  të BE-së IPA Adriatik<br>• Proçesi i reformës administrativo-territoriale në fillimet e tij | • Nivel i dobët koordinimi midis institucioneve publike qëndrore dhe vendore në zbatimin e strategjive rajonale dhe vendore të zhvillimit<br>• Fonde të pamjaftueshme për mirëmbajtjen e zonës arkeologjike<br>• Fonde të pamjaftueshme nga qeveria për ofrimin me cilësi e standarte të shërbimeve publike<br>• Kompetenca të pakta të qeverisë vendore për shërbimet publike të shëndetit, arsimit, shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe uljes së varfërisë |

# Vizioni "Lezha 2030"

Lezha, qytet i gjelbërt turistik që pasuron jetën dhe trashëgiminë unike historike dhe kulturore, me ekonomi konkurruese e biznes inovator, me lidhje të shpejta e zhvillim urban e mjedisor të qëndrueshëm, qytet me komunitete dinamike e rini inovatore, që frymëzon progres e kërkimtari e që ofron dije të avancuar e mirëqenie për të gjithë.

## Qëllimet dhe Objektivat Zhvillimore



| QËLLIMET | OBJEKTIVAT |
|---|---|
| **TURIZIMI, KULTURA DHE ARKEOLOGJIA** | |
| **1**<br>Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm me trashëgimi të pasur kulturore, historike e arkeologjike, ku vizitorët i gëzohen bukurive natyrore dhe ofertës cilësore e të shumëllojshme turistike | **1.1**<br>Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët |
| | **2.1**<br>Rritja e kulturës dhe cilësisë së shërbimit të mikpritjes në bashkëpunim të ngushtë me aktorët e turizmit dhe qendrat e zhvillimit profesional |
| **EKONOMIA DHE SIPËRMARRJA** | |
| **2**<br>Ekonomi konkurruese, me zhvillim dinamik të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, mbështetur në industri mjedisore dhe teknologji inovative e që nxit investimet e shanset e barabarta për sipërmarrje | **3.2**<br>Fuqizim i kapaciteteve dhe shumëllojshmërisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që shfrytëzojnë prodhimin dhe prurjen turistike rajonale, zejet dhe produktet e traditës |
| | **4.2**<br>Tërheqja e zhvilluesve dhe investimeve në parkun e biznesit për të rritur punësimin, diversifikuar ekonominë dhe shtuar zinxhirin e vlerës së produkteve |
| | **5.2**<br>Fuqizimi ekonomik dhe rritja e pjesëmarrjes në sipërmarrje e të rinjve, grave dhe vajzave dhe njerëzve me sfida shoqërore |
| **ZHVILLIMI HAPSINOR DHE INFRASTRUKTURA** | |
| **3**<br>Zhvillim hapsinor funksional e bashkëkohor i bashkisë që harmonizon interesin e qytetarit me rritjen ekonomike, zhvillimin kulturor e mjedisor, e që rrit aksesin dhe modernizon lëvizshmërinë | **6.3**<br>Zhvillim harmonik dhe me standarte i hapësirave urbane që ofrojnë jetesë cilësore të komunitetit, rritje të vlerës së biznesit dhe të zonave arkeologjike e historike të qytetit |
| | **7.3**<br>Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale |
| | **8.3**<br>Ndërtimi i profilit arkitektonik, dizajnit e pejsazhit urban që pasurojnë jetën e njerëzve dhe e bën qytetin tërheqës dhe cilësisht të jetueshëm |

| QËLLIMET | OBJEKTIVAT |
|---|---|
| **CILËSIA E JETËS DHE KOMUNITETI** | |
| **4** Komunitet me jetë të shëndetëshme dhe aktive, me angazhim kulturor të larmishëm e ndërveprim shoqëror të harmonishëm, që mbështet barazinë gjinore, përfshirjen sociale në një shoqëri të informacionit. | **9.4** Pasurimi i jetës kulturore dhe komunitare që mundëson përparimin shpirtëror e kulturor të banorëve dhe ndërveprime shqërore të harmonishme mes njerëzve dhe brezave |
| | **10.4** Rritja e aftësive, aksesit dhe përfshirjes dixhitale të komunitetit në shoqërinë e informacionit |
| | **11.4** Shtimi i shanseve integruese, pasurimi dhe modernizmi i jetës së fëmijëve, të rinjve, grave dhe vajzave |
| | **12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave |
| | **13.4** Fuqizimi i mundësive të njerëzve në nevojë për shanse të barabarta zhvillimi dhe integrim në jetën shoqërore dhe komunitare |
| **MJEDISI DHE SHËRBIMET PUBLIKE** | |
| **5** Qytet me mjedis të pastër e të shëndetshëm që mbron jetën, klimën dhe biodiversitetin, e ku komuniteti përfiton shërbime publike cilësore e të sigurta | **14.5** Ulja e ndotjeve në mjedis dhe rritja e mekanizmave mbrojtës për natyrën dhe biodiversitetin |
| | **15.5** Menaxhimi i integruar dhe mjedisor i mbetjeve të ngurta urbane në partneritet me komunitetin, biznesin dhe OJF-të |
| | **16.5** Ofrimi i shërbimeve publike mjedisore dhe efiçente që mbrojnë jetën, natyrën e biodiversitetin dhe i shtojnë vlerën qytetit |
| | **17.5** Ofrimi i shërbimeve të furnizimit të shëndetëshme dhe efiçente që sigurojnë mirëqenien e njerëzve dhe zhvillimin e biznesit |
| | **18.5** Rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe e përdorimit me efiçencë të energjisë |

| QËLLIMET | OBJEKTIVAT |
|---|---|
| **DIJA DHE ZHVILLIMI NJERËZOR** | |
| **6**<br>Qytet universitar, ku dijet e avancuara dhe profesionalizmi garantojnë ritmet e zhvillimit ekonomik e njerëzor, dhe mbështesin ambicien, inovacionin dhe integrimin e rinisë | **19.6**<br>Ngritja në qytet e qendrave universitare e kërkimore që nxisin dhe inkurajojnë dijet e avancuara për të rinjtë dhe mbështesin zhvillimin e qytetit |
| | **20.6**<br>Rritja e aftësive dhe kualifikimeve profesionale të fuqisë punëtore që mundëson përfshirje aktive të të dy gjinive në tregun e punës dhe jetën shoqërore të qytetit |
| | **21.6**<br>Rritja e cilësisë së dijes dhe standarteve të mësimdhënies dhe aksesit në arsimin parauniversitar |
| **DEMOKRACIA DHE QEVERISJA VENDORE** | |
| **7**<br>Qeverisje bashkiake efiçente, e hapur, përfshirëse e moderne që mundëson arritjen e vizionit për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit dhe integrimin e komunitetit në hapësirën evropiane të zhvillimit | **22.7**<br>Modernizimi i politikëbërjes dhe rritja e cilësisë dhe efiçencës së ekzekutivit bashkiak për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë dhe ofrimin e shërbimeve me standarte evropiane |
| | **23.7**<br>Ngritja dhe përparimi inovator i qeverisjes inteligjente e elektronike bashkiake që garanton shërbime cilësor dhe ndërveprim aktiv e domokratik me qytetarët dhe bizneset |
| | **24.7**<br>Fuqizimi i demokracisë vendore me pjesëmarrje aktive të komunitetit në vendimmarrjen e qeverisë bashkiake |

# Matrica e Planit Strategjik të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Bashkia Lezhë

| Qëllimet | Objektivat | Programet | Nr | Projekti |
|---|---|---|---|---|
| **QËLLIMI 1. TURIZIMI, KULTURA DHE ARKEOLOGJIA** | | | | |
| Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm me trashigimi të pasur kulturore, historike e arkeologjike, ku vizitorët i gëzohen bukurive natyrore dhe ofertës cilësore e të shumëllojshme turistike | **1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashigimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **1/1.1** Infrastruktura kulturore dhe historike | 1 | Ndërtimi i Muzeut Etnografik në shtëpinë "Mlikaj" |
| | | | 2 | Restaurimi i shtëpisë tradicionale "Zekaj" |
| | | | 3 | Sistemimi i zonave pranë kalasë me hapësira të gjelbëruara |
| | | | 4 | Restaurimi i zonës arkeologjike pranë Memorialit të Skënderbeut dhe mureve ilire |
| | | | 5 | Rehabilitimi i kalasë mesjetare për t'a kthyer në mjedis aktivitetesh kulturore dhe të vizitueshëm nga turistët |
| | | | 6 | Zgjerimi i zonës së gërmimeve arkeologjike |
| | | | 7 | Realizimi i gërmimeve arkeologjike horizontale në zonën arkeologjike |
| | | | 8 | Katalogimi i kulturës materiale arkeologjike dhe dokumentimi i tyre në broshurën e parkut arkeologjik të Lezhës |
| | | | 9 | Restaurimi i objekteve në qafë të kalasë duke përfshirë varrezat mesjetare dhe ndërtesën e kultit Kristian |
| | | | 10 | Ndërtimi i mbulesës së re të monumentit të varrit të Skënderbeut |
| | | | 11 | Ndërtimi i Muzeut Historik të Lezhës |
| | | | 12 | Ndërtimi i sinjalistikës për turistët në Parkun Arkeologjik |
| | | | 13 | Ndërtim i Muzeut Arkeologjik të Lezhës |
| | | | 14 | Lirimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonës përreth Kalasë nga ndërtimet e paligjshme |
| | | | 15 | Hartimi i strategjisë së kulturës dhe krijimtarisë |
| | | | 16 | Gjelbërimi i hapësirave në zonën arkeologjike |
| | | | 17 | Ndërtimi i shtegut turistik me shkallare për në Kala |
| | | **2/1.1** Promovimi i resurseve turistike | 18 | Zhvillimi i hartës turistike të zonës arkeologjike |
| | | | 19 | Ngritja e zyrës së informacionit turistik |
| | | | 20 | Hartimi i guidës turistike dhe paketës promovuese për turizmin në Lezhë |
| | | | 21 | Fushatë sensibilizuese për mbrojtjen e zonës arkeologjike |
| | | | 22 | Zhvillimi i stendës promocionale "Lezha IME" |
| | | | 23 | Hartimi i masterplanit për zhvillimin e turizmit në Lezhë |
| | | | 24 | Zhvillimi i fushatës sensibilizuese për mbrojtjen e zonës arkeologjike |
| | | | 25 | "Dita e Kalasë", me aktivitete kulturore, promovuese dhe ndërgjegjësuese |
| | | | 26 | Turne edukuese në Lezhë me gazetarë dhe agjenci turistike për promovimin e qytetit |
| | | | 27 | Panairi vjetor i kulinarisë dhe hotelerisë së zonë së Lezhës, çmimi i vitit |
| | | | 28 | Krijimi i aplikacionit në celular "Thesaret e Lezhës" |
| | | **3/1.1** Pasurim i profilit turistik të qytetit me bukuritë natyrore të zones përreth qytetit | 29 | Promovimi i Tumave me Gures si pjesë e intinerarit turistik të Lezhës |
| | | | 30 | Restaurimi i Kroit të Hidrolez dhe kthimi në objekti të vizitueshëm |
| | | | 31 | Restaurimi i Kroit të Shehrit dhe kthimi në objekt të vizitueshëm |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **2.1** Rritja e kulturës dhe cilësisë së shërbimit të mikpritjes në bashkëpunim të ngushtë me aktorët e turizmit dhe qendrat e zhvillimit profesional | **4/2.1** Zinxhirët e biznesit (cluster) për turizmin kulturor dhe natyror | 32 | Tryeza vjetore "Mikëpritja Lezhiane" me agjencitë publike dhe bizneset e industrisë së mikëpritjes |
| | | | 33 | Ngritja e zinxhirit (cluster) të bizneseve të turizmit |
| | | **5/2.1** Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për turizmin cilësor | 34 | Trajnim për çertifikimin e njësive akomoduese |
| | | | 35 | Kurs trajnimi për guidat për prezantimin e zonën së vizitueshme turitiske në Lezhë |
| **QËLLIMI 2.** EKONOMIA DHE SIPËRMARRJA | | | | |
| Ekonomi konkurruese, me zhvillim dinamik të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, mbështetur në industri mjedisore dhe teknologji inovative e që nxit investimet e shanset e barabarta për sipërmarrje | **3.2** Fuqizim i kapaciteteve dhe shumëllojshmerisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që shfrytëzojnë prodhimin dhe prurjen turistike rajonale, zejet dhe produktet e traditës | **6/3.2** Lehtësirat dhe kuadri rregullator për bizneset dhe sipërmarrjen | 36 | Hartimi i planit të zhvillimit të zonë së vjetër industriale të Lezhës |
| | | | 37 | Studimi "Nxitja dhe lehtësira fiskale vendore për bizneset e reja të përpunimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale në Lezhë" |
| | | | 38 | Nxitja dhe lehtësira fiskale vendore për bizneset e reja të energjisë së rinovueshme |
| | | | 39 | Nxitja dhe lehtesira fiskale vendore për bizneset e reja të turizmit |
| | | **7/3.2** Nxitja e inovacionit dhe sipërmarrjes në biznes | 40 | Botim me informacion dhe ilustrime fotografike të zejeve dhe produkteve artizanale të Lezhës |
| | | | 41 | Projekti "Nxitja e bizneseve familiare të produkteve të artizanatit" |
| | | | 42 | Projekti "Promovimi i potencialeve për zhvillimin e biznesit agro-ushqimor në zonën industriale të qytetit" |
| | | | 43 | Ndërtimi i tregtores për frura perime, produkteve të bulmetit, mishit dhe peshkut |
| | | | 44 | Krijimi i hartës së bizneseve në territorin e qytetit |
| | | **8/3.2** Fuqizimi i kapaciteteve të bizneseve | 45 | Kurse trajnimit për çertifikimin e produkteve vendore |
| | | | 46 | Kurse trajnimi për bizneset e reja në menaxhim biznesi |
| | **4.2** Tërheqja e zhvilluesve dhe investimeve në parkun e biznesit për të rritur punësimin, diversifikuar ekonominë dhe shtuar zinxhirin e vlerës së produkteve | **9/4.2** Infrastruktura dhe planifikimi për sipërmarje në parkun e biznesit | 47 | Ndërtimi i Parkut të Biznesit në partneritet me biznesin privat |
| | | | 48 | Instalimi i infrastrukturës së furnizimeve për zonën e Parkut të Biznesit |
| | | **10/4.2** Lehtësirat dhe kuadri rregullator për sipërmarje në parkun e biznesit | 49 | Hartimi i rregullores për menaxhimin e Parkut të Biznesit |
| | | | 50 | Paketa e lehtësirave fiskale për bizneset e Parkut të Biznesit |
| | | | 51 | Hartimi i portalit në faqen e internetit të Bashkisë "Investo në Parkun e Biznesit Lezhë" |
| | **5.2** Fuqizimi ekonomik dhe rritja e sipërmarrjes së të rinjve, grave dhe vajzave dhe njerëzve me sfida shoqërore | **11/5.2** Infrastruktura dhe kapacitetet për sipërmarrje e të rinjve grave dhe vajzave | 52 | Mbajtja e panairit vjetor të ideve invatore të të rinjve grave dhe vajzave për biznes |
| | | | 53 | Ngritja e inkubatorit të biznesit social |
| | | | 54 | Hartimi i paketës rregullatore për inkubatorin e biznesit |
| | | **12/5.2** Lehtesirat dhe kapacitetet për sipërmarje të personave me sfida sociale | 55 | Ngritja e qendrës së prodhimeve artizanale në shërbim të komunitetit rom |
| | | | 56 | Paketa fiskale me lehtësira për personat me sfida sociale |

# QËLLIMI 3. ZHVILLIMI HAPSINOR DHE INFRASTRUKTURA

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zhvillim hapsinor funksional e bashkëkohor i Bashkisë që harmonizon interesin e qytetarit me rritjen ekonomike, zhvillimin kulturor e mjedisor, e që rrit aksesin dhe modernizon lëvizshmërinë | **6.3** Zhvillim harmonik dhe me standarte i hapësirave urbane që ofrojne jetesë cilësore të komunitetit, rritje të vleres së biznesit dhe të zonave arkeologjike e historike të qytetit | **13/6.3** Rivitalizimi bashkëkohor i blloqeve mes pallateve dhe hapësirave publike urbane | 57 | Sistemim me standarte i bllokut të banimit Bregu i Drinit me lulishte dhe kënd lojrash për fëmijë (ish-komunale) |
| | | | 58 | Sistemim me standarte i bllokut të banimi të lagjes SMT me lulishte dhe kënd lojrash për fëmijë |
| | | | 59 | Sistemim me standarte i bllokut të banimit të lagjes “Besëlidhja” me lulishte dhe kënd lojrash për fëmijë |
| | | | 60 | Sistemim me standarte i bllokut të banimit në lagjen “Gurra” me lulishte dhe kënd lojrash për fëmijë |
| | | | 61 | Sistemim me standarte i bllokut të banimit në lagjen “Skënderbeg” me lulishte dhe kënd lojrash për fëmijë |
| | | | 62 | Sistemim me standarte i bllokut të banimit në lagjen “Spitalit” me lulishte dhe kënd lojrash për fëmijë |
| | | | 63 | Rikualifikimi urban modern i qendrës së qytetit |
| | | | 64 | Sistemimi i bllokut të banimi në lagjen “Nënë Tereza” |
| | | **14/6.3** Hartimi i studimeve dhe kuadrit rregullator për zhvillimin urban modern | 65 | Hartimi i instrumentit të përgjithshëm urban për qytetin |
| | | | 66 | Hartimi i instrumentit pjesor urban për zhvillimin e zonës në dy anët e Lumit Drin |
| | | | 67 | Krijimi i sistemit GIS për menaxhimin e zhvillimit të territorit |
| | | | 68 | Hartimi i rregullores vendore për zhvillimin e territorit |
| | | | 69 | Hartimi i instrumentit pjesor urban për zonën e vjetër industriale |
| | **7.3** Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **15/7.3** Rehabilitimi me starndarte i sistemit rrugor në qytet | 70 | Rehabilitimi rrugës Spital-Sheher |
| | | | 71 | Sistemim, asfaltim e ndriçim i rrugëve në Bllokun 11.2 ha në lagjen “Besëlidhja” |
| | | | 72 | Rikonstruksion i rrugës e sistemim bllokut të banimit tek Shkolla ”Gj.Fishta” |
| | | | 73 | Rikonstruksion i plotë i Rrugës “Shtraus”, lagja Besëlidhja Lezhë (Faza 3) |
| | | | 74 | Asfaltimi me standarte i Rrugës “Gjergj Fishta” |
| | | | 75 | Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore dhe sistemimi hapësirës publike në lagjen “Kodër Marlekaj” |
| | | | 76 | Asfaltimi i Rrugës “Faik Konica” |
| | | | 77 | Asfaltimi i Rrugës “Papa Gjon Pali II” |
| | | | 78 | Asfaltim i Rrugës ‘Kosova” |
| | | | 79 | Rehabilitimi i rrugës kryesore në lagjen S.M.T |
| | | | 80 | Rikonstruksion i urës së qytetit |
| | | | 81 | Rehabilitimi i urës e vjetër duke ruajtur elementët e arkitekturës tradicionele |
| | | | 82 | Asfaltimi i Rrugës “Luigj Gurakuqi” |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 83 | Asfaltim i Rrugës “Fran Bardhi” |
| | | | 84 | Asfaltim i Rrugës në lagjen “Nënë Tereza” |
| | | | 85 | Asfaltim i rrugës për tek Spitali |
| | | **16/7.3** Ndërtimi i infrastrukturës cilësore për transportin | 86 | Ndërtim i unazës se qytetit |
| | | | 87 | Ndërtimi i rrugës Qendër- Kala-Sheher |
| | | | 88 | Sistemim i brigjeve dhe ndërtimi i portit mbi Lumin Drin në qytet |
| | **8.3** Ndërtimi i profilit arkitektonik, dizajnit e pejsazhit urban që pasurojnë jetën e njerëzve dhe e bën qytetin tërheqës dhe cilësisht të jetueshëm | **17/8.3** Kuadri rregullator vendor për arkitekturën dhe dizajnin në qytet | 89 | Hartimi i rregullores për fasadat për ruajtjen e tipareve arkitekturore të zonës së Lezhës |
| | | | 90 | Mbajtja e një konkursi ndërkombetar për arkitekturën moderne të qendrës së qytetit |
| | | | 91 | Hartimi i studimit për profilin arkitekturor dhe elementët e dizajnit urban në qytet |
| | | **18/8.3** Profili arkitekturor dhe dizajni urban | 92 | Rehabilitimi i fasadave të pallateve në bulevardin Gjergj Fishta |
| | | | 93 | Vendosja e skulpturave në zonat kryesore urbane të qytetit |

## QËLLIMI 4. CILËSIA E JETËS DHE KOMUNITETI

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Komunitet me jetë të shëndetëshme dhe aktive, me angazhim kulturor të larmishëm e ndërveprim shoqëror të harmonishëm, që mbështet barazinë gjinore, përfshirjen sociale në një shoqëri të informacionit. | **9.4** Pasurimi i jetës kulturore dhe komunitare që mundëson përparimin shpirtëror e kulturor të banorëve dhe ndërveprime shqërore të harmonishme mes njerëzve dhe brezave | **19/9.4** Zhvillimi i kulturës dhe krijimitarisë për komunitetin | 94 | Reabilitimi Pallatit të Kulturës (faza II) |
| | | | 95 | Ndërtimi i dhomës për muzikën në Pallatin e Kulturës |
| | | | 96 | Ndërtimi i sallës për artin alternativ në Pallatin e Kulturës |
| | | | 97 | Nxitja e ngritjes së kinemasë në qytet |
| | | **20/9.5** Shkëmbimet kulturore rajonale të komunitetit | 98 | Ngritja e Qendrës Rinore |
| | **10.4** Rritja e aftësive, aksesit dhe përfshirjes dixhitale të komunitetit në shoqërinë e informacionit | **21/10.4** E-komuniteti aktiv në Lezhë | 99 | Kurse trajnimi për të rinjtë gratë dhe vajzat me sfida sociale për përdorimin e blogjeve dhe forumeve në mediat sociale për ndërveprim me qeverinë bashkiake dhe me aktorë të tjerë në komunitet |
| | | | 100 | Vendosja e kompjuterave në qendrat e shërbimit social në qytet për të nxitur komunikimin elektronik |
| | | | 101 | Ngritja e bibliotekës elektronike të qeverisë bashkiake |
| | | | 102 | Ndërtimi i sistemit WF në lulishten kryesore të qytetit |
| | **11.4** Shtimi i shanseve integruese, pasurimi dhe modernizmi i jetës së fëmijëve, të rinjve, grave dhe vajzave | **22/11.4** Zhvillimi bashkëkohor i fëmijëve | 103 | Festivali i fëmijëve të shkollave 9–vjeçare |
| | | | 104 | Fëmijët në programet rajonale |
| | | **23/11.4** Barazia gjinore | 105 | Organizmi i kurseve të rrobaqepsisë dhe të kompjuterit për gratë dhe vajzat në nevojë |
| | | | 106 | Hartimi i strategjisë së barazisë gjinore për Bashkinë Lezhë |
| | | | 107 | Ofrimi i lehtësirave të shërbimeve shëndetësore për gratë dhe vajzat në nevojë |
| | | | 108 | Integrimi gjinor në politikat e zhvillimit të Bashkisë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **24/11.4** Zhvillimi bashkëkohor i rinisë | 109 | Organizimi i festave me të rinj në të gjithë lagjet e qytetit |
| | | | 110 | Organizimi i Ditës së Rinisë |
| | | | 111 | Festival i zërave të rinj |
| | | | 112 | Zhvillimi i strategjisë për rininë |
| | | | 113 | Rinia agjente për ndryshim social |
| | **12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **25/12.4** Jetesa e shëndetëshme e komunitetit | 114 | Rikonstruksioni dhe zgjerimi i qendrës shëndetësore në lagjen “Skënderbeg” |
| | | | 115 | Instalimi i stacionit për monitorimin e cilësisë së ajrit në Lezhë |
| | | | 116 | Ndërtimi i stabilimentit për denatyrimin e mbetjeve teknologjike të produkteve ushqimore |
| | | | 117 | Ngritja e sistemit modern të monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ujit të pijshëm të ujësjellësit |
| | | | 118 | Monitormi i cilësisë së ujit të Lumit Drin |
| | | | 119 | Ndërtimi i qendrës shëndetësore në lagjen Skënderbeg në shërbim të komunitetit rom dhe egjiptian |
| | | **26/12.4** Mjediset çlodhëse dhe sportive për komunitetin | 120 | Ndërtimi i pallatit të sportit |
| | | | 121 | Ndërtimi i qendrës sportive, pranë kompleksit të shkollave |
| | | | 122 | Ndërtimi i qendrës sportive në shkollën Nënë Tereza |
| | | | 123 | Ndërtimi i Qendrës së Lojërave me Dorë |
| | | | 124 | Ndërtimi i shëtitores në Lumin Drin |
| | | | 125 | Ndërtimi i qendrës sportive, pranë shkollës Gjergj Fishta |
| | | | 126 | Krijimi i parkut natyror në 2.5 ha mbi lagjen “Nënë Tereza” panoramike nga deti |
| | | | 127 | Mbjellja e së paku 5 llojeve të  pemëve autoktone në dekorimin e qytetit |
| | | | 128 | Aktivizimi i shëtitjes me varka përgjatë Lumit Drin |
| | | **27/12.4** Siguria e qytetarëve | 129 | Sistemimi i Përroti të Manatise në anën e rrugës “Shtrarus” |
| | | | 130 | Vendosja në dy pika e hidrometrit  për monitorimin e nivelit të Lumit Drin |
| | | | 131 | Sistemimi i territorit pranë kalasë për të mbrojtur zonën nga rrëshqitjet e dheut dhe gurëve |
| | | | 132 | Policimi komunitar për sigurinë në shkolla |
| | | | 133 | Fushatë sensibilizimi me nxënësit dhe prindërit për sigurinë në shkolla |
| | | **28/13.4** Shërbimet shoqërore eficente dhe cilësore për njerëzit në nevojë | 134 | Ndërtimi i strehezës për rehabilitimin e grave dhe vajzave të dhunuara |
| | | | 135 | Instalimi i linjes 24 orëshe për dhunën ndaj gruas dhe në familje |
| | | | 136 | Hapja e 2 mikro çerdhe-kopësht pranë vendeve të punës në ndihmë të nënave |
| | | | 137 | Ngritja e qendrës ditore në lagjen “Skënderbeg” në shërbim edhe të komunitetit Rom dhe Egjyptian |
| | | | 138 | Ngritja e qendrës së moshës së tretë në lagjen “Nënë Tereza” |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **13.4** Fuqizimi i mundësive të njerëzve në nevojë për shanse të barabarta zhvillimi dhe integrim në jetën shoqërore dhe komunitare | | 139 | Ngritja e qendrës së moshës së tretë në lagjen “Skënderbeg” |
| | | | 140 | Ndërtimi i qendrës ditore për moshën e tretë në lagjen “Gurra” |
| | | | 141 | Hartimi i strategjisë së shërbimeve shoqërore dhe aksesit |
| | | | 142 | Ndërtimi i qendrës ditore për moshën e tretë në lagjen e Spitalit |
| | | | 143 | Zbatimi i standarteve në mjediset publike për lëvizjen e njerëzve me aftësi të kufizuara |
| | | | 144 | Ndërtimi i qendrës ditore me standarte për fëmijët me sfida sociale dhe fizike |
| | | **29/13.4** Strehimi shoqëror | 145 | Ndërtimi i tre pallateve për strehim social |
| **QËLLIMI 5.** MJEDISI DHE SHËRBIMET PUBLIKE | | | | |
| Qytet me mjedis të pastër e të shëndetshëm që mbron jetën, klimën dhe biodiversitetin, e ku komuniteti përfiton shërbime publike cilësore e të sigurta | **14.5** Ulja e ndotjeve në mjedis dhe rritja e mekanizmave mbrojtës për natyrën dhe biodiversitetin | **30/14.5** Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit | 146 | Hartimi i strategjisë vendore të mbrojtjes së mjedisit |
| | | | 147 | Plani i mbrojtjes së gjallesave të Lumit Drin |
| | | | 148 | Vendosja e koshave për mbetjet përgjatë dy anëve të Lumit Drin, segmenti që kalon përmes Bashkisë Lezhë |
| | | | 149 | Plani për mbrojtjen e peisazhit natyror me pasuritë arkeologjike |
| | | | 150 | Ngritja e sistemit për monitorimin e zhurmave në qytet |
| | | | 151 | Hartimi i planit të pastrimin të ajrit në qendër të qytetit nga ndotja nga gazrat e makinave dhe pluhurat |
| | | **31/14.5** Ndërgjegjësim dhe pjesëmarrja e publikut në mbrojtjen e mjedisit | 152 | Ngritja e grupeve komunitare për monitorimin e mjedisit |
| | | | 153 | Aktivitete ndërgjegjësimi me grupmosha, me profesionistë, tregtarë, industrialistë për sigurinë në përdorimin e kimikateve |
| | **15.5** Menaxhimi i integruar dhe mjedisor i mbetjeve të ngurta urbane në partneritet me komunitetin, biznesin dhe OJF-të | **32/15.5** Infrastruktura dhe teknologjia e menaxhimi të integruar dhe mjedisor të mbetjeve | 154 | Modernizmi i mjeteve për mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve |
| | | | 155 | Ngritja e sistemit per largimin e mbetjet spitalore dhe të rrezikshme |
| | | | 156 | Modernizimi dhe rritja e kapacitetit të Qendrës për Ndarjen e Mbetjeve të Ricikluеshme |
| | | | 157 | Riparimi i 108 kontenierëve në qytet |
| | | | 158 | Blerja e 201 kontenierëve të rinj (PMM) |
| | | | 159 | Fshirja me autofshesë e hapësirave publike |
| | | | 160 | Krijimi i skemës për mbledhjen, transportin e depozitimin e mbetjeve të ndërtimit |
| | | | 161 | Modernizmi i sistemit për mbledhjen e tarifës së pastrimit |
| | | | 162 | Avancimi i sistemit GIS për menaxhimin e mbetjeve |
| | | | 163 | Ditët e pastrimit vullnetar me 300 nxënës dhe studentë |
| | | **33/15.5** Riciklimi i mbetjeve të ngurta urbane | 164 | Instalimi i skemës derë -më-derë për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve në Zonën B dhe C të qytetit |
| | | | 165 | Aplikimi i sistemin me 2 rryma, për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në të gjithë qytetin |
| | | | 166 | Java e informimit publik për promovimin e ndarjes së mbetjeve në burim nga familjet dhe mbledhja e diferencuar e mbetjeve |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Qytet me mjedis të pastër e të shëndetshëm që mbron jetën, klimën dhe biodiversitetin, e ku komuniteti përfiton shërbime publike cilësore e të sigurta | | | 167 | Hartimi i rregullores vendore për riciklimin e mbetjeve të ngurta urbane |
| | | | 168 | Pastrimi i plastikës me pjesëmarrje dhe menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë e Lezhës (PMM) |
| | **16.5** Ofrimi i shërbimeve publike mjedisore dhe efiçente që mbrojnë jetën, natyrën e biodiversitetin dhe i shtojnë vlerën qytetit | **34/16.5** Sistemi efiçent dhe kanalizimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura | 169 | Rikonstruksioni i kanalizimeve të ujrave të ndotura në lagjet periferike të qytetit |
| | | | 170 | Lidhja e sistemit të ujrave të ndotura me impjantin e trajtimit të ujrave të ndotura |
| | | **35/16.5** Ndriçimi publik efiçent e mjedisor | 171 | Rehabilitimi i ndriçimit publik në rrugën e Spitalit |
| | | | 172 | Hartimi i planit të ndriçimit publik të Bashkisë |
| | | | 173 | Dixhitalizim i manaxhimit të ndriçimit publik të qytetit |
| | | **36/16.5** Lëvizshmëria mjedisore dhe e sigurtë e banorëve | 174 | Ndërtimi i trotuarit nga “Ura e Cenit” tek Rruga “Shtraus” |
| | | | 175 | Ndërtimi i mbikalimit për këmbësorë tek Kisha e Dom Lleshit |
| | | | 176 | Ndërtimi i mbikalimit për këmbësorët në Gurrat |
| | | | 177 | Ndërtimi i mbikalimi për këmbesorët tek rotonda |
| | | | 178 | Ndërtimi i pasarelës panoramike mbi Lumin Drin |
| | | | 179 | Ndërtimi i korsive të biçikletave |
| | | | 180 | Ndërtimi i rampave për lëvizjen e njerëzve me aftësi të kufizuara (PAK) |
| | | **37/16.5** Transporti dhe trafiku modern | 181 | Ndërtimi i një parkimi nëntokësor |
| | | | 182 | Ndërtimi i terminalit për transportin e udhëtarëve, tek stacioni i trenit |
| | | | 183 | Vendosja e semaforëve për rregullimin e trafikut rrugor |
| | | | 184 | Plotësimi me standarte i sinjalistikës vertikale për trafikun |
| | | | 185 | Ndërtimi i qendrës elektronike të kontrollit të trafikut urban |
| | | | 186 | Vendosja e sistemit të plotë të adresave |
| | **17.5** Ofrimi i shërbimeve të furnizimit të shëndetëshme dhe efiçente që sigurojnë mirëqenien e njerëzve dhe zhvillimin e biznesit | **38/17.5** Furnizimi me ujë të pijshëm cilësor | 187 | Ndërtimi i dy depove të reja të ujësjellësit për qytetin, me kapacitet total prej 7000m3 |
| | | | 188 | Plotësimi i rrjetit të ujësjellësit në të gjithë territorin e Bashkisë sipas standarteve e normave teknike. |
| | | | 189 | Dyfishimi i kapacitetit të depos së ujësjellësit egzistuese të ujësjellësit |
| | | | 190 | Rikonstruksioni i rrjetit shpërndarës egzistues të ujësjellesit |
| | | **39/17.5** Sistemi i kanalizimit të ujrave të shiut | 191 | Ndërtimi i sistemit plotësues të kanalizimeve të ujrave të shiut në qytet |
| | | | 192 | Rehabilitimi i rrjetit egzistues të kanalizimeve të ujrave të shiut |
| | | **40/17.5** Furnizimi me gaz i qytetit nepërmjet sistemit qendror | 193 | Hartimi i studimit të fizibilitetit për furizimin me gaz të qytetit përmjet sistemit qendror |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **18.5** Rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe e përdorimit me eficencë të energjisë | **41/18.5** Energjia e rinovueshme | 194 | Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinën e Bashkisë |
| | | | 195 | Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinën e gjimnazit "Hydajet Lezha" |
| | | | 196 | Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinën e pallatit të kulturës |
| | | | 197 | Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinat e shkollave 9-vjeçare të qytetit |
| | | | 198 | Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinat e kopshteve të qytetit |
| | | | 199 | Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinën e konviktin të shkollës "Kolin Gjoka" |
| | | | 200 | Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinat e qendrave ditore të shërbimeve komunitare |
| | | | 201 | Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinën e Spitalit |
| | | | 202 | Fushatë ndërgjegjësimi për energjinë e rinovueshme |
| | | **42/18.5** Efiçenca e energjisë | 203 | Pilotimi në një godinë që administrohet nga Bashkia të furnizimit me energji zero |
| | | | 204 | Instalimi i ndriçimi LED në 100% të ndriçuesve publik në rrugët egzistuese të qytetit |
| | | | 205 | Vendosja e llampave me kursim energjie në godinat që administrohen nga Bashkia |
| | | | 206 | Hartimi i planit të efiçencës së energjisë |
| | | | 207 | Rehabilitimi i godinës së Bashkise në nivelet e përdorimit më të ulët të energjisë |
| | | | 208 | Efiçenca e energjisë në ndërtesa ekzistuese me bashkëpronësi |

## QËLLIMI 6. DIJA DHE ZHVILLIMI NJERËZOR

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Qytet universitar, ku dijet e avancuara dhe profesionalizmi garantojnë ritmet e zhvillimit ekonomik e njerëzor, dhe mbështesin ambicien, inovacionin dhe integrimin e rinisë | **19.6** Ngritja në qytet e qendrave universitare e kërkimore që nxisin dhe mbështesin dijet e avancuara për të rinjtë dhe mbështesin zhvillimin e qytetit | **43/19.6** Qendrat e arsimit të lartë | 209 | Hapja e qendrës së arsimit të lartë për turizmin |
| | | | 210 | Hapja e qëndrës së arsimit të lartë për albanologji |
| | | **44/19.6** Bashkëpunimi mes qendrave universitare dhe Bashkisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës së Lezhës | 211 | Ngritja e bordit koordinues mes qendrës universitare për turizmin dhe Bashkisë për mbështetjen e zhvillimit të turizmit në zonën e Lezhës |
| | | | 212 | Angazhimi i studenteve në punë kërkimore në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm në zonën e Lezhës |
| | **20.6** Rritja e aftësive dhe kualifikimeve profesionale të fuqisë punëtore që mundëson përfshirje aktive të të dy gjinive në tregun e punës dhe jetën shoqërore të qytetit | **45/20.6** Infrastruktura e arsimit profesional | 213 | Ngritja e qendrës së formimit profesional |
| | | | 214 | Zhvillimi i një serie kursesh trajnimi për të punësuarit në sektorin e turizmit |
| | | | 215 | Kurs trajnimi për menaxhimin e hotelerisë dhe kulinarisë për zonën e Lezhës |
| | | | 216 | Rehabilitimi i Shkollës "Kolin Gjoka" |
| | | **46/20.6** Rrjetëzimi punëdhënës punëkërkues | 217 | Punësimi aktiv në sektorin privat në partneritet me institucionet publike |
| | | | 218 | Mbajtja e panairit vjetor të punës |
| | | | 219 | Fushatë ndërgjegjësimi për ndjekjen e arsimit profesional nga gra dhe vajza |
| | | | 220 | Fushatë ndërgjegjësimi për avantazhet e arsimit profesional |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Qytet universitar, ku dijet e avancuara dhe profesionalizmi garantojnë ritmet e zhvillimit ekonomik e njerëzor, dhe mbështesin ambicien, inovacionin dhe integrimin e rinisë | **21.6** Rritja e cilësisë së dijes dhe standarteve të mësimdhënjes dhe aksesit në arsimin parauniversitar | **47/21.6** Zhvillimi arsimor i fëmijëve parashkollorë me metoda dhe njohuri bashkëkohore | 221 | Trajnimi i edukatorëve dhe mësuesve për zhvillim të fëmijëve parashkollorë me metoda bashkëkohore |
| | | | 222 | Reahabilitimi dhe zgjerim i kopshtit me ushqim në lagjen "Besëlidhja" |
| | | | 223 | Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në lagjen "Skënderbeg" |
| | | | 224 | Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në lagjen e Spitalit (Varosh) |
| | | | 225 | Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në lagjen "Nënë Tereza" |
| | | | 226 | Ndërtimi i kompleksit arsimor, çerdhe, kopësht dhe shkollë 9-vjeçare në lagjen "Skënderbeg" me fokus arsimimin e komunitetit rom dhe egjiptian |
| | | | 227 | Reahabilitimi i kopshtit në lagjen "Gurrat" |
| | | | 228 | Ndërtimi i çerdhes në lagjen "Nënë Tereza" |
| | | | 229 | Ndërtimi i çerdhes në lagjen "Skënderbeg" |
| | | **48/21.6** Sistemi arsimor parauniversitar modern dhe me akses të barabartë | 230 | Caktimi i fondit të veçantë për mbështetjen e të rinjëve rom dhe egjiptian që do të ndjekin studimet e larta |
| | | | 231 | Mbështetje me mjete finaciare për të rinjtë rom dhe egjiptian për të nxitur shkollimin e tyre në Lezhë |
| | | | 232 | Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare në lagjen e Spitalit (Varosh) |
| | | | 233 | Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare në lagjen "Skënderbeg" |
| | | | 234 | Rehabilitimi i Shkollës "Gjergj Fishta" |
| | | | 235 | Hartimi i studimit mbi mjedisin e shëndetshëm në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit |
| | | **49/21.6** Dixhitalizimi i shërbimeve të institucioneve të dijes dhe arsimit | 236 | Zhvillimi i faqes së internetit në shkollat 9-vjeçare e të mesme të qytetit |
| | | | 237 | Plotësimi i shkollave me laboratore kompjuterike |
| | | | 238 | Informatizimi i bibliotekës së qytetit |
| **QËLLIMI 7.** QEVERISJA BASHKIAKE | | | | |
| Qeverisje bashkiake efiçente, e hapur, përfshirëse e moderne që mundëson arritjen e vizionit për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit dhe integrimin e komunitetit në hapësirën evropiane të zhvillimit | **22.7** Modernizimi i politikëbërjes dhe rritja e cilësisë dhe efiçencës së egzekutivit bashkiak për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm të Bashkisë dhe ofrimin e shërbimeve me standarte evropiane | **50/22.7** Efiçenca e kostos së shërbimeve publike | 239 | Mbajtja e anketimit vjetor me publikun për cilësinë e shërbimeve publike bashkiake |
| | | | 240 | Fuqizimi i kapaciteteve të auditit të brendëshëm të Bashkisë |
| | | | 241 | Kryerja e analizës finaciare dhe hartimi i raportit për rritjen e efiçencës së përdorimit të fondeve buxhetore bashkiake në shërbimet kryesore publike |
| | | | 242 | Miratimi i standarteve dhe treguesve të monitorimit të cilësisë së shërbimeve publike bashkiake |
| | | **51/22.7** Zhvillimi i njohurive dhe aftësive të avancuara të vendimmarrësve dhe punonjësve të Bashkisë | 243 | Avancimi i njohurive të ekzekutivit të Bashkisë për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm me pjesëmarrje |
| | | | 244 | Avancimi i njohurive të këshillit bashkiak për hartimin dhe analizën e buxhetit bashkiak mbi bazë rezultatesh |
| | | | 245 | Instalimi i sistemit modern të menaxhimit të burimeve njerëzore të qeverisë bashkiake |
| | | | 246 | Trajnimi i ekzekutivit për hartimin e projekteve të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë |
| | | | 247 | Trajnimi i ekzekutivit për shërbimet elektronike |
| | | | 248 | Trajnimi i ekzekutivit për barazinë gjnore |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Qeverisje bashkiake efiçente, e hapur, përfshirëse e moderne që mundëson arritjen e vizionit për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit dhe integrimin e komunitetit në hapësirën evropiane të zhvillimit | | **52/22.7** Transparenca dhe llogaridhënja e qeverisë bashkiake | 249 | Trajnimi i ekzekutivit për integritetin dhe etikën në qeverisje |
| | | | 250 | Trajnimi i ekzekutivit të Bashkisë për transparencën dhe llogaridhënjen në qeverisje |
| | | | 251 | Rikonstruksioni i sallës së mbledhjeve të këshillit bashkiak dhe instalimi i fonisë dhe regjistrimi me video i mbledhjeve të këshillit bashkiak |
| | **23.7** Ngritja dhe përparimi inovator i qeverisjes inteligjente e elektronike bashkiake që garanton shërbime cilësor dhe ndërveprim aktiv e domokratik me qytetarët dhe bizneset | **53/23.7** Qeverisja elektronike | 252 | Informatizimi i shërbimeve publike administrative të qeverisë bashkiake |
| | | | 253 | Përdorimi i firmës elekronike për shërbimet dhe transaksionet e Bashkisë me qytetarët dhe bizneset |
| | | | 254 | Instalimi i pagesave online nëpërmjet faqes së internetit të Bashkisë |
| | | | 255 | Informatizimi i arkivave të Bashkisë |
| | | | 256 | Avancimi i shërbimeve të faqes së internetit të Bashkisë |
| | | | 257 | Hartimi i strategjisë për qeverisjen elektronike |
| | | | 258 | Ngritja e Qendrës së Thirrjeve në godinën e Bashkisë |
| | | | 259 | Ngritja e Zyrës me Një Ndalesë në godinën e Bashkisë dhe instalimi i moduleve të e-qeverisjes |
| | | | 260 | Instalimi i e-pjesëmarrjes në çeshtjet bashkiake |
| | | | 261 | Aktivizimi i sistemit informativ gjeografik (GIS) për përdorimin e hartës së menaxhimit të mbetjeve urbane |
| | | | 262 | Ndërtimi i platformës elektronike për monitorimin dhe raportimin nga publiku mbi cilësinë e shërbimeve publike |
| | **24.7** Fuqizimi i demokracisë vendore me pjesëmarrje aktive të komunitetit në vendimmarrjen e qeverisë bashkiake | **54/24.7** Institucionalizimi i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen bashkiake | 263 | Institucionalizimi i pjesëmarrje së komunitetit dhe biznesit në diskutimin e paketës fiskale |
| | | | 264 | Institucionalizimi i pjesëmarrjes së të rinjve, grave dhe vajzave në proçesin e buxhetimit vendor vjetor dhe afatmesëm |
| | | | 265 | Ngritja e zyrës së komunikimit me rininë |
| | | | 266 | Fuqizimi i Këshillit të Partneritetit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bashkisë me komitetin këshillimor për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut |
| | | | 267 | Instalimi i buxhetimit të ndjeshëm gjinor me pjesëmarrje |
| | | **55/24.7** Qytetari aktiv në zhvillimiin modern të qytetit dhe komunitetit | 268 | Java “Si e dua qytetin tim” |
| | | | 269 | Emisioni “Lezha dhe perspektiva Evropiane e komunitetit” |

# Matrica e Treguesve të Planit Strategjik të Zhvillimit të Qëndrueshëm

| Objektivat | Nr | Treguesit Matës<br>Emërtimi | Vlera bazë Bashkia /2013 | Strategjia Kombetare/Rajonale | Shënjestra e Bashkisë | Sektori bashkiak monitorues |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **QËLLIMI 1.** TURIZIMI, KULTURA DHE ARKEOLOGJIA | | | | | | |
| **1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | 1 | nr. i vizitorëve vendas e të huaj, sipas gjinisë, në Memorialin e Skënderbeut | 18,282 (3000 të huaj) | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | 2 | m² gërmime arkeologjike në zonën arkeologjike | 930 | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | 3 | nr. i objekteve të trashigimisë kulturore të restauruara | 2 | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | 4 | nr. i botimeve që promovojnë turizmin në Lezhë | 30 | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | 5 | nr. i artikujve për promovimin e Lezhës të botuar në median e huaj | 9 | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| **2.1** Rritja e kulturës dhe cilësisë së shërbimit të mikpritjes në bashkëpunim të ngushtë me aktorët e turizmit dhe qendrat e zhvillimit profesional | 6 | % e njësive akomoduese në Qytetin e Lezhës të çertifikuara nga agjencitë qeveritare | 0 | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | 7 | nr. i zinxhirëve/rrjeteve (cluster) të krijuar mes bizneseve në zone e Lezhës për ofrimin e shërbimeve turistike | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| **QËLLIMI 2.** EKONOMIA DHE SIPËRMARRJA | | | | | | |
| **3.2** Fuqizim i kapaciteteve dhe shumëllojshmërisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që shfrytëzojnë prodhimin dhe prurjen turistike rajonale, zejet dhe produktet e traditës | 8 | % e NVM-ve në qytet që janë miqësore me mjedisin | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | 9 | % e të punësuarve në biznese të gjelbëra dhe inovatore, sipas gjinisë | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | 10 | % e bizneseve familiare që punojnë me zejet dhe produktet e traditës | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | 11 | nr. biznese të reja për 10,000 banorë | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | 12 | nr. i bizneseve të trajnuar, sipas gjinisë, për çertifkimin e produkteve | | | | Integrimi gjinor |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **4.2** Tërheqja e zhvilluesve dhe investimeve në parkun e biznesit për të rritur punësimin, diversifikuar ekonominë dhe shtuar zinxhirin e vlerës së produkteve | **13** | nr. i ndërmarrjeve aktive jo-bujqësore të reja për 1000 banorë | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | **14** | % e ndërmarrjeve përpunuese të çertifikuara me ISO | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | **15** | % rritjes së ndërmarrjeve jo bujqësore | | Strategjia e zhvilimit te biznesit | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | **16** | % e vendeve të punës në Parkun e Biznesi në raport me vendet e punës në sektorin privat në qytet | 0% | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| **5.2** Fuqizimi ekonomik dhe rritja e sipërmarrjes së të rinjve, grave dhe vajzave dhe njerëzve me sfida shoqërore | **17** | % e biznese të vogla e të mesme që zotërohen nga gra dhe vajza | 39.3% | | | Integrimi gjinor |
| | **18** | % e rritjes së nivelit të punësimit tek të rinjtë | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |
| | **19** | % e të rinjve që zotërojnë biznese të vogla e të mesme | | | | Zhvillimi i qëndrueshëm |

## QËLLIMI 3. ZHVILLIMI HAPSINOR DHE INFRASTRUKTURA

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **6.3** Zhvillim harmonik dhe me standarte i hapësirave urbane që ofrojne jetesë cilësore të komunitetit, rritje të vlerës së biznesit dhe të zonave arkeologjike e historike të qytetit | **20** | % e sipërfaqes së hapësirave mes pallatave të rehabilituara plotësisht dhe me standarte | | | | Zhvillimi i territorit |
| | **21** | % e sipërfaqes urbane publike e rikualifikuar plotësisht dhe me standarte bashkëkohore | | | | Zhvillimi i territorit |
| | **22** | $m^2$ hapësirë banimi cilësore për banorë | | | | Zhvillimi i territorit |
| **7.3** Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **23** | % e sipërfaqeve të rrugëve të asfaltuara me standart të lartë | 66% | | 100% (2030) | Shërbimet publike |
| | **24** | nr. i infrastrukturave moderne që mundësojnë transport modern dhe mjedisor | 80% | | | Shërbimet publike |
| | **25** | % e territorit të Bashkisë e akesuar me rrugë me standarte | | | | Zhvillimi i territorit |
| | **26** | nr. i makinave private të regjistruara për 100 banorë | | | | Zhvillimi i territorit |
| | **27** | % e njerëzve që shkojnë në punë në këmbë e me biçikletë në raport me njerëzit që lëvizin me mjete motrike | | | | Zhvillimi i territorit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **8.3** Ndërtimi i profilit arkitektonik, dizajnit e pejsazhit urban që pasurojnë jetën e njerëzve dhe e bën qytetin tërheqës dhe cilësisht të jetueshëm | **28** | % e territorit të mjediseve publike me mobilim urban moden | | | | Zhvillimi i territorit |
| | **29** | % e ndërtimeve të reja (me leje zhvillimi), në raport me totalin e ndërtimeve të reja (me leje zhvillimi), që përfshijnë elementë arkitekturorë të traditës | 0% | | | Zhvillimi i territorit |
| **QËLLIMI 4. CILËSIA E JETËS DHE KOMUNITETI** | | | | | | |
| **9.4** Pasurimi i jetës kulturore dhe komunitare që mundëson përparimin shpirtëror e kulturor të banorëve dhe ndërveprime shqërore të harmonishme mes njerëzve dhe brezave | **30** | nr. i të rinjve të angazhuar drejtpërdrejtë në organizimin e aktiviteteve që pasurojnë jetën kulturore në qytet | | | | Mirëqenia sociale |
| | **31** | nr. i të rinjve që marrin pjesë në aktivitetet e qendrës ditore sociale | | | | Mirëqenia sociale |
| | **32** | nr. në vit i aktiviteteve artistike e kulturore të organizuar me qëllim pasurimin e jetës së komunitetit | 27 | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | **33** | % e rritjes në vit të vet iniciativave të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në dobi të jetës aktive në komunitet | | | | Mirëqenia sociale |
| **10.4** Rritja e aftësive, aksesit dhe përfshirjes dixhitale të komunitetit në shoqërinë e informacionit | **34** | % e familjeve me akses në internet me shpejtësi mbi 4 Mbps | 22% | | | IT |
| | **35** | % e bizneseve me akses në internet me shpejtësie mbi 30 megabits për sekond | 35% | | | IT |
| | **36** | % e familjeve me akses në internet me shpejtësie mbi 30 megabits për sekond | 0% | EU 2020, 50% e familjeve | | IT |
| **11.4** Shtimi i shanseve integruese, pasurimi dhe modernizmi i jetës së fëmijëve, të rinjve, grave dhe vajzave | **37** | nr. i fëmijëve që marrin pjesë në aktivitetet rajonale dhe evropiane | | | | Mirëqenia sociale, rinia |
| | **38** | nr. i organizatave të shoqërisë civile që trajtojnë çështjet e zhvillimit të grave e vajzave dhe të rinjve | | | | Mirëqenia sociale, rinia |
| | **39** | nr. i të rinjve që marrin pjesë në aktivitetet rajonale dhe evropiane | | | | Mirëqenia sociale, rinia |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **40** | përputhshmëria e treguesve të cilësisë së ajrit P.M10, P.M2.5 me standartet evropiane të cilësisë së ajrit | | Strategjia ndërsektoriale e mjedisit 2013-2020 | | Shërbimet publike |
| | **41** | m² sipërfaqe e gjelbër për banorë | 3m² | | 5 m² (2020) 6 m² (2030) | Shërbimet publike |
| | **42** | nr. i pemëve dekorative në hapësirën publike të qytetit | 2026 | | | Shërbimet publike |
| | **43** | m² për frymë e sipërfaqes së mjediseve sportive | 1.046 m² | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | **44** | nr. i aktiviteteve sportive jashtë kurikulës shkollore të organizuara me komunitetin | | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | **45** | nr. i ankesave adresuar Bashkisë, sipas gjinisë, në lidhje me sigurinë e shëndetin e qytetarëve | | | | Shërbimet publike |
| **13.4** Fuqizimi i mundësive të njerëzve në nevojë për shanse të barabarta zhvillimi dhe integrim në jetën shoqërore dhe komunitare | **46** | % e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike | 5.3% (2013) | | | Mirëqenia sociale |
| | **47** | % e grave dhe vajzave në nevojë që marrin shërbime të fuqizimit social | | | | Mirëqenia sociale |
| | **48** | % e mjediseve publike (godina dhe rrugë) me akses sipas standarteve për personat me aftësi të kufizuara | 7% | | | Mirëqenia sociale |
| | **49** | % e fëmijëve në nevojë që marrin shërbime sociale, sipas gjinisë | 28% (12% e fëmijëve vajza) | | | Mirëqenia sociale |
| | **50** | % e personave të moshës së tretë që marrin shërbime shoqërore nga Bashkia, sipas gjinisë | | | | Mirëqenia sociale |
| | **51** | % e personave me status të pastrehit të strehuar në banesa sociale, sipas gjinisë | | | | Mirëqenia sociale |

## QËLLIMI 5. MJEDISI DHE SHËRBIMET PUBLIKE

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **14.5** Ulja e ndotjeve në mjedis dhe rritja e mekanizmave mbrojtës për natyrën dhe biodiversitetin | **52** | % e sipërfaqes së qytetit që monitorohet aktivisht nga Bashkia dhe komuniteti në lidhje me mbrojtjen e mjedisit | 20% | | 65% (2018) 100% (2025) | Shërbimet publike |
| | **53** | vlera mesatare e zhurmës gjatë natës | | 45 dB(A), për zonat urbane | | Shërbimet publike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **15.5** Menaxhimi i integruar dhe mjedisor i mbetjeve të ngurta urbane në partneritet me komunitetin, biznesin dhe OJF-të | 54 | % e sipërfaqes së qytetit që mbulohet me shërbim sipas kërkesave ligjore të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve urbane | 80% | | 100% (2016) | Shërbimet publike |
| | 55 | % e mbulimit të kostos operative të shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve | 48% (2011) (familjet 9%, bizneset 39%. institucionet 0%) | | 100% (2030) | Shërbimet publike |
| | 56 | % e mbetjeve urbane që shkojnë në fushë depozitimin sanitar (landfillin) të Bushatit | 83 %, 2012 (PMM), (6020 ton-2013) | Deri në v.2025 të reduktohet depozitimi i mbetjeve në landfill në rreth 30% | 73% (2018) 53% (2025) | Shërbimet publike |
| | 57 | % e sipërfaqeve të rrugëve që do të fshihen me autofshesë | 20% | | 30% (2016) | Shërbimet publike |
| | 58 | % e qytetarëve që vlerësojnë qytetin të pastër dhe shumë të pastër, sipas gjinisë | 76% (PMM) | | 92% (2018) | Shërbimet publike |
| | 59 | % e peshës së 4 përbërësve të mbetjeve të ngurta urbane që përgatiten për ripërdorim dhe riciklim nga QNMRC | 17% (PMM) | 50% të peshës së përgjithshme të 4 rrymave të mbetjeve (qelq, letër metal, plastike) përgatiten për riciklime ripërdorim, 2020 | 50%, viti 2020 (PMM) 90%, viti 2030 | Shërbimet publike |
| | 60 | % e sasisë së mbetjeve që ndahen nga QNMRC dhe kanë destinacion të sigurtë tregun e riciklimit | 24%, viti 2011 (PMM) | | 29% (2015) 100% (2018) | Shërbimet publike |
| | 61 | % e familjeve që ndajnë mbetjet në burim dhe përfitojnë largimin e diferencuar të mbetjeve | 0.20% | | 40% (2018) 100% (2030) | Shërbimet publike |
| | 62 | % e sasisë së mbetjeve të ricikIueshme që destinohen në QNMRC (PMM) | 17%, viti 2011 | | 37% (2015) 100% (2018) | Shërbimet publike |
| **16.5** Ofrimi i shërbimeve publike mjedisore dhe efiçente që mbrojnë jetën, natyrën e biodiversitetin dhe i shtojnë vlerën qytetit | 63 | % e godinave në Bashki të lidhura me sistemin e kanalizimit të ujrave të ndotura | 73% | (draft SKZhl- furnizmi me ujë, ujrat e ndotura), Bashkia | 100% (2025) | Shërbimet publike |
| | 64 | % e popullsisë e lidhur me sistemin e kanalizimit të ujërave të ndotura | | (draft SKZhl- furnizmi me ujë, ujrat e ndotura), Bashkia | 70% (2018) 95% (2025) | Shërbimet publike |
| | 65 | % e vëllimit të përgjithshëm të ujërave të ndotura të gjeneruara në qytet të trajtuara nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura | 0% | | 97% (2025) | Shërbimet publike |
| | 66 | nr. i km korsi të dedikuara për biçikleta | 0 km | | 1.6 km (2020) | Shërbimet publike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 67 | % e ndërtesave publike të pajisura me rampa | 2% | | 24% (2015) | Shërbimet publike |
| | 68 | % e popullsisë që përdor transportin publik | | | 100% (2015) | Shërbimet publike |
| | 69 | % e rrugëve kryesore me sinjalistikë moderne dhe të kontrolluar elektronikisht | 0% | | 90% (2020) | Shërbimet publike |
| **17.5** Ofrimi i shërbimeve të furnizimit të shëndetëshme dhe efiçente që sigurojnë mirëqenien e njerëzve dhe zhvillimin e biznesit | 70 | % e familjeve që furnizohen 24 orë në ditë me ujë të pijshëm nga sistemi i ujësjellësit, dhe sipas standarteve të OBSH | 0% | | 100% (2020) | Shërbimet publike |
| | 71 | % e bizneseve që furnizohen 24 orë në ditë me ujë të pijshëm nga sistemi i ujësjellësit, dhe sipas standarteve të OBSH | 0% | | 100% (2016) | Shërbimet publike |
| | 72 | nr. i orëve që furnizohen ndërtesat dhe bizneset me ujë të pijshëm nga sistemi i ujësjellësit | 12-16 orë | | 24 hours (2016) | Shërbimet publike |
| | 73 | % e zonës urbane që mbulohet me rrjetit e furnizimit me ujë të pijshëm nga ujësjellësi | 94% | draft SKZhl: water supply, polluted waters, municipality (National) | 100% (2018) | Shërbimet publike |
| | 74 | % e tubacioneve në ml e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm i rehabilituar me standarte | 70 % (146 km) | | 100% (2020) | Shërbimet publike |
| | 75 | % e zonës urbane mbulohet me rrjetit e kanalizimeve të ujrave të shiut | 60% | | 100% (2018) | Shërbimet publike |
| | 76 | % e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të shiut e rehabilituar | 35% | | 100% (2018) | Shërbimet publike |
| | 77 | % e ndërtesave të lidhura me sistemin qëndror të furnizmit me gaz | 0% | | 80% (2030) | Shërbimet publike |
| **18.5** Rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme e përdorimit me efiçencë të energjisë | 78 | % e banesave që përdorin ngrohje diellore të ujit | 1% | | 70% (2030) | Shërbimet publike |
| | 79 | % of energjisë së rinovueshme e përdorur në qytet në krahasim me konsumin total | 0% | | 35% (2030) | Shërbimet publike |
| | 80 | % e ndriçuesve publik në rrugët e qytetit, me kursim energjie | 2% | | 530 LED lights (2025) | Shërbimet publike |
| | 81 | % e sipërfaqes publike të qytetit e mbuluar me ndriçim LED | 0% | | 80% (2018) | Shërbimet publike |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 82 | % e energjisë së kursyer në objektet publike që administrohen nga Bashkia, nëpërmjet përdorimit të kërkesave ligjore për kursimin e energjisë | 10% | | 90% (2030) | Shërbimet publike |
| | 83 | % e ndërtesave të rihabilituara të sjellura në nivelet e përdorimit më të ulët të energjisë | | | 90% (2030) | Shërbimet publike |
| | 84 | % e ndërtesave të reja që përdorin izolim termik për kursimin e energjisë | | | 100% (2030) | Shërbimet publike |

## QËLLIMI 6. DIJA DHE ZHVILLIMI NJERËZOR

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **19.6** Ngritja në qytet e qendrave universitare e kërkimore që nxisin dhe mbështesin dijet e avancuara për të rinjtë dhe mbështesin zhvillimin e qytetit | 85 | nr. i studenteve universitarë që ndjekin arsimin e lartë në Lezhë, sipas gjinisë | 0 | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | 86 | nr. i degëve të arsimit të lartë në qytetet | 0 | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| **20.6** Rritja e aftësive dhe kualifikimeve profesionale të fuqisë punëtore që mundëson përfshirje aktive të të dy gjinive në tregun e punës dhe jetën shoqërore të qytetit | 87 | % e nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm që ndjekin shkollat e arsimit profesional, sipas gjinisë | 40% (51% jane gra dhe vajza) | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | 88 | % e punësimit të plotë e sezonal, të njerëzve të çertifikuar nga strukturat e arsimit profesional, sipas gjinisë | 60 % (kryesisht pune sezonale), (35% gra dhe vajza) | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | 89 | % e grave dhe vajzave të punësuara nëpërmjet formimit profesional | 8 | Strategjia për barazinë gjinore 2011-2015 | | Rinia dhe integrimi gjinor |
| | 90 | nr. i grave dhe vajzave që përfitojnë nga programet e trajnimit për përputhjen me nevojat e tregut (aftësimi profesional e punësim aktiv) | 180 | (SKZhI--gjinor) | | Rinia dhe integrimi gjinor |
| **21.6** Rritja e cilësisë së dijes dhe standarteve të mësimdhënjes dhe aksesit në arsimin parauniversitar | 91 | nr. i të rinjve, sipas gjinisë, që marrin pjesë në programet e punësimit aktiv të ofruara nga sektori privat në partneritet me institucionet publike | 60 (53% gra dhe vajza) | SKZhI | | Rinia dhe integrimi gjinor |
| | 92 | % e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës ndaj totallt të grave të afta për punë | 58% | | | Rinia dhe integrimi gjinor |
| | 93 | % braktisjes së shkollës në arsimin fillor dhe të detyrueshëm (5 deri 16 vjeç), sipas gjinisë | 0% | Strategjia kombëtare e arsimit parauniversitar, 2013, NSDC 2020 | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **94** | % e nxënësve që vazhdojnë arsimin universitar dhe atë profesional, sipas gjinisë | 76% ne UT (maturante), 20% në profesional (nga 9-vjeçar) (35% gra dhe vajza) | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | **95** | % e 5-vjeçarëve që marrin pjesë në arsimin parashkollor, sipas gjinisë | 90% (45% gra dhe vajza) | (SKZhI-- arsimi) | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | **96** | % e nxënësve që mbarojnë shkollën e mesme (kalueshmëria), sipas gjinisë | 97%, 98% gra dhe vajza | | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| | **97** | nr. i nxënësve për kompjuter të lidhur në internet në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme | 22 | Strategjia ndërsektoriale e shoqërisë së informacionit | | Arsimi, kultura, turizmi, sportet |
| **QËLLIMI 7.** DEMOKRACIA DHE QEVERISJA VENDORE | | | | | | |
| | **98** | % e banorëve që vlerësojnë mirë dhe shumë mirë cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike, sipas gjinisë | | | | Komunikimit me publikun |
| | **99** | nr. i bashkëpunimeve ndërvendore të Bashkisë | 8 | | | Zhvillimit të qëndrueshëm |
| | **100** | nr. i studimeve për rrijen e efiçencës në ofrimin e shërbimeve publike bashkiake (është ulur kostoja pa ulur cilësinë) | | | | Shërbimeve publike, Auditi brendshëm |
| **22.7** Modernizimi i politikëbërjes dhe i ofrimit të shërbimeve ndaj publikut për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm dhe me standarte evropiane të Bashkisë | **101** | % e këshilltarëve bashkiak të trajnuar për hartimin dhe monitorimin e politikave për zhvillim të qëndrueshëm të Bashkisë, sipas gjinisë | 64% (6.25 janë gra dhe vajza) | | | Sekretari i Këshillit Bashkiak |
| | **102** | % e këshilltarëve bashkiak të trajnuar për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm, sipas gjinisë | 72% (5.56 janë gra dhe vajza) | | | Sekretari i Këshillit Bashkiak |
| | **103** | % i punojësve të trajnuar për tema shumëplanëshe (cross cuting) p.sh barazia gjinore, menaxhimi, planifikimi, monitorimi i performancës, buxhetimi, sipas gjinisë | 88% (42% e grave dhe vajzave janë trajnuare) | | | Menaxhimit të burimeve njerëzore |
| | **104** | % e punojësve të trajnuar në vit për fushën e sektorit ku punon, sipas gjinisë | 73% (37% e grave dhe vajzave janë trajnuar) | | | Menaxhimit të burimeve njerëzore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **105** | % e projekteve të fituara kundrejt totalit të dorëzuar në qeveri, donatorë dhe programe zhvillimore të BE | 36% | | | Zhvillimit të qëndrueshëm |
| | **106** | nr. i raporteve të transparencës dhe llogaridhënjes bashkiake të publikuara nga Bashkia | 59 | | | Komunikimit me publikun |
| **23.7** Ngritja dhe përparimi inovator i qeverisjes inteligjente e elektronike bashkiake që garanton shërbime cilësor dhe ndërveprim aktiv e domokratik me qytetarët dhe bizneset | **107** | nr. i shërbimeve online që ofrohen nga faqja e internetit e Bashkisë | 3 (info, shkarkim formularësh, dërgo mesazh) | | 6, në vitin 2020 | TIK |
| | **108** | nr. i banorëve dhe bizneseve që qasen çdo vit në faqen e internetit të Bashkisë për të marrë shërbime | 27,538 (mesatar 2300/ muaj) | | | TIK |
| | **109** | % e të rinjve, sipas gjinisë, që shërbehen nga Zyra me Një Ndalesë në Bashki | | | | Drejtuesi i Zyrës me Një Ndalesë |
| **24.7** Fuqizimi i demokracisë vendore dhe pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrjen e qeverisë bashkiake | **110** | % vjetore e pjesëmarrjes së të rinjve në mekanizmat e konsultimit për vendimmarrjen bashkiake, sipas gjinisë | | | | Rinia dhe integrimi gjinor |
| | **111** | % e mbledhjeve në vit e këshillit bashkiak me praninë e grupeve të interesit | | | | Sekretari i Këshillit Bashkiak |
| | **112** | nr. i komenteve për projekt vendimet dhe vendimet e këshillit të Bashkisë të dërguar Bashkisë | | | | Sekretari i Këshillit Bashkiak |
| | **113** | % vjetore e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në mekanizmat e konsultimit për vendimmarrjen bashkiake | | | | Rinia dhe integrimi gjinor |
| | **114** | % e publikut që shprehet se janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me përfshirjen nga Bashkia të pubikut në vendimmarrjen bashkiake | | | | Komunikimit me publikun |

# Fishat e projekteve

## Qëllimi 1. Turizimi, kultura dhe arkeologjia

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Ndërtimi i Muzeut Etnografik në shtëpinë "Mlikaj" | **Programi: 1/1.1** Infrastruktura kulturore dhe historike |
|---|---|---|
| 1 | **Objektivi i Strategjisë: 1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.3** Nr. i objekteve të trashëgimisë kulturore të restauruara |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Shtëpia e Mlikajve (Ish Muzeu Etnografik) ndodhet në lagjen e vjetër "Skënderbeg" të qytetit të Lezhës. Është ndërtuar në fund të shek.XIX-të si një banesë popullore qytetare. Nga viti 1910-1911 është banuar nga familja Mlikaj deri në vitet 1980-1981, kur ajo shdërrohet në Muze Etnografik, dhe shërben si i tillë deri në vitin 1992. Fondi muzeal që ekspozohej dikur tek Shtëpia e Mlikajve sot ruhet në një sallë të Bibliotekës Publike të qytetit tonë. Ai përbëhet nga një numër i konsiderueshëm objektesh etnografike (mbi 800 të tilla) dhe janë në gjendje relativisht të mirë. Objektet kanë secila pasaportën e vet me numër dhe janë të dixhitalizuara. Ndërtesa aktuale e ish-Muzeut Etnografik (Shtëpia e Mlikajve) ashtu si ajo e Zekajve, ka vlera të mëdha historike, arkitekturore dhe estetike. Gjendja e saj sot nuk është dhe aq e mirë. Problematika kryesore e këtij objekti është çatia dhe dekoracionet prej druri në të gjithë dhomat e saj si dhe çardaçet.

***Synimi i projektit***

Projekti synon kthimin e kësaj shtëpie karakteristike të qytetit të Lezhës, e cila ka titullin Monument Kulture të kategorisë së I-rë, në muze etnografik të zonës së Lezhës.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Blerja e objektit
- Restaurimi i objekteve
- Promovimi i këtyre objekteve.

**Rezultatet e pritshme:**

- Muzeu etnografik për trevën e Lezhës
- 808 objekte etnografike me passaportë të ekspozuara
- Rritja e numrit të turistëve
- Rritja e interesit për kërkuesit në fushën e historisë, kulturës dhe turizmit

**Grupet e synuara:**

- Turistët
- Agjencitë qeveritare të turizmit
- Bizneset që lidhen me turizmin
- Komuniteti
- Studiuesit e fushave te ndryshme

**Aktorët e mundshëm:**

- IMK
- Pronarë
- Bashkia
- Qarku

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Instituti i Monumenteve të Kulturës
- Agjencitë rajonale dhe qendrore
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**

- Muzeu Etnografik për ruajtjen dhe ekspozimin e objekteve muzeale në kushte optimale

**Treguesit matës:**

- Nr. i objekteve të ekspozuara
- Nr. i vizitorëve

**Para kushtet:**

- Vullneti për bashkërendimin e përpjekjeve nga aktorët e interesuar

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i kontributeve të aktorëve
- Mos parashikimi në kohë i fondeve nga institucionet përkatëse
- Përkeqësimi i gjendjes së objekteve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| Krijimi i hapësirave të mbrojtura ekspozuese | 7,000,000 |
| Pajisja me elemente të tjera ekspozuese si stenda etj. | 7,000,000 |
| Materiale promocionale | 30,000 |
| **Totali** | **14,030,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:** 2014-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:** 2016

| Nr. | Titulli i Projektit: Restaurimi i shtëpisë tradicionale "Zekaj" | Programi 1/1.1 Infrastruktura kulturore dhe historike |
|---|---|---|
| 2 | **Objektivi i Strategjisë: 1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.3** Nr. i objekteve të trashëgimisë kulturore të restauruara |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Ndërtesa e shtëpisë së Zekajve i përket periudhës kur lagja "Varosh" shndërrohet në Sheherin Otoman. Rrënojat e vjetra të themeleve dhe objekteve datohen si të fund shekullit 18-të dhe fillimit të shekullit të 19-të. Në këtë ndërtesë janë kryer punime rindërtimi herëpashere në përiudha të ndryshme kohore. Me kthimin e saj në monument kulture të kategorisë së parë janë realizuar dy ndërhyrje restauruese, ku e fundit ishte ajo e vitit 1988. Shtëpia e Zekajve nga pikëpamja konstruktive ruhet relativisht mirë, (përjashto një dhomë nga ana e pasme, e cila është shembur pjesërisht. Ndërsa çatia dhe interieri i brendshëm janë degraduar dhe grabitur. Si pasojë e rënies së shiut brenda dhomave, çardaçet, dyert, dritaret dhe dollapet qorr janë dëmtuar shumë nga lagështira dhe grabitjet nga keqbëresit. Po si rezultat i pikimit të shiut janë dëmtuar edhe dy oxhaqe me vlera të mëdha artistike, si edhe tavani me kupolë dhe ai me dërrasë pishe, rozetat, kthinat dhe hamami. Hyrja kryesore e cila përbëhet nga një portë e bukur me qemer, është rrëzuar duke ngelur vetëm qemeri pa çatinë sipër. Duke parë këtë gjendje, zgjidhja afatshkurtër për shpëtimin e këtij monumenti të rrallë është riparimi urgjent i çatisë në mënyrë që këtij objekti të mos i bie shiu brenda. Kjo shtëpi konsiderohet si pjesë e ansamblit të vlerave arkitektonike të qytetit të Lezhës dhe do të ndihmojë në zhvillimin e turizmit.

***Synimi i projektit***

Projekti ka për qëllim mbrojtjen e këtij objekti, shpallur monument kulture dhe duke qenë shtëpi banimi me vlera të rëndësishme të arkitekturës qytetare lezhjane do të ndikojë në konsolidimin e vlerave historiko-kulturore.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Projekti teknik
- Zbatimi

**Rezultatet e pritshme:**
- Mure, çati, dritare etj të restauruara
- Rritja e numrit të turistëve
- Rritja e interesit për kërkuesit në fushën e historisë, kulturës dhe turizmit

**Grupet e synuara:**
- Turistët
- Agjencitë qeveritare të turizmit
- Bizneset që lidhen me turizmin
- Komuniteti

**Aktorët e mundshëm:**
- Iinstituti i Monumenteve të Kulturës (IMK)
- Pronarët e banesës
- Bashkia

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**
- IMK
- Pronarët e banesave
- Donatorë

**Produktet:**
- Restaurimi i mureve, çatisë, dritareve etj
- Kthimi i Shtëpisë Zekaj në objekt të vizitueshëm

**Treguesit matës:**
- Nr. i vizitorëve në Shtëpinë Zekaj

**Para kushtet:**
- Vullneti për bashkërendimin e përpjekjeve nga aktorët e interesuar
- Shtëpitë e ruajnë statusin e tyre si monumente kulture të kategorisë së I-rë

**Faktorë rrezikues:**
- Mos koordinimi i kontributeve të aktorëve
- Mos parashikimi në kohë i fondeve nga institucionet përkatëse
- Përkeqësimi i gjendjes së objekteve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | | |
|---|---|---|
| • Restaurimi i shtëpisë Zekaj | | 35,000,000 |
| • Mobilim prehistorik | | 1,500,000 |
| | **Totali:** | **36,500,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2014-2020

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016-2023

| Nr. 4 | **Titulli i Projektit:** Restaurimi i zonës arkeologjike pranë Memorialit të Skënderbeut dhe mureve ilire | **Programi: 1/1.1** Infrastruktura kulturore dhe historike |
|---|---|---|
| | **Objektivi i Strategjisë: 1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.3** Nr. i objekteve të trashëgimisë kulturore të restauruara |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Memoriali i ndërtuar në vitin 1981 ngrihet mes një ansambli arkeologjiko-historik me vlera të mëdha kulturore. Portat kryesore të Lissit vlerësohen si ndër më të mirat të Ballkanit antik. Pjesa kryesore e Memorialit përbëhet nga muret origjinale të Katedrales së Shën-Nikollit të shek.XIV-të, e cila ne 1580 u kthye në xhami me emrin "Selimije". Ky objekt evidenton dy ngjarje madhore për kombin shqiptar, ku në Katedralen e Shën Nikollit u mbajt Kuvendi i Lezhës me 2 mars 1444 dhe së dyti është vendi ku nga janari i 1468 deri në shtatorin e 1478 qendroi i varrosur heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastrioti- Skënderbeu. Zona ka një sipërfaqe prej 2,3 ha, dhe përfshin Memorialin e Skënderbeut, si dhe objekte Iliro-Romake, Bizantine e Mesjetare. Aktualisht zona është e vizitueshme, jo vetem Memoriali, por edhe ansambli i madh arkeologjiko-historik. Mund të themi se është monumenti më i vizituar në qytetin tonë nga vizitorë vendas dhe të huaj. Tipar i veçantë i tij është se ai shtrihet në zemër të qytetit antik të poshtëm ku zona arkeologjike përreth ia shton edhe më shumë interesin. Kjo zonë duhet të pasqyrohet më mirë me zbulimet që janë bërë nga arkeologët shqiptarë dhe gjermanë, siç janë babtisteri i shek.VI mbas Kr., mozaiku i shek. II-I para Kr., muret rrethuese, të cilat duhet te restaurohen,si dhe tre topa mesjetarë te cilët kanë nevojë të kenë shtretërit e tyre. Më qëllim që të ruhet nga kënetëzimi, ky ansambël i madh historiko-arkitektonik duhet të ketë një projekt kanalizimi drejt lumit.

***Synimi i projektit***

Projekti do të synojë ruajtjen e resurseve arkeologjike dhe forcimin e strukturave te kësaj zone.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Evidentimi e të gjithë objekteve të cilët mund të kthehen në objekte të vizitueshme
- Restaurimi i objekteve
- Pajisja me tre shtretër për topat mesjetarë
- Kanalizim drejt lumit Drin
- Restaurimi i objekteve
- Pajisja me sinjalistikë informuese

**Rezultatet e pritshme:**

- Përmirësimi i infrastrukturës së zonës
- Pajisja me tre shtretër për tre topat mesjetarë
- Ujrat e bardha të sistemuara
- Pastrim nga vegjetacioni në ketë zonë
- Shtim objektesh te vizitueshme (Baptisteri, Mozaiku dhe objekte të tjera arkeologjike)
- Rritja e numrit të turistëve

**Grupet e synuara:**

- Turistët
- Agjencitë qeveritare të turizmit
- Bizneset që lidhen me turizmin

**Aktorët e mundshëm:**

- Instituti i Monumenteve të Kulturës
- Instituti i Arkeologjisë
- Bashkia
- Agjencitë rajonale dhe qendrore
- Universitetet

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Ministria e Kulturës
- Bashkia
- Agjencitë rajonale dhe qendrore
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**

- Zonë e rikonstrukturuar
- Shumë objekte të vizitueshme

**Treguesit matës:**

- $m^2$ hapësirë arkologjike e vizitueshme
- Nr. i objekteve të përshtatura

**Para kushtet:**

- Vullneti për bashkërendimin e përpjekjeve nga aktorët e interesuar
- Kjo zonë konsiderohet e mbrojtur me ligj si zonë arkeologjike

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i kontributeve të aktorëve
- Mos parashikimi në kohë i fondeve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| • Punime gërmimi e pastrimi të kanalit dhe kullimi i tij | 100,000 |
| • Heqja e inerteve, mbeturinave e sistemime | 50,000 |
| • Rikonceptim dhe rregullim i interierit të Memorialit | 80,000 |
| • Restaurim e konservim i afreskut të Shën Kollit | 50,000 |
| • Ndriçimi i brendshëm dhe i jashtëm | 100,000 |
| • Ndërtim i tre shtretërve të topave mesjetarë | 200,000 |
| • Ndërtim i një pike shërbimi | 500,000 |
| **Totali:** | **1,080,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:** 2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:** 2015

| Nr. | Titulli i Projektit: Rehabilitimi i kalasë mesjetare për t'a kthyer në mjedis aktivitetesh kulturore dhe të vizitueshëm nga turistët | Programi: 1/1.1 Infrastruktura kulturore dhe historike |
|---|---|---|
| 5 | Objektivi i Strategjisë: 1.1 Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.3 Nr. i objekteve të trashëgimisë kulturore të restauruara |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Kalaja mesjetare e Lezhës ka origjinë ilire (shek.V-IV-të p.Kr.). Rreth shekujve 8-9 mbi themelet e Akropolit Antik ngrihen muret mesjetare të saj. Këtu mund të shikohen gjurmë të arkitekturave ilire, romake, bizantine, veneciane dhe osmane. Objektet më interesante për t`u vizituar janë rrënojat e ndërtesave para dhe pas osmane brenda saj, kullat mbrojtëse, çisternat e ujrave të shiut, xhamia etj. Rreth viteve 1400 ajo iu nënshtrua një rindërtimi venedikas, ndërsa në vitin 1520-1521, pas pushtimit osman u rindërtua nga ana e tyre. Në mesjetë Kalaja e Lezhës ishte një nga fortesat kryesore që mbronin kufirin verior të Durrësit. Për këtë arsye kujdesi për fortifikimin e saj ka qenë i vazhdueshëm gjatë gjithë mesjetës. Gjatë fushatave të ndryshme restauruese janë realizuar disa ndërhyrje me karakter konservues, konsolidues dhe njohës. Muret e saj rrethuese paraqesin disa probleme si: 5 çarje vertikale, spostim i një segmenti muri prej 15 metrash linear (qysh ne vitin 1977), por ka edhe probleme të tjera si, gërryerjet e themeleve (erozioni), degradimi i mureve të ambjenteve të brendshme dhe vegjetacioni.

***Synimi i projektit***

Ky projekt synon përmirësimin e gjendjes së Kalasë Mesjetare të Lezhës duke restauruar, konsoliduar dhe konservuar muraturën rrethuese dhe atë të ambienteve nga degradimi i mëtejshëm, parandalimin e erozionit që vihet re në disa segmente të themeleve të kësaj kalaje.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Projekti Teknik
- Zbatimi i projektit për restaurimin e objekteve (muret rrethuese dhe të ambjenteve të brendshme)
- Monitorimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Mbrojtja e këtij objekti të rëndësishëm të trashëgimisë
- Përmirësimi i mureve rrethuese dhe ambienteve të brendshme të Kalasë
- Rritja e numrit të turistëve

**Grupet e synuara:**

- Turistët
- Arkeologë dhe studiues
- Agjencitë qeveritare të turizmit
- Bizneset që lidhen me turizmin
- Komuniteti

**Aktorët e mundshëm:**

- IMK
- Bashkia
- Agjencitë rajonale dhe qendrore

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Ministria e Kulturës
- Bashkia
- Agjencitë rajonale dhe qendrore
- Donatorë

**Produktet:**

- Restaurime
- Punime sistemimi

**Treguesit matës:**

- $m^2$ murë mbrojtëse
- $m^3$ gërmime
- Nr. i objekteve të restauruara

**Para kushtet:**

- Vullneti për bashkërendimin mes aktorëve të interesuar
- Ekzistojnë fondet për realizimin e projektit

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i kontributeve të aktorëve
- Mos parashikimi në kohë i fondeve nga institucionet përkatëse

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

- Restaurimi i objekteve — **Totali: 10,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2015-2016

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2017

| Nr. | Titulli i Projektit: Zgjerimi i zonës së gërmimeve arkeologjike | Programi: 1/1.1 Infrastruktura kulturore dhe historike |
|---|---|---|
| 6 | **Objektivi i Strategjisë: 1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.2** $m^2$ gërmime arkeologjike në zonën arkeologjike |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Kalaja Mesjetare e Lezhës është njëra ndër pesë kalatë kryesore të Adriatikut shqiptar. Në qafën e kalasë nga ana lindore duke filluar ngjitur me muret e saj, gjendet njëri ndër sektorët kryesorë të varrezës mesjetare të Lezhës, e cila njihet si varreza e Qafës se Kalasë, Lezhë. Ajo ka një rëndësi të veçantë, pasi lidhet me atë të Komanit, të cilat përcjellin shkencërisht të provuar, vazhdimësinë e jetës Iliro-Arbërore. Me gjithë gërmimet e realizuara deri tani, varreza mesjetare e Lezhës ka nevojë që të eksplorohet totalisht në të tre sektorët e identifikuar deri tani. Të nxirret materiali i bollshëm arkeologjik (inventari i varreve), si edhe objektet me funksione të ndryshme që i përkasin fazave në vazhdimësi të antikitetit të vonë dhe të gjithë mesjetës.

### *Synimi i projektit*

Synohet që me këto gërmime, të evidentohen objekte të ndryshme që bëjnë të mundur studimin e një periudhe që është akoma pak e zbuluar për Lezhën, si dhe parandalimin e ndërtimeve pa leje.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Kryerja e gërmimeve arkeologjike
- Restaurimi i objekteve të identifikuara

**Rezultatet e pritshme:**
- Shtimi, restaurimi i objekteve me vlerë muzeale
- Evidentimi i periudhës Mesjetare
- Rritja e numrit të vizitorëve
- Rritja e numrit të ekspeditave arkeologjike

**Grupet e synuara:**
- Grupet e ekspeditave arkeologjike
- Turistët
- Agjencitë qeveritare të turizmit
- Bizneset që lidhen me turizmin

**Aktorët e mundshëm:**
- Instituti i Monumenteve të Kulturës
- Bashkia
- Agjencitë rajonale dhe qendrore
- Universitetet

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**
- Ministria e Kulturës
- Bashkia
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**
- Objekte të restauruara
- Shtimi i objekteve te trashëgimisë

**Treguesit matës:**
- $m^3$ gërmime
- Nr. i objekteve arkologjike të gjetura

**Para kushtet:**
- Zona është e rrethuar dhe nuk ka probleme pronësie
- Vlerat që përmban justifikojnë shpenzimet

**Faktorë rrezikues:**
- Mos parashikimi në kohë i fondeve nga institucionet përkatëse
- Zona mund të vazhdojë të rrezikohet nga ndërtimet pa leje

## Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:

| | |
|---|---|
| • Kryerja e gërmimeve arkeologjike | 1,500,000 |
| • Restaurimi i objekteve të identifikuara | 1,000,000 |
| **Totali:** | **2,500,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2013-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2014 - 2016

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Ndërtimi i mbulesës së re të monumentit të Varrit të Skënderbeut | **Programi: 1/1.1** Infrastruktura kulturore dhe historike |
|---|---|---|
| **10** | **Objektivi i Strategjisë: 1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.1** Nr. i vizitorëve vendas e të huaj, sipas gjinisë, në Memorialin e Skënderbeut |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Memoriali bazuar në vlerat që ofron, ka nevojë imediate për restaurimin e plotë të mbulesës së tij, ndriçimin e plotë, restaurimin e afreskut, si dhe të vendosjes së një sinjalistike bashkëkohore në zonën arkeologjike përreth tij.

***Synimi i projektit***

Projekti synon krijimin e një mbulese të re të Varrit të Skënderbeut që do të ketë një ndikim të fortë vizual duke vënë gjithnjë në eficencë sa më të plotë Katedralen. Ideja është që të vihet vendi i varrimit të Heroit Kombëtar nën flamurin shqiptar: sfumaturat e reflekseve do të jenë kuq e zi (kujton simbolin kombëtar), efekt ky edhe më i dukshëm natën, falë një ndriçimi të kujdesshëm. Zona e mbuluar dhe e shtruar do të jetë në total 1700m$^2$: kjo hapësirë është gjithashtu e përshtatshme për ekspozita dhe ngjarje të veçanta publike si ceremoni, përkujtimore, festa qytetare, vizita nga jashtë etj.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Sistemi i mbulimit të muzeut.
- Vaska në aks me varrin dhe pjesa e fundit e kanalit.

**Rezultatet e pritshme:**

- Memoriali i Skënderbeut dhe zona per rreth është rikualifikuar.
- Rritja e numrit te turistëve në zonë.
- Rritja e fitimeve nga bizneset që janë të bazuara në turizëm.

**Grupet e synuara:**

- Turistët potenciale të qytetit
- Komuniteti i Lezhës
- Bizneset e ndryshme

**Aktorët e mundshëm:**

- Ministria e Kulturës
- Qarku
- Bashkia Lezhë
- Shoqatat e turizmit

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Ministria e Kulturës
- Qarku
- Bashkia Lezhë
- Shoqatat e turizmit
- Donatorë te mundshëm

**Produktet:**

- Memoriali i rikualifikuar
- Rritja e ofertës turistike

**Treguesit matës:**

- m$^2$ sipërfaqe e sistemuar
- Nr. i turistëve në zonë

**Para kushtet:**

- Bashkia sheh prioritet risistemimin e Memorialit të Skënderbeut
- Aktorët e përfshirë janë dakort me këtë projekt

**Faktorë rrezikues:**

- Fondet e kërkuara janë shumë të mëdha.
- Ekzistenca e zonës së mbrojtur si monument kulture brenda kësaj zone

**Shpenzimet të përafërta të llogaritura:** **Totali: 99,814,680 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2017-2020

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2020 - 2023

| Nr. | Titulli i Projektit:<br>Ndërtimi i Muzeut Historik të Lezhës | Programi: 1/1.1<br>Infrastruktura kulturore dhe historike |
|---|---|---|
| 11 | **Objektivi i Strategjisë: 1.1**<br>Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.3**<br>Nr. i objekteve të trashëgimisë kulturore të restauruara |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Lezha qendër historike e kulturore, sot qendër Prefekture, nuk ka një godinë për Muzeun Historik dhe Etnografik. Ruhen rreth mbi 2.000 objekte të kulturës materiale e shpirtërore nga fusha e arkeologjisë, etnografisë, vepra arti, dokumentacion, etj. Ndjehet e nevojshme dhe e domosdoshme ngritja e këtij muzeu historik dhe etnografik. Qyteti flet për histori të pasur, me monumente të kulturës, objektet e kultit, monedhat, zbulimet arkeologjike, dokumentet e shkruara, ngjarje e figura të shquara janë dëshmi për të kaluarën e qytetit mbi 2400 vjeçar. Është qyteti i Besëlidhjeve të mëdha Kombëtare si: Kuvendit të Lezhës 2 Mars 1444 dhe i Koncilit të Arbrit me 14 janar 1703, është qyteti simbol i harmonisë, bashkëjetesës, tolerancës fetare e harmonisë njerëzore. Të gjitha këto e bëjnë të domosdoshme ngritjen e një Muzeu Historiko-Etnografiko-Arkeologjik.

***Synimi i projektit***

Në muze do të shpalosen vlerat kulturore, shpirtërore dhe historike të trevës së Lezhës në aspektin historik dhe etnografik duke ruajtur vlerat arkitektonike të banesave qytetare lezhjane.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Projekti
- Ndërtimi i muzeut
- Restaurimi i reparteve dhe pasjisja me të gjitha elementët mbrojtës
- Pajisja me sinjalistikë informuese
- Monitorimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Materialet (objektet) që ruhen të ekspozuara sipas standarteve bashkëkohore
- Prezantimin e vlerave historike dhe etnografike të qytetit
- Zhvillimi i turizmit historik dhe kulturor

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Turistët
- Agjencitë qeveritare të turizmit
- Bizneset që lidhen me turizmin

**Aktorët e mundshëm:**

- Instituti i Monumenteve të Kulturës
- Bashkia
- Agjencitë rajonale dhe qendrore
- Komuniteti

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Ministria e Kulturës
- Bashkia
- Agjencitë rajonale dhe qendrore
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**

- Muzeu historik i qytetit

**Treguesit matës:**

- $m^2$ hapësirë ekspozuese
- Nr. i objekteve të ekspozuara
- Nr. i vizitorëve

**Para kushtet:**

- Vullneti për bashkërendimin e përpjekjeve nga aktorët e interesuar
- Kjo zonë konsiderohet e mbrojtur me ligj si zonë arkeologjike

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i kontributeve të aktorëve
- Mos parashikimi në kohë i fondeve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| • Ndërtimi i muzeut. | 15,000,000 |
| • Restaurimi i reparteve, pajisja me elementët mbrojtës | 5,000,000 |
| • Pajisja me sinjalistikë informuese. | 500,000 |
| **Totali:** | **20,500,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2016

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2017

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Lirimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonës përreth Kalasë nga ndërtimet e paligjshme | **Programi: 1/1.1** Infrastruktura kulturore dhe historike |
|---|---|---|
| **14** | **Objektivi i Strategjisë: 1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.3** Nr. i objekteve të trashëgimisë kulturore të restauruara |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Sipërfaqja arkeologjike në qytetin e Lezhës ndahet në dy zona, "A" dhe "B". Shuma e kësaj sipërfaqeje arrin afërsisht në 50 ha duke zënë rreth gjysmën e sipërfaqes së qytetit (ky zonifikim u miratua nga VKM e datës 01.11.2010). Në zonën "A" ndalohen kategorikisht ndërtimet. Ndërsa në zonën "B" lejohen vetëm me lejen e IMK dhe IA, Tiranë. Fenomeni i ndërtimeve pa leje ka filluar që në vitin 1990. Aktualisht sot vetëm në zonën "A" janë afërsisht 186 të tilla. Më shqetësuese janë 36 ndërtime në pjesën e mesme të qytetit antik dhe përreth Memorialit të Vendvarrimit të Skënderbeut.

***Synimi i projektit***

Projekti ka për qëllim ruajtjen nga degradimi të kësaj zone, e cila shkaktohet prej ndërtimeve abuzive.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Evidentimi i të gjithë ndërtimeve pa leje, nxjerrja e preventivit për vlerësimin e çdo objekti që do të prishet
- Largimi i mbeturinave të ndërtimit dhe rehabilitimi i ambientit, mbjellja e pemëve dekorative
- Përgatitja e miratimi i një plani urbanistik pjesor për këtë zonë

**Rezultatet e pritshme:**

- Mbrojtja e gjithë zonës nga dëmtimet
- Krijimi i hapësirës së lirë për zbatimin e planeve të miratuara nga strukturat kompetente
- Përmirësimi i imazhit të zonës

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Bizneset që lidhen me turizmin

**Aktorët e mundshëm:**

- Ministria e Kulturës
- Bashkia
- Inspektoriati i Ndërtimit
- Policia e Rendit

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Ministria e Kulturës
- Bashkia
- Agjencitë rajonale dhe qendrore
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**

- Zonë arkeologjike sipas parametrave te përcaktuar në ligj

**Treguesit matës:**

- $m^2$ hapësirë publike e përfituar
- Nr. i objektevë të shembura

**Para kushtet:**

- Kjo zonë konsiderohet e mbrojtur me ligj si zonë arkeologjike
- Bashkia ka bërë një punë paraprake në drejtim të identifikimit të problemeve dhe sensibilizimit të tyre
- Strukturat përgjegjëse janë më të impenjuara në zbatimin e ligjit

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i kontributeve të aktorëve
- Mosparashikimi në kohë i fondeve nga institucionet përkatëse
- Zona mund të vazhdojë të rrezikohet nga ndërtimet pa leje
- Problemi i strehimit të familjeve që do t`u prishen shtëpitë

**Shpenzimet të përafërta të llogaritura :**

| | |
|---|---|
| • Prishje e ndërtimeve 500 $m^2$ x 200 | 600,000 |
| • Transporti i mbeturinave 4.000 $m^3$ x 600 | 2,400,000 |
| • Sistemim terreni 5.000 $m^2$ x 40 | 200,000 |
| • Mbjellje drurësh 200 copë x 1000 | 200,000 |
| • Plani urban i zonës | 200,000 |
| **Totali:** | **3,600,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori e shërbimeve publike, Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2014

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Restaurimi i Kroit "Hidrolez" dhe kthimi në objekt të vizitueshëm | **Programi: 3/1.1** Pasurim i profilit turistik të qytetit me bukuritë natyrore të zonës përreth qytetit |
|---|---|---|
| **30** | **Objektivi i Strategjisë: 1.1** Evidentimi dhe promovimi intensiv i trashëgimisë së pasur kulturore, historike e arkeologjike të Lezhës në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.3** Nr. i objekteve të trashëgimisë kulturore të restauruara |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Kroi "Hidrolez" mendohet që ka shërbyer si burim ujor që nga antikiteti. Fare pranë tij gjenden muret e Lissusit, dhe një portë që studiuesit e quajnë Porta e Burimit. Kroi ka dy depozita uji të ndërtuara me llaç hidrik, të cilat janë të periudhave të ndryshme historike. Përveç dy depozitave që thamë dhe një blloku antik gjysëm të punuar sot nuk ka ngelur gjë tjetër nga punimet e lashta. Firma ndërtuese që realizoi projektin e rrugës Lezhë-Kala ka ndërtuar një muraturë guri në anën e majtë të burimit. Uji i këtij burimi, i cili nuk shteron as në muajt e thatë të vitit vazhdon derdhjen e tij natyrore.

### *Synimi i projektit*

Ky burim duhet të kthehet në një burim funksional siç ka qenë në kohët e mëparshme

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Projekti
- Monitorimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Funksional për komunitetin
- Shtimi i pasurisë së objekteve të trashëgimisë

**Grupet e synuara:**

- Turistët potenciale të qytetit
- Komuniteti i Lezhës
- Bizneset e ndryshme

**Aktorët e mundshëm:**

- Ministria e Kulturës
- Qarku
- Bashkia Lezhë
- Shoqatat e turizmit

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Ministria e Kulturës
- Qarku
- Bashkia Lezhë
- Shoqatat e turizmit
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**

- Funksionimi normal i "Hidrolezit"
- Rritja e ofertës turistike

**Treguesit matës:**

- Nr. i elementëve arkitekturor të shtuar
- $m^2$ sipërfaqe e sistemuar
- Nr. i turistëve në zonë

**Para kushtet:**

- Bashkia sheh si prioritet risistemimin e kësaj pike të qytetit
- Aktorët e përfshirë janë dakort me këtë projekt

**Faktorë rrezikues:**

- Fondet e kërkuara janë shumë të mëdha
- Ekzistenca e zonës së mbrojtur si monument kulture brenda kësaj zone

**Shpenzimet të përafërta të llogaritura:** **Totali: 300,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:** 2014 - 2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:** 2015 - 2016

## Qëllimi 2. Ekonomia dhe sipërmarrja

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Studimi "Nxitja dhe lehtësira fiskale vendore për bizneset e reja të përpunimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale në Lezhë" | **Programi: 6/3.2** Lehtësirat dhe kuadri rregullator për bizneset dhe sipërmarjen |
|---|---|---|
| 37 | **Objektivi i Strategjisë: 3/2** Fuqizimi i kapaciteteve dhe shumëllojshmerisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që shfrytëzojnë prodhimin dhe prurjen turistike rajonale, zejet dhe produktet e traditës | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.11** Nr. biznese të reja për 10,000 banorë |

### Përshkrim i shkurtër i projektit

***Situata***

Turizmi mbetet si prioriteti kryesor në zhvillimin e ekonomisë së Bashkisë Lezhë. Për këtë arsye, përveç projekteve për rritjen e ofertës turistike, restaurimin e objekteve, një nga synimet e Bashkisë është edhe hartimi i politikave favorizuese ndaj subjekteve që operojnë në fushën e shërbimeve turistike.

***Synimi i projektit***

Kryerja e një studimi kompleks periodik për llojet e taksave dhe tarifave vendore, që aplikon Bashkia, për biznesin e turizmit dhe agrobiznesit, me qëllim llogaritjen e avantazheve dhe disavantazheve ekonomike që do të kemi nga aplikimi i diferencuar i taksave në këtë fushë.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Ngritja e grupit te punës
- Studimi periodik i mundësive
- Draftimi i politikave lehtësuese
- Miratimi i dokumentit
- Aplikimi i politikave fiskale lehtësuese.

**Rezultatet e pritshme:**

- Shërbime më cilësore në fushën e turizmit dhe agroindustrisë

**Grupet e synuara:**

- Biznesi i turizmit dhe agroindustrisë

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- Biznesi

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Biznesi
- Donatorët

**Produktet:**

- Studimi periodik
- Politika fiskale lehtësuese

**Treguesit matës:**

- Nr. i bizneseve të përfshira

**Para kushtet:**

- Burimeve njerëzore brenda dhe jashtë administratës së Bashkisë Turizmi është prioritet i Bashkisë

**Faktorë rrezikues:**

- Mosaprovimi në këshill i politikave fiskale lehtësuese

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

- Pagesa për ekspertët 100,000 Lekë/vit **Totali: 500,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**

2015-2019

**Periudha e pritjes së rezultatit:**

2016-2020

| Nr. | **Titulli i Projektit:**<br>Projekti “Nxitja e bizneseve familiare të produkteve të artizanatit” | **Programi: 7/3.2**<br>Nxitja e inovacionit dhe sipërmarrjes në biznes |
|---|---|---|
| **41** | **Objektivi i Strategjisë: 3.2**<br>Fuqizim i kapaciteteve dhe shumëllojshmërisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që shfrytëzojnë prodhimin dhe prurjen turistike rajonale, zejet dhe produktet e traditës | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.10**<br>% e bizneseve familjare që punojnë me zejet dhe produktet e traditës |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Profesionalizimi në kryerjen e shërbimeve është një tregues që ndikon në rritjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në qytet. Për të ndihmuar në rritjen e cilësisë, zhvillimi i bizneseve familjare është më se i nevojshëm. Për këtë arsye ofrimi i trajnimeve të herëpasherëshme lidhur me planet e biznesit dhe menaxhimin e këtyre bizneseve kosiderohet i rëndësishëm.

***Synimi i projektit***

Projekti synon trajnimin e njerëzve në komunitet për krijimin dhe mbarëvajtjen e bizneseve familjare, rrjedhimisht dhe nxitjen e cilësisë së organizimit dhe funksionimit të këtyre bizneseve në mënyrë që t'i bëjnë ballë vështirësive të tregut, dhe të jenë konkurruese.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Identifikimi i familjeve potencial për zhvillim biznesi
- Trajnime/workshope/konferenca për aftësimin e familjeve te biznesit familjar
- Monitorimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Rritje sasiore dhe cilësore e biznesit familjar
- Rritje e numrit të personave të trajnuar në kompjuter, financë dhe menaxhim.

**Grupet e synuara:**

- Familjet që merren me këtë lloj biznesi
- Sipërmarrësit

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- DHTI
- Universitetet

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Donatorë

**Produktet:**

- Biznese familjare me shërbim të përmirësuar
- Persona të trajnuar

**Treguesit matës:**

- Nr. i personave të trajnuar

**Para kushtet:**

- Ambiente te përshtatshme
- Interesi i bizneseve për tu trajnuar

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesa e burimeve njërëzore
- Mos angazhimi i aktorëve
- Mungesë burimi financiar

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 1,000,000 Lekë.**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**

2014-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**

2016

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Projekti "Promovimi i potencialeve për zhvillimin e biznesit agro-ushqimor në zonën industriale të qytetit" | **Programi: 7/3.2** Nxitja e inovacionit dhe sipërmarrjes në biznes |
|---|---|---|
| **42** | **Objektivi i Strategjisë: 3.2** Fuqizim i kapaciteteve dhe shumëllojshmerisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që shfrytëzojnë prodhimin dhe prurjen turistike rajonale, zejet dhe produktet e traditës | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 11, 12** Nr. biznese të reja për 10,000 banorë<br>Nr. i bizneseve të trajnuar, sipas gjinisë, për çertifkimin e produkteve |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Projekti synon stimulimin e ri-zhvillimit të sektorit të agrobiznesit në Bashkinë e Lezhës. Gjatë dekadës së fundit, aktiviteti në këtë sektor ka rënë shumë. Në veçanti, ky projekt do të përgatisë plan-biznese për këtë sektor. Meqenëse 200,336 m$^2$ është pronë private, nga sipërfaqja totale e zonës industriale, mendohet të ndihmohen pronarët aktuale apo ato që dëshirojnë të përfshihen në këtë lloj biznesi për të përgatitur plane biznesi për aktivitete të parashikuara në planifikimin zonal ose lotizimin. Ky projekt parashikon përgatitjen e planit të biznesit, që do të përgatiten nga specialistë të mirëfilltë, do t'i vihen në dispozicion pronarëve dhe komunitetit të biznesit. Këto aktivitete janë: fabrika e salcës së domates, fabrika e përpunimit dhe konservimit të fruta-perimeve, fabrika e vajit, fabrika e përpunimit të mishit, fabrika e produkteve të qumështit, fabrika e pijeve alkoolike, etj.

### *Synimi i projektit*

Ky projekt synon mbështetjen për përgatitjen e planeve të biznesit për pronarët e interesuar për biznes në zonën industriale për zhvillimin ekonomik të zonës.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Përgatitja e planeve të biznesit
- Takime me aktorët e mundshëm
- Promovimi i këtyre planeve

### Rezultatet e pritshme:

- Shtimi i bizneseve agropërpunuese
- Rritja e prodhimeve bujqësore–blegtorale
- Zvogëlimi i papunësisë
- Përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e rrethinave të zonës

### Grupet e synuara:

- Komuniteti
- Komuniteti i biznesit
- Pronarët e objekteve
- Bashkia

### Aktorët e mundshëm:

- Bashkia
- DHTI
- OJF
- Agjencitë rajonale dhe kombëtare

### Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Bashkia
- Biznesmenët
- DHTI
- Donatorë

### Produktet:

- Plane biznesi

### Treguesit matës:

- Nr. i bizneseve të hapura
- Sasia e produkteve të përpunuara

### Para kushtet:

- Pronarët e objekteve janë të interesuar
- Aktorët janë pozitivë lidhur me të ardhmen e sektorit
- Lënda e parë sigurohet lehtësisht
- Zhvillimi i NVM-të po nxiten edhe nga institucionet e huaja e vendase

### Faktorë rrezikues:

- Mos sigurimi i fondeve të nevojshme
- Mos koordinimi i aktorëve
- Mos interesimi i pronarëve që bashkëpunojnë me aktorë të tjerë

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 1,500,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

### Periudha e zbatimit:

2014-2015

### Periudha e pritjes së rezultatit:

2015

| Nr. | Titulli i Projektit: | Programi: 7/3.2 |
|---|---|---|
| | **Titulli i Projektit:** Ndërtimi i tregtores fruta-perime, produkteve të bulmetit e mishit dhe peshkut | **Programi: 7/3.2** Nxitja e inovacionit dhe sipërmarrjes në biznes |
| **43** | **Objektivi i Strategjisë: 3.2** Fuqizim i kapaciteteve dhe shumëllojshmërisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që shfrytëzojnë prodhimin dhe prurjen turistike rajonale, zejet dhe produktet e traditës | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 11** Nr. biznese të reja për 10,000 banorë |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Rritja e popullsisë së qytetit të Lezhës dhe cilësisë së jetës në të ka sjellë edhe nevojën për ofrimin e shërbimeve sa më cilësorë në kushte higjenike sa më të përshtatshme. Rriten shërbimet.Tregu ekzistues nuk përballon të gjitha nevojat. Ky treg do t'u shërbejë banorëve të rrethinave që produktet e tyre të kenë treg shitje sipas standarteve të përcaktura me ligj.

300 subjekte industriale dhe ushqimore të përqendruara në tregun aktual dhe rreth 30 tregtarë ambulant nga rrethinat me produkte ushqimore tregtojne nëpër pika të pakontrolluara.

### *Synimi i projektit*

Ky projekt synon ndërtimin e një tregu për shitjen e frutave-perimeve, mishit, peshkut dhe bulmetrave në një sipërfaqe me kushte normale higjeno-sanitare.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Ndërtimi i tregut
- Ndërtimi i infrastrukturës ndihmëse për 35 njësi tregtare: 15 për shitjen e peshkut (20 $m^2$ secila), 10 për shitjen e frutave dhe perimeve (25 $m^2$ secila) dhe 10 për bulmetrat (15 $m^2$ secila).
- Instalimi i tregtarëve

### Rezultatet e pritshme:

- Tregtim i produkteve në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare
- Krijimi i vendeve të punës
- Rritje e të ardhurave të Bashkisë
- Shmangie e konkurencës së pandershme

### Grupet e synuara:

- Komuniteti
- Tregtarët
- Bashkia

### Aktorët e mundshëm:

- Bashkia
- Komuniteti i biznesit
- DRTT

### Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Bashkia
- DRTT
- Komuniteti i biznesit
- Donatorë

### Produktet:

- Treg i ri fruta - perime dhe bulmet

### Treguesit matës:

- Nr. i tregtarëve të instaluar
- % këtij tregu e drejtuar në këtë pol
- Sasia e të ardhurave të mbledhura

### Para kushtet:

- Ka sipërfaqe trojesh të lira
- Nevoja për tregtimin në nivel bashkëkohor të produkteve ushqimore

### Faktorë rrezikues:

- Mos realizimi i bashkëpunimit me pronarët e trojeve
- Mos aktivizimi i fondeve të nevojshme në kohën e duhur

### Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:

| | | |
|---|---|---|
| Shtrimi dhe asfaltimi, qera | | 6,000,000 |
| Rrethimi me mur dekorativ | | 500,000 |
| Ndërtimi i 35 njësive tregtare | | 17,500,000 |
| Vendosja e ndriçimit dhe ujit | | 350,000 |
| | **Totali:** | **24,350,000 lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:** 2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:** 2015

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Krijimi i hartës së bizneseve në territorin e qytetit | **Programi: 7/3.2** Nxitja e inovacionit dhe sipërmarrjes në biznes |
|---|---|---|
| 44 | **Objektivi i Strategjisë: 3.2** Fuqizim i kapaciteteve dhe shumëllojshmërisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që shfrytezojnë prodhimin dhe prurjen turistike rajonale, zejet dhe produktet e traditës | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr, 8, 9, 10** % e NVM-ve në qytet që janë miqësore me mjedisin<br>% e të punësuarve në biznese të gjelbërta dhe inovatore, sipas gjinisë<br>% e bizneseve familjare që punojnë me zejet dhe produktet e traditës |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Në Lezhë operojnë rreth 1000 subjekte tregtare, të shpërndara në një territor prej më shumë se 5 ha. Lind nevoja që bizneset të shpërndahen në mënyrë adekuate, duke krijuar mundësi qytetarëve që të marrin shërbime të njëkohshme në të gjithë territorin.

***Synimi i projektit***

Realizimi i një harte, ku në të gjithë rrugët kryesore dhe lagjet e qytetit, të jenë të shënuara bizneset kryesore sipas llojeve të aktiviteteve. Do të punohet mbi hartën e azhornuar të qytetit, me shkallë 1:1000 dhe ajo do të rifreskohet çdo vit. Kjo hartë do të realizohet në bashkëpunim me Drejtorinë Bashkiake të Taksave dhe Tarifave. Ajo do të jetë në përdorim të të gjithë të interesuarve.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Identifikimi i të gjitha subjekteve
- Punimi i hartës në GIS

**Rezultatet e pritshme:**

- Lehtësimi i identifikimit të bizneseve vendase
- Lehtësimi i reklamimit të këtyre aktiviteteve
- Shtim i aktivitetit të biznesit

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti i biznesit
- Investitorët
- Institucionet vendore dhe qendrore

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- DHTI
- DRTT

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- DRTT e DHTI
- Donatorë

**Produktet:**

- Harta e subjekteve tregtare

**Treguesit matës:**

- Nr. i subjekteve të identifikuar
- Kopje hartash të shpërndara

**Para kushtet:**

- Burimet njerëzore në Bashki (inxhinierë)
- Hartat ekzistuese
- Të dhënat mbi përqendrimin e biznesit në zona nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave

**Faktorë rrezikues:**

- Mos aktivizimi në kohë i burimeve financiare të Bashkisë
- Mos organizimi në mënyrën e duhur të komunitetit të biznesit

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 1,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Instalimi i infrastrukturës së furnizimeve për zonën e Parkut të Biznesit | **Programi: 9/4.2** Infrastruktura dhe planifikimi për sipërmarje në Parkun e Biznesit |
|---|---|---|
| **48** | **Objektivi i Strategjisë: 4.2** Tërheqja e zhvillimeve dhe investimeve në parkun e biznesit për të rritur punësimin, diversifikuar ekonominë dhe shtuar zinxhirin e vlerës së produkteve | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 15, 16** % rritjes së ndërmarrjeve jo bujqësore<br>% e vendeve të punës në Parkun e Biznesit në raport me vendet e punës në sektorin privat në qytet |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Parku i Biznesit do të shtrihet në pjesën veriore të qytetit dhe ka formë trekëndore me kufi me sipërfaqe totale 548,035 $m^2$ (pronë shtetërore 347,699 $m^2$ dhe pronë private 200,336 $m^2$ ). Kjo zonë ka nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën brenda zonës dhe atë lidhëse.

Ky projekt parashikon ndërtimin e këtyre fasiliteteve lehtësuese për zhvillimin e zonës:

1. Ndërtimi i tunelit lidhës me Portin e Shëngjinit
2. Rruga për në zonën e parkut
3. Stacioni hekurudhor i mallrave
4. Ura lidhëse me rrugën kombëtare Lezhë-Shkodër

### *Synimi i projektit*

Ky projekt synon krijimin e një infrastrukture brenda zonës industriale si dhe infrastrukturën lidhëse me Portin e Shëngjinit dhe rrugën kombëtare për zhvillimin e Parkut të Biznesit.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Ndërtimi i tunelit lidhës me Portin e Shëngjinit
- Ndërtimi i rrugës në zonën industriale
- Ndërtimi i urës lidhëse me rrugën kombëtare
- Ndërtimi i stacionit të mallrave në Parkun e Biznesit

**Rezultatet e pritshme:**
- Infrastrukturë e ndërtuar në zonën industriale

**Grupet e synuara:**
- Biznesi e Komuniteti
- Bashkia dhe komunat përreth

**Aktorët e mundshëm:**
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Bashkia
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë
- Shoqata Biznesi
- Agjencitë e Zhvillimit

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**
- Minisria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Bashkia
- Donatorët
- Agjenci Zhvillimi Kombëtare & Ndërkombëtare

**Produktet:**
- Ura e ndërtuar
- Tuneli dhe rruga
- Stacioni i mallrave

**Treguesit matës:**
- Metra lineare rrugë/tunel/urë
- Sasia e mallrave të transportuara

**Para kushtet:**
- Burime njerëzore për hartimin e projekteve në Bashkinë Lezhë

**Faktorë rrezikues:**
- Mungesë e fondeve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 3,500,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:** 2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:** 2015

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Hartimi i portalit në faqen e internetit të Bashkisë “Investo në Parkut e Biznesit Lezhë” | **Programi: 10/4.2** Lehtësirat dhe kuadri rregullator për sipërmarje në Parkun e Biznesit |
|---|---|---|
| **51** | **Objektivi i Strategjisë: 4.2** Tërheqja e zhvillimeve dhe investimeve në parkun e biznesit për të rritur punësimin, diversifikuar ekonominë dhe shtuar zinxhirin e vlerës së produkteve | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr, 14, 15, 16** nr. i ndërmarrjeve përpunuese të çertefikuara me ISO<br>% rritjes së ndërmarrjeve jo bujqësore<br>% e vendeve të punës në Parkun e Biznesit në raport me vendet e punës në sektorin privat në qytet |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***
Aktivitetet që parshikon ky projekt për të stimuluar: prodhime konfeksionesh, prodhime këpucësh, ndërtim, prodhime agro-ushqimore, përpunim alumini, përpunim druri, transport, tregti, shërbime të ndryshme, etj.

***Synimi i projektit***
Ky projekt synon promovimin Parkut të Biznesit për të përmirësuar situatën e mbështetur zhvillimin ekonomik vendor, veçanërisht ndërmarrjet e vogla e të mesme me impakt miqësor me mjedisin.

***Aktivitete kyçe të projektit:***
- Broshurë informative për investitorët
- Takime me investitor potencial
- Dokumentacion ligjor për investitorët
- Hapje biznesesh të reja

**Rezultatet e pritshme:**
- Investitor potencial për bizenese të reja dhe konkurruese në treg
- Zhvillimi i bizneseve vendase
- Krijimi i bizneseve të reja
- 3000 vende pune

**Grupet e synuara:**
- Biznesi vendas dhe i huaj
- Të rinjtë dhe të rejat e papunë

**Aktorët e mundshëm:**
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë
- Bashkia
- Qarku
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë
- Shoqata Biznesi
- Agjenci Zhvillimi

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Ekonomisë
- Bashkia
- Donatorët
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë
- Agjenci Zhvillimi Kombëtare & Ndërkombëtare

**Produktet:**
- Bizneset e instaluara
- Produktet e secilit biznes

**Treguesit matës:**
- Nr. bizneseve
- Nr. i të punësuarëve

**Para kushtet:**
- Ekzistenca e hapësirës së nevojshme për zbatimin e aktivitetit
- Eksperiencë pozitive
- Mbështetja e Bashkisë ndaj aktivitetit

**Faktorë rrezikues:**
- Pronësia e hapësirës (pjesa private)
- Mungesë e fondeve
- Konkurenca e bizneseve rajonale

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| • Broshura informative | 500,000 |
| • Vizita pune për takim me investitor | 500,000 |
| **Totali:** | **1,000,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2015-2020

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2018-2025

# Qëllimi 3. Zhvillimi hapsinor dhe infrastruktura

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Rikualifikimi urban modern i qendrës së qytetit | **Programi: 13/6.3** Rivitalizimi bashkëkohor i blloqeve mes pallateve dhe hapësirave publike urbane |
|---|---|---|
| 63 | **Objektivi i Strategjisë: 6.3** Zhvillim harmonik dhe me standarte i hapësirave urbane që ofrojne jetesë cilësore të komunitetit, rritje të vlerës së biznesit dhe të zonave arkeologjike e historike të qytetit | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 21** % e sipërfaqes urbane publike e rikualifikuar plotësisht dhe me standarte bashkëkohore |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Qyteti i Lezhës karakterizohet nga një shtresëzim urban i arnuar, i cili duhet rivlerësuar për të gjetur një vazhdimësi në shprehjen arkitektonike, e cila të tregojë në njëfarë mënyre historinë e qytetit dhe t'u japë një identitet banorëve të saj.

### *Synimi i projektit*

Projekti synon rikualifikimin urban të të gjithë qendrës së qytetit. Ai synon kthimin e qendrës në hapësirë për këmbësorët duke zhvendosur parkimin në anën tjetër të lumit. Gjithashtu synohet t'i jepet një vlerë tjetër marrdhënies mes pronës publike dhe private duke i kthyer të gjitha në një përvojë konkrete të projektimit. Ky projekt synon të rikualifikojë të gjithë zonën nga sheshi "Besëlidhja", në rrugën "Hafiz Ali Ulqinaku" duke përfshirë sheshin "Gjergj Kastrioti", urën mbi Drin dhe Memorialin e Skënderbeut.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Rikualifikimi i urës mbi Lumin Drin
- Shtrimi suplementar i fillimit të rrugës "Gjergj Fishta" dhe lidhja e rrugës automobilistike me atë pedonale
- Rikualifikimi i sheshit "Besëlidhja"
- Rikulifikimi i lulishtes qendrore
- Rikualifikimi i sheshit kryesor para Bashkisë
- Kalimi mbi lumin Drin për këmbësorë
- Rikualifikimi i rrugës përgjatë zonës arkeologjike

## Rezultatet e pritshme:

- Qendër urbane bashkëkohore që përshtatet mjaft mirë me kontekstin historik të qytetit
- Integrimi i anës perëndimore të lumit Drin në qendrën e qytetit

## Grupet e synuara:

- Turistët potenciale të qytetit
- Komuniteti i Lezhës
- Bizneset e ndryshme

## Aktorët e mundshëm:

- Bashkia Lezhë
- Shoqatat e turizmit
- Donatorë të ndryshëm

## Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Qeveria Shqiptare
- Bashkia Lezhës dhe Shoqatat e turizmit
- Donatorë të mundshëm

## Produktet:

- Ura mbi Lumin Drin e rikualifikuar
- Rruga "Gjergj Fishta" e asfaltuar
- Sheshit "Besëlidhja" i rikualifikuar
- Lulishtja qendrore e rikualifikuar
- Sheshi kryesor para Bashkisë i rikualifikuar
- Ndërtimi i kalimit mbi lumin Drin për këmbësorë

## Treguesit matës:

- m$^2$ hapësirë e rivitalizuar
- Nr. i aseteve të zhvilluara në zonë

## Para kushtet:

- Ndërtimi i këtij projekti është prioritet i Bashkisë dhe Qeverisë, pronat janë të gjitha publike.

## Faktorë rrezikues:

- Vështirësi në sigurimin e fondeve.

## Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:

| | |
|---|---|
| • Rikonstruksioni i urës mbi lumin Drin | 26,600,000 |
| • Shtrimi suplementar i fillimit të rrugës "Gjergj Fishta" | 77,000,000 |
| • Rikualifikimi i sheshit "Besëlidhja" | 37,800,000 |
| • Rikualifikimi i lulishtes | 67,200,000 |
| • Rikualifikimi i sheshiit kryesor | 138,600,000 |
| • Rikualifikimi rrugës përgjatë zonës arkeologjike | 32,200,000 |
| • Kalimi mbi lumin Drin për këmbësorë | 49,000,000 |
| • Kosto punësh dhe sigurie në punë | 12,852,000 |
| • Kostot e lidhjes me shërbimet e tjera | 169,559,040 |
| **Totali** | **610,811,040 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i drejtorisë së zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:** 2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:** 2016

| Nr. | Titulli i Projektit: Hartimi i instrumentit të përgjithshëm urban për qytetin | Programi: 14/6.3 Hartimi i studimeve dhe kuadrit rregullator për zhvillimin urban modern |
|---|---|---|
| 65 | **Objektivi i Strategjisë: 6.3** Zhvillim harmonik dhe me standarte i hapësirave urbane që ofrojne jetesë cilësore të komunitetit, rritje të vlerës së biznesit dhe të zonave arkeologjike e historike të qytetit | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 20, 22** % e sipërfaqes urbane publike e rikualifikuar plotësisht dhe me standarte bashkëkohore<br>m² hapësirë banimi cilësore për banorët |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Ky projekt trajton një nevojë urgjente e që ka një ndikim të madh në rregulloret vendore. Lezha ka një nevojë urgjente për një plan urban të plotë për të sistemuar shtresat natyrale të popullsisë, ndarjet dhe instalimin e infrastrukturës. Një plan rregullues do të zgjidhë shumë probleme të krijuara në qytet gjatë një dekade e gjysmë si rezultat i ndryshimeve të mëdha demografike. Në sajë të rritjes së popullsisë dhe ndërtimeve jo të sigurta të blloqeve të apartamenteve dhe ndërtimeve të tjera, hartimi dhe realizimi i një plani rregullues është me rëndësi të madhe. Plani do të ndalojë ndërtimet informale dhe ilegale dhe do të disiplinojë industrinë e ndërtimit duke krijuar hapësira të lejueshme për ndërtime të standardeve të larta. Si rrjedhim, kjo do të tërheqë investimet vendase dhe të huaja.

***Synimi i projektit***

Projekti synon hartimin e planit të përgjithshëm rregullues duke kordinuar punën e bërë deri më sot dhe duke e avancuar projektin deri në përfundim të tij.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi i fizibilitetit
- Takime me komunitetin
- Takime me grupet e interesit
- Takimet me aktorët kryesorë vendimmarrës

**Rezultatet e pritshme:**

- Sistemimi i blloqeve të reja të banimit
- Ndihmohet biznesi
- Ofrimi i shërbimeve cilësore për komunitetin
- Disiplinimi i ndërtimeve të reja

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Biznesi
- Bashkia
- Turizmi

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Universitetet politeknike
- Partnerët e Bashkisë
- OJF
- Grupet e interesit
- Komuniteti

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Universitetet politeknike
- Partnerët e Bashkisë
- OJF
- Grupet e interesit
- Donatorët
- Komuniteti

**Produktet:**

- Plani i Përgjithshëm Rregullues i Bashkisë Lezhë

**Treguesit matës:**

- Sipërfaqja e sistemuar
- Nr. i projekteve të përfshira
- % e komunitetit të kënaqur

**Para kushtet:**

- Janë përcaktuar kufinjtë territorialë të Bashkisë

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i veprimeve të aktorëve
- Mos sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 10,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2014-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Sistemim, asfaltim e ndriçim i rrugëve në Bllokun 11.2 ha në lagjen "Besëlidhja" | **Programi: 15/7.3** Rehabilitimi me starndarte i sistemit rrugor në qytet |
|---|---|---|
| **71** | **Objektivi i Strategjisë: 7.3** Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 20, 23** % e sipërfaqes së hapësirave mes pallatave të rehabilituara plotësisht dhe me standarte % e sipërfaqeve të rrugëve të asfaltuara me standart të lartë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Blloku 11.2 ha është një nga lagjet më të reja dhe më të populluara të qytetit, një lagje e krijuar vitet e fundit, por me një zhvillim të jashtëzakonshëm urbanistik dhe ekonomik. Aktualisht aksi rrugor në Bllokun 11.2 ha është i paasfaltuar dhe pa ndriçim e sigurinë e nevojshme. Kjo rrugë lidh gjithë pjesën tjetër të qytetit me një nga rrugët më kryesore, rrugën "Shtraus". Me sistemimin e saj dhe sigurimin e parametrave bashkëkohore të një rruge urbane do sigurojmë përfitime të shumta për banorët e kësaj lagje dhe gjithë qytetit. Gjithashtu një rrugë e sistemuar do të thotë më shumë qarkullim, më tepër lëvizje mjetesh dhe njerëzish dhe për rrjedhojë një aktivitet ekonomik më frytdhënës për gjithë qytetin. Rruga aktuale duke mos plotësuar standartet për një rrugë të sigurtë rrit mundësinë e aksidenteve. Përmirësimi në gjeometrinë dhe sipërfaqen e rrugës mund të reduktojë ndjeshëm numrin e aksidenteve si dhe mund të sjellë eliminim të trafikut.

***Synimi i projektit***

Përmirësimi në gjeometrinë dhe sipërfaqen e rrugës mund të reduktojë ndjeshëm numrin e aksidenteve si dhe mund të sjellë eleminim të trafikut.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi
- Projektimi
- Zbatimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Rrugë me standarte bashkëkohore
- Ulje e parametrave të ndotjes së mjedisit
- Biznes më i zhvilluar
- Aksesimi i shpejtë tek shkollat e qytetit

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Biznesi lokal

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia e Biznesi
- Donatorët

**Produktet:**

- Rruga me parametrat bashkëkohore
- Zonë e ndriçuar
- Zonë e gjelbëruar

**Treguesit matës:**

- $m^2$ rrugë e ndërtuar
- $m^2$ sipërfaqe e ndriçuar
- $m^2$ sipërfaqe publike e sistemuar

**Para kushtet:**

- Interesimi i qeverisë vendore dhe qendrore

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi i mjeteve financiare në kohë

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 54,716,256 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori e shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**
2013-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015-2016

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Rikonstruksion i plotë i rrugës “Shtraus”, lagja “Besëlidhja” Lezhë (Faza 3) | **Programi: 15/7.3** Rehabilitimi me starndarte i sistemit rrugor në qytet |
|---|---|---|
| 73 | **Objektivi i Strategjisë: 7.3** Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 23** % e sipërfaqeve të rrugëve të asfaltuara me standart të lartë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Rruga “Shtraus” është një nga rrugët më të rëndësishme të qytetit të Lezhës, një rrugë që lidh këtë qytet me pjesën jugore të vendit, në të cilën zhvillojnë aktivitetin e tyre një numër i konsiderueshëm biznesesh dhe që ndodhet pranë tregut të lirë të qytetit. Kjo rrugë aktualisht është në një gjendje shumë të keqe, është e paasfaltuar dhe e pandriçuar, duke krijuar kështu një sërë problemesh për qarkullimin e automjeteve dhe për zhvillimin normal të veprimtarisë së bizneseve.

***Synimi i projektit***

Projekti synon rikonstruksionin e rrugës “Shtraus” gjë e cila do të përmirësojë ndjeshëm mobilitetin (qarkullimin e mjeteve), do ulë sasinë e ndotjes së ajrit, do t’i japë një zhvillim të ri bizneseve dhe do ta bëjë Lezhën një qytet më të aksesueshëm nga rajoni dhe pjesa tjetër e vendit.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi
- Projektimi
- Zbatimi
- Monitorimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Rruga më kryesore e qytetit do të ketë parametra bashkëkohorë, asfaltim,ndriçim dhe sinjalistikë moderne
- Zhvillimi i biznesit në zonë dhe në tregun e lirë të qytetit
- Përmirësim i qarkullimit rrugor
- Përmirësim i treguesve të ndotjes së mjedisit

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Biznesi lokal
- Pushteti lokal
- Policia rrugore

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti
- Donatorët

**Produktet:**

- Rruga “Shtraus” e rikonstruktuar me parametra bashkëkohorë

**Treguesit matës:**

- $m^2$ rrugë e ndërtuar
- $m^2$ sipërfaqe e ndriçuar
- $m^2$ sipërfaqe publike e sistemuar

**Para kushtet:**

- Rruga ka nevojë për ndërhyrje urgjente
- Bashkërendimi me komunitetin
- Nevoja për uljen e ndotjes
- Interesimi i qeverisë qendrore

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi i mjeteve financiare në kohë,

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Total 51,016,554 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori e shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**
2013-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015-2016

| Nr. 75 | Titulli i Projektit: Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore dhe sistemimi hapësirës publike në lagjen ”Kodër Marlekaj” | Programi: 15/7.3 Rehabilitimi me starndarte i sistemit rrugor në qytet |
|---|---|---|
| | **Objektivi i Strategjisë: 7.3** Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 23, 25** % e sipërfaqeve të rrugëve të asfaltuara me standart të lartë<br>% e territorit të Bashkisë e aksesuar me rrugë me standarte |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***
Dy nga lagjet e sapo krijuara, lagja “Kodër Marlekaj” dhe zona 11,2 ha, ju mungon pothuajse fare infrastruktura e domosdoshme. Ndërtimet në këto lagje janë të padisiplinuara. Me hartimin e planit rregullues urban të këtyre lagjeve i vihet fre ndërtimit në mënyrë kaotike dhe ndërkohë që instalimi i infrastrukturës do të ndihmojë në arritjen e qëllimeve të planit urban të qytetit.

Ndërhyrja në infrastrukturën rrugore, të ndriçimit, ujësjellësit, KUZ, KUB dhe në rrjetin e telefonisë fikse janë të domosdoshme.

***Synimi i projektit***
Ndërhyrja në infrastrukturën rrugore, të ndriçimit, ujësjellësit, KUZ, KUB dhe në rrjetin e telefonisë fikse në funksion të cilësisë së jetës së qytetarëve.

***Aktivitete kyçe të projektit:***
- Projektimi
- Zbatimi
- Monitorimi i nivelit të kënaqësisë në komunitet

**Rezultatet e pritshme:**
- Ndërtime të disiplinuara e të ligjshme
- Përfundimi i plotë i infrastrukturës
- Përmirësimi i kushteve të jetesës

**Grupet e synuara:**
- Komuniteti
- Biznesi lokal
- Pushteti lokal

**Aktorët e mundshëm:**
- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti
- Donatorët

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**
- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti
- Donatorët

**Produktet:**
- Rehabilitimi i rrugëve në lagjen “Kodër-Marlekaj”
- Sistemimi i sipërfaqes publike të lagjes
- Ndriçimi i sipërfaqeve të lagjes

**Treguesit matës:**
- $m^2$ rrugë e ndërtuar
- $m^2$ sipërfaqe e ndriçuar
- $m^2$ sipërfaqe publike e sistemuar

**Para kushtet:**
- Hartimi i planit rregullues
- Bashkërendimi me komunitetin
- Interesimi i qeverisë qendrore për bashkëfinancim

**Faktorë rrezikues:**
- Mos sigurimi i mjeteve financiare në kohë

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali 204,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i drejtorisë së zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2013-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2014

| Nr. | **Titulli i Projektit:**<br>Rehabilitimi i rrugës kryesore në lagjen S.M.T | **Programi: 15/7.3**<br>Rehabilitimi me starndarte i sistemit rrugor në qytet |
|---|---|---|
| **79** | **Objektivi i Strategjisë: 7.3**<br>Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 23, 25**<br>% e sipërfaqeve të rrugëve të asfaltuara me standart të lartë<br>% e territorit të Bashkisë e akesuar me rrugë me standarte |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Lagjia S.M.T është një bllok banimi i shkëputur nga pjesa tjetër e qytetit dhe e rrethuar nga ndërtime të shumta që i përkasin komunave fqinje të Kolshit dhe Shëngjinit. Kjo zonë ka qenë historikisht një nga zonat kryesore industriale të qytetit. Aktualisht zona është zgjeruar tej zonës urbane të lejuar. Përmirësimi i infrastrukturës në këtë zonë do të mund të krijonte mundësi të shumta që zona të zhvillonte përsëri bizneset duke u rikthyer në zonë industriale dhe mundësi punësimi për banorët. Kjo gjë do të ndikonte drejtpërsëdrejti edhe në rrijten e cilësisë së jetesës së banorëve të kësaj zone.

***Synimi i projektit***

Projekti synon ndërtimin e rrugës në lagjen S.M.T, gjë e cila do të përmirësojë ndjeshëm qarkullimin e mjeteve në lagje, do krijojë hapësirat për parkim, do ulë sasinë e ndotjes së ajrit, do t'i japë një zhvillim të ri bizneseve.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi i fizibilitetit
- Projekti inxhinierik
- Zbatimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Përmirësim i infrastrukturës rrugore të lagjes S.M.T
- Rritje e mundësive për biznes në këtë zonë
- Përmirësim i cilësisë së jetesës në këtë lagje

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Biznesi
- Bashkia

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Komuniteti

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia e Komuniteti
- Donatorët

**Produktet:**

- Rruga e lagjes SMT është e urbanizuar dhe me kushte bashkëkohore

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e sistemuar
- $m^2$ trotuare
- Nr. i pemëve të mbjella

**Para kushtet:**

- Trupi i rrugës është i qëndrueshëm
- Nuk ka ndërtime pa leje përgjatë rrugës

**Faktorë rrezikues:**

- Mos trajtimi i këtij projekti si prioritar
- Pamundësi financiare

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali 17,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori e shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**
2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016

| Nr. 84 | **Titulli i Projektit:** Asfaltim i rrugës në Lagjen "Nënë Tereza" | **Programi: 15/7.3** Rehabilitimi me starndarte i sistemit rrugor në qytet |
|---|---|---|
| | **Objektivi i Strategjisë: 7.3** Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 23** % e sipërfaqeve të rrugëve të asfaltuara me standart të lartë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Lagja "Nënë Tereza" është një nga lagjet më të reja të qytetit, dhe njëkohësisht ndër më të populluarat. Duke qenë se kjo lagje është ndërtuar nga banorët e ardhur nga rrethinat e qytetit, dhe përbëhet kryesisht nga banesa private të vendosura në mënyrë shumë informale, një rrugë që lidh lagjen me pjesën tjetër të qytetit, kthehet në një investim të rëndësisë primare. Rruga aktuale është shumë e ngushtë dhe e pa shtruar me asfalt, duke rritur rrezikshmërinë për aksidente dhe amortizim të mjeteve të transportit. Banorët e kanë të vështirë për të aksesuar shkollat, qendrat shëndetësore dhe shërbime të tjera të nevojshme.

***Synimi i projektit***

Projekti synon ndërtimin e rrugës në lagjen "Nënë Tereza", gjë e cila do të përmirësojë ndjeshëm qarkullimin e mjeteve në lagje, do krijojë hapësirat për parkim, do ulë sasinë e ndotjes së ajrit, do t'i japë një zhvillim të ri bizneseve.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi
- Projektimi
- Zbatimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Një rrugë e re e rikonstruktuar dhe që përmbush standartet bashkëkohore.
- Rritje e cilësisë së jetës për banorët
- Përmirësim i treguesve të mjedisit

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Biznesi lokal
- Pushteti lokal
- Policia rrugore

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia e Komuniteti
- Donatorët

**Produktet:**

- Rruga "Shtraus" me parametra bashkëkohorë

**Treguesit matës:**

- $m^2$ rrugë e ndërtuar
- $m^2$ sipërfaqe e ndriçuar
- $m^2$ sipërfaqe publike e sistemuar

**Para kushtet:**

- Prishja e ndërtimeve pa leje
- Bashkërendimi me komunitetin
- Interesimi i qeverisë qendrore

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi i mjeteve financiare në kohë
- Konfliktet që vijnë nga shembja e banesave

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 113,054,563 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori e shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**
2013-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015

| Nr. | Titulli i Projektit: Ndërtimi i unazës së qytetit | Programi: 16/7.3 Ndërtimi i infrastruktures cilësore për transportin |
|---|---|---|
| 86 | **Objektivi i Strategjisë: 7.3** Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 25** % e territorit të Bashkisë e akesuar me rrugë me standarte |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Aktualisht qyteti i Lezhës ka patur një zgjerim të theksuar me një rritje urbane jashtë kapaciteteve të rrugëve ekzistuese. Për këtë arsye lind domosdoshmëria e ndërtimit të unazës së qytetit gjë që do të shmangte trafikun nga rrugët që aktualisht kalojnë nëpër qendër. Eshtë e nevojshme zbutja e trafikut dhe ulja e ndotjes në qytet.

***Synimi i projektit***

Ndërtimi i unazës nëpërmjet një projekti që përshtatet me planin rregullues do të zgjidhë shumë çeshtje dhe të përmirësojë qarkullimin e makinave, transportin e mallrave dhe njerëzve, uljen e ndotjes së ambientit dhe sigurinë e jetës së njerëzve dhe vizitorëve.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Projektimi
- Zbatimi (ndërtimi rrugës dhe urës mbi Lumin Drin)
- Monitorimi

**Rezultatet e pritshme:**

- 3 km rrugë e re e ndërtuar me urën ndërlidhëse
- Zbutja e trafikut
- Ulja e ndotjes

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Biznesi
- Pushteti lokal

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore - Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Bashkia

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Bashkia
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**

- Ndërtimi i unazës së qytetit

**Treguesit matës:**

- $m^2$ rrugë e ndërtuar
- $m^2$ urë mbi lumin Drin
- % e makinave që nuk futen në qytet

**Para kushtet:**

- Hartimi i planit rregullues
- Interesi i qeverisë qendrore në bashkëfinancim

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi i mjeteve financiare në kohë

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali 400,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i drejtorisë së zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2016

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2018

| Nr. | Titulli i Projektit: | Programi: 16/7.3 |
|---|---|---|
| | Sistemim i brigjeve dhe ndërtimi i portit mbi Lumin Drin në qytet | Ndërtimi i infrastrukturës cilësore për transportin |
| 88 | **Objektivi i Strategjisë: 7.3**<br>Ndërtimi i infrastrukturës moderne dhe i sistemit rrugor funksional që integron të gjitha zonat dhe garanton lëvizshmëri të sigurtë dhe lidhje të shpejta me tregjet rajonale | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: n. 24**<br>Nr. i infrastrukturave moderne që mundësojnë transport modern dhe mjedisor |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Lumi i Drinit është i rëndësishëm në shumë aspekte për qytetin, bujqësinë, peshkimin, furnizimin me ujë, si dhe ka një potencial të madh për transportin vendas. Hapja e një porti të ri hap një perspektivë të re për qytetin duke e lidhur atë me detin Adriatik. Ky port rrit perspektivën për zhvillimin e turizmit, ndërkohë që gërmimi në fund të lumit dhe forcimi i brigjeve të tij do të përmirësojnë situatën e përmbytjeve nga të cilat Lezha shpesh është e rrezikuar.

### *Synimi i projektit*

Ky projekt konsiston në rregullimin e rrjedhës së ujit përgjatë lumit Drin ndërsa hyn në Lezhë si dhe në ndërtimin e një porti të ri për qytetin. Ai do të zgjidhë disa probleme sociale e ekonomike dhe do të veprojë si një bazë për zhvillimin e turizmit. Në përfundim, ky projekt do të ketë një influencë të madhe në zhvillimin ekonomik të qarkut në tërësi dukë zgjidhur shumë probleme të ndryshme, sidomos rreth zonave të Zadrimës.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Studimi i fizibilitetit
- Ndërtimin e një rrugë me trotuarë dhe të ndriçuara
- Ndërtimi i zonës argëtuese për grupmosha të ndryshme
- Ndërtimi i portit lundrues për turistët

### Rezultatet e pritshme:

- Përmirësimi i habitatit dhe  mjedisit për komunitetin
- Përmirësimi infrastrukturës për agrobiznesin
- Më shumë perspektivë për sektorin e turizmit
- Shtimi i zonës së gjelbëruar

### Grupet e synuara:

- Komuniteti
- Të rinjtë
- Turistët

### Aktorët e mundshëm:

- Bashkia
- Ministria e Mjedisit
- Shoqatat e mjedisit

### Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Bashkia
- Ministria e Mjedisit
- Donatorë

### Produktet:

- Lumi Drin i sistemuar
- Zonë e gjelbëruar
- Port për varka lundruese

### Treguesit matës:

- $m^2$ hapësirë publike e zhvilluar me stadarte

### Para kushtet:

- Ekzistenca e portit historik
- Kërkesë e përsëritur e komunitetit

### Faktorë rrezikues:

- Mungesë financimi
- Bizneset

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali 500,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i drejtorisë së zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015-2016

# Qëllimi 4. Cilësia e jetës dhe komuniteti

| Nr. | Titulli i Projektit: Rikonstruksion Pallati I Kultures (faza II) | Programi: 19/9.4 Zhvillimi i kulturës dhe krijimitarisë për komunitetin |
|---|---|---|
| 94 | Objektivi i Strategjisë: 9.4 Pasurimi i jetës kulturore dhe komunitare që mundëson përparimin shpirtëror e kulturor të banorëve dhe ndërveprime shqërore të harmonishme mes njerëzve dhe brezave | Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 32 Numri në vit i aktiviteteve artistike e kulturore të organizuar me qëllim pasurimin e jetës së komunitetit |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

***Situata***

Pallati i Kulturës “Ded Ndue Lazri” është ndërtuar në vitin 1983, duke krijuar hapësira e mundësi më të mëdha për zhvillimin e kulturës dhe arteve në qytetin e Lezhës. Kjo ndërtesë ka mundësuar që nga Lezha të marrin fillesat e karrierës e të ngjitin shkallaret për në veprimtari në shkallë vendi këngëtarë, drejtues e interpretues të nivelit kombëtar. Edhe sot e kësaj dite Pallati i Kulturës mbetet institucioni kryesor kulturor për qytetin e Lezhës. Kohë pas kohe këtu zhvillohen veprimtari të vogla, të mëdha, koncerte me të ftuar e interpretues lokal e kombëtar. Në Pallat ka një Galeri Artesh të Bukura, sallën e leksioneve, sallën e madhe si dhe ambiente për zhvillimin e përgatitjeve për spektaklet që janë kthyer në shkolla të vërteta për baletin, këngëtarët, piktorët etj. Pallati i Kulturës është restauruar disa herë, por duke qenë një ndërtesë e madhe me ambiente të ndryshme, ka nevojë për ndërhyrje të herëpashershme në mënyrë që të përmirësohen kushtet.

***Synimi i projektit***

Faza e II-të e restaurimit të Pallatit të Kulturës ka si synim ndërhyrjen në sallën e madhe të shfaqjeve duke mundësuar përmirësimin e kushteve të kësaj salle. Është planifikuar që të kryhet një restaurim i plotë i sallës, skenës, arenës, ngrohjes, fonisë dhe ndriçimit.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Punime ndërtimi
- Punime elektrike
- Punime hidraulike

**Rezultatet e pritshme:**

- Sallë shfaqjesh moderne
- Aktivitete kulturore më cilësore
- Rritje e pjesëmarrjes së publikut në ngjarje

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti i artistëve
- Banorët
- Bashkia

**Aktorët e mundshëm:**

- Ministria e Kulturës
- Bashkia
- Qarku
- OJF Kulturore

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Ministria e Kulturës
- Bashkia
- Qarku
- Donatorë

**Produktet:**

- Sallë moderne e Pallatit të Kulturës e përshtatshme për aktivitete të ndryshme si dhe kinema teatër.

**Treguesit matës:**

- $m^2$ punime
- $m^3$ sallë e ngrohur
- Nr. i eventeve të reja

**Para kushtet:**

- Pallati i Kulturës vazhdon të mbetet institucioni kryesor për kulturën në qytet dhe në qark
- Palët janë të interesuara për zhvillimin e kulturës dhe aktiviteteve kulturore në qytet

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i kontributeve të aktorëve
- Mos parashikimi në kohë i fondeve nga institucionet përkatëse
- Përkeqësimi i gjendjes së objektit

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 39,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015

| Nr. | Titulli i Projektit: Ngritja e Qendrës Rinore | Programi: 20/9.4 Shkëmbimet kulturore rajonale të komunitetit |
|---|---|---|
| 98 | **Objektivi i Strategjisë: 9.4** Pasurimi i jetës kulturore dhe komunitare që mundëson përparimin shpirtëror e kulturor të banorëve dhe ndërveprime shoqërore të harmonishme mes njerëzve dhe brezave | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr 30** Nr. i të rinjve të angazhuar drejtpërdrejtë në organizimin e aktiviteteve që pasurojnë jetën kulturore në qytet |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Prej vitesh në Lezhë është shumë aktivë parlamenti rinor dhe organizime të tjera rinore që kanë qenë shumë aktivë në mbajtjen e shëndetëshme të jetës qytetare. Por në Lezhë nuk ekziston një qendër e mirëfilltë rinore e cila të ndikojë në aktivizimin dhe mundësinë për të kaluar kohën e lirë për rininë e qytetit.

***Synimi i projektit***

Qëllimi i Qendrës Rinore është: të ofrojë një vend të shëndetshëm, ku të rinjtë do të kenë mundesi të mësojnë, t'u japin zë çështjeve rinore dhe të marrin pjesë aktive në komunitetin e tyre. Qendra Rinore Lezhë synon të avancojë ndjenjën e respektit, përgjegjësisë për rininë dhe sigurisë me qëllim të krijimit të një shoqërie tolerante demokratike në Shqipëri.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi i fizibilitetit
- Hartimi i projektit teknik
- Ndërtimi i qendrës
- Blerja dhe instalimi i mobiljeve dhe veglave muzikore
- Blerja dhe instalimi i kompjuterave dhe mjeteve audio-vizive

**Rezultatet e pritshme:**

- Edukimi i të rinjëve për adresimin e çështjeve rinore
- Informimi i të rinjëve
- Krijimi dhe forcimi i rrjetit rinor
- Kalimi i kohës së lirë në mënyrë sa më të kulturuar

**Grupet e synuara:**

- Djemtë dhe vajzat e shkollave të Bashkisë Lezhë
- Djemtë dhe vajzat e moshës 19-26 vjeç
- Gjithë komuniteti në përgjithësi

**Aktorët e mundshëm:**

- Shoqata "Komiteti rinor"
- Bashkia Lezhë
- Universitete të ndryshme
- OJF vendore

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Komiteti rinor
- Qeveria Qendrore
- Donatorë

**Produktet:**

- Ndërtimi i qendrës shumë funksionale në shërbim të rinisë
- Mobilimi i qendrës
- Pajisja e qendrës me kompjutera dhe mjete muzikore e audio-vizive

**Treguesit matës:**

- $m^2$ hapësirë e ndërtuar
- Nr i frekuentuesve
- Nr. i mjediseve të shërbimit

**Para kushtet:**

- Mjediset e mjaftueshme për një qendër bashkëkohore rinore

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesa e buxhetit për investime në infrastrukturën e Qendrës Rinore.

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| Rikonstruksioni pjesor i zyrës: | 457,754.4 Lekë |
| Mobilim: | 548,400 Lekë |
| **TOTALI:** | **1,006,154 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i mirëqenies sociale dhe rinisë

**Periudha e zbatimit:**
2017

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2018

| Nr. | Titulli i Projektit: Integrimi gjinor në politikat e zhvillimit të Bashkisë | Programi: 23/13.4 Barazia gjinore |
|---|---|---|
| 108 | Objektivi i Strategjisë: 11.4 Shtimi i shanseve integruese, pasurimi dhe modernizmi i jetës së fëmijëve, të rinjve, grave dhe vajzave | Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: 47 % e grave dhe vajzave në nevojë që marrin shërbime të fuqizimit social |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Punonjësit lokalë kanë kapacitet për integrimin gjinor në planet lokale, ofrojnë shërbime të vetëdijes gjinore për qytetarët, për zbatimin e legjislacionit GE profesionalisht dhe në koordinim me njëri-tjetrin. Ndërgjegjësimi i komunitetit është rritur dhe dialogu mbi çështjet gjinore mes Bashkisë dhe komunitetit është promovuar. Praktikat e reja për buxhetimin gjinor janë futur dhe pilotuar për një planifikim më të mirë të burimeve në mënyrë që të plotësojnë nevojat e komunitetit.

***Synimi i projektit***

Qëllimi ynë në këtë projekt do të jetë për të kontribuar për integrimin gjinor në planet e zhvillimit lokal në rajonin e Lezhës.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Fuqizimi i seksionit të barazisë gjinore në Bashki me punësimin e një specialisti të ri si pikë fokale gjinore
- Përmirësimi i kapaciteteve të punonjësve lokalë mbi buxhetimin gjinor dhe përfshirjen e këndvështrimit gjinor
- Përgatitja e planit të veprimit për integrimin gjinor, si pjesë e Strategjisë Rajonale për Zhvillim Ekonomik
- Pilotimi i iniciativës së re të procesit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor
- Mobilizimi i grave të moshuara për promovimin e politikave të barazisë gjinore
- Infrastruktura e zyrës së Barazisë gjinore dhe Dhunës në familje do të mbështetet

**Rezultatet e pritshme:**

- Seksioni i Barazisë gjinorë në Bashki është përforcuar
- Paisja me Planin e Veprimit për integrimin gjinor, në Planin Strategjik të Zhvillimit
- Zbatimi i iniciativës së re të procesit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor
- Gratë e moshuara angazhohen për promovimin e politikave të barazisë gjinore
- Zyra e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje e plotësuar me infrastrukturë

**Grupet e synuara:**

- Gratë
- Komuniteti

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia,
- Shoqatat e grave
- Organizmat ndërkombëtare

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Organizmat ndërkombëtare
- Donatorë

**Produktet:**

- Plan Veprimi për Integrimin gjinor
- Zyra e barazisë gjinore
- Gra të angazhuara

**Treguesit matës:**

- Nr. i grave të përfshira
- Nr. i grave aktive

**Para kushtet:**

- Politikat gjinore ne nivel qendror janë të qarta
- Angazhimi i politikbërësve është serioz
- Angazhimi i grave

**Faktorë rrezikues:**

- Pamundësia e grave për t'u anagazhuar

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 3,326,566 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i mirëqenies sociale dhe rinisë

**Periudha e zbatimit:**
2012-2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2013

| Nr. | Titulli i Projektit: | Programi: 24/11.4 |
|---|---|---|
| | Rinia agjente për ndryshim social | Zhvillimi bashkëkohor i rinisë |
| 113 | **Objektivi i Strategjisë: 11.4**<br>Shtimi i shanseve integruese, pasurimi dhe modernizmi i jetës së fëmijëve, të rinjve, grave dhe vajzave | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 38, 39**<br>Nr. i organizatave të shoqërisë civile që trajtojnë çështjet e zhvillimit të grave e vajzave dhe të rinjve<br>Nr. i të rinjve që marrin pjesë në aktivitetet rajonale dhe evropiane |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***
Prej vitesh në Lezhë është shumë aktiv Parlamenti Rinor dhe organizime të tjera rinore që kanë qenë shumë aktivë në mbajtjen të shëndetëshme të jetës qytetare. Por në Lezhë nuk ekziston një qendër e mirëfilltë rinore e cila të ndikojë në aktivizimin dhe mundësinë për të kaluar kohën e lirë për rininë e qytetit.

***Synimi i projektit***
Realizimi i projektit krijon mundësinë të rinjve e të rejave të qytetit të Lezhës të përmirësojnë eksperiencat e tyre si dhe aftësitë e tyre edukuese, sociale dhe ndërvepruese duke i mbajtur larg nga dukuritë negative të kohës. Projekti krijon mundësinë e kalimit në mënyrë të kulturuar të kohës së lirë.
Ky projekt parashikohet të realizohet në tre faza:

***Aktivitete kyçe të projektit:***
- Zgjedhja e vendit dhe përgatitja e projektit teknik;
- Ndërtimi i qendrës;
- Pajisja e saj me bazën e nevojshme materiale për sallat si ajo e leksioneve, të lojërave dhe të internetit

**Rezultatet e pritshme:**
- Rritja e nivelit social dhe edukativ i rinisë së qytetit

**Grupet e synuara:**
- OJF rinore
- Rinia
- Komuniteti

**Aktorët e mundshëm:**
- Bashkia
- Komiteti rinor
- Orgnaizma kombëtare e ndërkombëtare
- Shkollat

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**
- Bashkia
- Shkollat
- OJF
- Donatorë

**Produktet:**
- Rini aktive dhe e organizuar

**Treguesit matës:**
- Nr. i të rinjve të përfshirë
- Nr. i iniciativave të ndërmarra

**Para kushtet:**
- Ekzistenca e hapësirave ose e ndërtesës për këtë qëllim

**Faktorë rrezikues:**
- Mungesë fondesh

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 6,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i mirëqenies sociale dhe rinisë

**Periudha e zbatimit:**
2015-2017

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016 e në vazhdim

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Rikonstruksioni dhe zgjerimi i qendrës shëndetësore në Lagjen “Skënderbeg” | **Programi: 25/12.4** Jetesa e shëndetëshme e komunitetit |
|---|---|---|
| **114** | **Objektivi i Strategjisë: 12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 45** Nr. i ankesave adresuar Bashkisë, sipas gjinisë, në lidhje me sigurinë e shëndetin e qytetarëve |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Shërbimi shëndetësor është një ndër shërbimet më jetësore për funksionimin normal të një komuniteti dhe ekzistenca e një qendre shëndetësore funksionale në çdo lagje është një hap i nevojshëm për ofrimin e këtij shërbimi. Ambulanca e lagjes Skënderbeg është në një gjendje jashtëzakonisht të keqe, pa infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për funksionimin normal të saj. Rikonstruksioni dhe zgjerimi i kësaj ambulance është i domosdoshëm dhe duke marrë në konsideratë dhe faktin që lagja “Skënderbeg” është kryesisht e banuar nga shtresa të marxhinalizuara të popullsisë si komuniteti Rom, ky investim kthehet në një investim me prioritet të lartë.

***Synimi i projektit***

Projekti synon rikonstruksionin dhe zgjerimin e ambulancës në lagjen “Skënderbeg” duke e përshtatur me kushtet moderne të këtij lloj shërbimi.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Projekti teknik
- Zbatimi i projektit
- Marrja në dorëzim
- Pajisja me mjetet e nevojshme

**Rezultatet e pritshme:**

- Godinë e rikonstruktuar që plotëson të gjitha parametrat për funksionim normal të qendrës shëndetësore
- Rritje e cilësisë së jetës për banorët e lagjes

**Grupet e synuara:**

- Banorëte lagjes Skënderbeg
- Komuniteti Rom dhe Egjyptian

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia Lezhë
- Drejtoria e Shërbimit Shëndetësor Parësor
- Donatorë të mundshëm

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia Lezhë
- Drejtoria e Shërbimit Shëndetësor Parësor
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**

- Godinë sipas standarteve bashkëkohore
- Pajisje mjeksore për shërbim të cilësisë së lartë

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e rehabilituar e godinës

**Para kushtet:**

- Bashkia është tepër e vetëdijshme për rëndësinë e këtij investimi
- Situata aktuale kërkon nevojë urgjente për ndërhyrje

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i veprimeve ndërmjet aktorëve
- Mos realizimi i kontributeve të parashikuara

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 14,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2014

| Nr. | Titulli i Projektit: | Programi: 25/12.4 |
|---|---|---|
| | Instalimi i stacionit për monitorim e cilësisë së ajrit në Lezhë | Jetesa e shëndetëshme e komunitetit |
| **115** | **Objektivi i Strategjisë: 12.4**<br>Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 40**<br>Përputhshmëria e treguesve të cilësisë së ajrit P.M10, P.M2.5 me standartet evropiane të cilësisë së ajrit |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Situata: Zhvillimi i dendur urban i qytetit dhe rritja e fluksit të qarkullimit të automjeteve, aktiviteti ndertues intensiv, shkarkimet e furrave të bukes etj, ka ndikuar në rritjen e ndotësve në ajër. Në mënyrë të veçantë koncentrimi i këtyre shkarkimeve rritet gjatë përiudhës së ngrohtë si dhe e ardhjes së pushuesve nga emigracioni si rezultat i trafikut të renduar si dhe kur piku i levizjes është më i lartë sidomos në mëngjez. Në qytetin e Lezhës nuk bëhen monitorime periodike të cilësisë së ajrit. Qyteti i Lezhës nuk është përfshirë në sisteimin kombëtar të monitorimit të ajrit.

***Synimi i projektit***

a. Përfshirjen e Lezhës në rrjetin kombëtare të monitorimit të ajrit.
b. Ndërtimin e një stacioni monitorues të cilësisë ajrit në qytetin e Lezhës.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Lobimi për tu përfshirë qyteti i Lezhës në rrjetin kombëtar për monitorimin e cilsësë së ajrit
- Ndërtimi i një stacioni për monitorimin e pavarur nga sistemi kombëtar të cilsësë së ajrit në qytetin e Lezhës e instalimi i pajisjeve përkatëse
- Kualifikimi i një specialisti që do të operojë në ketë stacion
- Kryerja periodike e monitorimit dhe publikimi i rezultateve direkt në faqen e internetit të Bashkisë Lezhë

**Rezultatet e pritshme:**

- Përfshirja e Lezhës në skemën kombëtare të monitorimit të cilësisë së ajrit
- Ndërtimi i një pike monitoruese të cilësë së ajrit për qytetin e Lezhës
- Komuniteti dhe vëndimmarrësit të ndërgjëgjesuar për cilësinë e ajrit

**Grupet e synuara:**

- Banorët e Lezhës
- Turistët potenciale të qytetit
- Bizneset e ndryshme

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria e Shqipërisë
- Bashkia Lezhë
- Donatorët (REC)

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria e Shqipërisë
- Bashkia Lezhë
- Donatorët (REC)

**Produktet:**

- Stacion i ndërtuar për monitorimin e ajrit

**Treguesit matës:**

- Bashkia e përfshirë në programin kombëtar të monitorimit të ajrit
- Periodiciteti i publikimit të rezultateve të monitorimit në Raportin Kombëtar për Gjendjen e Mjedisit, në faqen e internetit

**Para kushtet:**

- Ndërtimi i këtij stacioni nuk kërkon shumë investime dhe rezultatet janë mjaft të mirëpritura e të kërkuara nga shumë aktorë

**Faktorë rrezikues:**

- Sigurimi i pagesës për mirëmbajtje e blerje reagentesh
- Finacimi i pagës së operatorit, në vazhdimësi

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| • Krijimi i mjedisit ku do të instalohen pajisjet matëse | 800,000 |
| • Paisjet matëse të cilësisës së ajrit | 1,000,000 |
| • Punësimi i operatorëve | 5,000,000 në vit |
| **Totali:** | **6,800,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2014-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2014-2015

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Ndërtimi i stabilimentit për denatyrimin e mbetjeve teknologjike të produkteve ushqimore | **Programi: 25/12.4** Jetesa e shëndetëshme e komunitetit |
|---|---|---|
| **116** | **Objektivi i Strategjisë: 12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 45** Numri i ankesave adresuar Bashkisë, sipas gjinisë, në lidhje me sigurinë e shëndetin e qytetarëve |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Qyteti i Lezhës është qendra e Qarkut dhe si i tillë është qendra e një tregu relativisht të madh të produkteve ushqimore. Duke patur edhe disa pika thertoresh, fabrika të mëdha të përpunimit të peshkut dhe impiante të tjera të përpunimit të ushqimeve, mbetjet që krijohen nga kjo industri përbëjnë një sasi të madhe mbetjesh të cilat mbeten të papërunuara. Duke qenë se mbetjet teknologjike të industrisë ushqimore mund të trajtohen në mënyrë specifike atëherë lind nevoja për krijimin e një stabilimenti për denatyrimin e këtyre mbetjeve duke eliminuar mundësitë që këto mbetje të rrezikojnë jetën e qytetarëve.

***Synimi i projektit***

Ulja e sasisë së mbetjeve që krijon industria në qytetin e Lezhës. Ndërtimi i një stabilimenti për denatyrimin e mbetjeve teknologjike të thertores, të sallamerisë, të stabilimenteve të përpunimit të qumështit, të rrjetit tregtar e përpunues të peshkut.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Takime me palët e interesuara
- Hartimi i projektit teknik
- Ndërtimi i stabilimentit
- Hartimi i një plani të menaxhimit të stabilimentit

**Rezultatet e pritshme:**

- Ulja e sasisë së mbetjeve teknologjike
- Eliminimi i rrezikut nga mbetjet
- Rritja e mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve
- Përmirësimi i nivelit të shëndetit publik

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Tregtarët në industrinë ushqimore
- Përpunuesit në industrinë ushqimore

**Aktorët e mundshëm:**

- Biznesi
- Drejtoria e Shëndetit Publik
- Ministria e Shëndetësisë
- Bashkia

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Biznesi
- Ministria e Shëndetësisë
- Bashkia
- Donatorët

**Produktet:**

- Sistem Menaxhimi të Mbetjeve Teknologjike

**Treguesit matës:**

- Sasia e mbetjeve të përpunueshme
- % e mbetjeve teknologjike të mbledhura

**Para kushtet:**

- Ekzistenca e tregut
- Koordinimi dhe interesimi maksimal i aktorëve
- Vend për ndërtimin e stabilimentit
- Ndërgjegjësimi i punonjësve të këtij sektori

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesë mbështetjeje financiare

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **10,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori e shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**
2019

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2020

| Nr. | Titulli i Projektit: Ndërtimi i qendrës sportive, pranë kompleksit të shkollave | Programi: 26/12.4 Mjediset çlodhëse dhe sportive për komunitetin |
|---|---|---|
| 121 | **Objektivi i Strategjisë: 12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 43, 44** $m^2$ për frymë e sipërfaqes së mjediseve sportive<br>Nr. i aktiviteteve sportive jashtë kurikulës shkollore të organizuara me komunitetin |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Kompleksi i shkollave ndodhet në lagjen Besëlidhja dhe mbledh grupin më të madh të nxënësve të qytetit të Lezhës. Në këtë kompleks ndodhet dhe Qendra e Zhvillimit Ditor, një institucioni mjaft i rëndësishëm për trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijeve me aftësi të kufizuar. Rritja e hapësirave sportive për këto persona është e një rëndësie thelbësore. Aktualisht terrenet sportive në këtë kompleks janë jashtë standarteve të kërkuara dhe nuk plotësojnë nevojat e nxënësve të këtyre shkollave. Shpesh nxënësit janë të detyruar të kalojnë orët e edukimit fizik në oborrin e shkollës pa e zhvilluar këtë lëndë. Ky investim do të plotësojë ndëryrjen e bërë përpara dy viteve me ndërtimin e murit rrethues kompleksit të shkollave.

***Synimi i projektit***

Ky projekt parashikon krijimin e një qendre multifunksionale sportive për nxënësit dhe stafin e kompleksit të shkollave. Rritja e numrit të popullsisë me hapa jashtëzakonisht të shpejtë për shkak të zhvillimit të madh që po përjeton Lezha në shumë fusha, ka bërë që hapësirat sportive publike të mos jenë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e popullsisë. Ky projekt gjithashtu do t'ju shërbejë dhe banorëve të lagjes pasi kjo qendër parashikon krijimin e mundësisë për ushtrimin e shumë sporteve si: futboll, volejboll, basketboll, gjimnastikë etj. Në qendër do të ofrohen të gjitha kushtet teknike dhe mjedisore për të siguruar shëndetin dhe jetën e përfituesve. Objektet e mira janë themelore për zhvillimin e mundësive sportive për të gjithë dhe qendra do të inkurajojë një krenari civile dhe do të ndihmojnë procesin e rivitalizimit të privuar të zhvillimit të shumë sporteve në shkollat tona. Qendra sportive do plotësoje të gjitha parametrat për funksionim normal të jetës sportive në kompleksin e shkollave dhe në lagjen Besëlidhja.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Rikonstruksioni i qendrës sportive
- Zgjerimi i një qendrës sportive

**Rezultatet e pritshme:**

- Një qendër sportive e rikonstruktuar dhe e zgjeruar që plotëson të gjitha parametrat për funksionim normal të jetës sportive në shkolla
- Pajisje me mjetet e nevojshme për një proçes mësimor normal për lëndën e edukimit fizik
- Rritje e cilësisë së jetës për nxënësit e shkollës dhe banorët e lagjes

**Grupet e synuara:**

- Nxënësit e kompleksit të shkollave
- Banorët e lagjes Besëlidhja

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia Lezhë
- Drejtoria Arsimore Rajonale

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Bashkia Lezhë

**Produktet:**

- Qendra sportive e rikonstruktuar me standarte për zhvillimin optimal të orëve të mësimit dhe jetës sportive në lagje

**Treguesit matës:**

- $m^2$ të qendrës sportive
- Numri i frekuentuesve

**Para kushtet:**

- Disponimi i hapësirave publike në këtë lagje
- Mbështetje e nxënësve dhe komunitetit për projektin

**Faktorë rrezikues:**

- Vështirësi në sigurimin e mirëmbajtjes së qendrës në vazhdimësi
- Mungesa e koordinimit ndërmjet aktorëve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| • Punime gërmimi | 373,301 |
| • Punime gërmimi | 975,979 |
| • Punime shtresash dhe mbulesë | 6,584,984 |
| • Punime elektrike | 265,287 |
| **Totali:** | **8,199,551 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtoria e Programim Zhvillimit

**Periudha e zbatimit:**
2013 – 2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015

| Nr. | Titulli i Projektit: Ndërtimi i qendrës sportive në shkollën Nënë Tereza | Programi: 26/12.4 Mjediset çlodhëse dhe sportive për komunitetin |
|---|---|---|
| 122 | **Objektivi i Strategjisë: 12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 43, 44** $m^2$ për frymë e sipërfaqes së mjediseve sportive<br>Nr. i aktiviteteve sportive jashtë kurikulës shkollore të organizuara me komunitetin |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Lagja Nënë Tereza është lagja me problematike në qytet përsa i përket urbanistikës, pasi shumica e ndërtesave janë informale dhe të vendosura në mënyrë të çrregullt. Kjo ka bërë që hapësirat publike dhe sportive të jenë inekzistente. Aktualisht terrenet sportive në këtë shkollë janë jashtë standarteve të kërkuara dhe nuk plotësojnë nevojat e nxënësve, aq më pak të banorëve të lagjes. Shpesh nxënësit janë të detyruar të kalojnë orët e edukimit fizik në oborrin e shkollës pa e zhvilluar këtë lëndë.

***Synimi i projektit***

Nëpërmjet këtij projekti parashikohet krijimi e një qendre multifunksionale sportive për nxënësit dhe stafin e kësaj shkolle. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje synojmë të rrisim hapësirat sportive në një nga lagjet me rritjen më të madhe të popullsisë së viteve të fundit. Ky projekt gjithashtu do t'ju shërbejë dhe banorëve të lagjes në këtë drejtim. Kjo qendër parashikon krijimin e mundësisë për ushtrimin e shumë sporteve si: futboll, volejboll, basketboll, gjimnastikë etj, dhe do të ofrojë të gjitha kushtet teknike dhe mjedisore për të siguruar shëndetin dhe jetën e përfituesve. Kjo qendër do të inkurajojë një krenari civile dhe të ndihmojnë proçesin e rivitalizimit të privuar të zhvillimit të shumë sporteve në shkollat tona. Qendra do plotësojë të gjitha parametrat për funksionim normal të jetës sportive në kompleksin e shkollave dhe në lagjen Besëlidhja.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Rikonstruksioni i qendrës sportive
- Zgjerimi i një qendrës sportive

**Rezultatet e pritshme:**

- Një qendër sportive e rikonstruktuar dhe e zgjeruar që plotëson të gjitha parametrat për funksionim normal të jetës sportive në shkolla
- Pajisje me mjetet e nevojshme për një proces mësimor normal për lëndën e edukimit fizik
- Rritje e cilësisë së jetës për nxënësit e shkollës dhe banorët e lagjes

**Grupet e synuara:**

- Nxënësit e Shkollës Nënë Tereza
- Banorët e lagjes Besëlidhja

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia Lezhë
- Drejtoria Arsimore Rajonale

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Bashkia Lezhë

**Produktet:**

- Qendra sportive e rikonstruktuar me standarte për zhvillimin optimal të orëve të mësimit dhe jetës sportive në lagje

**Treguesit matës:**

- $m^2$ të qendrës sportive
- Numri i frekuentuesve

**Para kushtet:**

- Disponimi i hapësirave publike në këtë lagje
- Mbështetje e nxënësve dhe komunitetit për projektin

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesa e koordinimit ndërmjet aktoreve.
- Vështirësi në sigurimin e mirëmbajtjes së qendrës në vazhdimësi

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | | |
|---|---|---|
| • | Punime gërmimi | 3,522,788 |
| • | Punime beton arme | 17,673,532 |
| • | Punime murature | 31,199,797 |
| • | Punime shtresash dhe çatie | 492,834 |
| • | Punime elektrike | 775,402 |
| • | Impjant ngrohje | 2,827,408 |
| | **Totali:** | **56,491,761 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtoria e Programim Zhvillimit

**Periudha e zbatimit:**
2013-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016

| Nr. | Titulli i Projektit: Ndërtimi i Qendrës së Lojërave me Dorë | Programi: 26/12.4 Mjediset çlodhëse dhe sportive për komunitetin |
|---|---|---|
| 123 | **Objektivi i Strategjisë: 12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 43, 44** nr. i aktiviteteve sportive jashtë kurikulës shkollore të organizuara me komunitetin |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Qytetarët e Lezhës kanë kërkuar prej vitesh ndërtimin e një qendre sportive në qytetin e tyre ku lojrat basketboll dhe volejboll si dhe lloje të tjera sportesh mund të luhen. Komuniteti i Lezhës është sportdashës dhe ka shumë potenciale duke marrë parasysh rezultatet e shkëlqyera që janë arritur nga atletët e tij në vite.

***Synimi i projektit***

Është parashikuar që objekti të ndërtohet mbi një sipërfaqe prej 936 $m^2$ brenda rrethimit të stadiumit "Besëlidhja". Ky projekt do të jetë me përfitim të madh për të rinjtë e qytetit dhe për qarkun. Qendra e sportit mund të përdoret nga skuadrat vendase për ndeshjet me skuadrat kundërshtare nga brenda dhe jashtë vendit.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi i fizibilitetit
- Ndërtimi
- Aktivitete sensibilizuese

**Rezultatet e pritshme:**

- Përmirësim i cilësisë së ambientit ku do të luhen ndeshjet midis skuadrave vendase
- Përmirësim i cilësisë së sportit
- Përmirësim i shëndetit të qytetarëve

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Klubi shumësportesh
- Sportistët

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Shoqata e biznesit
- OJF sportive

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Donatorë të ndryshëm
- Bashkia
- Shoqata e biznesit

**Produktet:**

- Ndërtimi i Qendrës së Lojrave me Dorë në kushte bashkëkohore

**Treguesit matës:**

- $m^2$ terren i sistemuar
- Nr. i ambienteve sportive
- Nr. i ambienteve ndihmëse

**Para kushtet:**

- Aprovimi nga ana e Bashkisë
- Ekzistenca e sportistëve që praktikojnë këto sporte

**Faktorë rrezikues:**

- Kosto shumë e lartë

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 25,500,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2015-1016

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016

| Nr. | Titulli i Projektit: Ndërtimi i shëtitores në Lumin Drin | Programi: 26/12.4 Mjediset çlodhëse dhe sportive për komunitetin |
|---|---|---|
| 124 | **Objektivi i Strategjisë: 12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 41, 42** $m^2$ sipërfaqe e gjelbër për banorë<br>Nr. i pemëve dekorative në hapësirën publike të qytetit |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Lezha është një qytet me zhvillim të vazhdueshëm, dhe është shumë e vështirë që rritja e popullsisë të shoqërohet në mënyrë progresive me shtim të hapësirave publike për argëtimin e qytetarëve. Ndërtimi i një shëtitoreje do t'i japë një pamje tjetër qytetit, do zhvillojë në mënyrë të ndjeshme biznesin e vogel, dhe bizneset turistike, do ta bëjë Lezhën një qytet më të këndshëm për t'u jetuar dhe më interesant për t'u vizituar. Lumi Drin është pasuri natyrore jashtëzakonisht e madhe, por pastrimi i tij, ndërtimi i shëtitores, gjelbërimi dhe ndriçimi do siguronin një vlerë të shtuar të konsiderueshme për gjithë rajonin.

***Synimi i projektit***

Synimi kryesor është ndërtimi i një shëtitoreje të parametrave bashkëkohore në brigjet e lumit Drin, duke shtuar hapësiart publike, gjelbërimin dhe duke ndihmuar në forcimin e biznesit lokal.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi i fizibilitetit
- Projekti inxhinierik
- Zbatimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Shëtitore bashkëkohore buzë Lumit Drin
- Rritje e cilësisë së jetës për qytetarët
- Shtim të hapësirave të gjelbëruara
- Zhvillim i biznesit lokal
- Zhvillim i turizmit

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Biznesi
- Bashkia
- Turizmi

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti
- Donatorët

**Produktet:**

- Shëtitorja në bregun e lumit Drin bashkë me hapësirat publike dhe të gjelbëruara

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e sistemuar
- $m^2$ trotuare të ndërtuara
- Nr. i stolave dhe hapësirave për pushim
- $m^2$ sipërfaqe e gjelbër

**Para kushtet:**

- Bashkërendimi i punës me komunitetin
- Plani pjesor urbanistik për zonën

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi i mjeteve financiare në kohë

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totall: 7,000,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2017-1020

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2020

| Nr. | Titulli i Projektit: Ndërtimi i qendrës sportive, pranë shkollës Gjergj Fishta | Programi: 26/12.4 Mjediset çlodhëse dhe sportive për komunitetin |
|---|---|---|
| 125 | **Objektivi i Strategjisë: 12.4** Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 43, 44** $m^2$ për frymë e sipërfaqes së mjediseve sportive<br>Nr. i aktiviteteve sportive jashtë kurikulës shkollore të organizuara me komunitetin |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Shkolla Gjergj Fishta është një nga shkollat më të vjetra dhe me të rëndësishme të qytetit. Godina ku zhvillojnë mësimin nxënësit e kësaj shkolle është ndërtuar prej dekadash, por mirëmbahet vazhdimisht nga Bashkia. Aktualisht shkolla disponon vetëm një fushë sportive në gjëndje të amortizuar, të pasistemuar dhe që nuk i ofron kushtet optimale për zhvillimin normal të orëve të mësimit të edukimit fizik. Shkolla ndodhet në lagjen më të populluar të qytetit, një lagje e cila ka mungesë të theksuar të ambjenteve publike për argëtim.

### *Synimi i projektit*

Ky projekt parashikon krijimin e një qendre multifunksionale sportive për nxënësit dhe stafin e Shkollës Gjergj Fishta. Gjithashtu kjo qendër do t'ju shërbejë dhe banorëve të kësaj lagje, që është relativisht lagja më e vjetër e qytetit. Kjo qendër parashikon krijimin e mundësisë për ushtrimin e shumë sporteve si: futboll, volejboll, basketboll, gjimnastikë etj, dhe do të ofrojë të gjitha kushtet teknike dhe mjedisore për të siguruar shëndetin dhe jetën e përfituesve. Kjo qendër do të inkurajojë një krenari civile dhe të ndihmojnë procesin e rivitalizimit të privuar të zhvillimit të shumë sporteve në shkollat tona, dhe ajo do të plotësojë të gjitha parametrat për funksionim normal të jetës sportive në shkollë.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Rikonstruksioni i qendrës sportive
- Zgjerimi i qendrës sportive

### Rezultatet e pritshme:

- Një qendër sportive e rikonstruktuar dhe e zgjeruar që plotëson të gjitha parametrat për funksionim normal të jetës sportive në shkolla
- Pajisje me mjetet e nevojshme për një proces mësimor normal për lëndën e edukimit fizik
- Rritje e cilësisë së jetës për nxënësit e shkollës dhe banorët e lagjes

### Grupet e synuara:

- Nxënësit e shkollës Gjergj Fishta
- Banorët e lagjes Besëlidhja

### Aktorët e mundshëm:

- Bashkia Lezhë
- Drejtoria Arsimore Rajonale

### Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Bashkia Lezhë

### Produktet:

- Qendra sportive e rikonstruktuar me standarte për zhvillimin optimal të orëve të mësimit dhe jetës sportive në lagje

### Treguesit matës:

- $m^2$ të qendrës sportive
- Numri i frekuentuesve

### Para kushtet:

- Disponimi i hapësirave publike në këtë lagje
- Mbështetje e nxënësve dhe komunitetit për projektin

### Faktorë rrezikues:

- Vështirësi në sigurimin e mirëmbajtjes së qendrës në vazhdimësi
- Mungesa e koordinimit ndërmjet aktorëve

### Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:

| | |
|---|---|
| • Punime gërmimi | 373,301 |
| • Punime beton arme | 975,979 |
| • Punime shtresash dhe mbulese | 6,584,984 |
| • Punime elektrike | 265,287 |
| **Totali:** | **8,199,551 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtoria e Programim Zhvillimit

**Periudha e zbatimit:**
2013 – 2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015

| Nr. | Titulli i Projektit: Sistemimi i përroit të Manatisë në anën e rrugës "Shtraus" | Programi: 27/12.4 Siguria e qytetarëve |
|---|---|---|
| 129 | Objektivi i Strategjisë: 12.4 Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave | Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 45 Nr. i ankesave adresuar Bashkisë, sipas gjinisë, në lidhje me sigurinë e qytetarëve |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Përroi i Grykë - Manatisë që shtrihet në jug të qytetit të Lezhës përgjatë rrugës "Shtraus" që është edhe kufiri jugor i territorit të qytetit të Lezhës. Aktualisht përroi është në gjendje të keqe, duke qenë se nuk ka punime për të mbrojtur tokën nga gërryerjet apo nga hedhja e mbeturinave inerte nga persona të papërgjegjshëm. Sistemimi i këtij përroi do të mundësonte rrjedhë të kontrolluar të ujit që derdhet në lumin Drin, siguri për ndërtesat në anë të lumit si dhe të infrastrukturës rrugore, si dhe mundësi për një pamje më të bukur të zonës, duke shmnagur kështu edhe hedhjen e pakontrolluar të materialeve inerte apo mbetjeve të tjera urbane në përrua.

***Synimi i projektit***

Sistemimi i këtij përroi do të mundësonte rrjedhë të kontrolluar të ujit që derdhet në lumin Drin, siguri për ndërtesat në anë të lumit dhe infrastrukturës rrugore, si dhe mundësi për një pamje më të bukur të zonës, duke shmnagur kështu edhe hedhjen e pakontrolluar të materialeve inerte apo mbetjeve të tjera urbane në përrua.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi i fizibilitetit
- Projekti inxhinierik
- Zbatimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Sistemim i përroit të Grykë Manatisë (3 km)
- Përmirësim i infrastrukturës ambjentaliste
- Mbrojtje nga përmbytjet

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti dhe Biznesi
- Bashkia
- Turistët

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komunat fqinje Kolsh e Shëngjin
- Komuniteti

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti
- Donatorët

**Produktet:**

- Përroi i Grykë -Manatisë kthehet në një rrjedhë uji të sistemuar
- Hapësira të gjelbra të sistemuara për publikun

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e sistemuar
- $m^2$ trotuare
- ml shteg biçikletash
- Nr. i stolave dhe hapësirave për pushim
- $m^2$ sipërfaqe e gjelbër

**Para kushtet:**

- Ka një interes të përbashkët të tre njësive vendore për ta sistemuar këtë rrjedhe uji.
- Qytetarët janë të ndërgjegjësuar për nevojën për sistemim.

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi mes tre njësive vendore.
- Rrjedha të mëdha uji që ndryshojnë shtratin e përroit.
- Mos sigurimi i fondeve.

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 30,779,526 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2016-2018

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2018

| Nr. | Titulli i Projektit: | Programi: 28/13.4 |
|---|---|---|
| | Ngritja e qendrës ditore në lagjen "Skënderbeg" në shërbim edhe të komunitetit Rom dhe Egjyptian | Shërbimet shoqërore efiçente dhe cilësore për njerëzit në nevojë |
| **137** | **Objektivi i Strategjisë: 13.4**<br>Fuqizimi i mundësive të njerëzve në nevojë për shanse të barabarta zhvillimi dhe integrimi në jetën shoqërore dhe komunitare | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 46, 47**<br>% e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike<br>% e grave dhe vajzave në nevojë që marrin shërbime të fuqizimit social |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Të gjendur në varfëri ekstreme, të pashkolluar, në situatë ku e kanë humbur dëshirën për të punuar dhe ndryshuar, komuniteti Rom & Egjyptian sot me sa duket nuk kanë asnjë shpresë. Dhe kjo ka qenë e trashëguar gjithnjë në këtë qytet si edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë dhe Ballkanit. Në qytetin tonë ka 500 anëtarë të komunitetit rom, nga të cilët 120 shkojnë në shkollë fillore, 100 mbarojnë klasën e nëntë, 50 shkojnë në shkollë të mesme, 30 e mbarojnë shkollën e mesme dhe vetëm 1 student universitar.

### *Synimi i projektit*

Ky projekt synon rritjen e cilësisë së jetesës së komunitetit target si dhe afrimin e tyre me komunitetet e tjera duke ndihmuar në integrimin e tyre shoqëror.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Hartimi i projektit teknik
- Zbatimi i projektit
- Hartimi i planit të menaxhimit

### Rezultatet e pritshme:

- Ndërtimi i qendrës ditore.
- Integrimi social i anëtarëve të komunitetit Rom.

### Grupet e synuara:

- Komuniteti Rom
- Komuniteti Egjyptian

### Aktorët e mundshëm:

- Bashkia
- Komuniteti
- Kryqi i kuq
- OJF, etj.

### Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Bashkia
- Biznesi lokal
- Organizmat humanitare
- Donatorë

### Produktet:

- Qendra Ditore për komunitetin Rom & Egjyptian

### Treguesit matës:

- $m^2$ sipërfaqe e përfituar
- Nr. i fëmijëve nëpër grupe

### Para kushtet:

- Bashkia e ka prioritet integrimin social të këtij komuniteti
- OJF dhe komuniteti janë shumë të interesuar për përmirësimin e cilësisë

### Faktorë rrezikues:

- Mungesa e fondeve
- Rreziku që vjen nga diskriminimi pozitiv

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe: Totali: 3,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i mirëqenies sociale dhe rinisë

**Periudha e zbatimit:** 2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:** 2015

| Nr. | Titulli i Projektit: Ngritja e qendrës së moshës së tretë në lagjen “Skënderbeg” | Programi: 28/13.4 Shërbimet shoqërore eficente dhe cilësore për njerëzit në nevojë |
|---|---|---|
| 139 | Objektivi i Strategjisë: 13.4 Fuqizimi i mundësive të njerëzve në nevojë për shanse të barabarta zhvillimi dhe integrim në jetën shoqërore dhe komunitare | Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: 50 % e personave të moshës së tretë që marrin shërbime shoqërore nga Bashkia, sipas gjinisë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Mosha e tretë është një nga shtresat më vulnerabël të shoqërisë së sotme, një shtresë e cila ka nevojë që të ndjehet sërishë aktive, të informohet apo dhe argëtohet. Aktualisht në Lezhë funksionon vetëm një qendër e moshës së tretë dhe ndodhet në lagjen “Besëlidhja”. Personat e moshës së tretë të cilët banojne në lagjen “Skënderbeg” e kanë të vështirë ta aksesojnë këtë qendër pasi ndodhet larg vendbanimit të tyre dhe dihen vështirësitë që kanë këto persona në lëvizje. Një faktor tjetër me rëndësi është që kjo qendër është e strukturuar në mënyrë të tillë që vështirëson praninë e grave dhe ndërtimi i një qendre të re ku dhe gratë të ndihen të përfshira do sillte një përmirësim të dukshëm shërbimeve sociale në qytetin tonë.

***Synimi i projektit***

Projekti synon ngritjen dhe vënien në funksion të qendrës për moshën e tretë në lagjen “Skënderbeg”, duke ndihmuar kështu një nga grupmoshat më vulnerabël të shoqërisë e cila në perspektivë afatgjatë do të ketë shumë më tëpër nevojë për këto qendra.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Ngritja e qendrës
- Sensibilizmi i qytetarëve
- Menaxhimi i qendrës

**Rezultatet e pritshme:**

- Qendër bashkëkohore për moshën e tretë
- Përmirësim i cilësisë së shërbimeve sociale
- Rritje e cilësisë së jetës për personat që përfitojnë drejtpërdrejtë nga projekti.

**Grupet e synuara:**

- Personat e moshës së tretë, banorë të lagjes “Skënderbeg”.
- Komuniteti i Lezhës
- Komuniteti rom dhe egjyptian

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- OJF
- Kryqi i Kuq
- Caritas

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Kryqi i Kuq, Caritas
- Komuniteti
- Donatorë

**Produktet:**

- Qendra për moshën e tretë në lagjen “Skënderbeg”
- Plani i menaxhimit të qendrës

**Treguesit matës:**

- Nr. i frekuentuesve
- $m^2$ sipërfaqe e sistemuar
- Nr. i shërbimeve të ofruara

**Para kushtet:**

- Bashkia Lezhë ka një ekperiencë relativisht të mirë në këtë drejtim, pasi për qendrën aktuale ka nje bashkëpunim shumë të suksesshëm midis institucionit dhe komunitetit.

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi ne kohe i fondeve
- Vështirësi në mirëmbajtjen dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së projektit

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 200,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i mirëqenies sociale dhe rinisë

**Periudha e zbatimit:**
2014-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016

## Qëllimi 5. Mjedisi dhe shërbimet publike

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Ngritja e sistemit për largimin e mbetjeve spitalore dhe të rrezikshme | **Programi: 32/15.5** Infrastruktura dhe teknologjia e menaxhimit të integruar dhe mjedisor të mbetjeve |
|---|---|---|
| **155** | **Objektivi i Strategjisë: 15.5** Menaxhimi i integruar dhe mjedisor i mbetjeve të ngurta urbane në partneritet me komunitetin, biznesin dhe OJF-të | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 58** % e qytetarëve që vlerësojnë qytetin të pastër dhe shumë të pastër, sipas gjinisë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Qyteti i Lezhës është qendra e Qarkut dhe si i tillë ka dy spitale rajonale: Spitalin e Përgjithshëm rajonal në lagjen "Varosh" dhe Spitalin Obstetrik-Gjinekologjik në lagjen "Besëlidhja" gjithashtu ka një qendër shëndetësore dhe katër ambulanca dhe disa klinika private që operojnë në qytet. Duke qenë se mbetjet spitalore kërkojnë trajtim të veçantë atëherë lind nevoja për krijimin e një sistemi që përfshin të gjitha këto institucione duke eliminuar mundësitë që këto mbetje të rrezikojnë jetën e qytetarëve.

Aktualisht nuk ka ndonjë trajtim të veçantë të këtyre mbetjeve nga Spitali i Lezhës (Spitali rajonal dhe Materniteti). Mbetjet nga Departamenti i Sëmundjeve Infektive vazhdojnë të jenë një problem i veçantë.

Realizimi i këtij projekti do të përmirësojë shëndetin publik dhe të mbrojë qytetarët nga shfaqja e sëmundjeve të ndryshme. Riorganizimi i këtij sistemi është i një rëndësie kryesore dhe kjo do të realizohet duke pasur parasysh zhvillimin e planifikuar urban të qytetit.

***Synimi i projektit***

Me këtë projekt parashikohet planifikimi dhe zgjidhja e administrimit të mbetjeve spitalore. Aktualisht nuk ka ndonjë trajtim të veçantë të këtyre mbetjeve nga spitali i Lezhës (Spitali rajonal dhe Materniteti).

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Takime me palët e interesuara
- Identifikimi i nevojave
- Hartimi i planit të menaxhimit
- Instalimi i sistemit në terren

**Rezultatet e pritshme:**

- Eleminimi i rrezikut të madh që shkaktojnë mbetjet
- Rritja e mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve
- Përmirësimi i nivelit të shëndetit publik

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Spitali

**Aktorët e mundshëm:**

- Drejtoria e Shëndetit Publik
- Spitali
- Ministria e Shëndetësisë
- Bashkia

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Spitali
- Ministria e Shëndetësisë
- Bashkia
- Donatorët

**Produktet:**

- Ngrtitja e sistemit të menaxhimit të mbetjeve spitalore

**Treguesit matës:**

- Nr. i qendrave të përfshira në sistem
- Sasia e mbetjeve të mbledhura
- % e mbetjeve të mbledhura

**Para kushtet:**

- Rikonstruksioni i spitalit
- Vend i përshtatshëm për ndërtimin e spitaleve
- Ndërgjegjësimi i punonjësve të këtij sektori

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesë mbështetje financiare

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| • Fushatë sensibilizimi | 50,000 |
| • Përgatitje e detyrës së projektimit | 50,000 |
| • Organizimi i tenderit | 100,000 |
| • Realizimi i projektit | 300,000 |
| **Totali:** | **500,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**
2015-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016

| Nr. | Titulli i Projektit: Ndërtimi i një parkimi nëntoksor | Programi: 37/16.5 Transporti dhe trafiku modern |
|---|---|---|
| 181 | **Objektivi i Strategjisë: 16.5** Ofrimi i shërbimeve publike mjedisore dhe efiçente që mbrojnë jetën, natyrën e biodiversitetin dhe i shtojnë vlerën qytetit | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 68** % e popullsisë që përdor transportin publik |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Shtimi i numrit të automjeteve dhe parkimi i tyre në mënyrë të pakontrolluar po kthehet në një problem shqetësues për qytetin e Lezhës. Rritja në mënyrë progresive e numrit të popullesisë, zgjerimi nga ana hapësinore e qytetit dhe lidhjet me qytetet e mëdha të vendit si Shkodra apo Tirana, që po bëhen gjithnjë e më të konsiderueshme, po e kthejnë nevojën e qytetarëve për automjete në një domosdoshmëri. Kjo shoqërohet me vështirësi për gjetjen e vendeve të parkimit, me parkim të mjeteve në hapësira publike duke sjellë dëmtimin e hapësirave të gjelbra dhe të ambienteve të pushimit dhe argëtimit për qytetarët. Duke analizuar situatën e vend-parkimeve në qytetin e Lezhës, mbështetur në monitorimet e zhvilluara nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, si dhe në rekomandimet e dhëna nga studimi i viabilitetit të vitit 2009, arrijmë në dy përfundime kryesore:

1. Është imediate nevoja e ndërtimit të parkimit, të përshtatshëm për akomodimin e të paktën 300 autoveturave.
2. Ky vend-parkim duhet të jetë në zemër të qytetit, brenda zonës së konturuar nga semafori, stadiumi, ish-grumbullimi dhe ura e vjetër e Drinit. Ky parkim mund të ndërtohet në dy apo tre kate. Në rastin e një parkimi me tre kate, i bie që çdo kat të ofrojë hapësirë për parkimin e 100 autoveturave.

Duke llogaritur përmasat e një vend-qendrimi për autovetura: 2.5 metra x 6 metra = 15 $m^2$, sipërfaqje e nevojshme për çdo autoveturë 100 autovetura x 15 $m^2$ =1500 $m^2$, sipërfaqeje parkimi. Po t'i shtosh kësaj dhe 500 $m^2$ të nevojshme për realizimin e modulacione të qarkullimit, brenda parkimit, sipërfaqja e kërkuar për kat del 2000 $m^2$, ose 2 dynym.

***Synimi i projektit***

Ndërtimi i këtij parkingu nëntokësor do zgjidhë përfundimisht problemin e parkimit të automjeteve në zonën urbane të Lezhës.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi i fizibilitetit
- Ndërtimi i parkingut
- Ndërtimi i hapësirave publike rreth tij

**Rezultatet e pritshme:**

- Krijimi i një numri të madh të vendeve të parkimit
- Shtim i hapësirave të gjelbërta
- Ulje e numrit të makinave të parkuara në mënyrë të pakontrolluar

**Grupet e synuara:**

- Komuniteti
- Bashkia Lezhe
- Policia rrugore

**Aktorët e mundshëm:**

- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Bashkia
- Policia Bashkiake
- Shoqatat e transportit

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Shoqatat e transportit
- Donatorët

**Produktet:**

- Parkingu ndërkombëtar

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe parkimi
- Nr. i posteve për parkim
- $m^2$ sipërfaqe publike

**Para kushtet:**

- Hapësira është e lirë
- Ekziston vullneti politik në nivel lokal
- Ekziston infrastruktura lidhëse

**Faktorë rrezikues:**

- Problemi i strehimit të familjeve që do tu prishen shtëpitë
- Mos kordinimi i veprimeve nga aktorët kryesorë
- Mos sigurimi në kohë i fondeve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 100,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2016

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2018

| Nr. | Titulli i Projektit: Ndërtimi i terminalit për transportin e udhëtarëve, tek stacioni i trenit | Programi: 37/16.5 Transporti dhe trafiku modern |
|---|---|---|
| 182 | **Objektivi i Strategjisë: 16.5** Ofrimi i shërbimeve publike mjedisore dhe efiçente që mbrojnë jetën, natyrën e biodiversitetin dhe i shtojnë vlerën qytetit | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: Nr. 68** % e popullsisë që përdor transportin publik |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Qyteti i Lezhës është një qytet me levizje tepër të theksuara demografike. Duke qenë kryeqendër e qarkut ajo vizitohet çdo ditë nga banorët e rrethinave të cilët kryesisht përdorin mjetet e trasportit publik. Këto mjete kryesisht fugona aktualisht kryejne një lëvizje të pakontrolluar, ndalojnë vend e pa vend dhe krijojnë konfuzion në rrugët e qytetit, duke ngadalësuar dhe bllokuar jo pak herë trafikun hyrës dhe dalës nga Lezha. Bashkia Lezhë shërben si qendër për punësimin, arsimin parauniversitar, shërbimet administrative, kujdesin shëndetësor dhe transportin publik për komunat përreth. Aktualisht linjat e transportit të pasagjerëve, stacionet janë të shtrirë rreth qytetit të Lezhës, shpesh në vende të papërshtatshme, në rrugët: Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Frang Bardhi dhe në kryqezimin tek ura e Lezhës. Duke pasur parasysh se përveç 28 subjekteve të linçensuara në Bashkinë Lezhë kemi dhe 200 subjekte operative të liçensuara nga 8 komunat përreth, tregues për ngarkesën që ata sjellin me trafikun, veçanërisht në qoftë se ne do të shtojmë dhe linjat ndër-urbane në kuadër të Rajonit, për rrethet Kurbin dhe Mirditë (150 subjekte). Terminali Transport përveç minimizimin e lëvizjes së këtyre mjeteve në qendër të qytetit, e cila vuan nga ngarkesa e trafikut, do të sjellë një ndikim pozitiv për komunat, sepse:

- Ajo do të lehtësojë qasjen për qytetarët e Lezhës dhe komunave përreth në stacionin e autobusëve për linjat urbane/ndërurbane, dhe qasje nga stacioni në qytetin e Lezhës.
- Do të shmangë humbjen e kohës për shkak të trafikut në qendër të qytetit.
- Do të lehtësojë linjat urbane dhe lokale të lidhur me linjat ndër-urbane brenda dhe jashtë rrethit.

***Synimi i projektit***

Zhvillimi dhe Promovimi i transportit publik për zhvillim të qëndrueshëm në rajon

1. Zbatimi i një sistemi të kordinuar të transportit publik që ofron një zgjedhje të qëndrueshme të udhëtimit që adreson nevojat e individëve dhe komunitetit në tërësi.
2. Sigurimi i lëvizshmërisë efikase, efektive, miqësore për mjedisin, dhe të sigurt për të gjithë përdoruesit e transportit publik.

Nëpërmjet këtij projekti synohet një integrim i transportit interurban, duke mundësuar kështu organizim më të mirë të këtij transporti dhe përmirësim të qarkullimit në qytet.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studim i fizibilitetit
- Projekti
- Ndërtimi i terminalit
- Monitorimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Sistemim të kordinuar të transportit
- Lëvizshmëri efikase, efektive, miqësore për mjedisin dhe të sigurt për të gjithë përdoruesit e transportit publik
- Aksesi i shpejtë i komunitetit në informacionin e terminalit
- Ulja e rasteve të aksidenteve

**Grupet e synuara:**

- Banorët e Qarkut Lezhë
- Banorët e qytetit Lezhë
- Policia Rrugore
- Shoqatat e transportit

**Aktorët e mundshëm:**

- Ministria Transportit dhe Infrastrukturës
- Bashkia
- Policia Rrugore
- Shoqatat e transportit
- Shoferët
- Komunat përreth Lezhës

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Qarku
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Donatorë të mundshëm

**Produktet:**

- Një terminal i ndërtuar me teknologji bashkëkohore, i ndriçuar, me tabelat përkatëse, i ndarë në stacione, që përmbledh gjithë mjetet e trasportit ndërurban të qytetit në mënyrë të organizuar

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e sistemuar
- Nr. i posteve për nisje
- Nr. i pasagjerëve që përdorin këtë terminal
- Nr. i autobuzëve që përdorin këtë terminal

**Para kushtet:**

- Bashkia është shumë e ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e këtij projekti dhe e konsideron atë të një prioriteti të lartë

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi në kohë i kontributit të nevojshëm.

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 42,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2014-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016-2017

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Plotësimi me standarte i sinjalistikës vertikale për trafikun | **Programi: 37/16.5** Transporti dhe trafiku modern |
|---|---|---|
| **184** | **Objektivi i Strategjisë: 16.5** Ofrimi i shërbimeve publike mjedisore dhe efiçente që mbrojnë jetën, natyrën e biodiversitetin dhe i shtojnë vlerën qytetit | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 69** % e rrugëve kryesore me sinjalistikë moderne dhe të kontrolluar elektronikisht |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Mungesa ose dëmtimi i sinjalistikës vertikale bëhet shpesh shkak për ngadalësim të trafikut, apo dhe aksidente të ndryshme. Në qytetin e Lezhës pjesa më e madhe e tabelave ekzistuese janë amortizuar dhe dëmtuar duke përbërë një problem për qarkullimin normal të automjeteve. Zëvendësimi i tyre, apo edhe shtimi i tabelave të reja aty ku mungojnë është objektivi i këtij projekti. Rritja e numrit të popullsisë në qytetin e Lezhës ka rritur në mënyre progresive edhe numrin e automjeteve që qarkullojnë në rrugë çdo ditë dhe tabelat e reja do ndihmonin mjaft në orientimin e tyre dhe përmirësimin e parametrave të trafikut. Shtimi i tabelave specifike për turizmin dhe hapësirat e parkimit do stimulojë zhvillimin e turizmit në rajon.

***Synimi i projektit***

Pajisjen e qytetit me sinjalistikë vertikale të njëjtësuar në të gjithë qytetin duke përmirësuar kështu parametrat e qarkullimit rrugor duke ndihmuar në uljen e trafikut dhe zvogëlimin e numrit të aksidenteve dhe duke ndihmuar edhe zhvillimin shumë dimensional të qytetit.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Studimi i opsioneve të trafikut
- Hartimi i një harte GIS të sinjalistikës
- Zbatimi

**Rezultatet e pritshme:**

- Vendosje e tabelave të reja dhe zëvendësim i atyre ekzistuese
- Përmirësim i parametrave të qarkullimit rrugor
- Ulje e rasteve të bllokimit të trafikut dhe aksidenteve në rrugë
- Zhvillimi i turizmit në rajon

**Grupet e synuara:**

- Shoqatat e transportit
- Komuniteti
- Biznesi lokal
- Pushteti lokal
- Policia rrugore

**Aktorët e mundshëm:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia
- Komuniteti
- Policia rrugore

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Qeveria qendrore
- Bashkia e Komuniteti
- Universitetet politeknike
- Donatorët

**Produktet:**

- Sinjalistikë e përmirësuar në gjithë qytetin e Lezhës

**Treguesit matës:**

- Nr. i tabelave të vendosura
- % e qytetit e mbuluar me sinjalistikë

**Para kushtet:**

- Bashkëpunim me policinë rrugore

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi i mjeteve financiare në kohë

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 942,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**

**Periudha e pritjes së rezultatit:**

| Nr. | Titulli i Projektit: Vendosja e paneleve të energjisë diellore në godinën e konviktit të shkollës “Kolin Gjoka” | Programi: 41/18.5 Energjia e rinovueshme |
|---|---|---|
| 199 | **Objektivi i Strategjisë: 18.5** Rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe përdorimi me efiçencë i energjisë | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 79, 82** % e energjisë së rinovueshme e përdorur në qytet në krahasim me konsumin total<br>% e energjisë së kursyer në objektet publike që administrohen nga Bashkia, nëpërmjet përdorimit të kërkesave ligjore për kursimin e energjisë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Ky projekt vjen në kuadër të “Programit Shqiptar, pjesë e Iniciativës Globale për Transformimin e Tregut për Përdorimin e Paneleve Diellore për Ujë të Ngrohtë”. Duke qenë se Lezha gjendet në zonën e Mesdheut me dritë diellore përmbi mesataren atëherë shfrytëzimi i kësaj drite kthehet në një mundësi reale për sigurimin e energjisë dhe uljen e kostove të operimit të konviktit dhe po ashtu të çerdhes së qytetit, me synimin që të shtirhet në të gjitha institucionet sipas nevojave. Ky projekt synon instalimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë në konviktin e vajzave të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka” ku aktualisht frekuentohet nga 60-80 vajza të cilat kanë nevoja jetike lidhur me ujin e ngrohtë dhe çerdhen ”Besëlidhja”. Gjithashtu ky projekt synon instalimin e paneleve diellore edhe në çerdhen publike të lagjes “Besëlidhja”, duke eliminuar përdorimin e energjisë elektrike dhe energjinë termike për ngrohjen e ujit.

***Synimi i projektit***

Objektivi kryesor i këtij projekti është promovimi i energjisë diellore si një nga burimet më të fuqishme të energjive të rinovueshme në Shqipëri nëpërmjet mënjanimit të pengesave dhe reduktimit të kostos së zbatimit.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Tenderimi i paisjeve
- Instalimi i paneleve djellore
- Trajnimi i stafit për përdorim
- Mirëmbajtja

**Rezultatet e pritshme:**

- Energjia për ngrohjen e ujit për nevojat e institucioneve sigurohet nga panelet diellore

**Grupet e synuara:**

- Frekuentuesit e konviktit “Kolin Gjoka”
- Frekuentuesit e çerdhes “Besëlidhja”

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- Qarku
- MTKRS

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia dhe Këshilli i Qarkut
- Qeveria Shqiptare
- Donatorë

**Produktet:**

- Sigurimi i energjisë për ngrohjen e ujit nga panelet diellore

**Treguesit matës:**

- $m^3$ ujë i ngrohtë i siguruar nga këto panele
- Nr. kilovat energji të prodhuar
- % e ujit të ngrohtë siguruar nga energjia diellore

**Para kushtet:**

- Shkolla profesionale “Kolin Gjoka” mbetet shkollë rajonale me konvikt
- Palët e interesuara janë dakort për instalimin e paneleve për energjinë diellore në këto institucione

**Faktorë rrezikues:**

- Mos koordinimi i kontributeve të aktorëve
- Mos parashikimi në kohë i fondeve nga institucionet përkatëse

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 375,442.00 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**
2013-2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2014

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Instalimi e ndriçimi LED në 100% të ndriçuesve publik në rrugët ekzistuese të qytetit | **Programi: 42/18.5** Efiçenca e energjisë |
|---|---|---|
| **204** | **Objektivi i Strategjisë: 18.5** Rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe përdorimi me efiçencë i energjisë | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 79, 80, 81** % of energjisë së rinovueshme e përdorur në qytet në krahasim me konsumin total<br>% e ndriçuesve publik në rrugët e qytetit, me kursim energjie<br>% e sipërfaqes publike të qytetit e mbuluar me ndriçim LED |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Lezha është një qytet në rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm, kryeqendër qarku dhe një qytet me potencial të jashtëzakonshëm turistik. Si e tillë ndriçimi i ambjenteve publike të qytetit kthehet në një domosdoshmëri. Pjesa me e madhe e lagjeve të qytetit të Lezhës aktualisht janë të ndriçuara, por teknologjia e përdorur le për të dëshiruar pasi konsumon dhe ndikon në ndotje mjedisore. Ndriçimi nuk është i kënaqshëm dhe kostoja e mirëmbatjes është relativisht e lartë. Ndriçimi LED i qytetit të Lezhës është pjesë përbërëse e të giithë procesit që ka të bëje me zhvillimin e realizimin e sukseshëm të të giitha objektivave strategjike për ketë qytet. Kostot e faturave elektrike që Bashkia paguan për ndriçimin e qytetit janë të larta, dhe ky investim do ketë një kthim tepër të lartë duke konsideruar uljen e ndjeshme të këtyre kostove.

***Synimi i projektit***

Ndriçimi LED lidhet jo vetëm me zhvillimin bashkëkohor infrastrukturor të qytetit, por dhe atë ekonomik, me peisazhin e zhvillimin miqësor me mjedisin. Nëpërmjet këtij projekti synohet të zëvendësohen llambat ekzistuese me llamba të reja të teknologjisë LED, të cilat sigurojnë një ndriçim më të mirë, kursejnë energji në mënyrë të konsiderueshme dhe kanë një jetëgjatësi më të lartë. Ky investim do ketë një kthim tepër të shpejtë duke konsideruar uljen e ndjeshme të kostove.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Identifikimi i nevojave aktuale për ndriçimin e qytetit
- Hartimi i projektit
- Instalimi i ndriçuesve

**Rezultatet e pritshme:**

- Qyteti do jetë i ndriçuar më mirë
- Kostoja e mirëmbajtjes së ndiriçimit të qytetit do jetë ndjeshmërisht me e ulët

**Grupet e synuara:**

- Bashkia
- Komuniteti

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia dhe OJF-të
- Donatorë

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Donatorë

**Produktet:**

- Ndriçim më cilësor i qytetit
- Kosto më e ulët mirëmbajtjeje

**Treguesit matës:**

- Nr. i ndriçuesve LED të instaluar në zonat publike
- % e energjisë e kursyer nga ndriçuesit publik
- Nr. kilovat energji të kursyer

**Para kushtet:**

- Plani për shpërndarjen e ndriçuesve në qytet
- Furnizmi i rregullt me energji elektrike

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesë financimit të mjaftueshëm
- Dëmtimi i llambave nga njerëzit, gjatë zbatimit të projektit

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 7,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike

**Periudha e zbatimit:**
2013-2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016

| Nr. 208 | **Titulli i Projektit:** Efiçenca e energjisë në ndërtesa ekzistuese me bashkëpronësi | **Programi: 42/18.5** Efiçenca e energjisë |
|---|---|---|
| | **Objektivi i Strategjisë: 18.5** Rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe i përdorimit me efiçencë të energjisë | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: 83** % e ndërtesave të rehabilituara të sjellura në nivelet e përdorimit më të ulët të energjisë |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Sektori i banesave është një nga konsumatorët më të mëdhenj të energjisë elektrike të vendit. Referuar statistikave sektori i banesave ka qenë konsumatori më i lartë i energjisë elektrike, duke lënë pas edhe sektorin e shërbimeve. Për vitin 2012, konsumi i energjisë elektrike për familjarët ka qënë 54% e konsumit final të energjisë elektrike. Është përllogaritur që në sezonin e dimrit veprimtaritë që ndikojnë më shumë në konsumin e energjisë elektrike brenda një banese janë ngrohja e hapësirave me 60% dhe ngrohja e ujit me 25%.

### *Synimi i projektit*

Objektivi kryesor i këtij financimi është aplikimi i kërkesave për rinovimin e ndërtesave ekzistuese në bashkëpronësi me qëllim:

- ndërgjegjësimin e përfituesve për funksionimin e asamblesë të bashkëpronarëve sipas kërkesave të ligjit
- reduktimin e humbjeve të energjisë
- rritjen e vlerës së ndërtesës
- përmirësimin e kushteve të jetesës
- rritjen e të ardhurave reale personale
- pjesëmarrja vullnetare e komunitetit gjatë gjithë fazave të projektit për të siguruar qëndrueshmërinë e tij

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Përzgjedhja e banesave
- Hartimi i projektit teknik
- Ndërgjegjësimi i banorëve për përfitimet nga projekti
- Ngritja e asamblesë së bashkëpronarëve në banesat e përzgjedhura
- Rehabilitimi i banesave të përzgjedhura

### Rezultatet e pritshme:

- Përfitues të ndërgjegjësuar për funksionimin e asamblesë së bashkëpronarëve sipas kërkesave të ligjit
- Humbje të energjisë të reduktuara
- Ndërtesë me vlerë të rritur
- Të ardhura personale të rritura
- Komunitet më i ndërgjegjësuar për punë vullnetare

### Grupet e synuara:

- Banorët e pallatit
- Komuniteti qytetar në përgjithësi

### Aktorët e mundshëm:

- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit
- Donatorë
- Bashkia Lezhë
- Asambleja e Bashkëpronarëve
- Komuniteti

### Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit
- Donatorë
- Bashkia Lezhë

### Produktet:

- Tarracë/Çati e termoizoluar
- Dyer dhe dritare sipas standarteve të efiçencës së energjisë
- Ndriçim me llampa efiçente
- Kontroll dhe mirëmenaxhim i konsumit të energjisë

### Treguesit matës:

- Humbja e energjisë

### Para kushtet:

- Vullneti politik i Bashkisë Lezhë
- Vullneti i banorëve për tu përfshirë në projekt

### Faktorë rrezikues:

- Mosgjetja e fondeve

### Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:

| | | |
|---|---|---|
| • Punime prishjeje | | 267,048 |
| • Punime suvatimi dhe shtresash | | 11,411,275 |
| | **Totali:** | **11,678,323 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtoria e Programim Zhvillimit

**Periudha e zbatimit:**
2013

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2014

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Zhvillimi i një serie kursesh trajnimi për të punësuarit në sektorin e turizmit | **Programi: 45/20.6** Infrastruktura e arsimit profesional |
|---|---|---|
| **214** | **Objektivi i Strategjisë: 20.6** Rritja e aftësive dhe kualifikimeve profesionale të fuqisë punëtore që mundëson përfshirje aktive të të dy gjinive në tregun e punës dhe jetën shoqërore të qytetit | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 88, 89, 90** % e punësimit të plotë e sezonal, të njerëzve të çertifikuar nga strukturat e arsimit profesional, sipas gjinisë<br>% e grave dhe vajzave të punësuara nëpërmjet formimit profesional<br>Nr. i grave dhe vajzave që përfitojnë nga programet e trajnimit për përputhjen me nevojat e tregut (aftësimi profesional e punësim aktiv) |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Qyteti i Lezhës është një nga destinacionet kryesorë turistike në Shqipëri. Në Lezhë dhe në zonat rreth saj ekzistojnë një numër i madh njësish shërbimi që operojnë në fushën e turizmit, me një cilësi shërbimi të kënaqshme, por shpesh nuk mungojnë edhe rastet e punës së pakualifikuar.

***Synimi i projektit***

Ky projekt synon krijimin e një qendre trajnimi profesional për punonjësit e sektorit të turizmit. Kjo qendër do të kualifikojë si ata punonjës që aktualisht punojnë në sektorin e turizmit por edhe ato që përgatiten për t'u integruar në këtë sektor. Kurset që do të ofrohen do të jenë për kuzhinierë, kamerierë, hotelierë, recepsionistë, baristë, menaxherë, operatorë të agjencive turistike, udhërrëfyes ose shoqërues grupesh turistike etj. Do të synohet sjellja e njohurive dhe kulturës profesionale bashkëkohore. Kjo qendër do të nxisë edhe hapjen e sipërmarrjeve të reja të vogla e të mesme nëpërmjet nxitjes së shpirtit sipërmarrës dhe të vetëpunësimit.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Identifikimi i nevojave aktuale të sektorit të turizmit
- konsultime me palët e interesuara
- ofrimi i kurseve
- nxitja e krijimit të NVM

**Rezultatet e pritshme:**

- Rritja e cilësisë së shërbimeve dhe kapaciteteve pritëse
- Rritja e ofertës në llojshmërinë e shërbimeve dhe produkteve në sektorin e turizmit
- Rritje e numrit të të punësuarve të rinj
- Rritje e numrit të fluksit të turistëve

**Grupet e synuara:**

- Punonjësit e sektorit të turizmit dhe shërbimeve
- Bizneset që operojnë në sektorin e turizmit dhe shërbimeve
- Investitorët
- Njerëz që mund të punësohen në këto sektorë, kryesisht të rinjtë

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- DHTI
- Shoqatat e hotelerisë dhe restoranteve
- Shkollat profesionale

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- DHTI
- OJF të hotelerisë
- Donatorë të ndryshëm

**Produktet:**

- Punonjës të kualifikuar në sektorin e turizmit
- Shërbime inovatore dhe cilësore për turizmin

**Treguesit matës:**

- Nr. i punonjësve të trajnuar
- Nr. i të trajnuarve të punësuar
- Nr. i NVM të hapura.

**Para kushtet:**

- Tregu i favorshëm turistik
- Evidentimi i nevojës për kualifikim

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesë financimi

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| • Bazë materiale | 50,000 |
| • Paga trajnerësh | 50,000 |
| • Shpenzime operative | 50,000 |
| • Botime | 3,500,000 |
| **Totali:** | **3,650,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
Verë 2015

## Qëllimi 6. Dija dhe zhvillimi njerëzor

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Rehabilitimi i Shkollës “Kolin Gjoka” | **Programi: 45/20.6** Infrastruktura e arsimit profesional |
|---|---|---|
| 216 | **Objektivi i Strategjisë: 20.6** Rritja e aftësive dhe kualifikimeve profesionale të fuqisë punëtore që mundëson përfshirjen aktive të të dy gjinive në tregun e punës dhe jetën shoqërore të qytetit | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 87, 89** % e nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm që ndjekin shkollat e arsimit profesional, sipas gjinisë<br>% e grave dhe vajzave të punësuara nëpërmjet formimit profesional |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Shkolla “Kolin Gjoka” është shkolla kryesore e formimit profesional shtetëror në Qarkun e Lezhës ku numri i nxënësve dhe degët profesinale kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Kjo shkollë frekuentohet nga nxënës nga gjithë Qarku Lezhë. Shkolla aktualisht është në gjendje të amortizuar edhe për shkak se ka kohë që nuk janë kryer investime madhore në të. Për këtë arsye është i nevojshem restaurimi total i ambienteve të kësaj shkolle, duke përfshirë laboratorë të ndryshëm dhe ambientet sportive.

***Synimi i projektit***

Restaurimi dhe modernizimi i shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Punime ndërtimi
- Punime hidraulike
- Punime elektrike
- Mobilim

**Rezultatet e pritshme:**

- Infrastrukturë e mjediseve të brendëshme dhe të jashtme komplet e rinovuar ne funksion të cilësisë së mësimdhënies
- Përmirësimi i imazhit urban të qytetit

**Grupet e synuara:**

- Nxënësit
- Mësuesit
- Komuniteti qytetar
- Komuniteti i qarkut

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- Ministria e Arsimit dhe Sporttit
- Komuniteti i biznesit

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Qeveria e Shqipërisë
- Donatorë (IPA)

**Produktet:**

- Shkolla “Kolin Gjoka” me ambjente të rikonstruktuara, moderne dhe bashkëkohore

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e sistemuar
- Nr. i nxënësve që studiojnë

**Para kushtet:**

- Arsimi profesional rajonal është i rëndësishëm në zinxhirin arsimor
- Investimet në këtë lloj arsimi janë prioritet

**Faktorë rrezikues:**

- Mos sigurimi në kohë i kontributit të nevojshëm financiar

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 35,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2013-2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Rehabilitimi dhe zgjerimi i kopshtit me ushqim në lagjen "Besëlidhja" | **Programi: 47/21.6** Zhvillimi arsimor i fëmijëve parashkollorë me metoda dhe njohuri bashkëkohore |
|---|---|---|
| 222 | **Objektivi i Strategjisë: 21.6** Rritja e cilësisë së dijes dhe standarteve të mësimdhënjes dhe aksesit në arsimin parauniversitar | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 95** % e 5-vjeçarëve që marrin pjesë në arsimin parashkollor, sipas gjinisë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Kopshti "Besëlidhja" është kopshti qendror i qytetit i frekuentuar përgjithësisht nga të gjithë anëtarët e komunitetit qytetar të Lezhës, aktualisht në gjendje jo shumë të mirë për arsye të lagështirës së krijuar dhe të hapësirave të pamjaftueshme për fëmijët që e frekuentojnë. Është i domosdoshëm rikonstruksioni i tij për t'iu përshtatur nevojës në rritje nga komuniteti qytetar dhe për krijimin e kushteve bashkëkohore për fëmijët. Ky projekt është përzgjedhur si prioritet për investimet e vitit 2014 në Bashkinë Lezhë sepse: hapësira ekzistuese e brendshme është e pamjaftueshme për 250 fëmijët që ndodhen aktualisht aty. Mjedisi fizik, tejmase i amortizuar nuk siguron cilësinë e jetës dhe shëndetit për fëmijët që frekuentojnë kopshtin. Siperfaqja e dhomave është jashtë standarteve teknike të vendosura $3m^2$ /fëmijë. Mjedisi i jashtëm është i papërshtashëm për zhvillimin e aktivitetit normal të grupmoshës parashkollore. Ai nuk siguron cilësi dhe siguri për jetën e fëmijëve

***Synimi i projektit***

Me këtë projekt synojmë të ofrojmë hapësirë të brëndshme dhe të jashtme të mjaftueshme sipas standareteve bashkëkohore si dhe të adresojmë kërkesat në rritje të qytetarëve, për të aksesuar këtë shërbim, në funksion të rritjes së cilësisë së jetës dhe zbatimit optimal të kurrikulës mësimore për moshën parashkollore.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Prokurimi
- Realizimi i rindërtimit të kopshtit
- Ndërtimi i mjediseve të brendshme e të jashtme të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të kopshtit
- Supervizimi i punimeve nga specialistë të liçensuar të caktuar nga Bashkia Lezhë sipas kushteve të paracaktuara në kontratë
- Marrja në dorëzim
- Vlerësimi i kënaqësisë së komunitetit për investimin e kryer

**Rezultatet e pritshme:**

- Mjedis i brëndshëm sipas standarteve teknike bashkëkohore për këtë grupmoshë
- 10 dhoma me sip.75 $m^2$
- Akomondim i mjedist te brendshëm në funksion të cilësisë së jetës dhe cilësisë së procesit edukativ
- Mjedis i jashtëm sipas standarteve ligjore

**Grupet e synuara:**

- 250 vogëlushë të regjistruar në kopshtin "Besëlidhja"
- 250 familje të këtyre fëmijëve
- Komuniteti në përgjithësi në lagjen "Besëlidhja"
- Bashkia Lezhë
- Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- Komuniteti
- Donatorë

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia dhe biznesi lokal
- Organizmat humanitare
- Donatorë

**Produktet:**

- Kopësht i rikontsruktuar me hapësira më të mëdha e kushte bashkëkohore

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e përfituar
- Nr. i fëmijëve nëpër grupe

**Para kushtet:**

- Arsimi parashkollor është prioritet i Bashkisë
- OJF dhe komuniteti janë shumë të interesuar për përmirësimin e cilësisë

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesa e fondeve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 84,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2015

| Nr. | Titulli i Projektit: Rehabilitimi i kopshtit në lagjen "Gurrat" | Programi: 47/21.6 Zhvillimi arsimor i fëmijëve parashkollorë me metoda dhe njohuri bashkëkohore |
|---|---|---|
| 227 | **Objektivi i Strategjisë: 21.6** Rritja e cilësisë së dijes dhe standarteve të mësimdhënjes dhe aksesit në arsimin parauniversitar | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 95** % e 5-vjeçarëve që marrin pjesë në arsimin parashkollor, sipas gjinisë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Kopshti "Gurra" është një kopësht në lagjen "Gurra", i vendosur në një godinë relativisht të vjetër. Ky kopësht ka grupe me drekë dhe pa drekë, ka 5 grupe fëmijësh të moshave 3-4; 4-5; 5-6 vjeç me djem dhe vajza në total 139 fëmijë dhe stafin. Aktualisht fëmijët janë në godina të ndryshme në distancë me njëra-tjetrën. Kushtet higjeno-sanitare janë jashtë standaretve teknike, në mjediset e brendshme ka lagështirë, kjo ka ulur kërkesën e banorëve të lagjes për këtë kopsht. Godina rezulton me shumë dëme në bazë materiale dhe në ambietin fizik, ku dhoma e gjumit e këtyre fëmijeve edhe sot nuk është në funksion, për shkak të zjarrit të shkaktuar nga persona të papërgjegjshëm në dhjetor 2013. Grupet pa ushqim janë të vendosur në një godinë të përbashkët me nxënësit e moshës 15-18 vjeç, ku ndajnë të njejtin tualet.

***Synimi i projektit***

Me këtë projekt synojme të ofrojmë hapësirë të brendshme dhe të jashtme të mjaftueshme sipas standareteve bashkëkohore si dhe të adresojme kërkesat në rritje të qytetarëve, për të aksesuar këtë shërbim, në funksion të rritjes së cilësisë së jetës dhe zbatimit optimal të kurrikulës mësimore për moshën parashkollore.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Prokurimi i punimeve
- Rikonstroksion i mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm
- Mobilim (pajisje me bazën e nevojshme materiale)
- Vlerësimi i kënaqësisë së komunitetit për investimin e kryer.

**Rezultatet e pritshme:**

- Krijimi i një mjedisi të brendshëm konform rregullave për jetë të sigurtë e të shëndetëshme
- Krijimi i një mjedisi të jashtëm me parametrat e ligjore për zhvillim normal të procesit mësimor

**Grupet e synuara:**

- Fëmijët dhe stafi
- Komuniteti i lagjes Gurra
- Bashkia Lezhë
- Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- Komuniteti
- OJF

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Biznesi lokal
- Organizmat humanitare, donatorë

**Produktet:**

- Kopësht i rikonstruktuar me hëpësira më të mëdha e kushte bashkëkohore

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e përfituar
- Nr. i fëmijëve nëpër grupe

**Para kushtet:**

- Arsimi parashkollor është prioritet i Bashkisë
- OJF dhe komuniteti janë shumë të interesuar për përmirësimin e cilësisë

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesa e fondeve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 12,600,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2014

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2014

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Rehabilitimi i Shkollës "Gjergj Fishta" | **Programi: 48/21.6** Sistemi arsimor parauniversitar modern dhe me akses të barabartë |
|---|---|---|
| 234 | **Objektivi i Strategjisë: 21.6** Rritja e cilësisë së dijes dhe standarteve të mësimdhënjes dhe aksesit në arsimin parauniversitar | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr. 94, 96, 97** % e nxënësve që vazhdojnë arsimin universitar dhe atë profesional, sipas gjinisë<br>% e nxënësve që mbarojnë shkollën e mesme (kalushmëria), sipas gjinisë<br>Nr. i nxënësve për kompjuter të lidhur në internet |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Infrastruktura në shkollën "Gjergj Fishta" është e amortizuar, pasi nuk i është nënshtruar asnjë rikonstruksioni total për shumë vite. Si rrezultat nxënësit e kësaj shkolle zhvillojnë mësim në kushte jo të favorshme për të qenë efektiv gjatë procesit mësimor-edukativ.
Faza e parë e këtij projekti do të konsistojë në rikonstruksionin e fasades së jashtme dhe në fazën e dytë (verë 2014) do të rikonstrukturohet komplet ambienti i brendshëm.
Gjithashtu parashikohen sistemime dhe gjelbërim dhe në ambientin rrethues, përfshirë këtu dhe zona sportive.

***Synimi i projektit***

Restaurimi dhe modernizimi i shkollës 9-vjeçare "Gjergj Fishta" në funksion të procesit të mësimdhënies dhe cilësisë së jetës.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Punime rehabilitimi, hidraulike dhe elektrike
- Mobilim

**Rezultatet e pritshme:**

- Nxënës të motivuar për të qenë efektiv në procesin mësimor
- Mjedise cilësore të shkollës

**Grupet e synuara:**

- Nxënësit
- Mësuesit

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- Ministria e Arsimit dhe Sportit

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Qeveria e Shqipërisë

**Produktet:**

- Infrastrukture e godinës dhe e mjedisit rrethues me standarte bashkëkohore
- Sipërfaqe e gjelbëruar
- Mjedise sportive

**Treguesit matës:**

- $m^2$ sipërfaqe e klasave të rehabilituara
- $m^2$ sipërfaqe e gjelbëruar
- $m^2$ mjedise sportive të rehabilituara

**Para kushtet:**

- Arsimi 9-vjeçar është i rëndësishëm për komunitetin
- Investimet në këtë lloj arsimi janë prioritet

**Faktorë rrezikues:**

- Mungesa e një ambienti për mësimdhënie ndërkohë që kryhen punimet
- Mos sigurimi në kohë i fondeve

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:** **Totali: 35,000,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

**Periudha e zbatimit:**
2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016

| Nr. | Titulli i Projektit: Informatizimi i bibliotekës së qytetit | Programi: 49/21.6 Dixhitalizimi i shërbimeve të institucioneve të dijes dhe arsimit |
|---|---|---|
| 238 | Objektivi i Strategjisë: 21.6 Rritja e cilësisë së dijes dhe standarteve të mësimdhënjes dhe aksesit në arsimin parauniversitar | Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 94, 96 % e nxënësve që vazhdojnë arsimin universitar dhe atë profesional, sipas gjinisë % e nxënësve që mbarojnë shkollën e mesme (kalushmëria), sipas gjinisë |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Biblioteka e qytetit disponon një fond prej rreth 100,000 libra me mbi 25,000 titujsh, nga të cilët 1,100 i përkasin kryesisht literaturës fetare në gjuhët latinisht, italisht e turqisht etj., 74 prej të cilave inkunabula, që u përkasin botimeve të periudhës para vitit 1830. Biblioteka përfundoi rehabilitimin në vitit 2001 dhe ofron 5 salla leximi me 250 vende dhe 7 punonjës. Aktualisht biblioteka nuk e ka fondin e dixhitalizuar dhe nuk ka pajisje elektonike për këtë proçes.

### *Synimi i projektit*

Përfshirja e Bibliotekës Publike Lezhe në sistemin bibliografik COBBIS.AL, sistem i cili është i vendosur mbi platformën e përbashkët bibliografike rajonale COBBIS.NET, ka të bëjë me krijimin e një katalogu të përbashkët bibliografik lokal Cobbis.Al dhe rajonal Cobbis.Net, në të cilin marrin pjesë katalogues nga biblioteka të ndryshme të përfshira në projekt dhe të pajisur me liçensat përkatëse për katalogim. Ky proçes bën të mundur përpunimin e përbashkët të materialeve bibliotekare. Çdo njësi bibliografike katalogohet vetëm njëherë në një nga vendet pjesëmarrëse dhe më pas kjo njësi mund të shkarkohet nga kataloguesit e bibliotekave të tjera duke e bërë pjesë të bazës të tyre të të dhënave. Nëpërmjet këtij sistemi, bibliotekat kursejnë burime njerëzore, të cilat janë  të nevojshme për katalogim, kohë si dhe shumë pajisje dhe mirëmbajtje të sistemit TIK apo programeve kopjuterike të cilat duhet të jenë në çdo kohë të azhornueshme për të qënë efiçiente.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Kryerja e trajnimeve përkatëse dhe liçensimi i punonjësve për katalogim
- Paisja me teknologjinë TIK të mundësuar nga IZUM

### Rezultatet e pritshme:

- Krijimi i një sistemi katalogimi me të gjitha pajisjet e nevojshme, të cilat do të mundësohen pikërisht nga ky projekt
- Qasje online në fondet e bibliotekës
- Rritja e cilësisë së shërbimeve të bibliotekës

### Grupet e synuara:

- Përdoruesit e bibliotekës brenda dhe jashtë qytetit të Lezhës
- Bibliotekat homologe dhe pjesëmarrëse në projekt në marrëdhëniet e ndryshme ndërbibliotekare

### Aktorët e mundshëm:

- Shoqata e Bibliotekarëve të Shqipërisë
- IZUM (Instituti i Shkencave dhe Informacionit, Maribor, Slloveni)
- Bashkia Lezhë

### Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Shoqata e Bibliotekarëve të Shqipërisë
- IZUM
- Bashkia Lezhë
- Biblioteka Publike Lezhë

### Produktet:

- Dixhitalizimi i bibliotekës
- Akses online në fondet e bibliotekës

### Treguesit matës:

- Nr. i përdoruesve që qasen online në bibliotekë
- Nr. i fondeve të kataloguara elektonikisht

### Para kushtet:

- Akses në internet
- Pajisjet teknologjike për dixhtalizim

### Faktorë rrezikues:

- Aksesi në internet
- Ndërtimi

### Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:

| | |
|---|---|
| Instalim programi (programi, antivirusi dhe instalimi): | 280,000 |
| Mirëmbajtje programi (50 € në muaj për 2 vjet): | 168,000 |
| Kompjutera (2 copë): | 196,000 |
| Printer për etiketa (1 copë): | 18,200 |
| Trjanimet e kataloguesve (2 persona): | 252,000 |
| **Totali:** | **1,828,400 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i Bibliotekës Bashkiake, Lezhë

**Periudha e zbatimit:** 2013

**Periudha e pritjes së rezultatit:** 2014

## Qëllimi 7. Demokracia dhe qeverisja vendore

| Nr. | **Titulli i Projektit:** Rikonstruksioni i sallës së mbledhjeve të këshillit bashkiak dhe instalimi i fonisë dhe regjistrimi me video i mbledhjeve të këshillit bashkiak | **Programi: 52/22.7** Transparenca dhe llogaridhënia e qeverisë bashkiake |
|---|---|---|
| 251 | **Objektivi i Strategjisë: 22.7** Modernizimi i politikëbërjes dhe rritja e cilësisë dhe efiçencës së ekzekutivit bashkiak për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm të Bashkisë dhe ofrimin e shërbimeve me standarte evropiane | **Treguesi Matës i Objekivit të Strategjisë: nr. 106, 98** Nr. i raporteve të transparencës dhe llogaridhënjes bashkiake të publikuara nga Bashkia<br>% e banorëve që vlerësojnë mirë dhe shumë mirë cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike, sipas gjinisë |

**Përshkrim i shkurtër i projektit**

***Situata***

Sfidat e zhvillimit kanë ndikuar që bota të përparojë mjaft dhe njerëzit të kërkojnë zbatimin e teknologjive të fundit në jetën e përditshme. Aktualisht salla e këshillit bashkiak nuk ofron kushte as fizike dhe as teknologji per të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetrave në takime. Medja ka të vështirë për të reflektuar transparencën e takimeve sepse sistemi audio mungon totalisht. Nevoja për transparencë në shërbimet që ofron Bashkia si dhe një qasje sa më e integruar ndaj këtyre shërbimeve nga ana e qytetarëve janë baza për rikonstruksionin e sallës së mbledhjeve në Bashki në kuadër të rikonstruksionit total të ambientve të punës dhe përshtatjes me teknologji të re. Kërkesa për shpejtësi, saktësi dhe efikasitet në ofrimin e informacionit e bën akoma më të nevojshëm përdorimin e teknologjive të reja. Duke dëshiruar një vendimmarrje sa më transparente dhe një mundësim të qytetarëve për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit jo vetëm fizike, por edhe elektronikisht, atëherë lind nevoja për përshtatjen e ambienteve sipas kërkesave të reja.

***Synimi i projektit***

Rikonstruksioni fizik i sallës së mbledhjeve dhe pajisja me një sistem audio-video bashkëkohor për të rritur performancën dhe ndihmuar transparencën.

***Aktivitete kyçe të projektit:***

- Punime ndërtimi dhe elektrike
- Pajisja me bazën materiale audio-video

**Rezultatet e pritshme:**

- Sallë moderne mbledhjesh e pajisur me teknologjinë moderne audio-video

**Grupet e synuara:**

- Qytetatrët
- Këshilli bashkiak e punonjësit e Bashkisë

**Aktorët e mundshëm:**

- Bashkia
- OJF

**Kontribuesit e mundshëm në projekt:**

- Bashkia
- Donatorë

**Produktet:**

- Sallë moderne mbledhjesh e pajisur me sistem audio-video moderne

**Treguesit matës:**

- Nr. i mbledhjeve të këshllit të regjistruara dhe transmetuara në faqen e internetit
- Nr. i qytetarëve që marrin pjesë në mbledhjet e këshillit

**Para kushtet:**

- Drejtuesit e Bashkisë janë të angazhuar për caktuar mjediset e nevojshme për projektin.
- Këshilli i Bashkisë është i angazhuar të financojë mirëmbajtjen e sistemit të regjistrimit

**Faktorë rrezikues:**

- Mosalokimi i fondeve të nevojshme nga këshilli i Bashkisë

**Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:**

| | |
|---|---|
| • Punime rehabilitimi | 10,000,000 |
| • Paisje audio-video | 5,000,000 |
| **Totali** | **15,000,000 Lekë** |

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtoria planifikimit dhe zhvillimit të territorit

**Periudha e zbatimit:**
2015

**Periudha e pritjes së rezultatit:**
2016 e në vazhdim

| Nr. 259 | Titulli i Projektit: Ngritja e Zyrës me “Një Ndalesë” (Z1N) dhe instalimi i moduleve të e-qeverisjes | Programi: 53/23.7 Qeverisja elektronike |
|---|---|---|
| | **Objektivi i Strategjisë: 23.7** Ngritja dhe përparimi inovator i qeverisjes inteligjente e elektronike bashkiake që garanton shërbime cilësore dhe ndërveprim aktiv e domokratik me qytetarët dhe bizneset | **Treguesi Matës i Objektivit të Strategjisë: nr.109** %. i të rinjëve, sipas gjinisë, që shërbehen nga Zyra me “Një Ndalesë” në Bashki |

## Përshkrim i shkurtër i projektit

### *Situata*

Z1N, do të përmirësojë informacionin dhe komunikimin e qeverisë bashkiake me qytetarët, bizneset dhe vizitorët e saj, duke përmirësuar kështu demokracinë vendore, transparencën, efikasitetin dhe efektivitetin e administratës së Bashkisë në ofrimin e shërbimit dhe aspektin tërheqës të Bashkisë. Nëpërmjet Z1N qytetarët, bizneset dhe vizitorët mund të marrin brenda kohës më të shkurtër të mundshme, në një vend, shumicën e informacioneve administrative dhe informacione të tjera, si dhe dokumentet/lejet, nga një staf i cili përqëndron punën e tij tek qytetari dhe është i mirë kualifikuar. Nga ana tjetër, Z1N do të kombinohet me mekanizma të reja dhe moderne për reagimet e kërkesave e qytetarëve, si dhe konsultimet me to. Z1N mund të përshkruhet si një vend ku pranohen kërkesat, ankesat dhe aplikimet për shërbimet e ndryshme të konsumatorëve, e përpunohen (duke ju adresuar më tej zyrave prodhuese për të ndjekur procedurat e duhura administrative brenda zyrës përkatëse të shërbimit) dhe i kthehen më pas tek konsumatori.

### *Synimi i projektit*

Ky projekt synon instalimin dhe përdorimin e sistemeve elektronike për kompjuterizimin e proceseve të punës së administratës së Bashkisë Lezhë duke përdorur module të posaçme elektronike, familjarizimin me to dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Qëllimi i përdorimit të moduleve është informatizimi i procesit të dokumentimit dhe procesimit të kërkesë-ankesave për Bashkinë dhe informacion për vendimmarrjen e Bashkisë dhe përdorimi i tyre në intranetin e institucionit. ky projekt do të shoqërohet edhe me trajnimin e nevojshëm të stafit të Bashkisë për përdorimin e këtyre moduleve si dhe me informacionion për qytetarët lidhur me mundësitë që ofron ky model i ri qeverisje.

### *Aktivitete kyçe të projektit:*

- Punime rehabilitimi, elektrike dhe intraneti
- Pajisja me bazën materiale
- Hartimi i planit të menaxhimit dhe asistenca për ngritjen e zyrës
- Blerja e paisjeve të infrastrukturës elektronike
- Blerja dhe instalimi i moduleve
- Trajnimi i stafit

### Rezultatet e pritshme:

- Shërbimi ndaj qytetarëve kryhet më shpejt, me një efikasitet të lartë
- Punonjësit e Bashkisë përdorin modulet

### Grupet e synuara:

- Bashkia Lezhë;
- Komuniteti qytetar
- Komuniteti i biznesit

### Aktorët e mundshëm:

- Bashkia Lezhë
- OJF

### Kontribuesit e mundshëm në projekt:

- Bashkia, DLDP
- Donatorë të tjerë

### Produktet:

- Ofrimi i shërbimeve në kohë më të shpejtë dhe në cilësi më të mirë nëpërmjet përdorimit të moduleve elektronike.
- Staf i kualifikuar i Bashkisë

### Treguesit matës:

- Nr. i punojësve të trajnuar
- Nr. i shërbimeve që ofron zyra
- Nr. i qytetarëve që e përdorin këtë zyrë

### Para kushtet:

- Drejtuesit e lartë të Bashkisë janë të angazhuar për të mbështetur reformën dhe alokimin e burimeve të nevojshme

### Faktorë rrezikues:

- Mos alokimi i fondeve të nevojshme
- Mos angazhimi i plotë i punojësve

### Shpenzimet e llogaritura sipas aktiviteteve kyçe:

- Faza I — 2,000,000
- Faza II — 1,200,000

**Totali: 3,200,000 Lekë**

**Personi i kontaktit për projektin:** Drejtori i zhvillimit, arsimit, kulturës, turizmit, sportit

### Periudha e zbatimit:

2013-2014

### Periudha e pritjes së rezultatit:

2014





# 6 SHTOJCAT

**Shtojca 1:** Lista e shkurtimeve

**Shtojca 2:** Raporti mbi vrojtimin e mjedisit të favorshëm për biznesin vendor

**Shtojca 3:** Lista e anëtarëve të Këshillit të Partneritetit për Zhvillimin Strategjik të Lezhës

**Shtojca 4:** Urdhër i Kryetarit të Bashksë për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm për Bashkinë Lezhë

**Shtojca 5:** Vendimi i Këshillit Bashkiak Lezhë për miratimin e Këshillit të Partneritetit për hartimin e Planit Strategjik të Bashkisë

**Shtojca 6:** Vendimi i Këshillit Bashkiak Lezhë për miratimin e Matricës dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë, 2013-2030

# **Shtojca 1:** Lista e Shkurtimeve

| | |
|---|---|
| BE | Bashkimi Evropian |
| DELTA | Drejtimi i Ekonomisë Lokale përmes Teknikave dhe Aleancave |
| DHTU | Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë, Lezhë |
| FLAG | Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje |
| IZUM | Instituti i Shkencave dhe Informacionit, Maribor, Slloveni |
| KPZhSQ | Këshilli i Partneritetit për Zhvillim Strategjik të Qëndrueshëm |
| LGI | Instituti për Qeverinë Vendore, Budapest |
| OJF | Organizata Jo Fitimprurëse |
| PNU | Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara |
| PNUD | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| PMM | Plani i Menaxhimit të Mbetjeve, Bashkia Lezhë |
| REC | Agjencia Rajonale e Mjedisit |
| SWOT | Analiza e Pikave të Forta, të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve |
| TIK | Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit |
| ZHEV | Zhvillimi Ekonomik Vendor |

# Shtojca 2:

## Raporti mbi vrojtimin e mjedisit të favorshëm për biznesin vendor, njohuritë për planet strategjike dhe vlerësimin e vënies në jetë të objektivave të zhvillimit strategjik.

### Hyrje

Më prill-maj 2010, në Lezhë, u ndërmorr një vëzhgim për vlerësimin e perceptimit që sipërmarrjet e zonës kishin për mjedisin në të cilin punojnë. Veç kësaj, u vlerësua edhe njohuria që kishin për ekzistencën dhe perceptimin e efektit potencial të Planit Strategjik. Vëzhgimi synonte edhe që të mundësonte krahasimin mes mjedisit të sipërmarrjes në vitet 2005 dhe 2010; po ashtu, kërkon të japë informacion thelbësor cilësor për t'ia shtuar vlerësimit sasior, tashmë të kryer për Planin Strategjik të Zhvillimit Ekonomik Vendor të bashkisë.

Raporti vijues paraqet një analizë të përmbledhur të gjetjeve kryesore të vëzhgimit. Veç kësaj, është përfshirë një raport më i gjerë, në të cilin bëhet krahasimi i performancës së pesë bashkive që marrin pjesë në projektin DELTA. Të dhënat e vëzhgimit mund të gjenden dhe elektronikisht, çka u jep mundësi bashkive që të bëjnë analiza të mëtejshme sipas nevojave të tyre.

Vëzhgimi, që u analizua nga Dr. Iain Wilson, u krye në bashkëpunim të ngushtë me z. Pjetër Kola, drejtor kabineti i kryebashkiakut, me ndihmën e ekspertëve të FLAG-ut, z. Erind Kraja dhe z. Arben Kashahu, si dhe vëzhguesit z. Altin Vathaj, znj. Faustina Kola, z. Eduard Koca dhe znj. Frida Prendi.

### Përshkrim statistikor i modeleve të sipërmarrjeve të intervistuara

U intervistuan gjashtëdhjetë e tre sipërmarrje që veprojnë në Lezhë, që përfaqësojnë rreth 6% të 954 sipërmarrjeve të regjistruara në bashki.

U mblodhën opinione nga përfaqësuesit e sipërmarrjeve që vijojnë: pronar në 58 sipërmarrje (92% e numrit gjithsej) dhe administrator në pesë sipërmarrje (8%). (P.1)

Njëzet e pesë (40%) e sipërmarrjeve u përfshinë në ofrim shërbimesh, 21 (33%) në tregti, dymbëdhjetë (19%) në prodhim dhe katër (6%) në ndërtim; vetëm një ishte sipërmarrje tregtare dhe bar-kafe. (P.2)

Pesëdhjetë e gjashtë (89%) e 63 sipërmarrjeve kishin një pronar. (P.3)

Kohëzgjatja e aktivitetit të sipërmarrjeve varionte nga dy në nëntëmbëdhjetë vjet, ku 60 për qind ishin aktivë prej dhjetë a më shumë vitesh. (P.5)

Sa i përket kufizimit të sipërmarrjes në qytet, dyzet e katër (70%) sipërmarrje e kishin nga tre të katërtat në gjithsej, 12 (19%) mes gjysëm dhe treçerek, pesë (8%) mes çerek dhe gjysmë, dhe dy (3%) çerek apo më pak. (P.6)

Nëntë sipërmarrje (14%) zhvillonin diku mes çerekut dhe gjysmës së sipërmarrjes së tyre jashtë qytetit, por diku në rajon. Pesë sipërmarrje (8%) e shtrinin çerekun ose më pak të aktivitetit të tyre diku në Shqipëri dhe një (2%) mes çerekut dhe gjysmës, ndërsa një sipërmarrje kryente 90 për

qind të veprimtarisë jashtë vendit (ku pjesa tjetër kryhej diku në Shqipëri, por jashtë qytetit). (P.6)

Dyzet e nëntë sipërmarrje (78%) raportuan që kishin pesë apo më pak të punësuar, tetë kishin tetë deri në dhjetë të punësuar, katër kishin nga njëmbëdhjetë në 50, një kishte nga 51 në 200 dhe një kishte më shumë se 200 të punësuar. (P.7)

## Gjetjet kryesore për klimën e sipërmarrjes në Lezhë

- Gjashtëdhjetë e tre për qind e sipërmarrjeve raportuan që e kishin të vështirë të gjenin punëtorë të kualifikuar, ndërsa vetëm 29 për qind raportuan të kundërtën. (P.9)
- Pesëdhjetë e një për qind raportuan që kishin mungesa në punëtorë të aftë teknikisht, 40 për qind për staf me aftësi për shitje dhe marketing, 32 për qind për aftësi në kompjuter dhe administrim, 21 për qind për punëtorë që ofronin shërbim cilësor, dhe 17 për qind kishin vështirësi të gjenin financierë. Disa ankoheshin për vështirësi (apo nevojë) për të gjetur personel me aftësi në financë ose buxhetim. Një sipërmarrje kërkonte gazetarë të mirë, një kërkonte një specialist komunikimesh, një kërkonte thjesht staf të besuar dhe një kërkonte personel të trainuar. (P.10)
- Shtatëdhjetë e tetë për qind raportuan që konkurenca kryesore ishte vendore, ndërsa 38 për qind mendonin që sipërmarrjet kombëtare dhe importet përbënin konkurentin kryesor. (P.11)
- Shtatëdhjetë për qind mendonin që shoqatat e biznesit mund të ndihmonin sipërmarrjen e tyre, ndërsa 25 për qind mendonin që ato nuk mund të ndihmonin. (P.12)
- Një e treta e sipërmarrjeve mundën të përmendnin një shoqatë (si psh., Dhoma e Tregtisë) që mund të ndihmonin, ndërsa 30 për qind nuk e dinin, dhe 13 për qind u përgjigjën ‘asnjë’. Shtatëmbëdhjetë për qind nuk iu përgjigjën pyetjes, ndërsa tre thanë që s’kishin marrë ndonjë ndihmë; një përmendi një shoqatë dhe një tjetër specifikoi që nuk kishte shoqatë në fushën e veprimtarisë së tyre. (P.13)
- Faktorët kryesorë që shiheshin si pengesa të shtrirjes së sipërmarrjes ishin konkurenca e pandershme (30%), kriza e sotme ekonomike (34%) dhe taksat e larta (14%). Të njëjtët faktorë u regjistruan edhe si faktorët më kryesorë dytësorë me përkatësisht, 22, 14 dhe 11 për qind. (P.15)
- Gjashtëdhjetë e katër për qind e sipërmarrjeve raportuan që u duheshin më pak se dhjetë ditë për të përtëritur liçencat e tyre, dhjetë për qind deri në një muaj dhe tetë për qind deri në muaj. Shumica (67%) e quanin kohën që kërkohej të pranueshme, vetëm 24 për qind e mendonin tepër të gjatë. Nga ata që e shihnin kohën që duhej si tepër të gjatë (15), dhjetë mendonin që duheshin shtatë ose më pak ditë dhe tetë ose më pak ditë. (P.16)
- Tri problemet kryesore që sipërmarrjet hasnin në lidhjet me qeverinë vendore ishin korrupsioni dhe praktikat e paligjshme (56%), konkurenca e parregulluar nga sektori informal (44%) dhe përdorimi i pushtetit të bashkisë për konkurencë të pandershme (40%). Në fakt, tërë këto aspekte përbënin të paktën një problem të moderuar për të paktën 60 për qind të sipërmarrjeve. (P.17)
- Një e katërta e sipërmarrjeve raportuan që ishin inspektuar një a dy herë nga autoritetet e taksave, ndërsa gjysma ishte inspektuar deri në pesë herë. Njëri raportoi që ishte

inspektuar 30 herë. Një e treta e sipërmarrjeve raportuan që ishin inspektuar më pak se tre herë nga inspektorët e shëndetsisë, një e treta deri në pesë herë nga policia bashkiake. Në përgjithësi, shumica e kontrolleve ishin rutinë, ndaj quheshin të pranueshme nga sipërmarrjet. Dhjetë për qind e sipërmarrjeve raportuan që kishin paguar gjobë (të gjitha për autoritetet e taksave, që varionin nga 10,000 në 100,000 lekë) por askush nuk raportoi për dhënie mite. Trembëdhjetë për qind mendonin që kontrolli nga autoritetet mjedisore nuk ishte i zbatueshëm. (P.20)

- Sa u përket faktorëve që pengojnë rritjen dhe funksionimin e biznesit, në lidhje me infrastrukturën, 71 për qind e të intervistuarve tregonin rrugët dhe 48 për qind tregonin mjediset e sipërmarrjes ose tokën si problem i madh ose shumë i madh. Përkundrazi, përkatësisht 72, 71 dhe 62 për qind, mendonin që hekurudha, aksesi në aeroport ose në port nuk luanin asnjë rol. Sa u përket shërbimeve publike, diku mes 70 dhe 86 për qind e sipërmarrjeve mendonin që administrata fiskale, organet që lëshojnë liçencë e leje, ndërmarrjet e furnizimit me energji dhe ujë dhe largimit të mbeturinave, dhe dy të tretat zjarrfikësit, ishin të rëndësishme ose mjaft të rëndësishme, ndërsa diku mes gjysmës dhe një të tretës mendonin që telekomunikimet, mbrojtja policore dhe rregullat e planifikimit dhe zonimit ose nuk kishin rëndësi ose përbënin një problem të vogël. Sa i përket cilësisë së jetesës që lidhet me zhvillimin e biznesit, përkatësisht 94 për qind, 71 për qind dhe 63 për qind, mendonin që niveli i taksave, kostot e telekomunikimit dhe sistemi arsimor ishin faktorë madhorë. Përkundrazi, mes 58 dhe 73 për qind e sipërmarrjeve mendonin që faktorë të tjerë (kujdesi shëndetsor, lehtësitë hoteliere dhe ato për konferenca, siguria, kostoja e strehimit dhe mjediset argëtuese), kishin aspak, pak ose efekt të moderuar. Ndër faktorët e tjerë, (në rend zbritës për nga rëndësia), diku mes 50 dhe 84 për qind shikonin qëndrimin e qeverisë vendore, korrupsionin, disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse, mungesën e personelit të kualifikuar, aksesin në financim dhe dogana dhe rregulloret e tregtisë që kanë efekt të madh. (P.21)
- Gjashtëdhjetë e dy për qind mendonin që ndërtimi, ndërsa njëmbëdhjetë për qind mendonin që turizmi ishin sektorët me rritje më të shpejtë në bashkësinë e tyre. Tridhjetë për qind mendonin që shërbimet, 16 për qind ndërtimi, 14 për qind tregtia dhe dhjetë për qind turizmi ishin sektorët e dytë me rritje më të shpejtë; 20 për qind nuk jepnin përgjigje. (P.29)
- Tridhjetë për qind mendonin që tregtia ka rënë më shumë, 16 për qind bujqësia, dhjetë për qind prodhimi, ndërsa 22 për qind nuk u përgjigjën ose nuk e dinin. (P.30)
- Dyzet e tetë për qind mendonin që vendndodhja gjeografike e Lezhës përbënte tiparin më tërheqës, e ndjekur nga potenciali turistik (19%) dhe natyra (13%). Tipari i dytë më i përmendur ishte sërish vendndodhja (19%), ndjekur nga natyra (14%), potenciali turistik (13%) dhe siguria (10%). (P.31)
- Dyzet për qind mendonin që infrastruktura e varfër dhe investimet ishin tipari më i keq në mbështetje të sipërmarrjes në Lezhë, ndjekur nga kriza ekonomike që vijon (13%) dhe konkurenca e pandershme (11%). Dobësitë e dyta më kryesore të përmendura ishin infrastruktura (24%), konkurenca e pandershme dhe administrata publike (11% secila). (P.32)
- Pesëdhjetë e nëntë për qind e sipërmarrjeve raportuan që mjedisi i biznesit është përmirësuar në tre vitet e fundit, ndërsa njëmbëdhjetë për qind mendonin që ishte përkeqësuar. (P.33)

- Dyzet e një për qind sugjeruan se si mund të përmirësohej zhvillimi ekonomik i Lezhës (si punësimi i më shumë njerëzve, punë më e zellshme, rritje e shitjeve, dhe disa që thonin që do e bënin mjedisin e sipërmarrjes së tyre më tërheqës si mjet për të mirësuar), ndonëse 44 për qind iu gjegjën pyetjes sikur të ishin ndonjë zyrtar bashkiak, të themi kryetari i bashkisë (d.t.th., ç'do të bënin ata nëse do të ishin kryebashkiak: më e zakonshmja, do përmirësonin infrastrukturën dhe do ulnin taksat). Pesëmbëdhjetë për qind ose nuk u përgjigjën ose nuk dinin se ç'do të bënin. (P.34)
- Pesëdhjetë e pesë për qind mendonin që ekonomia ka treguar rritje të moderuar ose të ngadaltë në këto pesë vjet, ndërsa 24 për qind mendonin që ka pësuar rënie modeste. Dhjetë për qind mendonin që kishte rënë ndjeshëm. (P.35)

## Pritshmëritë e sipërmarrjeve

- Njëzet e shtatë për qind e sipërmarrjeve raportuan që do e zgjeronin biznesin brenda bashkisë, ndërsa 21 për qind kishin ndërmend të zgjeroheshin jashtë bashkisë. Pesëdhjetë e dy për qind raportuan që nuk planifikonin të zgjeronin aktivitetin. (P.8)
- Pesëdhjetë e një për qind e sipërmarrjeve thanë që do të investonin po në biznesin e tyre, katërmbëdhjetë për qind u përgjigjën që nuk do investonin dhe gjashtë për qind nuk e dinin, ndërsa dhjetë (ose 16%) do të investonin në aktivitet tjetër (4 në turizëm, 3 në tregti, 2 në prodhim, dhe një në ndërtim). (P.14)
- Tre pritshmëritë më të përmendura ishin konkurenca e ndershme (37%), taksa të ulura (24%), dhe infrastruktura e përmirësuar (13%). Këto pritshmëri ishin gjithashtu të dytat më të përmendura me 22, 17 dhe 13 për qind. (P.18)
- Tre faktorët e parë më të përmendur për ndihmën që bashkia mund t'i jepte një sipërmarrjeje ishin infrastruktura e përmirësuar (47%), ofrimi i nxitësve përmes politikave të taksave vendore (35%) dhe procedurat e përmirësuara (15%). Më të përmendurat në radhë të dytë ishin ofrimi i informacionit dhe infrastruktura e përmirësuar (25% secila). Më e fundit në listë ishte ofrimi i trainimeve për bizneset (në krye të listës për 3%, dhe e fundit në listë për 21% të bizneseve). (P.19)

## Njohuritë që sipërmarrjet kanë për funksionet e bashkisë

- Pesëdhjetë e gjashtë për qind e sipërmarrjeve raportuan që nuk e dinin për rolin e zyrës ZHEV; 61 për qind thanë të njëjtën gjë për zyrën e ZHER. (P.22)
- Tridhjetë e tetë për qind e sipërmarrjeve raportuan që nuk e dinin për shoqatat vendore profesionale apo për rolin që ato luajnë. (P.22)
- Pesëdhjetë e katër për qind e sipërmarrjeve raportuan që qeveria vendore ofronte mbështetje të mirë ose mjaft të mirë për sipërmarrjet vendore. Në të vërtetë, 83 për qind mendonin që niveli qe i pranueshëm ose më i mirë; këtë e mendonin 52 për qind për mbështetjen nga shërbimet profesionale private. Afro një e treta e sipërmarrjeve mendonin që mbështetja nga shoqatat e biznesit dhe ato profesionale nuk qe e mirë, ndërsa rreth 40 për qind nuk dinin gjë për nivelin e mbështetjes nga organizma ndërkombëtare apo OJF. Diku 17 për qind mendonin që çdo lloj mbështetje e tillë qe pa lidhje. (P.22)

- Nëse përkatësisht 84, 70, 90 dhe 63 për qind mendonin që kryetari i bashkisë, këshilli bashkiak, zyra e taksave dhe financës në bashki dhe drejtoria rajonale e taksave kishin qenë mbështetës, 67, 49, 73 dhe 38 për qind përkatësisht, mendonin që ato kishin qenë mjaft mbështetëse. Përkundrazi, 54 dhe 49 për qind nuk dinin gjë për mbështetje nga zyra e ZHEV dhe prefektura ose e shihnin si pa lidhje. (P.23)
- Pesëdhjetë e katër për qind mendonin që zyrat e financës dhe taksave kishin ndikuar për mirë në sipërmarrjen e tyre, ndërsa 13 për qind shënuan 'asnjë'. (P.24)
- Dyzet e një për qind e sipërmarrjeve raportuan që asnjë drejtori e bashkisë s'kishte penguar aktivitetin e tyre; njëmbëdhjetë për qind thonin që pengesë ishte zyra e taksave. Tridhjetë për qind nuk iu përgjigjën pyetjes. (P.25)
- Sa i përket pyetjes se cila drejtori kishte të bënte me zhvillimin ekonomik vendor, pesëdhjetë e shtatë për qind e sipërmarrjeve nuk e dinin, nuk u përgjigjën ose shënuan 'asnjë'. Një e katërta shënuan zyrën e ZHEV, ndërsa 14 për qind mendonin që ishte zyra e taksave ose financës. (P.26)
- Gjashtëdhjetë për qind e sipërmarrjeve mendonin që bashkia ishte grupi më veprues në promovimin e zhvillimit ekonomik vendor, trembëdhjetë për qind thonin për biznesin privat dhe pesë për qind për partneritetin publik-privat; 17 për qind nuk e dinin. (P.27)
- Afro një në katër sipërmarrje mendonin që veprimtaritë për zhvillim ekonomik vendor ishin funksion i decentralizuar që kryhej nga disa drejtori në bashki, trembëdhjetë për qind mendonin që kontrollohej tërësisht nga një drejtori në bashki dhe katërmbëdhjetë për qind nga zyra e kryetarit të bashkisë. Tridhjetë e tetë për qind nuk e dinin. (P.28)

## Njohuritë e bizneseve për Planin Strategjik të Lezhës për Zhvillim Ekonomik

Tabela që vijon paraqet përqindjet e përgjigjeve për pyetjet në lidhje me objektiva specifike të Planit Strategjik. Përgjigja më e zakontë jepet e nxirë dhe e theksuar me të gjelbër:

| Nr | Pyetje | Po | Jo | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|
| 36 | A ka planifikim për zhvillimin e potencialit të turizmit në Lezhë? | 56 | 11 | 33 |
| 37 | A ka planifikim për promovimin e potencialit të turizmit në Lezhë? | 43 | 13 | 44 |
| 38 | A janë në funksionim qendrat turistike apo arkeologjike? | 41 | 32 | 27 |
| 39 | A janë ekspozuar objekte arkeologjike? | 40 | 27 | 33 |
| 40 | A është rritur numri i sipërmarrjeve që mbështesin turizmin në Lezhë? | 57 | 13 | 29 |
| 41 | A është rritur numri i sipërmarrjeve vendore? | 73 | 11 | 16 |
| 42 | A është krijuar ndonjë mjedis stimulues për partneritete të qëndrueshme mes palëve të interesuara aktive? | 11 | 30 | 59 |

| Nr | Pyetje | Po | Jo | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|
| 43 | A janë hartuar plane afatgjata të zhvillimit urban në Lezhë? | 38 | 10 | 52 |
| 44 | A ka planifikim për infrastrukturën bazë? | 41 | 14 | 44 |
| 45 | A është përmirësuar infrastruktura rrugore? | 49 | 49 | 2 |
| 46 | A janë përmirësuar mjediset publike në qytet? | 81 | 17 | 2 |
| 47 | A ka përmirësime në cilësinë e shëndetit publik? | 54 | 30 | 16 |
| 48 | A janë përfshirë qytetarët në përmirësimin e shëndetit publik? | 35 | 35 | 29 |

Në përgjithësi, shumica e sipërmarrjeve mendonin që pesë nga trembëdhjetë objektivat ishin përmbushur-që zhvillimi i potencialit të turizmit në Lezhë ishte planifikuar (P.36), që numri i sipërmarrjeve që mbështetnin përmirësimin e turizmit vendor ishte rritur (P.40), që numri i sipërmarrjeve vendore ishte rritur (P.41), që mjediset publike në qytet ishin përmirësuar (P.46) dhe që cilësia e shëndetit publik ishte përmirësuar (P.47). Kishte pasiguri të lartë për krijimin e mjedisit të partneritetit (P.42) dhe hartimin e planeve të zhvillimit urban (P.43), dhe dyvlershmëri për promovimin e potencialit turistik (P.37), për vënien në funksionim të qendrave turistike (P.38) dhe ekspozimin e objekteve arkeologjike (P.39), planifikimin e infrastrukturës bazë (P.44), përmirësimin e infrastrukturës rrugore (P.45), si dhe nëse ka patur ose jo përfshirje të qytetarëve në përmirësimin e shëndetit publik (P.48). (P.36–48.)

- Dyzet e nëntë për qind e sipërmarrjeve nuk ishin në dijeni të ekzistencës së strategjisë ZHEV në Lezhë, ose qenë të pasigurt. Dyzet e nëntë për qind thanë që kishin marrë informacion për strategjinë nga media, 33 për qind nga zyra e ZHEV në bashki dhe 21 për qind nga faqja e bashkisë në internet, ndërsa 37 për qind e patën marrë informacionin nga të paktën dy burime. Tre për qind patën kontribuar në strategji dhe një individ kishte kontribuar në zhvillimin dhe vënien në jetë të strategjisë dhe ishte informuar nga tërë burimet. (P.49&50.)
- Gjashtëmbëdhjetë për qind e sipërmarrjeve mendonin që ishin të informuar mirë për jetësimin e strategjisë, tre të katërtat mendonin që nuk qenë mjaftueshëm të informuar dhe tetë për qind nuk e dinin. (P.51)

## SWOT (në pyetësor)

### Pikat e forta

- Vendndodhja: afër detit; larmi toke bujqësore pjellore; në rrugën kryesore veri-jug
- Potenciali turistik
- Bukuria natyrore
- Siguria

### Pikat e dobta

- Konkurenca e pandershme
- Infrastruktura e dobët
- Investime të varfra
- Kriza ekonomike
- Politikë e pafavorshme taksimi
- Shërbime të varfra publike (elektricitet, ujë, largim mbeturinash, sistem arsimor)

### Mundësitë

- Sipërmarrjet janë në dijeni të rolit dhe funksioneve të bashkisë;
- Pritshmëritë e sipërmarrjeve përmbledhin përmirësimin e infrastrukturës, ofrimin e nxitësve taksorë, procedura të përmirësuara dhe dhënie informacioni;
- Thuajse gjysma e sipërmarrjeve sugjeruan përmirësimin e zhvillimit ekonomik të Lezhës;
- Ruajtja e përmirësimit me të njëjtin hap e klimës së sipërmarrjes (ku shumë mendonin që ndërtimi dhe turizmi kishin rritje të shpejtë).

### Rreziqet

- Ekonomia informale është një nga faktorët më kryesorë që frenojnë zgjerimin e sipërmarrjes;
- Afro gjysma e bizneseve mendojnë të mos e zgjerojnë veprimtarinë e tyre;
- Korrupsioni dhe praktikat e parregullta shihen si pengesë madhore nga afro gjysma e bizneseve në Lezhë;
- Pothuaj tërë bizneset mendojnë që konkurenca e parregulluar dhe përdorimi i pushtetit bashkiak në konkurencë të pandershme paraqesin vështirësi të mëdha për sipërmarrjen në marrëdhëniet me qeverinë vendore.

## Krahasimi mes Vëzhgimeve të Mjedisit Mundësues të Biznesit të kryer në vitet 2004 dhe 2010, dhe njohuritë për Planin Strategjik të Lezhës për Zhvillim

Ky raport krahason ndryshimet në perceptimin për mjedisin që mundëson, lehtëson ose nxit zhvillimin e sipërmarrjes në qytetin e Lezhës. Përqasja mbështetet në dy vëzhgime të njëjta të kryera në 2004 dhe 2010, ndonëse i fundit ka një seksion shtesë që jep analizën e njohurisë për Planin Strategjik për Zhvillim Ekonomik Vendor, të hartuar më 2004 dhe që ende po përditësohet. Bashkë me vëzhgimin e ndërmarrë së fundmi, ky krahasim formon një pjesë integrale të Planit të ri dhe të rishikuar Strategjik për Zhvillimin e qytetit të Lezhës.

Të dyja vëzhgimet vlerësojnë perceptimin e mjedisit të sipërmarrjes në qytet, me synim kryesor

dhënien e materialit shtesë për procesin e planifikimit të ZHEV, si dhe vlerësimin në rastin e vëzhgimit më të fundit, që ka tri funksione shtesë, për të vlerësuar sa vijon:

1) Dijenia në bashkësi për ekzistencën e Planit Strategjik

2) Efekti, nëse ka, i Planit në bashkësi

3) Çdo ndryshim që ka ndodhur në gjashtë vitet e fundit në perceptimin e mjedisit mundësues të sipërmarrjes.

Raporti i sotëm përmbledh një rrëfim dhe një tabelë që krahason përqindjet në përqindje ndaj pyetjeve të ndryshme në vëzhgim.

## Ndryshimet kryesore që kanë ndodhur

## Ndryshim në përshkrimin e sipërmarrjes

Në vitin 2010 u intervistuan 25 për qind më shumë biznese se në vitin 2004: 63 nga 50. Ndërkaq, numri i sipërmarrjeve të regjistruara në bashki u rrit me një të tretën, nga 714 në 954, me rezultatin ku, krahasuar me 7 për qind të bizneseve të intervistuara më 2004, më 2010 u intervistuan 6.6 për qind.

Kuptohet që s'mund të komentohet tani nëse vetë Plani Strategjk për ZHEV ka qenë nxitës për rritjen me një të tretën të numrit të sipërmarrjeve në bashkinë Lezhë; mund të jetë që numri i sipërmarrjeve ekzistuese është i njëjti me atë dikur, por që ato që janë regjistruar janë rritur me një të tretën. Nëse është kështu, atëherë informaliteti është pakësuar, çka mund të vijë nga shumë faktorë; këtu mund të futen edhe efektshmëria e administratës bashkiake ose nxitja që u është bërë bizneseve që të regjistrohen. Nga ana tjetër, mund të mos jetë pakësim i numrit të paliçencuar të sipërmarrjeve, por thjesht një rritje e numrit të tyre. Nëse administrata bashkiake do të kishte të dhëna për numrin e sipërmarrjeve të ligjshme, do të sillte ndihmë në identifikimin e arsyeve për rritjen e sipërmarrjeve të regjistruara.

Pavarësisht arsyes së rritjes, rezultati (rritje me një të tretën e numrit të bizneseve të regjistruara) është shenjë nxitëse, sidomos në kohëra krizash ekonomike globale.

Në të dyja vëzhgimet, shumica e sipërmarrjeve përfaqësoheshin nga pronari, ku shifra rritej nga 82 në 92 për qind; gjithsesi, kjo rritje prej 12% mund të mos jetë domethënëse nga pikëpamja statistikore dhe mund të jetë rezultat i zgjedhjes së mostrave.

Përqindja e sipërmarrjeve tregtare ra nga 46 në 33 për qind, ndërsa ajo e sipërmarrjeve të shërbimeve nuk ndryshoi, me rreth 40 për qind; përqindja e sipërmarrjeve manifakturuese u rrit nga 6 në 19 për qind, ndërsa biznesi i ndërtimit mbeti prapë 6 për qind. Këto ndryshime nuk janë të mëdha dhe mund të pasqyrojnë përzgjedhjen në vëzhgim (renditja e sipërmarrjeve që do afrohen për intervistim) sesa ndonjë ndryshim në strukturën e llojit të sipërmarrjes në Lezhë. Nëse ndryshimi në për qindje pasqyron ndryshim strukturor është interesante, me një rritje në manifakturë dhe pakësim në tregti.

Numri i sipërmarrjeve që kishin një pronar u rrit ndjeshëm, nga 12 në 89 për qind, pra shtatë herë.

Gjetjet që burojnë nga analiza e pyetjeve të mësipërme mund të tregojë një rritje të sipërmarrjeve të vogla me një pronar. Në pamje të parë kjo duket se nuk ka të ngjarë sepse të tilla biznese priren të jenë më të mëdha se tregtia dhe ofrimi i shërbimeve, që kanë ndejtur në vend apo janë tkurrur. Tjetër mundësi është që ofruesit e shërbimeve kanë ndryshuar e janë me pronar të vetëm ndonëse numri i tyre ka mbetur i njëjtë. Gjithsesi, informacioni për numrin e të punësuarve jep mbështetje për nisjen e bizneseve të mëdha të manifakturës, ku katër për qind kanë më shumë se 50 të punësuar; ndërkaq, më 2004, nuk qenë intervistuar të tilla sipërmarrje. Ç'mbetet nga struktura e punësimit të bizneseve në Lezhë nuk ka ndryshuar në gjashtë vitet e fundit. Ndryshimi në strukturën e pronësisë është tepër i madh për të qenë pasojë e përzgjedhjes së mostrave, ndonëse ndryshimi në llojin e sipërmarrjes mund të jetë pasojë e përzgjedhjes.

Nisur nga hapësira kohore prej gjashtë vjetësh mes vëzhgimeve, kohëzgjatja e bizneseve të përzgjedhura nuk ka ndryshuar: më 2004 kohëzgjatja ishte nga 1 në 12, ndërsa më 2010 ishte nga 2 në 19; më 2004, shumica ishin aktive prej 6–10 vitesh, ndërsa më 2010, shumica ishin aktive prej më shumë se 10 vitesh. Gjashtëdhjetë për qind e bizneseve të vëzhguara e kishin nisur katër vjet para vëzhgimit të parë, shenjë inkurajuese.

## Ndryshime në gjetjet për klimën e biznesit në Lezhë

Numri i sipërmarrjeve që deklaruan vështirësi në gjetjen e punëtorëve nuk ndryshoi (58% më 2004; 63% më 2010).

Njësoj si më 2004, mungesa kryesore në staf lidhej me punëtorë me aftësi teknike, të ndjekura nga aftësi për shitje dhe marketing. Gjithsesi, përqindjet për mungesa janë më shumë se dyfishi, ku tashmë rreth një e treta e të intervistuarve identifikojnë mungesa në aftësi kompjuterike dhe administrimi.

Sipërmarrjet vendore përbënin rrezikun kryesor konkurues për 60 për qind të bizneseve më 2004, ndërkohë që kjo shifër u rrit në 78 për qind më 2010; importet si rrezik kryesor ranë nga 25 në 6 për qind. Sipërmarrjet kombëtare përbënin rrezik për 16 për qind të bizneseve në Lezhë.

Sa u përket faktorëve që pengonin zgjerimin e aktivitetit, kishte shumë pak ndryshime nga 2004 në 2010. Në vëzhgimin e mëparshëm, përkatësisht 36 dhe 22 për qind fajësonin konkurencën e padrejtë dhe taksat e larta, ndërsa këto shifra tashmë kanë rënë lehtë përkatësisht në 30 dhe 14 për qind; ndërkaq, fuqia e ulët blerëse (që lidhet ndër të tjera edhe me krizën ekonomike) që shkon për të parën herë 34 për qind, ndërsa infrastruktura e varfër, nga 34 për qind më 2004, ra në gjashtë për qind më 2010.

Shenja të mira vërehen në numrin e ditëve që nevojiten për të përtëritur një liçencë biznesi. Më 2004, 60 për qind e bizneseve kërkonin më pak se dhjetë ditë dhe më 2010, kjo shifër ishte rritur lehtë në 64 për qind. Po ashtu, më 2010, 67 për qind e sipërmarrjeve e vlerësonin të pranueshme kohën, dhe vetëm 24 për qind e çmonin tepër të gjatë. Prapëseprapë, dhjetë për qind e bizneseve kërkonin deri në një muaj, ndërsa tetë për qind deri në dy muaj, për të përtëritur liçencën.

Sa u përket vështirësive që ekzistojnë mes qeverisë vendore dhe sipërmarrjeve në Lezhë, më 2004, lista kryesohej nga ndryshimet e shpeshta të rregullave dhe rregulloreve (56% e shihnin

si problem serioz ose madhor), ndjekur nga korrupsioni dhe praktikat e paligjshme (50%) dhe kosto të paparashikuara dhe të tepërta, dhe konkurencë informale e parregulluar (48% secila). Gjashtë vjet më vonë kjo gjendje nuk ka ndryshuar shumë ku çështja e dytë është rritur me 56 për qind dhe konkurenca e parregulluar informale ka rënë lehtë nga 48 në 44 për qind. Vendi i kostove të paparashikuara dhe të tepërta u zu nga përdorimi i pushtetit të bashkisë në konkurencën e padrejtë, ndërsa ndryshimet e shpeshta të rregulloreve nuk qe më problem për shumicën e sipërmarrësve në vitin 2010.

Ndërsa më 2004, 80 për qind e bizneseve ishin inspektuar deri më pesë herë nga zyra e taksave, më 2010 kjo shifër kishte rënë me 50 për qind. Gjithsesi, numri i të gjobiturve u rrit, nga katër në dhjetë për qind, ndonëse në asnjë vit ndonjë biznes nuk pohoi të kishte dhënë mitë. Për mirë duket që numri i sipërmarrjeve të cilat qenë vizituar nga policia bashkiake kishte rënë nga 80 në 33 për qind.

Këndvështrimi për mjedisin e biznesit nuk pati ndryshime. Më 2004, 52 për qind e bizneseve mendonin që ishte përmirësuar krahasuar me tre vitet e mëparshme, ndërkohë që gjashtë vite më vonë shifra njohu rritje të lehtë, në 59 për qind.

### *Ndryshime në pritshmëritë e sipërmarrësve*

Gjatë gjashtë viteve të shkuara, për qindja e sipërmarrjeve që nuk mendonin të zgjeronin veprimtarinë e tyre duket se ka ndryshuar, nga 32 në 52 për qind. Nëse përqindja e atyre që mendonin ta zgjeronin brenda bashkisë kishte rënë, nga 48 në 27 për qind, për qindja e atyre që mendonin të zgjeronin veprimtarinë jashtë bashkisë njohu rritje në 21 për qind.

Ndërkohë që përqindja e bizneseve që prisnin që bashkia të përmirësonte mjedisin duke pakësuar taksat dhe përmirësuar infrastrukturën ra ndjeshëm (përkatësisht nga 44 në 24%, dhe nga 26 në 13%), pritshmëritë që do mund të luftonte konkurencën e padrejtë u rritën disi, nga 30 për qind në 37 për qind.

### *Ndryshime në njohuritë që bizneset kanë për funksionet e bashkisë*

U vunë re ndryshime në lidhje me dijeninë për funksionet e bashkisë; për qindja e bizneseve që s'e dinin për rolin apo funksionin e zyrës ZHEV dhe ZHER u rrit përkatësisht nga 44 në 56 për qind dhe nga 44 në 61 për qind. Mungesa e dijenisë për funksionin e shërbimeve private profesionale, 2 për qind në vitin 2004, nuk u vu re më 2010, ndërkohë që mungesa e dijenisë për shoqatat profesionale ra nga 76 në 33 për qind. Ndërkaq, përqindja e atyre që nuk e dinin për rolin e shoqatave të biznesit, organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve u regjistrua për të parën herë më 2010 (përkatësisht 33, 40 dhe 40%).

Ndonëse më 2004, 70 biznese nuk tregonin ndonjë zyrë që merrej me zhvillimin ekonomik, më 2010, 25 për qind tregonin zyrën ZHEV dhe 14 për qind zyrën e taksave dhe të financës.

Krahasimi mes treguesve të perceptimit të mjedisit mundësues për biznesin në Lezhë më 2004 dhe 2010.

| Çështja | | P. Nr | 2004 | 2010 |
|---|---|---|---|---|
| Përshkrimi i sipërmarrjes | | | | |
| Numri i sipërmarrjeve në bashki | | | 714 | 954 |
| Numri i sipërmarrjeve të intervistuara | | | 50 (7.0%) | 63 (6.6%) |
| | | | % | % |
| Intervistues | | 1 | | |
| | Pronar | | 82 | 92 |
| | Administrator | | 4 | |
| | Administrator kryesor | | 14 | 8 |
| Lloji i sipërmarrjes | | 2 | | |
| | Tregti | | 46 | 33 |
| | Shërbime | | 42 | 40 |
| | Manifakturë | | 6 | 19 |
| | Ndërtim | | 6 | 6 |
| | Bujqësi | | | |
| Pronësia | | 3 | | |
| | Vetëm | | 12 | 89 |
| | Kooperativë | | | |
| | Ndërmarrje publike | | | |
| | > 1 pronar | | 88 | |
| Kohëzgjatja e aktivitetit (vite) | | 5 | | |
| | Kohëzgjatja | | 1–12 vj | 2–19 vj |
| | Shumica nga | | 6–10 vj | ≥10 vj |
| | ≥10 | | | 60% |
| Pjesë e veprimtarisë brenda qytetit | | 6 | | 98 |
| | >3/4 | | | 70 |
| | 3/4>1/2 | | | 19 |
| | 1/2>1/4 | | | 8 |
| | ≤1/4 | | | 3 |
| Pjesë e veprimtarisë brenda qarkut por jashtë qytetit | | 6 | | 14 |
| | >3/4 | | | |
| | 3/4>1/2 | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 1/2>1/4 | | | 14 |
| | ≤1/4 | | | |
| Pjesë e aktivitetit brenda Shqipërisë por jashtë qarkut | | 6 | | 10 |
| | >3/4 | | | |
| | 3/4>1/2 | | | |
| | 1/2>1/4 | | | 2 |
| | ≤1/4 | | | 8 |
| Pjesë e aktivitetit jashtë Shqipërisë | | 6 | | 2 |
| | >3/4 | | | 2 (>90%) |
| | 3/4>1/2 | | | |
| | 1/2>1/4 | | | |
| | ≤1/4 | | | |
| Numri i të punësuarve | | 7 | | |
| | >200 | | | 2 |
| | 51–200 | | | 2 |
| | 11–50 | | 6 | 6 |
| | 6–10 | | 14 | 13 |
| | 1–5 | | 80 | 78 |
| Gjetjet kryesore për klimën e sipërmarrjes në Lezhë | | | | |
| Vështirësi në gjetjen e punëtorëve | | 9 | | |
| | Po | | 58 | 63 |
| | Jo | | 34 | 29 |
| Aftësi që i kërkohen stafit | | 10 | | |
| | Shitje & marketing + administrim | | | |
| | Shitje & marketing | | 16 | 40 |
| | Aftësi teknike | | 22 | 51 |
| | Administrim | | | 32 |
| | Kontabilitet | | | 17 |
| | Kompjuter | | | 32 |
| | Shërbime | | | 21 |
| | Financë, buxhetim | | | Pak |
| | Përvojë | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Staf i trajnuar | | | 2 |
| Burimi i konkurencës | 11 | | |
| Sipërmarrjet vendore | | 60 | 78 |
| Sipërmarrjet kombëtare | | | 16 |
| Importet | | 25 | 6 |
| A mund të ndihmojnë biznesin shoqatat e biznesit | 12 | S’janë | |
| Po | | 33 | 70 |
| Jo | | | 25 |
| Tregoni një shoqatë biznesi | 13 | | |
| CoC | | | 21 |
| Tjetër | | | 12 |
| ‘asnjë’ | | | 13 |
| Nuk e dinin ose s’u përgjigjën | | | 47 |
| Faktor që pengon zgjerimin e biznesit | 15 | | |
| Konkurenca e padrejtë | | 36 | 30 |
| Konkurenca | | | |
| Shumë sipërmarrje të njëjta | | | |
| Taksa të larta | | 22 | 14 |
| Mungesa e kapitalit | | | |
| Kriza e sotme ekonomike, fuqi e ulët blerëse, kostot e larta financiare | | | 34 |
| Infrastruktura e dobët | | | |
| (përf. energjinë elektrike) | | 34 | |
| Numri i ditëve për të përtëritur liçencë | 16 | | |
| ≤muaj | | | 10 |
| 1–2 muaj | | | 8 |
| ≤10 | | 60 | 64 |
| Tepër e gjatë | | | 24 |
| E pranueshme | | | 67 |
| Koha duhet të jetë ≤10 | | 90 | |
| Koha duhet të jetë ≤5 | | | 13 |
| Probleme mes biznesit dhe qeverisë vendore | 17 | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Korrupsioni & praktikat e paligjshme | | 50 | 56 |
| Kosto të paparashikuara dhe të tepërta | | 48 | |
| Konkurencë e parregulluar nga sektori informal | | 48 | 44 |
| Përdorimi i pushtetit bashk. për konkurencë të pandershme | | | 40 |
| Ndryshime të shpeshta të rregulloreve | | 56 | |
| Burokracia | | | |
| Numri i inspektimeve nga autoritetet | 20 | | |
| Zyra e taksave ≤5 herë | | 80 | 50 (1 biz., 30 herë) |
| Zyra e taksave ≤10 herë | | 8 | |
| Policia bashkiake ≤5 herë | | 80 | 33 |
| Autoriteti liçencues ≤5 herë | | | |
| Inspektime shëndetsore ≤5 herë | | | |
| Autoriteti bashkiak ≤5 herë | | | |
| Kontrolle rutinë | | | Shumica |
| Kontrolle të pranueshme | | | Shumica |
| Paguar gjobë | | 4 (taks) | 10 |
| Kujt | | | Taks |
| Shuma | | | 10–100,000 |
| Dhënë mitë | | 0 (taks) | |
| Kontrolle të pazbatueshme | | | 13, mjedisi |
| Faktorët që ndalonin rritjen e biznesit dhe të veprimeve | 21 | | |
| Infrastruktura | | | |
| Rrugët | | | 71 madh |
| Mjedise biznesi, toka | | | 48 madh |
| Akses në hekurudhë, aeroport, port | | | 72, 71, 62 jo, pa lidhje |
| Shërbimet publike | | | |
| Administrata e taksave, liçencuese | | | 81, 79 madh |
| Elektriciteti, uji, mbeturinat | | | 86, 70, 71 madh |
| Mbrojtja nga zjarri | | | 67 madh |
| Mbrojtja civile | | | 50 vogël |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Telekomunikacione | | 68 vogël |
| | Planifikimi urban | | 53 vogël |
| Cilësia e jetës | | | |
| | Niveli i taksave | | 94 madh |
| | Telekomunikimi | | 71 madh |
| | Sistemi arsimor | | 63 madh |
| | Siguria | | 73 vogël |
| | Kostot e strehimit, disponueshmëria | | 58 vogël |
| | Lehtësira argëtuese | | 61 vogël |
| | Kujdesi shëndetsor, hoteleria, mjedise konferencash | | 58–70 vogël |
| Faktorë të tjerë | | | |
| | Aksesi në financë | | 70 madh |
| | Disponueshmëria e shërbimeve mbështetëse | | 75 madh |
| | Qëndrimi i qeverisë vendore | | 84 madh |
| | Doganat dhe rregulloret për tregtinë | | 50 madh |
| | Mungesa e personelit të kualifikuar | | 71 madh |
| | Korrupsioni | | 79 madh |
| Sektori me rritje më të shpejtë | | 29 | |
| | Tregtia | | |
| | Shërbime | | |
| | Turizmi | | 11 |
| | Ndërtim | | 62 |
| Sektori i dytë me rritje më të shpejtë | | 29 | |
| | Ndërtim | | 16 |
| | Tregtia | | 14 |
| | Turizmi | | 10 |
| | Prodhimi | | |
| | Shërbime | | 30 |
| Sektori me më shumë rënie | | 30 | |
| | Ndërtimi | | |
| | Tregtia | | 30 |
| | Bujqësia | | 16 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ushqimi | | | |
| Shërbime | | | |
| Prodhimi | | | 10 |
| Tipari më tërheqës për mundësim sipërmarrjeje | 31 | | |
| Potenciali turistik | | | 19 |
| Natyra | | | 13 |
| Kultura e bashkëpunimit | | | |
| Vendndodhja gjeografike | | | 48 |
| Cilësia e lëndëve të para ose prodhimit | | | |
| Tipari i dytë më tërheqës për mundësim sipërmarrjeje | 31 | | |
| Potenciali turistik | | | 13 |
| Vendndodhja gjeografike | | | 19 |
| Natyra | | | 14 |
| Siguria | | | 10 |
| Lëndët e para | | | |
| Tipari më i keq për mundësim sipërmarrjeje | 32 | | |
| Konkurenca e padrejtë | | | 11 |
| Infrastruktura e dobët & investimet | | | 40 |
| Financim i varfër, fuqi e ulët blerëse, kriza ekonomike | | | 13 |
| Ndotja | | | |
| Korrupsioni | | | |
| Tipari i dytë më i keq për mundësim sipërmarrjeje | 32 | | |
| Fuqi e ulët blerëse dhe kriza ekonomike | | | |
| Konkurenca e padrejtë | | | 11 |
| Infrastruktura e dobët | | | 24 |
| Taksa të larta | | | |
| Administrata publike | | | 11 |
| Mjedisi i biznesit për tre vitet e kaluara | 33 | | |
| Përmirësuar | | 52 | 59 |
| Njësoj | | | |
| Përkeqësuar | | | 11 |
| Si munden ‘ata’ të përmirësojnë ZHEV | 34 | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bërë sugjerime: punësojnë më shumë, punojnë më fort, rritin shitjet, përmirësojnë mjediset | | | 41 |
| S'e dinin | | | 5 |
| Nuk u gjegjën | | | 10 |
| Keqkuptuan pyetjen: ç'mund të bëjë NJQV | | | 44 |
| Ndryshime në ekonomi për pesë vjet | 35 | | |
| Rritje e moderuar | | | 25 |
| Rritje e ngadaltë | | | 30 |
| Rënie modeste | | | 24 |
| Rënie domethënëse | | | 10 |
| Pritshmëritë e bizneseve në Lezhë | | | |
| Plan për të zgjeruar biznesin | 8 | | |
| Brenda bashkisë | | 48 | 27 |
| Jashtë bashkisë | | | 21 |
| Jashtë Shqipërisë | | | |
| Asnjë synim për zgjerim | | 32 | 52 |
| Investim në të njëjtin biznes | 14 | | |
| I njëjti | | | 51 |
| I ri | | | 16 |
| S'e di, nuk përgjigjet, 'asnjë' | | | 33 |
| Pritshmëritë kryesore | 18 | | |
| Taksa të ulura | | 44 | 24 |
| Luftë ndaj konkurencës së pandershme | | 30 | 37 |
| Procedura të përmirësuara | | | |
| Infrastrukturë e përmirësuar | | 26 | 13 |
| Pritshmëritë e rendit të dytë | 18 | | |
| Luftë ndaj konkurencës së pandershme | | | 22 |
| Taksa të ulura | | | 17 |
| Burokraci e ulët | | | |
| Infrastrukturë e përmirësuar | | | 13 |
| Ndihmesat kryesore që biznesi mund të marrë nga NJQV | 19 | | |
| Incentivë përmes politikave taksore | | | 35 |
| Infrastrukturë e përmirësuar | | | 47 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Procedura të përmirësuara | | | 15 |
| Ndihmesa të tjera që bizneset mund të marrin nga NJQV | 19 | | |
| Dhënie informacioni e përmirësuar | | | 25 |
| Incentiva përmes politikave taksore | | | |
| Infrastrukturë e përmirësuar | | | 25 |
| Ndihmesa të fundit që bizneset kërkojnë nga NJQV | 19 | | |
| Trajnim për bizneset | | | 21 |
| Njohuritë për funksionet e bashkisë | | | |
| Nuk e di rolin e zyrës ose e quaj pa lidhje | 22 | | |
| ZHEV | | 44 | 56 |
| ZHER | | 44 | 61 |
| NJQV | | | |
| Shërbime profesionale private | | 22 | |
| Shoqatat profesionale | | 76 | 33 |
| Shoqatat e sipërmarrjes | | | 33 |
| Organizata ndërkombëtare | | | 40 |
| OJF | | | 40 |
| Mbështetja e NJQV-së për biznesin vendor | 22 | | |
| Mirë, mjaft mirë | | | 54 |
| E pranueshme | | | 83 |
| Mbështetja e zyrës ZHEV për sipërmarrjen vendore | 22 | | |
| E pranueshme | | | |
| Mbështetje nga shërbimet profesionale private | 22 | | |
| Mirë, mjaft mirë | | | |
| E pranueshme | | 54 | 52 |
| Mbështetja e shoqatës së biznesit për sipërmarrjen vendore | 22 | | |
| E pranueshme | | | |
| Mbështetja e zyrës ZHER për sipërmarrjen vendore | 22 | | |
| E pranueshme | | | |
| Institucione që kanë qenë mjaft mbështetëse | 23 | | |
| Kryetari i Bashkisë | | | 67 |
| Këshilli Bashkiak | | | 49 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Zyra e bashkisë për taksat dhe financat | | | 73 |
| Drejtoria rajonale e taksave | | | 38 |
| Institucione që kanë qenë mbështetëse | 23 | | |
| Kryetari i Bashkisë | | | 84 |
| Këshilli Bashkiak | | | 70 |
| Zyra e Bashkisë për taksat dhe financat | | | 90 |
| Drejtoria rajonale e taksave | | | 63 |
| Zyra e ZHER | | | |
| Zyra e planifikimit urban | | | |
| Prefektura | | | |
| Nuk di për mbështetjen nga zyra ose e quaj pa lidhje | 23 | | |
| Zyra e ZHER | | | |
| Këshilli Bashkiak | | | |
| Zyra e planifikimit urban | | | |
| Zyra e ZHEV | | | 54 |
| Prefektura | | | 49 |
| Zyrat që kanë patur efekt pozitiv në sipërmarrje | 24 | | |
| Zyra e taksave/financës | | | 54 |
| Zyra e ZHEV ose ZHER | | | |
| Nuk e di, pa përgjigje | | | |
| 'asnjë' | | | 13 |
| Zyrat që kanë penguar zhvillimin e sipërmarrjes | 25 | | |
| Zyra e taksave/financës | | 22 | 11 |
| Drejtoria e shërbimeve | | 16 | |
| Zyra e planifikimit urban | | | |
| 'asnjë' | | | 41 |
| Nuk e di, pa përgjigje | | | 30 |
| Zyra që u mor me ZHEV | 26 | | |
| Zyra e ZHEV | | | 25 |
| 'një zyrë' në bashki | | | |
| Zyra e taksave / financës | | | 14 |
| Këshilli bashkiak | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Drejtoria e tregtisë | | | |
| Nuk e di, pa përgjigje, ‘asnjë’ | | 70 | 57 |
| Grupi më aktiv në promovimin e ZHEV | 27 | | |
| NJQV | | | 60 |
| Sipërmarrje private | | | 13 |
| PPP | | | 5 |
| Nuk e di, pa përgjigje | | | 17 |
| ZHEV, funksion i centralizuar apo decentralizuar | 28 | | |
| centralizuar (drejtori e vetme në NJQV) | | | 13 |
| Kryetari i Bashkisë | | | 14 |
| Decentralizuar | | | 25 |
| E përzier, centralizuar dhe decentralizuar | | | |
| Nuk e di | | | 38 |
| Dijenia për Planin Strategjik | | | |
| Opinion nëse janë arritur objektivat e planit | 36–48 | | |
| Shumica po | | | 38 |
| Shumica jo | | | |
| Shumica nuk e di | | | 15 |
| E dija për ekzistencën e Planit | 49, 50 | | |
| jo | | | 49 |
| Kam marrë informacion për Planin | | | 49 |
| Kontribuar në hartimin e Planit | | | 3 |
| Kontribuar në vënien në jetë të Planit | | | 3 |
| I informuar mjaftueshëm për Planin | 51 | | |
| Po | | | 16 |
| Jo | | | 75 |
| Nuk e di | | | 8 |
| Pa plotësuar | | | |

# Shtojca 3:

## Lista e anëtarëve të Këshillit të Partneritetit për Zhvillimin Strategjik të Lezhës

### I. Biznesi, Inovacioni, Punësimi, Burimet

**Arjan Barbullushi - Kordinator**

| | |
|---|---|
| 1. Agustin Marku | (Këshilli Bashkiak) |
| 2. Agron Vraja | (Këshilli Bashkiak) |
| 3. Nikoll Ndreca | (Këshilli Bashkiak) |
| 4. Liljana Dushku | (Bashkia) |
| 5. Preng Gjoka | (Bashkia) |
| 6. Ded Maluta | (Biznes) |
| 7. Taulant Pëllumbi | (Biznes) |
| 8. Gjok Nika | (Biznes) |
| 9. Margarita Trashaj | (Biznes, Arkitekte) |
| 10. Tereze Gega | (Sipërmarrje Artizanale) |
| 11. Avni Dani | (Biznes) |
| 12. Luigj Frangaj | (Drejtor Ujrave) |
| 13. Pashk Ndoci | (Drejtor Baseni) |
| 14. Besnik Lleshi | (Drejtor Pyjesh) |
| 15. Zef Maci | (Drejtor Ujësjellësi) |
| 16. Arben Betja | (Inspektoriati i Punës) |

### II. Mjedisi i Ndërtuar, Zhvillimi i Territorit Infrastruktur e Shërbimet Publike

**Arben Dodaj - Kordinator**

| | |
|---|---|
| 1. Eduart Sokoli | (Këshilli Bashkiak) |
| 2. Alban Zici | (Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik) |
| 3. Fran Tusha | (Shoqata e Ndërtuesve) |
| 4. Ded Malota | (Kompani Ndërtimi) |
| 5. Eris Bejo | (Arkitekte) |
| 6. Linda Maçi | (Qarku Lezhë) |
| 7. Bukuria Molla | (Juriste) |
| 8. Jak Gjini | (Inspektor Mjedisi) |
| 9. Ardian Laçi | (Gjimnazi Lezhë) |
| 10. Kaljana Hajdari | (Inxhinier Ndërtimi) |
| 11. Landa Preka | (Biznes) |
| 12. Xhemal Haxhia | (Prefektura) |

### III. Mjedisi Natyror, Klima dhe Biodiversiteti, Energjia e pastër

**Nikolin Prendi - Kordinator**

| | |
|---|---|
| 1. Pashk Gjidoda | (Këshilli Bashkiak) |
| 2. Vasil Martini | (Noter, Këshilli Bashkiak) |
| 3. Pjetër Lekgjoni | (Inxhinier ndërtimi) |
| 4. Ernes Marku | (Inxhinier transporti) |
| 5. Nikoll Lleshi | (Inxhinier gjelbërimi) |
| 6. Gjergj Kadeli | (Administrator i kompanisë së pastrimit) |
| 7. Gjergj Jaku | (Inxhinier kimist) |
| 8. Anton Luna | (Përgjegjës Sektori Veterinar) |
| 9. Rauf Selimi | (Shpresë për të Varfërit-OJF) |
| 10. Ndue Dragusha | (Gazetar) |
| 11. Ndue Doci | (Mjek) |

### IV. Shoqëria, Zhvillimi Njerëzor, Shëndeti e Mirëqenia, Jeta në Komunitet

**Llesh Doku - Kordinator**

| | |
|---|---|
| 1. Qazim Dushku | (Këshilli Bashkiak) |
| 2. Dava Rrusta | (Këshilli Bashkiak) |
| 3. Sander Marku | (Drejtoria e Shëndetit Publik) |
| 4. Kastriot Kodheli | (Drejtoria Rajonale e Arsimit) |
| 5. Adnan Pëllumbi | (Shtëpia e Pionerit) |
| 6. Lindita Petoku | (Përgjegjëse Zyrës Civile) |
| 7. Alma Jaku | (Qendra Ditore) |
| 8. Yllka Brahimi | (Punonjëse Sociale) |
| 9. Rexhep Vladi | (Shoqata e Veteranëve) |
| 10. Mark Koleci | (Shoqata Invalide të Lindur) |
| 11. Zef Lleshi | (Shoqata e të Verbërve) |
| 12. Mark Bilani | (Specialist Përkujdesje Shoqërore) |
| 13. Lena Pergega | (Drejtoreshë Çerdhe) |
| 14. Lindita Lleshi | (Drejtoreshë Kopshti Skënderbeg) |
| 15. Marije Pjetri | (Drejtoreshë Kopshti Besëlidhja) |
| 16. Elizabeta Gjoka | (Drejtoreshë Kopshti Gurra) |

## V. Kultura, Trashëgimia dhe Arti, Qeverisja

**Pashko Smaçi - Kordinator**

1. Bardh Dedgjonaj
2. Gjok Ndoka (Këshilli Bashkiak)
3. Arben Hajdarmataj (Drejtoria e Policisë)
4. Pashk Pervathi (Piktor)
5. Fred Stakaj (Media Lokale)
6. Ismet Zusi (Pallati Kulturës)
7. Marjana Deda (Muzeu)
8. Gjergj Shyti (Biblioteka)
9. Pjeter Lesaj (Inspektor sportesh)
10. Rudina Gjoka (Drejtoreshë Shkolla Profesionale)
11. Franga Hila (Drejtoreshë Shkolla Gjergj Kastrioti)
12. Aurora Huba (Komiteti Rinor)
13. Florinda Gjergji (Kryqi Kuq)
14. Mark Gjoka (Shega Lezhjane)
15. Bujar Berisha (Romët e Veriut)





*Aspekte nga mbledhjet e Këshillit të partneritetit për Zhvillimin Strategjik të Lezhës*

# Shtojca 4:

## Urdhër i Kryetarit të Bashksë për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm për Bashkinë Lezhë

BASHKIA LEZHE LISSUS

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LEZHË**

Bashkia; Lagja "Skenderbeg", Sheshi "Gj.Kastrioti", Lezhë - ALBANIA tel/fax: 0035521522270/22209 e-mail: mayor@lezha..org.

**URDHER**

**Nr.73. Date 26.12.2011**

PER

**NDRYSHIME NË GRUPIN KRYESOR TË PUNËS PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMITË QËNDRUESHËM PER BASHKINË LEZHË**

Mbeshtetur ne ligjin nr 8652 date 31.07.2000 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 44, pika "a" dhe "g " si dhe ne Rregulloren e Brendeshme te Aparatit te Bashkise,per te realizuar, hartimin e Strategjise se Zhvillimit te Qendrueshem per Bashkine Lezhe, ne kuader te Projektin DELTA 2:

**URDHEROJ**

Ngritjen e Grupit Kryesor te Punes per hartimin e Strategjise se Zhvillimit te Qendrueshem per Bashkine Lezhe, te perbere nga:

1. Dile Nikolla, Drejtore e Programim Zhvillimit, koordinatore per projektin DELTA
2. Frano Kulli, biznesmen, ish anetare i Keshillit Bashkiak Lezhe
3. Prek Miri, Drejtor i Finances ne Bashkine Lezhe
4. Nikolin Prendi, Drejtor i Drejtorise se Sherbimeve
5. Pashko Paloka, Kryetar i Dhomes se Tregetise, Lezhe

II. Grupit i Punes de te drejtohet nga Dile Nikolla, Drejtore e Programim Zhvillimit dhe koordinator per projektin DELTA 2.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI

VIKTOR TUSHAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKIA LEZHE

# Shtojca 5:

## Vendimi i Këshillit Bashkiak Lezhë për miratimin e Këshillit të Partneritetit për hartimin e Planit Strategjik të Bashkisë 2013-2030

BASHKIA LEZHE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Bashkia; Lagjia "Skenderbeg", sh. "Gjergj Kastrioti", Lezhë - ALBANIA tel/fax: 003552152270/ 2219 e-mail: mayor@lezha..org.

**VENDIM**

**Nr 34, Datë 03. 07.2012**

**PËR**
**MIRATIMIN E NGRITJES SË KËSSHILLIT TË PARTNERITETIT PËR ZHVILLIMIN STRATEGJIK TË QËNDRUSHËM TË BASHKISË (K-PZhSQ);**
**QËLLIMIT, ROLIT, FUNKSIONIT, PËRBERJES DHE STRUKTURES SE K-PZhSQ**
**( Shtojca 1 dhe 2)**

**Në mbështetje të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 8 pika 4 "Te drejtat e Zhvillimit Ekonomik"**, në kuadër të përpjekjeve për ushtrimin e funksionit të saj ligjor në nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik në bashki duke synuar përdorimin në mënyrë sa me efektive dhe eficente të burimeve njerëzore, natyrore, sociale,institucionale, financiare dhe fizike në dobi të krijimit të një ambienti miqësor për banorët, biznesete vizitorët.
Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas shqyrtimit me hollësi të materialit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, pas diskutimit të antarëve ;

**V E N D O S I**

**I. Të miratojë: Ngritjen e Struktures se Këshillit të Partneritetit për Zhvillimin Strategjik të Qëndrueshëm të Bashkisë ;**

**II. Qëllimin, Rolin, Funksionet, Përbërjen dhe Strukturen e Këshillit të Partneritetit për Zhvillimin Strategjik të Qëndrueshëm të Bashkisë (K-PZhSQ) -Shtojca 1**

**III. Miratohet struktura sipas Shtojces 2**

**IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.**

**V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.**

**SEKRETARI**
**GJOK CARI**

**KRYETARI**
**AGOSTIN MARKU**

# Shtojca 6:

## Vendimi i Këshillit Bashkiak Lezhë për miratimin e Matricës dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë, 2013-2030

BASHKIA LEZHE

LISSUS

REPUBLIKA E SHQIPERISE

**KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

Bashkia; Lagjia "Skenderbeg", sh. "Gjergj Kastrioti", Lezhë - ALBANIA tel/fax: 003552152270/ 2219 e-mail: mayor@lezha..org.

**VENDIM**

**Nr 63 , Datë 04. 11.2013**

**PËR**

**MIRATIMIN E PLATFORMËS DHE MATRICËN PER VIZIONIN DHE STRATEGJINË E ZHVILLIMIT TË QËNDRUSHËM TË BASHKISË LEZHË 2013-2030**

**Në mbështetje të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 8 pika 4 "Te drejtat e Zhvillimit Ekonomik"**, në kuadër të përpjekjeve për ushtrimin e funksionit të saj ligjor në nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik në bashki duke synuar përdorimin në mënyrë sa me efektive dhe efiçente të burimeve njerëzore, natyrore, sociale,institucionale, financiare dhe fizike në dobi të krijimit të një ambienti miqësor për banorët, biznesete vizitorët.

Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas shqyrtimit me hollësi të materialit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, pas diskutimit të antarëve ;

**V E N D O S I**

**I. Të miratojë: Platformës dhe Matricën per Vizionin dhe Strategjinë e Zhvillimit te Qëndrushëm të Bashkisë Lezhë 2013-2030.(Bashkëngjitur matrica)**

**II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.**

**III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.**

SEKRETARI
GJOK CARI

KRYETARI
AGOSTIN MARKU

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LEZHE

